



**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT
PROGRAMI I DOKTORATURËS
"SHKENCA EKONOMIKE"**

Disertacion

Në kërkim të gradës Doktor Shkencash

**RAPORTIMI FINANCIAR I NJËSIVE
EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME
STANDARDE KOMBËTARE APO
NDËRKOMBËTARE**

(Rast Studimi – Adoptimi i SNRF për NVM në Shqipëri)

**Udhëheqës Shkencor
Prof. Dr. Jorgji BOLLANO**

**Doktoranti
MSc. Elira HOXHA**

Durrës, 2014

© Copyright

i

Elira HOXHA

2014

**Udhëheqësi i Elira Hoxha vërteton se ky është version i miratuar
i disertacionit të mëposhtëm:**

**RAPORTIMI FINANCIAR I NJËSIVE EKONOMIKE TË
VOGLA DHE TË MESME
STANDARDE KOMBËTARE APO NDËRKOMBËTARE**

(Rast Studimi – Adoptimi i SNRF për NVM në Shqipëri)

Prof.Dr Jorgji BOLLANO

**RAPORTIMI FINANCIAR I NJËSIVE EKONOMIKE
TË VOGLA DHE MESME
STANDARDE KOMBËTARE APO NDËRKOMBËTARE**

(Rast studimi – Adoptimi i SNRF për NVM në Shqipëri)

Përgatitur nga MSc. Elira HOXHA

Disertacion i paraqitur në
Fakultetin e Biznesit
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Në përputhje të plotë
me kërkesat
për Gradën “Doktor”

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
Tetor, 2014

Dedikim!

*Ia dedikoj këtë punim njeriut që më deshi më shumë se veten e tij, mësonjësit tim që prej belbëzimeve të para, njeriut që më rriti dhe edukoi me aq dashuri dhe përkujdesje, njeriut mbiemrin e të cilit mbaj me krenari, engjëllit që nga parajsa më mbron dhe frymëzon. Në respekt dhe për nder të dashurisë atërore, ia dedikoj këtë punim babait tim të mrekulleshëm, **Besnik**.*

Mirënjohje dhe falenderime

“Askush nuk ecën vetëm rrugëve të jetës.....”.

Kjo është shprehja më kuptimplote që kam lexuar, në kontekstin e këtij punimi. Është e vërtetë se në rrugëtimin tim drejt realizimit të këtij punimi kam ecur përkrah shumë njerëzve dhe secili në statusin, mënyrën dhe mundësinë e tij më ka ndihmuar.

Gjej rastin të falenderoj nga zemra dhe t'i shpreh konsideratën dhe mirënjohjen time për ndihmën pa rezerva dhe mbështetjen sa profesionale aq dhe njerëzore, profesorit tim të nderuar, Z. Jorgji BOLLANO. Pa ndihmën e tij të paçmueshme nuk do ta kisha realizuar dot këtë punim. Mirënjohje Profesor!

I jam shumë mirënjohëse Institucionit ku punoj, Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, për aksesin që më ka mundësuar në literaturën që disponon në bibliotekën e vet si dhe për të gjitha kontaktet e nevojshme institucionale, brenda dhe jashtë vendit, që më ka vënë në dispozicion.

Dua të falenderoj në këtë punim, drejtuesit e UAMD dhe të gjithë kolegët në këtë Universitet, për besimin që më dhanë gjatë këtyre viteve se unë do t'ia dilja me sukses këtij angazhimi. Mirënjohje të veçantë për të gjithë lektorët e shkollës doktorale pranë UAMD, dijet që mora prej të cilëve jam munduar t'i vë maksimalisht në funksion të këtij punimi.

Me shumë konsideratë dua të falenderoj Prof. Kristaq Kumen, i cili në vetëdijen time është personi që zgjidhi një moment të lëkundur timin për të vazhduar përpara me këtë angazhim, dhe kjo ndodhi diku nga fundi i këtij punimi. Profesor Kume, edhe pse nuk më kish parë dhe njohur deri atë ditë në zyrën e tij, më këshilloi, më motivoi, më mbushi me besim për të vazhduar, e të gjitha këto sikur të ishim të njohur prej kohësh. Faleminderit Profesor!

Dua të falenderoj, por pa emra këtë herë sepse është e pamundur ta shkruaj atë listë të gjatë, të gjithë miqtë, të afërmit, kolegët dhe pedagogët e mi, të gjithë ata që, me durim, kohë e pakohë, më kanë dëgjuar, kundërshtuar, miratuar, këshilluar, korrigjuar, përgëzuar qoftë edhe vetëm buzëqeshur, në këto 5 vite të përpjekjes time për realizimin e këtij punimi.

Të fundit, por jo për nga rëndësia, dua të falenderoj familjen time, nënën, vëllanë dhe bashkëshortin që më kanë duruar, mbështetur dhe mbuluar me përkujdesje gjatë gjithë kësaj kohe kaq të ngarkuar për mua. Megjithatë ndjeshmërinë më të madhe e kam për tim bir i cili pa fjalë dhe gjeste pranoi në këto vite të mos i lexoja përherë një libër darkave, të mos e shëtisja shumë herë fundjavave apo dhe shumë mohime të tjera, sepse ai me zgjuarsin e kuptoi se ky angazhimi im kërkonte sakrificë. Ai e bëri me shumë kënaqësi pjesën e tij. Faleminderit Enid!

Deklaratë mbi origjinalitetin

Elira Hoxha

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruara nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam e vetëdijshme se në rast të mospërputhjeve, Këshilli i Profesorëve të UAMD-së është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me “Rregulloren e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Doktoratë) të UAMD-së, neni 33, miratuar prej Senatit Akademik të UAMD-së me Vendimin nr. _____, datë _____.

Durrës, më 02 Tetor 2014

PËRMBLEDHJE

Njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme janë motorri i ekonomisë së një vendi. Në Shqipëri, ashtu si në pjesën tjetër të Evropës, rreth 97.7% të njësive ekonomike janë të vogla dhe të mesme, duke krijuar një raport rreth 38 NVM për 1.000 banorë. Të punësuarit pranë NVM zënë rreth 78% të krahut të punës duke kontribuar kështu në përgjegjshmërinë sociale të këtyre njësive ndaj shoqërisë.

Njësitë ekonomike pavarësisht madhësisë së tyre janë të detyruara të hartojnë pasqyra financiare por seti i raportimit financiar të tyre është i ndryshëm në vende të ndryshme. Në korrik 2009, BSNK publikoi SNRF për NVM e zbatueshme nga njësitë ekonomike pa përgjegjësi publike që të hartojnë pasqyra të përgjithshme për përdorues të jashtëm të përgjithshëm.

Tema kryesore e këtij punimi është të vlerësojë përshtatshmërinë e adoptimit të SNRF për NVM në këndvështrimin nëse është vlerë e shtuar e raportimit financiar në Shqipëri duke kuptuar në të njëjtën kohë nëse janë NVM-të të gatshme dhe të interesuara për këtë adoptim.

Për t'ia arritur këtij objektivi u realizua punimi “Raportimi Financiar i Njësive Ekonomike të Vogla dhe të Mesme - Standarde Kombëtare apo Ndërkombëtare” ku si rast studimi u mor adoptimi i SNRF për NVM në Shqipëri. Në punim u integrua qasja e kërkimit cilësor, përmes intervistave me përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të NVM-ve dhe qasja e kërkimit sasior, për të kuptuar gadishmërinë e përgatitësve për të pranuar adoptimin e SNRF për NVM.

Punimi u kufizua në 40 intervista të zhvilluara me katër grupe kryesore, tre prej të cilëve ishin përdoruesit e pasqyrave financiare ndërsa grupi i katërt ishin akademikët në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Përveç intervistave u zhvillua edhe pyetësori i shpërndarë në 381 adresat e përgatitësve të pasqyrave financiare të njësive ekonomike, këto të fundit të përqëndruara brenda zonave urbane më të mëdha të Shqipërisë.

Të gjitha të dhënat empirike u analizuan kundrejt kuadrit teorik dhe përmes analizës u arrit në konkluzionet e punimit. Gjetjet empirike treguan se NVM-të nuk janë të interesuara të kalojnë drejt SNRF për NVM dhe përgatitësit nuk janë gati ta zbatojnë këtë standard. Gjithashtu përdoruesit e jashtëm nuk vlerësojnë se përmirësohen vendimet e tyre ekonomike nëse kalohet drejt SNRF për NVM. Në vlerësimin e tyre, adoptimi i SNRF për NVM, do të shoqërohej me kosto të konsiderueshme ndërkohë që përfitimet priten, nëse do të ketë, të realizohen në një periudhë afatgjatë.

Fjalë kyçe: Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Njësitë e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM), raportimi financiar në Shqipëri, Direktiva e Kontabilitetit në BE, Njësitë ekonomike të Vogla dhe të Mesme

SUMMARY

Small and medium enterprises (SMEs) are the engine of each country's economy. In Albania, as in the rest of Europe, about 97.7% of entities are small and medium enterprises, creating a ratio of about 38 SMEs per 1,000 inhabitants. Employees at SMEs account for about 78% of the labor force contributing to social responsibility of these enterprises.

Entities, regardless of their size, are required to prepare financial statements but the set of their accounting and financial reporting standards is different in each country. In July 2009, the IASB issued IFRS for SMEs applicable for entities without public interest to design general financial statements for overall external users.

The main theme of this paper is to evaluate the suitability of the adoption of IFRS for SMEs under the light of any added value of financial reporting in Albania understanding as well if SMEs are willing and interested of this obligatory adoption.

In order to achieve this objective was realized the paper "Financial Reporting of Small and Medium Enterprises - National or International Standards". For this purpose it was taken as a case study the adoption of IFRS for SMEs in Albania. In the were integrated both the qualitative research approach through interviews with key users of financial statements of SMEs and quantitative research approach as well to understand preparers' readiness to shift toward the adoption of IFRS for SMEs.

The research was limited to 40 interviews conducted with representatives of four main groups of interested parties, three of whom were users of financial statements while the fourth one was the group of academics in the field of accounting and financial reporting. Besides the interviews, the questionnaire was conducted as well, distributed to 381 addresses of preparers of financial statements in SMEs concentrated in larger urban areas of Albania.

All empirical findings were analyzed against the theoretical framework defining the conclusions reached in the paper. Empirical findings indicated that SMEs are neither interested in shifting towards IFRS for SMEs nor professionally ready to implement this standard. Also the external users do not believe that the adoption of IFRS for SMEs will improve their economic decisions. In their view, the adoption of IFRS for SMEs would be associated with significant costs while benefits are expected, if any, to be realized in the long term.

Keywords: National Accounting Standards (NAS), International Financial Reporting Standards for Small and Medium Enterprises (IFRS for SMEs), financial reporting in Albania, EU Accounting Directive, Small and Medium Enterprises

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI 1 – HYRJE	1
1.1 Hyrje.....	1
1.2 Problemi i kërkimit.....	1
1.3 Pyetja e kërkimit.....	4
1.4 Qëllimi i kërkimit.....	5
1.5 Kufizimet.....	5
1.6 Fjalorth.....	6
1.7 Renditja e kapitujve	7
KAPITULLI 2 - RISHIKIMI I LITERATURËS DHE KUADRI TEORIK.....	8
2.1 Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.....	8
2.1.1 Vështrim i përgjithshëm.....	8
2.1.2 Pasqyrat financiare dhe SNRF	11
2.1.3 Globalizimi.....	11
2.1.4 Standardet e mbështetura në parime kundrejt standardeve të mbështetura në rregulla	12
2.1.5 Kostot dhe përfitimet e SNRF.....	13
2.2 Njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme (NVM-të)	14
2.2.1 Vështrim i përgjithshëm.....	14
2.2.2 Çfarë janë njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme.....	15
2.2.2.1 <i>Dallimet në nevojat për raportim mes njësive të vogla e të mesme dhe njësive të mëdha.....</i>	17
2.2.2.2 <i>Ngjashmëritë në nevojat për raportim mes njësive të vogla e të mesme dhe njësive të mëdha.....</i>	18
2.2.3 Përdoruesit e pasqyrave financiare të mëdha vs. atyre të njësive të vogla dhe të mesme	19
2.2.4 Kostot dhe përfitimet e SNRF për NVM.....	20
2.3 SNRF për NVM-të	21
2.3.1 Vështrim i përgjithshëm	21
2.3.2 SNRF për NVM vs. standardeve lokale të kontabilitetit	22
2.3.3 Përdoruesit e pasqyrave financiare të NVM-ve.....	24
2.3.4 Një vështrim në brendësi të SNRF për NVM.....	25
2.3.5 SNRF e plota vs. SNRF për NVM	25
2.3.6 Faktorët që duhen mbajtur në konsideratë nëse shkohet drejt SNRF për NVM	27
2.3.7 Opinione lidhur me adoptimin e SNRF për NVM.....	28
2.3.7.1 <i>Pozicionimi aktual lidhur me implementimin e SNRF për NVM.....</i>	29
2.3.7.2 <i>Përdoruesit e pasqyrave financiare në këndvështrimin e standard hartuesve dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë.....</i>	30
2.3.8 Një studim i Komisionit Evropian lidhur me adoptimin e SNRF për NVM në Evropë	31
2.3.9 Qëndrime dhe fakte mbi adoptimin e SNRF për NVM në shtetet e zhvilluara Evropiane.....	32
2.4 Kuadri teorik	38

KAPITULLI 3 - METODOLOGJIA E KËRKIMIT	41
3.1 Zgjedhja e subjektit të punimit	41
3.2 Paragjykimet	42
3.3 Perspektiva.....	43
3.4 Filozofia e kërkimit	43
3.5 Qasja e kërkimit	44
3.6 Konceptimi i kërkimit	45
3.7 Strategjia e kërkimit	47
3.8 Mbledhja e të dhënave	48
3.9 Përzgjedhja e kampionit.....	50
3.10 Modeli i vendimmarrjes	52
3.11 Kriteri i cilësisë.....	53
3.12 Konsideratat etike	54
 KAPITULLI 4 - GJETJET EMPIRIKE	 55
4.1 Gjetjet empirike nga matricat krahasuese.....	55
4.1.1 Gjetjet nga matrica mes SKK-ve dhe SNRF për NVM	55
4.1.2 Gjetjet nga matrica mes SKK-ve dhe Direktivës së Kontabilitetit në BE.....	60
4.2 Gjetjet empirike nga pyetësorët.....	63
4.2.1 Profili i pjesëmarrësve në anketim përmes pyetësorit.....	63
4.2.2 Gjetjet e pyetësorëve	64
4.3 Gjetjet e intervistave me përdoruesit e informacionit financiar dhe akademikët e fushës	67
4.3.1 Gjetjet nga intervistat me analistët e kredive të bankave të nivelit të dytë	68
4.3.2 Gjetjet nga intervistat me përfaqësues tatimorë	70
4.3.3 Gjetjet nga intervistat me pronarë jo menaxherë	74
4.3.3.1 SNRF për NVM vs. SKK-ve	74
4.3.3.2 Karakteristikat e SNRF për NVM	77
4.3.3.3 Analiza kosto / përfitim e SNRF për NVM.....	79
4.3.3.4 Përgjegjësia shoqërore e njësive ekonomike.....	80
4.3.3.5 Standardet e mbështetura në parime vs. standardeve të mbështetura në rregulla.....	81
4.3.3.6 Përdoruesit e pasqyrave financiare.....	81
4.3.3.7 Statusi i zbatueshmërisë së standardeve.....	83
4.3.4 Gjetjet nga intervistat me akademikë të fushës	84
4.3.4.1 Avantazhet / disavantazhet nga adoptimi i SNRF për NVM...85	
4.3.4.2 Përshtatshmëria e kurikulave universitare me zhvillimet ndërkombëtare të raportimit financiar.....	86
4.3.4.3 Kosto e adoptimit të SNRF për NVM.....	87
 KAPITULLI 5 - ANALIZA DHE DISKUTIME	 90
5.1 Qasja e arsytimit logjik për analizën	90
5.2 Analiza edhe diskutime mbi aspektin politik	91
5.2.1 Çështjet e integritetit evropian	91

5.2.2	Nxitja e investimeve të huaja.....	92
5.2.3	Ndikimi në të ardhurat në buxhetin e shtetit	93
5.3	Analiza në aspektin teknik	95
5.3.1	Dallimet mes SKK-ve dhe SNRF për NVM.....	95
5.3.2	Dallimet mes SKK-ve dhe Direktivës së Kontabilitetit në BE.....	104
5.3.3	Përgatitja profesionale dhe gadishmëria e përgatitësve të pasqyrave financiare për të kaluar në një set të ri raportimi financiar	106
5.3.3.1	<i>Analiza e profilit të kampionit</i>	107
5.3.3.2	<i>Analiza e përgjigjeve lidhur me kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë e SKK –ve.....</i>	108
5.4	Analiza në aspektin ekonomik	117
5.4.1	Përdoruesit e pasqyrave financiare	117
5.4.1.1	<i>Analiza e përdoruesve pronarë jomenaxherë të pasqyrave Financiare</i>	117
5.4.1.2	<i>Analiza e institucioneve financiare si përdorues të pasqyrave Financiare</i>	119
5.4.1.3	<i>Analiza e intervistave me përfaqësuesit tatimorë.....</i>	121
5.4.2	Analiza kosto përfitim.....	122
5.4.3	SKK-të vs. SNRF për NVM.....	123
KAPITULLI 6 – KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME		126
6.1	Përmbledhje e përfundimeve.....	126
6.2	Konkluzioni	129
6.3	Rekomandime.....	130
6.4	Kontributi i punimit.....	131
6.5	Kërkime të mëtejshme.....	131

Lista e tabelave

Tabelë 2.1- Klasifikimi i njësive ekonomike në vendet anëtare të BE.....	16
Tabela 4.1- Përmbledhje nga matrica e dallimeve mes SKK –ve dhe Direktivës së BE-së	60
Tabela 4.2 –Pjesëmarrja në anketim sipas institucioneve financiare.....	68
Tabela 5.1 –Gjetjet kryesore të dallimeve mes SKK-ve dhe SNRF për NVM	90
Tabelë 5.2– Mesataret e përgjigjeve të sakta të ndara në tre nëngrupe.....	115
Tabelë 5.3 – Mesataret e përgjigjeve të sakta në seksionin e tretë të pyetësorit.....	116
Tabelë 5.4 - Niveli i të kuptuarit të SKK-ve nga institucionet financiare.....	119

Lista e figurave

Figurë 3.1 – Konceptimi i punimit.....	47
Figurë 3.2 – Modeli cilësor i vendimmarrjes.....	52
Figurë 5.1 – Qasja e arsytimit logjik.....	90

Lista e grafikëve

Grafiku 4.1- Përqindja e Institucioneve Financiare që raportuan se komponentët e Pasqyrave Financiare janë të dobishme	69
Grafiku 4.2- Përqindja e frekuencës së Raporteve të Kualifikuara të Audituesve	69
Grafiku 4.3- Perceptimi i bankave për të kuptuarit e SKK-ve nga klientët.....	70

Lista e anekseve

ANEKS 1 - Të dhëna statistikore për njësitë ekonomike, INSTAT 2013.....	132
ANEKS 2 - Matrica krahasuese mes SKK-ve dhe Direktivës së Kontabilitetit të BE	136
ANEKS 3 - Përmbajtja e seksioneve të SNRF për NVM	142
ANEKS 4 - Modeli i intervistës së zhvilluar me institucionet financiare.....	143
ANEKS 5 - Modeli i intervistës së zhvilluar me përfaqësuesit tatimorë.....	145
ANEKS 6 - Modeli i intervistës së zhvilluar me pronarë të njësisë ekonomike.....	147
ANEKS 7 - Modeli i intervistës së zhvilluar me Akademikët.....	149
ANEKS 8 - Rezultatet nga pyetësorët me përgatitësit e njësive ekonomike.....	150
ANEKS 9 - Matrica krahasuese mes SKK 1 & SNRF për NVM (seksionet 2, 10, 32).....	159
ANEKS 10 – Llogaritjet e pyetësorit për seksionin e III të pyetjeve.....	166

KAPITULLI 1 - HYRJE

1.1 Hyrje

Njësitë e vogla dhe të mesme luajnë një rol jetësor në ekonominë e një vendi. Rritja e tyre sjell efekte pozitive në ekonominë e përgjithshme. Ashtu si në vende të tjera të Evropës edhe në Shqipëri, njësitë e vogla dhe të mesme përfaqësojnë 97.7% të njësive të regjistruara në QKR dhe nisur nga shifra e tyre e afarizmit i ndajmë në njësi mikro, të vogla dhe të mesme. Për klasifikimin e tyre i referohemi Ligjit Nr 10042, datë 06.12.2008 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” ndërsa përsa i përket raportimit financiar të këtyre njësive i referohemi Ligjit nr 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Në Evropë, njësitë mikro, të vogla dhe të mesme rregullohen nga standardet lokale të secilit vend. Po kështu edhe në Shqipëri, me përjashtim të sektorit bankar, atij të sigurimeve, filialeve të njësive të listuara dhe njësitë ekonomike shumë të mëdha, të gjitha njësitë e tjera zbatojnë standardet kombëtare të kontabilitetit. Organizmi rregullator i kontabilitetit në Shqipëri është Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit i cili me ligj ka detyrën e hartimit të standardeve kombëtare të kontabilitetit.

Si rezultat i diskutimeve të BSNK¹, për setin e standardeve të kontabilitetit, të aplikueshme në të gjithë botën, për njësitë ekonomike që nuk kanë përgjegjësi publike, u hartua një standard i veçantë. Standardi Ndërkombëtar për Raportimin Financiar të Njësive të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM) u publikua në 9 korrik të vitit 2009. Sipas Ian Ball, Drejtorit Ekzekutiv të IFAC, “Ky standard global i kontabilitetit është një hap shumë i rëndësishëm në rrugën e konvergencës globale të praktikave të raportimit financiar të NVM-ve. Ky standard do të kontribuojë në rritjen e cilësisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare të NVM-ve kudo që janë nëpër botë dhe do t’u mundësojë këtyre njësive ekonomike akses më të mirë në financimet ndërkombëtare”.

Ky standard është i vlefshëm gjithashtu edhe për të gjithë përdoruesit e pasqyrave financiare të këtyre njësive ekonomike. Sipas Sylvie Voghel, drejtuesi i Komitetit të Praktikave të Njësive të Vogla dhe të Mesme, “Ky standard është një zhvillim shumë i rëndësishëm; megjithatë hartimi dhe publikimi i tij nuk është fundi i historisë, por vetëm kapitulli i hapjes.” (IFAC², 2010)

1.2 Problemi i kërkimit

Njësitë ekonomike, pavarësisht madhësisë së tyre, janë të detyruara, në respektim të ligjeve të vendeve të tyre të përgatisin pasqyra financiare në përputhje me kuadrin e raportimit financiar të miratuar në vendin e tyre.

Prej kohësh ka vazhduar debati për krijimin ose jo të një seti të vetëm standardesh për çdo njësi ekonomike pavarësisht madhësisë. Dhe këto debate e

¹ BSNK – Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, Londër

² IFAC – Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve

drejtuan BSNK të marrë një vendim mbi çështjen e krijimit të një Standardi Ndërkombëtar Kontabiliteti për njësi të ndryshme ekonomike sipas madhësisë së tyre (Pactor, p.31). Në vitet '90 hidhet propozimi i hartimit të një standardi të veçantë për njësitë e vogla dhe të mesme me argumentin se përdoruesit e këtyre pasqyrave ishin të ndryshëm nga përdoruesit e pasqyrave financiare të njësive ekonomike me përgjegjësi publike (Rundfelt, 2007, p.1).

Në vitin 2001, BSNK formalisht filloi projektin e hartimit të standardit të njësive të vogla dhe të mesme duke mbajtur në fokus ekonomitë e vendeve në zhvillim. Në vitin 2004, u hodh për diskutim një material me titull “Këndvështrimet paraprake mbi kontabilitetin e njësive të vogla dhe të mesme”. Për këtë material për diskutim mbërritën komente nga e gjithë bota dhe në fakt sugjerimet ishin gjerësisht të orientuara në çështjet themelore të çdo standardi kontabël, si njohja, matja, vlerësimi i mëpasshëm dhe paraqitja në pasqyrat financiare.

Drafti i parë i SNRF për NVM u publikua nga BSNK në shkurt 2007, me qëllimin për të ofruar një set parimesh kontabël për njësitë ekonomike jo të listuara, të mbështetura në SNRF-të e plota. Mbështetur në draftin e parë të paraqitur nga BSNK, u bënë disa teste mbi një kampion prej 116 njësish ekonomike në 20 vende të ndryshme. Në bazë të komenteve dhe rishikimeve që u bënë për draftin e paraqitur, si dhe të rezultateve të testeve, u lehtësua puna e BSNK në përmirësimin dhe thjeshtëzimin e standardit kontabël për NVM-të dhe në korrik të vitit 2009, BSNK publikoi SNRF për NVM (BSNK, 2009, p. 6-12).

Në publikimet e bëra nga BSNK, njësitë e vogla dhe të mesme janë ato njësi të cilat nuk kanë përgjegjësi publike, pra publikojnë pasqyra financiare me qëllim të përgjithshëm për përdoruesit e tyre të jashtëm. Këta përdorues të jashtëm janë *pronarët jo menaxherë, kreditorët aktualë dhe të mundshëm si dhe agjensitë e ndryshme të kreditimit të tyre*. SNRF për NVM nuk mund të përdoret nga njësi me përgjegjësi publike për shkak të aplikimit të kufizuar dhe thjeshtuar, hartuar posaçërisht vetëm për njësitë e vogla dhe të mesme. Filialet e një njësie të madhe ekonomike nuk u ndalohet të zbatojnë SNRF për NVM, nëse ato vetë nuk kanë përgjegjësi publike. Pasqyrat financiare të NVM-ve u ofrojnë përdoruesve të tyre informacion mbi pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e parasë. Një pjesë e mirë e përdoruesve të këtyre pasqyrave mbështeten në informacionin që japin këto pasqyra kur bëhet fjalë për vendimet e tyre të ardhshme ekonomike (BSNK, 2009, p. 10-11).

Në Shqipëri, ashtu si në pjesën tjetër të Evropës, rreth 97.7% të njësive ekonomike janë të vogla dhe të mesme, duke krijuar një raport rreth 38³ NVM për 1.000 banorë. Të punësuarit pranë NVM zënë rreth 78% të krahut të punës duke kontribuar kështu në përgjegjshmërinë sociale të këtyre njësive ndaj shoqërisë.

Duke parë peshën e këtyre njësive ekonomike në ekonominë e vendit tonë, në fillim të viteve 2000, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, me asistencën e Bankës Botërore që financoi reformën e kontabilitetit në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Price Waterhouse Coopers, ndërmorën inisiativën për hartimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit. Këto standarde ishin një variant shumë i thjeshtuar i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Ligji i ri “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, hyri në fuqi në 29.04.2004 ndërsa neni 4 i tij, i cili i bënte këto standarde të detyrueshme për zbatim, hyri në fuqi në 1 Janar 2008. Ky nen parashikonte

³ <http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx> (Sipas INSTAT në vitin 2013 popullsia mesatare vjetore në Shqipëri është 2.897.365 banorë ndërsa numri i NVM është 111.083)

katëgORIZIMIN E NJËSIVE EKONOMIKE SIPAS SETIT TË DETYRUESHËM TË STANDARDEVE KONTABËL TË ZBATUESHME NË HARTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE.

Neni 4 i ligjit për kontabilitetin, i ndryshuar me Ligjin 10110, datë 02.04.2009 “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, parashikon tre nivele të zbatueshmërisë së standardeve:

1. Në nivelin e parë përfshihen njësitë ekonomike të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) të plota. Këto janë njësi ekonomike të listuara dhe me interes publik si bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e sigurimeve dhe risigurimeve, fondet e letrave me vlerë edhe kur ato nuk janë listuar në një bursë zyrtare të letrave me vlerë gjithashtu edhe njësitë e tjera ekonomike të mëdha, të pa listuara kur ato kanë realizuar dy vitet e fundit njëkohësisht dy kritere:

- a) Të ardhura vjetore mbi 1.250 milion lekë;
- b) Numrin mesatar të punonjësve mbi 100 persona

2. Në nivelin e dytë përfshihen të gjitha njësitë ekonomike të cilat nuk zbatojnë SNRF-të e plota por zbatojnë 14 standardet kombëtare të kontabilitetit (SKK), të cilat janë hartuar në koherencë me SNRF-të e plota;

3. Në nivelin e tretë përfshihen mikronjësitë të cilat raportojnë mbi bazën e një SKK-je të veçantë të emërtuar SKK 15 “Mbi parimet e kontabilitetit dhe raportimit financiar nga mikronjësitë”.

Ligji “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, për caktimin e kufijve të xhiros, aktiveve apo numrit të të punësuarve, iu referua Ligjit “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar (Ligj Nr. 10042, datë 22.12.2008). Ky ligj, në nenin 4 të tij, ka përcaktuar kufijtë për klasifikimin e njësive ekonomike të cilët janë si më poshtë:

- Ndërmarrjet, në kuptim të këtij ligji, klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme;
- Kategoria e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM) përfshin ato ndërmarrje, ku punësohen më pak se 250 veta dhe që realizojnë një shifër afarizmi dhe/ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë;
- Ndërmarrje e vogël quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 50 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor, jo më të madh se 50 milionë lekë;
- Mikrondërmarrje quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 10 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor, jo më të madh se 10 milionë lekë.

Referuar klasifikimit të mësipërm janë hartuar 14 standarde kombëtare të kontabilitetit për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme dhe një standard tjetër i veçantë për njësitë ekonomike të klasifikuara mikro. SKK-të (1-14) u ndërtuan në koherencë me standardet e plota ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar. SKK 15, i cili u publikua një vit më vonë se 14 SKK-të e tjera, u konceptua si një variant tepër i thjeshtuar tashmë i SKK-ve.

Sjell dhe një herë në vëmendje se vetë Bordi i Londrës mori vendimin t’ia lehtësojë barrën raportuese NVM-ve duke thjeshtuar SNK / SNRF-të e plota në një variant të përshtatshëm për NVM. Në këtë kuadër, po t’i referohemi aktualitetit shqiptar sot, ku treguesit e zhvillimit të tregjeve, bizneseve dhe lëvizjes së lirë të kapitaleve janë tepër modestë krahasuar me treguesit e vendeve të tjera në Evropë,

është një hap i domosdoshëm rishikimi i kuadrit të raportimit financiar të njësive të vogla dhe të mesme. Por problemi qëndron në faktin se duhet marrë një vendim i rëndësishëm; *të mbajmë dhe të përmirësojmë standardet tona kombëtare apo të adoptojmë SNRF për NVM, ashtu si udhëzohet dhe rekomandohet nga disa organizma dhe institucione ndërkombëtare.*

1.3 Pyetja e kërkimit

Sot, në vende të ndryshme të botës, është një çështje shumë aktuale, ajo e adoptimit të SNRF për NVM. Duke qenë se standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar për njësitë e vogla dhe të mesme nuk janë të detyrueshme për t'u zbatuar, por nga ana tjetër shumë të vlefshme, për disa arsye që do të paraqiten në kapitullin e kuadrit teorik, është një sfidë argumentimi teorik dhe praktik i të gjitha pikëpyetjeve që mund të ngrihen lidhur me dobishmërinë dhe përfitueshmërinë e adoptimit të SNRF për NVM në Shqipëri. Për t'u përballur me sfidën e argumenteve, punimin e kam konceptuar sipas një rrjedhë logjike pyetjesh të nënrenditura në funksion të pyetjes së madhe të kërkimit: ***“A është adoptimi i SNRF për NVM vlerë e shtuar për raportimin financiar në Shqipëri?”***.

Nisur nga formimi im profesional, bagazhi teorik i krijuar në kontekstin e punimit dhe bindjeve personale si një vëzhgues i jashtëm i mjedisit të biznesit, ngre pohimin⁴ e rëndësishën në këtë punim ***“Adoptimi i plotë dhe i menjëhershëm i SNRF për NVM në Shqipëri nuk është një vlerë e shtuar e raportimit financiar”***.

Pohimi do të mbështetet / kundërshtohet me të dhënat cilësore dhe sasiore të mbledhura. Në rrugën e gjatë për të mbështetur këtë pohim, në punim shtrohen disa nënpyetje që e ndajnë analizën e problemit në tre seksione të mëdha. Vlera e shtuar e raportimit financiar vlerësohet në tre aspekte: aspektin politik, aspektin teknik dhe në aspektin ekonomik.

Kur i referohem *aspektit politik*, nënkuptoj faktin se a do të merrej ky vendim për adoptimin e SNRF për NVM nga politikëbërësit, të cilët kanë kriteret dhe prioritetet të tjera në gjykimin dhe vendimarrjen e tyre. Duke e parë këtë çështje lidhur ngushtë me interesat e përligjura në interes të publikut të organeve ligjvënëse, kam shtruar nënpyetjet:

- a) *Është adoptimi i SNRF për NVM një parakusht për integrimin e vendit tonë në Bashkimin Evropian?*
- b) *Nxit adoptimi i SNRF për NVM investimet e huaja në Shqipëri dhe një akses më të mirë të njësive ekonomike vendase në financimet e huaja?*
- c) *Krijohen më shumë të ardhura në arkën e shtetit (tatime dhe taksa) nga raportimi me SNRF për NVM, krahasuar me kuadrin aktual të raportimit financiar?*

Në *aspektin teknik*, e shoh problemin të lidhur me vlerën e shtuar që sjell adoptimi i SNRF për NVM duke e krahasuar atë me kuadrin aktual të raportimit financiar në Shqipëri, në nivel teknik. Për të vlerësuar këtë aspekt, kam shtruar nënpyetjet:

⁴ Në literaturën e huaj shkencore njihet si “statement thesis”

- a) A ka mes Direktivës së Kontabilitetit të BE dhe SNRF për NVM një dallim aq thelbësor sa pengon adoptimin e SNRF për NVM? (kjo pyetje bëhet për faktin se vendi ynë, si vend kandidat për hyrjen në BE ka prioritet Direktivën krahasuar me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit)
- b) A ka mes SKK-ve dhe SNRF për NVM dallime aq thelbësore sa që do të kërkonin ndryshime strukturore të thella në kuadrin e raportimit në kuptim të përmirësimit të tij?
- c) A janë të gatshëm (përgatitja e tyre profesionale) përgatitësit e pasqyrave financiare të kalojnë, për një periudhë të shkurtër kohe, nga një kuadër raportimi tek një kuadër tjetër?
- d) A ka adoptimi i SNRF për NVM ndikim të drejtpërdrejtë dhe të matshëm në përmirësimin e cilësisë së vendimeve ekonomike të përdoruesve?

Në aspektin ekonomik, kam patur synimin të vlerësoj nëse adoptimi i SNRF për NVM është një vendim ekonomikisht i dobishëm për njësitë ekonomike. Pra, përmes një analize kosto përfitim, do të mund të arrij në përfundime lidhur me interesin ekonomik që kanë njësitë ekonomike dhe përdoruesit e pasqyrave financiare për të investuar në kalimin drejt SNRF për NVM. Nën pyetjet e shtruar janë:

- a) Cilat mund të jenë kostot për t'u përballur nga njësitë ekonomike në procesin e adoptimit për herë të parë të SNRF për NVM? Po kosto të vijueshme?
- b) Cilat mund të jenë kostot për t'u përballur nga përdoruesit e tjerë të pasqyrave financiare në procesin e adoptimit për herë të parë të SNRF për NVM? Po kosto të vijueshme?
- c) Cila është pritshmëria e tyre për përfitimin nga kalimi drejt SNRF për NVM?

1.4 Qëllimi i kërkimit

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të vlerësojë dobishmërinë, për mjedisin shqiptar, të adoptimit të SNRF për NVM. Në terma të analizës kosto/përfitim, si e perceptojnë njësitë e vogla dhe të mesme këtë standard dhe a do të jetë ekonomikisht i favorshëm për to zbatimi i këtij standardi në hartimin e pasqyrave financiare; A ka ndikim në cilësinë e vendimmarrjes së përdoruesve të pasqyrave financiare; Sa varion qasja e implementimit të këtij standardi në teori krahasuar me implementimin e tij në praktikën e tregut fizik; Për më tepër, ky studim do të identifikojë problemet që do të hasen nga NVM-të në Shqipëri, në procesin e adoptimit të SNRF për NVM. Në fund, studimi do të synojë të zbulojë nëse në Shqipëri është vlerë e shtuar përmirësimi i standardeve kombëtare të kontabilitetit apo adoptimi i SNRF për NVM.

1.5 Kufizimet

Ky punim ka kufizimet e tij për shkak të vështirësisë së sigurimit të të dhënave ashtu dhe të burimeve financiare. Këto kufizime janë:

- Rishikimi i literaturës në këtë studim do të kufizohet vetëm në çështjet dhe në nevojat kryesore, për të cilat kërkohet zbatimi i standardeve të kontabilitetit për NVM.

Ky studim nuk do të marrë në konsideratë detaje apo të tjera sete të standardeve kontabël;

- Nuk do të bëhet interpretim i SNRF për NVM apo i SKK-ve pasi standardet janë të vetë shpjeguara. Punimi do të kufizohet në shpjegimet e dallimeve mes tyre;
- Ky studim do të kufizohet vetëm në vlerësimin dhe diskutimin e gadishmërisë së NVM në Shqipëri lidhur me adoptimin e SNRF për NVM dhe nuk do të merret me asnjë trajtim kontabël në pasqyrat financiare të tyre;
- Ky studim do të kufizohet vetëm në vlerësimin dhe diskutimin e një numri të kufizuar pronarësh jo menaxherë por gjithësesi të njësive ekonomike me përmasa ekonomike të konsiderueshme; ndërsa përsa i përket përdoruesve banka, është mundësuar intervistimi i të 16 institucioneve bankare të nivelit të dytë që operojnë në Shqipëri dhe 5 shoqërive të lizingut;
- Për shkak të burimeve financiare, ky studim do të kufizohet vetëm në NVM në Shqipëri, dhe kryesisht do të merren si kampionë NVM-të në qytetet më të mëdha urbane. Të dhënat do të sigurohen përmes pyetësorëve dhe intervistimeve duke bërë një klasifikim në pesë grupe të të anketuarëve dhe intervistuarve: hartuesit e pasqyrave financiare të NVM-ve, bankat e nivelit të dytë, pronarët jomenaxherë⁵, përfaqësues të administratës tatimore dhe opinionet e akademikëve të fushës.

1.6 Fjalorth

International Accounting Standard Board (IASB): Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit; *(akronimi shqip BSNK)*

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK): Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit është një organizëm publik, profesional, pavarur dhe që gëzon personalitet juridik. Ky organizëm ka për detyrë të hartojë standardet kombëtare të kontabilitetit.

International Financial Reporting Standard (IFRS): Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (të cilat janë udhëzime, trajtime, rregulla, politika dhe procedura të vendosura nga BSNK për përgatitjen e pasqyrave financiare. Objektivi i këtyre standardeve ndërkombëtare është t'u mundësojë investitorëve, njësive ekonomike dhe qeverive të krahasojnë me lehtësi pasqyrat financiare; *(akronimi shqip SNRF)*

Small and Medium-Sized Entities (NVM): Njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme (të cilat ndahen në tre kategori: mikro, të vogla dhe të mesme). Këto njësi ekonomike i përgjigjen këtyre kërkesave:

- Nuk kanë përgjegjësi publike (BSNK, 2010)
- Përgatisin pasqyra financiare me qëllim të përgjithshëm për përdoruesit e jashtëm *(akronimi në shqip NVM)*

⁵ Pronarët jomenaxherë janë aksionerët e njësive ekonomike që nuk janë, direkt apo indirect, të përfshirë në menaxhimin e saj

International Financial Reporting Standard (IFRS for SME): Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (të cilat janë një set standardesh të hartuara nga BSNK për hartimin e pasqyrave financiare me qëllim të përgjithshëm dhe hartohen nga njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme, private dhe pa përgjegjësi publike; *(akronimi shqip SNRF për NVM)*

Financial Accounting Standards Board (FASB): Bordi i Standardeve të Kontabilitetit Financiar: Organizëm profesional joqeveritar, jofitimprurës, që ka si qëllim kryesor të hartojë dhe përmirësojë parimet përgjithësisht të pranueshme të kontabilitetit në interes të publikut në SHBA, *(akronimi shqip BSKF)*

1.7 Renditja e kapitujve

Kapitulli 2 (Rishikimi i literaturës dhe kuadri teorik): Ky kapitull do të përmbajë një rishikim të literaturës në bazë të së cilës do të bëhet edhe formulimi i kuadrit teorik. Në këtë kapitull do të paraqiten teori dhe qasje ekzistuese në fushën ku është përqëndruar ky punim. Megjithatë, ky kapitull nuk do të kufizohet vetëm në rishikimin e literaturës por do të shkojë përtej, duke vëzhguar praktika të vendeve të tjera evropiane, meqenëse synon justifikimin e pohimit dhe studimit empirik.

Kapitulli 3 (Metodologjia): Ky kapitull do të trajtojë metodologjinë e punimit. Në këtë kapitull do të përkufizohen dhe shpjegohen metodat dhe qasjet e përdorura në kërkim. Gjithashtu, do të diskutohen metodat për mbledhjen e të dhënave empirike me qëllim mundësimin e përgjigjes për pyetjen e kërkimit dhe përzgjedhjes së studimit.

Kapitulli 4 (Gjetjet empirike): Në këtë kapitull do të paraqiten gjetjet empirike të mbledhura nga matricat krahasuese, të anketuarit dhe të intervistuarit. Gjithashtu, mbështetur në këto të dhëna, do të bëhen analiza dhe diskutime paraprake.

Kapitulli 5 (Analiza dhe diskutime): Ky kapitull do të zgjerojë analizën e kapitullit 4, të bërë mbi të dhënat e matricave, anketave dhe intervistave apo rishikimit të literaturës. Konkluzionet dhe rekomandimet do të jenë derivat i këtyre analizave.

Kapitulli 6 (Konkluzionet dhe rekomandimet): Ky kapitull i kthehet edhe një herë problemit të kërkimit dhe objektivave të vëna për këtë studim që në fillim të punimit. Në mbështetje të tyre do të përcaktohen konkluzionet dhe rekomandimet.

KAPITULLI 2 - RISHIKIMI I LITERATURËS DHE KUADRI TEORIK

Ky kapitull do të mbështetet në rishikimin e teorive të sotme dhe të mëparshme që kanë të bëjnë me fushën e kërkimit që unë kam zgjedhur dhe me kuadrin teorik mbi të cilin do të mbështetet ose kundërshtohet pohimi i kërkimit. Rishikimi i literaturës ndihmon kërkuesin të kuptojë dhe fitojë dije të saktë mbi teoritë ekzistuese, ide të mundshme mbi subjektin e kërkimit si dhe njohuri mbi qëndrueshmërinë dhe implikimet në fushën e kërkimit.

Rishikimi i literaturës në këtë kapitull është i ndarë në tre seksione. Seksioni i parë ka të bëjë me teorinë lidhur me SNK / SNRF-të, seksioni i dytë me teorinë lidhur me NVM-të dhe seksioni i fundit ka të bëjë me SNRF për NVM-të.

Ndërsa kuadri teorik është i fokusuar në gjetjet teorike lidhur me përdoruesit e informacionit financiar, lidhjen mes cilësisë së raportimit financiar dhe cilësisë së vendimeve të njësive ekonomike, lidhjen e drejtpërdrejtë të krahasueshmërisë së pasqyrave financiare me aksesin në financimet vendase dhe të huaja si dhe rëndësinë që ka transparenca e informacionit financiar në stabilitetin e tregut dhe ekonomisë së një vendi.

2.1 Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

2.1.1 Vështrim i përgjithshëm

Kuadri konceptual për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare hartuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), përcakton se objektivi i pasqyrave financiare është t'u japë një game të gjerë përdoruesish, informacion rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe flukseve të parasë të njësisë ekonomike. Ky informacion që japin pasqyrat financiare i ndihmon përdoruesit e tij të marrin vendime ekonomike më të shëndetshme (Epstein & Jermakowicz, 2010, p. 10-11).

Fillimisht rregullimet lidhur me raportimin financiar kanë qenë me karakter lokal, pra çdo vend kishte rregullimin e tij duke siguruar kështu që të gjitha njësitë ekonomike të paraqisnin pasqyrat e tyre financiare në një mënyrë të përcaktuar e cila ndër të tjera siguronte edhe krahasueshmërinë mes pasqyrave të njësive ekonomike në secilin vend. Ndërsa më vonë, në epokën e paqes dhe të tendencës drejt globalizimit, u paraqit ndjeshëm nevoja për një krahasim në shkallë ndërkombëtare të pasqyrave financiare.

Me qëllim që të zbutej, apo më mirë akoma, të shuhej diferenca në raportimin financiar të njësive ekonomike në vende të ndryshme, nga organizma ndërkombëtarë si BSKF dhe BSNK, në cilësinë e hartuesve ndërkombëtarë, u hartuan Standardet Përgjithësisht të Pranuara të Kontabilitetit, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (Elliott B. & Elliott J., 2002, p. 3-4).

SNRF-të janë konsideruar nga ekspertët dhe profesionistët si një përfshirje e parimeve të përgjithshme të kontabilitetit, vlerësimit të elementeve të pasqyrave financiare dhe teknikave të raportimit financiar (Chorafas D., 2006, p. 6). SNRF-të si një set standardesh të mbështetura në parime, përmbledhin një sërë parimesh të gjera si parimet e njohjes, të matjes, të çregjistrimit, të paraqitjes në pasqyra dhe të shënimeve shpjeguese. Këto parime derivojnë nga kuadri konceptual dhe janë subjekt i gjyqimit profesional gjatë aplikimit të tyre në skenarë të ndryshëm të biznesit (Nicoleta, Victoria & Mariana, 2009, p. 1125-1126).

E kundërta ndodh me parimet përgjithësisht të pranura të kontabilitetit (PPPK) në SHBA, pasi ato janë standarde të mbështetura kryesisht në rregulla, edhe pse në pjesën më të madhe ndajnë të njëtin kuadër konceptual dhe të njëjtat parime të përgjithshme me SNRF-të e plota. SNRF-të, meqenëse mbështeten në parime, japin më pak detaje krahasuar me PPPK-të.

Më shumë se 100 vende të botës raportojnë sipas SNRF-ve. Këto standarde sot shërbejnë si një gjuhë e vetme e unifikuar e raportimit financiar të cilat mund të interpretohen me lehtësi dhe në mënyrë të arsyeshme nga përdoruesit e pasqyrave financiare (Elena, Catalina, Stefana & Niculina, 2009).

SNRF-të njohën zhvillimin më të madh të tyre në vitin 2002 kur legjislacioni i Bashkimit Evropian kërkoi në mënyrë të detyrueshme që njësitë ekonomike të listuara në Evropë, të përgatitsnin pasqyrat e tyre financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të. Ky rregullim⁶ u kërkonte rreth 8.000 njësi ekonomike në rreth 30 vende në Evropë që prej Janarit 2005, të raportonin sipas SNRF-ve të miratuara në BE.

Adoptimi i SNRF-ve në Evropë ka qenë një proces shumë kërkues pasi u ka ofruar përdoruesve të informacionit financiar raporte dhe pasqyra të një cilësie të lartë, të harmonizuara dhe të krahasueshme. Adoptimi i SNRF-ve, përveç se u ka ardhur shumë në ndihmë investitorëve dhe përdoruesve të tjerë të jashtëm, gjithashtu ka rritur efikasitetin e tregjeve dhe ka reduktuar koston e sigurimit të kapitalit. Megjithatë një set standardesh shumë i njohur dhe i pranuar në tregun global, vende të tilla si SHBA dhe Japonia akoma ngurrejnë t'i përdorin ato në përgatitjen e pasqyrave financiare. Këto dy shtete kanë bërë përpjekje të vazhdueshme përmes bordeve të tyre standard hartues dhe bordit të standardeve të Londrës për të konverguar standardet e tyre lokale të kontabilitetit me SNRF (Mirza, Holt & Orrell, 2008, p. 1-2).

2.1.2 Pasqyrat financiare dhe SNRF

Çfarë janë pasqyrat financiare dhe përse ato duhet të hartohen sipas disa standardeve të caktuara? Këto dy pyetje sillen rreth të njëjtit argument, rreth objektivitetit të pasqyrave financiare. Për përgatitjen e saktë të pasqyrave financiare respektohen dy supozime bazë; parimi i konstatimit të të drejtave dhe detyrimeve dhe parimi tjetër ai i vijimësisë së njësisë ekonomike. Parimi i konstatimit ka të bëjë me njohjen e transkacioneve kur ato ndodhin, në një rrjedhë kronologjike, shkëputur nga momenti kur mjetet monetare arkëtohen ose paguhen. Parimi i dytë, ai i vijimësisë, ka të bëjë me vazhdimësinë në një periudhë të ardhshme, të parashikuar si të arsyeshme, të

⁶ Regulation (EC) No 1606/2002 of the European Parliament and of the Council, of 19 July 2002

aktivitetit të njësisë ekonomike, ku nuk ekziston mundësia apo qëllimi për t'u likuiduar apo shkurtuar aktivitetet e biznesit të njësisë ekonomike.

Por, çka është më e rëndësishme, është cilësia e raportimit financiar, pasi një raportim financiar cilësor mbulon perspektiva të ndryshme. Kuadri konceptual i BSNK i konsideron kuptueshmërinë, rëndësinë, besueshmërinë dhe krahasueshmërinë si katër karakteristikat cilësore të nevojshme në një raportim financiar të shëndoshë (Mirza, Holt & Orrell, 2008, p. 8-9).

Pasqyrat financiare nëse janë hartuar në përputhje me SNRF-të, konsiderohet se paraqesin me vërtetësi dhe ndershmëri pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e parasë të njësisë ekonomike. Zbatimi i SNRF-ve në pasqyrat financiare siguron qëndrueshmërinë e raportimit financiar. Qëndrueshmëria nënkupton mbajtjen në mënyrë të qëndrueshme të të njëjtave parimeve të kontabilitetit dhe paraqitjes së transaksioneve ekonomike në perioda të njëpasnjëshme.

Materialiteti dhe matjet sipas parimeve të SNRF-ve përcaktojnë klasat e elementeve të pasqyrave financiare si për grupet e ngjashme të zërave material edhe të grupeve jo të ngjashme të zërave material, të cilat ndryshojnë nga natyra dhe funksionet. Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me SNRF-të mundësojnë lehtësisht krahasimin e shifrave të periudhës aktuale me atë të mëparshme. Politikat kontabël të përdorura në pasqyrat financiare duhet të përmbledhen në shënimet shpjeguese të raportimit financiar (Mirza, Holt & Orrell, 2008, p. 13-17).

Si çdo proces tjetër, edhe adoptimi i SNRF-ve kaloi fazën e diskutime pro-cons duke vendosur përballë përfitimet dhe kostot. Në një artikull që fokusohet në studimin e bërë për adoptimin e SNRF-ve në Australi, thuhet se kalimi drejt SNRF-ve ishte kosto si në kohë ashtu dhe në burime për çdo njësi ekonomike, madje më shumë nga sa pritej (Street and Jr. Needles, 2009, p. 56-57). Ky tranzicion ishte shumë i mundimshëm për disa njësi ekonomike si për shkak të nxitimit ashtu dhe si pasojë e riskut për të gabuar, por gjithashtu, u kërkoi më shumë punë dhe burime nga sa kishin planifikuar.

Kosto e implementimit të SNRF-ve përfshin koston e procesit të tranzicionit, pasi disa njësi ekonomike duke mos patur ekspertizën e mjaftueshme i drejtohen shërbimeve të jashtme të kontabilitetit dhe auditimit. Kostot e tranzicionit janë më të ulta në ato vende ku ekziston një sistem i harmonizuar i kontabilitetit dhe anasjelltas; ky përfundim është arritur nga Taylor në një rast studimor (Taylor, 2009, p. 40 & 55). Parë në këndvështrimin e përfitimeve, argumenti më i madh i dhënë ka të bëjë me cilësinë e lartë të informacionit kontabël që gjenerohet nga përdorimi i këtyre standardeve. Ndërsa në një tjetër këndvështrim, atë të vlerës së shtuar të informacionit kontabël nga përdorimi i SNRF-ve në vend të standardeve të mëparshme lokale, megjithëse nuk ka asnjë evidencë bindëse që kjo të ketë ndodhur. Taylor në studimin e tij krahasoi vlerën e shtuar të përdorimit të SNRF-ve në përgatitjen e pasqyrave me koston e tranzicionit dhe vetë krijimit të tyre, e në fund konkludoi se për shkak të kostove të larta të tranzicionit në fazat fillestare, përfitimet e siguruar ishin të papërfillshme (Taylor, 2009, p. 55).

Modelet kontabël dhe ato financiare janë mjetet ku mbështetet kontabilizimi i një njësie ekonomike dhe nga përdorimi i tyre formalizohen parimet e raportimit të brendshëm dhe të jashtëm. Modelet e raportimit të brendshëm janë disi më pak të standardizuara sesa modelet e raportimit të jashtëm për faktin se menaxherët e njësisë ekonomike nuk duan shumë transparencë në kontabilitetin e tyre. Kështu që është e nevojshme të argumentohet se bashkë me raportimin e jashtëm financiar duhen përmirësuar dhe përcaktuar edhe modelet e raportimit të brendshëm. Në krijimin dhe

formulimin e modeleve të raportimit të brendshëm i duhet dhënë prioritet pajtueshmërisë së këtyre modeleve me modelet e raportimit të jashtëm. Kjo pajtueshmëri do të sigurojë arrijtjen e një niveli të dëshiruar të transparencës me qëllim kontrollin dhe monitorimin e veprimeve dhe vendimeve të menaxherëve të njësive ekonomike. Praktikë e jashtme të raportimit financiar kur janë të harmonizuara, ofrojnë mjaftueshëm transparencë kur monitorojnë dhe kontrollojnë aktivitete të njësisë ekonomike ku ekziston mundësia e shfrytëzimit të boshllëqeve (Aras & Crowther, 2008, p. 5).

Sot, vlen të trajtohet me përparësi sfida në nivel kombëtar drejt harmonizimit me sistemin kontabël të standardizuar të përhapur në të gjithë botën. Tranzicioni i suksesshëm drejt një sistemi kontabël të standardizuar si ai i SNRF-ve, do t'i bëjë raportimet financiare nëpër botë më universale, të kuptueshme dhe transparente. Përveç impaktit që kanë në nivel njësie ekonomike, do t'u mundësojë profesionistëve kontabël të kenë një set të vetëm standardesh për të zbatuar kudo nëpër botë, gjë që mundëson dhe transferimin e lehtë të dijeve dhe ekspertizës në këtë fushë. Me qëllim që të arrihet harmonizimi i standardeve të kontabilitetit, theksi duhet vënë në eliminimin e diferencave mes standardeve të ndryshme të kontabilitetit më shumë sesa në zgjerimin e fushës së zbatimit (Aras & Crowther, 2008, p. 6).

Pajtueshmëria e njësive ekonomike me SNRF-të sjell me vete edhe elemente të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave (PSK) për vetë njësinë ekonomike. PSK është përkufizuar si angazhimi i njësisë ekonomike në përmirësimin e mirëqenies së një komuniteti përmes përdorimit diskret të praktikave të biznesit dhe kontributit me burimet e njësisë ekonomike (Kotler & Lee, 2005, p. 3). Pajtueshmëria me PSK duhet bërë në mënyrë të vullnetshme nga vetë njësitë ekonomike dhe jo të jetë një veprim i detyruar. Vetë mënyra sesi paraqitet informacioni financiar tek përdoruesit e tij në përputhje me standardet specifike të kontabilitetit është gjithashtu një lloj PSK. Njësitë ekonomike janë gati të ndërmarrin hapa vullnetar drejt PSK, por çështjet që ngrihen më së shumti në këtë rast janë ato që kanë të bëjnë me faktin se si të mbahet një ekuilibër mes nevojave dhe pritshmërive të të interesuarve, të cilat janë gjithnjë në konflikt; si të sigurohet qëndrueshmëria dhe mënyrat e raportimit tek këta të interesuar; dhe së fundmi si të justifikohet se cili aktivitet është shoqërisht më i përgjegjshëm krahasuar me një tjetër (Aras & Crowther, 2008, p. 10).

2.1.3 Globalizimi

Globalizimi ka sofistikuar mënyrat sipas të cilave kërkojnë informacion financiar përdoruesit e tij prej njësive ekonomike. Këta përdorues sot kërkojnë një pamje më të kthjellët në terma të qartësisë, krahasueshmërisë dhe lehtësisë së të kuptuarit të proceseve të një njësie ekonomike si dhe vlerësimin e performancës së njësisë në terma të raportimit financiar. Harmonizimi i kontabilitetit ndërkombëtar i mundëson njësive ekonomike të globalizuara shansin e zgjerimit të aftësisë së tyre për të siguruar kapitale në tregun ndërkombëtar. Për harmonizimin e kontabilitetit ndërkombëtar, jo gjithçka i referohet çështjeve teknike lidhur me krahasueshmërinë, por duhen marrë në konsideratë edhe argumente që kanë të bëjnë me efikasitetin e standardeve të veçanta të raportimit financiar dhe në analizën kosto – përfitim të konvergencës (Bhimani, 2008, p. 446).

Me qëllim që të zgjidhet metoda më e përshtatshme kontabël, qeveria vendos të peshojë avantazhet dhe disavantazhet e metodave të ndryshme kontabël sipas

kërkesave të tyre lokale. Bazat mbi të cilat qeveritë bëjnë krahasimin e metodave të ndryshme kontabël janë ato ekonomike, institucionale dhe kulturore; dhe mbi të njëjtët faktorë vlerësohet edhe rëndësia e SNRF-ve krahasuar me kërkesat lokale. Për vendet në zhvillim, ky krahasim dhe vlerësim u mundëson atyre të gjejnë përgjigjet për çështjet që kanë të bëjnë me shkallën e ngjashmërisë me skenarët ekonomik dhe social të vendeve të zhvilluara; përmasat e sektorit publik dhe privat dhe kushtet e zhvillimit të tregjeve të kapitalit (Tyrrall, Woodward & Almagoul, 2007, p. 86).

Diferencat kontabël mes vendeve dhe ekonomive të ndryshme, vështirësojnë punën për investitorët, huadhënësit dhe përdoruesit e tjerë të informacionit kontabël, për të kuptuar dhe krahasuar raporte të ndryshme financiare. Përfitimet e raportimit financiar global nuk mund të kufizohen vetëm në përfitimet e arritura nga ofruesit e fondeve dhe të kapitalit; njësitë ekonomike, ato që kërkojnë të gjenerojnë kapitale nga tregjet, përfitojnë në terma të reduktimit të kostove të përputhshmërisë dhe uljes së pasigurive që ndikojnë në koston e kapitalit. Implementimi i standardeve globale ka rritur qëndrueshmërinë në cilësinë e auditimit dhe nga ana tjetër ka lehtësuar trajnimin dhe edukimin për këto standarde në nivel global (IASC Foundation Education, 2009, p. 1).

2.1.4 Standardet e mbështetura në parime kundrejt standardeve të mbështetura në rregulla

Kohët e fundit ka qenë shumë i ndezur debati nëse duhen përdorur standarde të mbështetura në parime apo të mbështetura në rregulla. Standardet e mbështetura në rregulla janë përcaktuar si standardet që shprehen në mënyrë eksplicite, në terma detyrues apo të pritshëm për çështje specifike, të ndjekur më pas nga udhëzime konkrete për implementim.

Ndërsa ato të mbështetura në parime, janë standarde që i referohen më shumë të të kuptuarit bazë, që ndihmojnë arsyetimin mbi ngjarje dhe transaksione (Nelson, 2003, p. 91). Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit janë ndërtuar mbi bazën e parimeve, gjë e cila krijon dyzim të termave kur i referohesh problemeve shumë të diskutueshme, gjithnjë krahasuar me trajtimin e standardeve të mbështetura në rregulla. Dykuptueshmëria lind në standardet e mbështetura në parime kur adresohen çështje të tilla si p.sh, mbajtja e kontabilitetit, njohja apo matja.

SNK/SNRF-të, standarde të mbështetura në parime, kanë fituar një popullaritet në mbarë botën dhe përdoren nga shumë vende të botës. SNRF-të u adoptuan në Gjermani dhe Mbretërinë e Bashkuar, të cilat para SNRF-ve zbatonin sisteme kombëtare të kombinuara, të mbështetura dhe në parime dhe në rregulla. Australia dhe Zelanda e Re, vende “common law” dhe Italia me Spanjën me sisteme të “ligjit civil”, gjithashtu adoptuan SNRF-të (Carmona & Trombetta, 2008, p. 456-457).

Sistemet e mbështetura në rregulla u japin kontabilistëve udhëzime të detajuara mbi implementimin e standardeve. Elementet e pasigurisë së kontabilistit reduktohen me përdorimin e rregullave specifike e në këtë mënyrë zbatimi i këtyre rregullave bëhet një veprim mekanik. Në të kundërt me to, sistemet e bazuara në parime janë më të hapura dhe elastike, me fokus tek edukimi dhe aftësitë profesionale të kontabilistëve dhe audituesve (Carmona & Trombetta, 2008, p. 457).

Përfitimi kryesor i standardeve të mbështetura në parime është se ofrojnë për përdoruesit një udhëzues të gjerë, të përgjithshëm dhe të përdorshëm në situatë të ndryshme. Këto standarde u lejojnë kontabilistëve të ushtrojnë gjykimin e tyre profesional lidhur me thelbin e transaksionit dhe nuk ka një listë rregullash për t'u ndjekur si në rastin e standardeve të mbështetura në rregulla.

Së bashku me përfitimin e përmendur më sipër, vijnë bashkë edhe disa kompleksitete të kontabilitetit të mbështetur në parime. P.sh, ka mungesë saktësie apo mospërputhje të vogla duke qenë se përdoren nga organizata të ndryshme e që mund të kenë qëndrime apo gjykime të ndryshme. Nga një këndvështrim ligjor, kontabilistët do të preferonin një kontabilitet të mbështetur në rregulla pasi ata "nuk do të donin të bënin asnjë gjykim personal profesional kur nuk ka rregulla të shkruara për t'u ndjekur" (Shortridge & Myring, 2004).

Të vendosësh për trajtimet kontabël nuk është një detyrë e thjeshtë për kontabilistët kur zbatojnë SNRF-të për ngjarje dhe transaksione specifike që kanë të bëjnë me biznesin apo çështje ekonomike. Në këtë mënyrë, SNRF-të kërkojnë që kontabilisti të ketë një dije të mira mbi biznesin ashtu si dhe mbi ekonominë. Në përdorimin e standardeve të mbështetura në parime roli i kontabilistëve është më diskret, thënë në terma të aftësisë së tyre teknike, sëbashku me përfshirjen e disa aspekteve etike dhe ligjore.

Ndërsa roli i audituesit, kur janë zbatuar SNRF-të, nuk kufizohet vetëm në raportimin e faktit që pasqyrat janë në përputhje me një set të caktuar standardesh, pasi sistemet e bazuara në parime kërkojnë që audituesit të kenë një të kuptuar shumë të mirë të shkallës në të cilën njësia ekonomike ka zbatuar SNRF-të dhe për këtë gjë të shprehen në raportin e tyre duke dhënë një siguri të arsyeshme (Aras & Crowther, 2008, p. 458).

Sistemet kontabël të mbështetura në parime kanë ndryshuar gjithashtu strukturën organizative të njësive ekonomike përsa i përket komunikimit të tyre si dhe kanë zëvendësuar sistemin tradicional të izolimit të departamentit të kontabilitetit. Meqenëse sistemet kontabël të mbështetura në parime kërkojnë ushtrimin e gjykitit profesional atëherë bëhet i domosdoshëm komunikimi mes departamenteve të ndryshme të njësisë ekonomike (Carmona & Trombetta, 2008, p. 460).

2.1.5 Kostot dhe përfitimet e SNRF

Adoptimi i SNRF-ve në Evropë, gjeneroi debate të forta në nivele qeverish përsa i përket diskutimeve lidhur me ndryshimet e propozuara në raportim (Armstrong, Barth, Jagolinzer & Riedl, 2008). Reagimi i investitorëve të njësive ekonomike evropiane ishte pozitiv në drejtim të adoptimit të SNRF-ve nëse këto të fundit do të ofronin një raport financiar me një cilësi më të lartë, do të minimizonin asimetrinë e informacionit, do të ulnin riskun e informacionit mes njësive ekonomike dhe investitorit e për rrjedhojë të të gjitha këtyre përfitime do të mundësohej reduktimi i kostos së kapitalit.

Aplikimi i SNRF-ve ul koston e krahasimit të pasqyrave financiare të njësive ekonomike të vendeve të ndryshme duke mundësuar kështu që tregu evropian i kapitalit të bëhet global e të rriten likuiditetet. I vetmi reagim kundër i investitorëve lidhet me faktin se për shkak të dallimeve rajonale mes njësive ekonomike, mund të ulët cilësia e raportimit dhe ekziston risku që kostot e implementimit dhe tranzicionit drejt SNRF-ve të tejkalojnë përfitimet prej tyre (Armstrong, Barth, Jagolinzer &

Riedl, 2008). Në studimin e këtyre katër autorëve, njësitë ekonomike me shkallë të ulët informacioni paraprak mbi adoptimin e SNRF-ve treguan një reagim pozitiv lidhur me to nëse SNRF-të u ofrojnë investitorëve përfitime të një informacioni të qëndrueshëm. U provua gjithashtu se kishte një reagim pozitiv edhe nga ato njësi ekonomike që kishin cilësi të lartë të informacionit paraprak lidhur me adoptimin e SNRF-ve, reagim i cili e kishte bazën tek pritshmëria e investitorëve për zvogëlim të asimetrisë së informacionit. Një reagim më pak pozitiv i njësive ekonomike ndaj adoptimit të SNRF-ve u konstatua në vende të 'common law' meqenëse në vendet me standarde të dobta kontabël janë parë disa shqetësime të investitorëve.

Komisioni Evropian (KE), ka të drejtën të shpallë për zbatim standardet e hartuara nga BSNK për implementimin e tyre në Bashkimin Evropian. Në këtë mënyrë, autoriteti rregullator shkon në të njëjtën linjë me KE në rastet kur duhet pranuar ose refuzuar një standard i veçantë apo ndonjë pjesë e tij. KE i kushton vëmendje tre kritereve kur duhet të shpallë për zbatim një standard. Këto kritere janë: standardi duhet të pajtohet me parimin e raportimit të vërtetë e të sinqertë sipas BE; standardi duhet të plotësojë kriteret e kuptueshmërisë, besueshmërisë, rëndësisë dhe krahasueshmërisë; adoptimi i çdo standardi duhet të jetë në interes të publikut Evropian (Armstrong, Barth, Jagolinzer & Riedl, 2008).

2.2 Njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme (NVM-të)

2.2.1 Vështrim i përgjithshëm

Njësitë e vogla dhe të mesme janë sektori më jetësor dhe i rëndësishëm në ekonominë e një vendi (Hillary, 2000 p. 11). Ato janë shtylla e një ekonomie dhe një faktor kyç për punësimin (Erixon, 2009, p. 293). NVM-të mundësojnë dhe gjenerojnë shanse për punësim, veçanërisht në periudha recesioni; ato janë një burim kryesor i modernizimit, risive dhe shpirtit sipërmarrës; ato krijojnë lidhjet mes përpjekjeve inovative të individëve; ato krijojnë konkurrencën dhe luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e ardhshëm të bizneseve. Me pak fjalë, ekonomitë e tregut dinamike dhe të shëndetshme janë totalisht të mbështetura në njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme. Këto të fundit janë shumë jetike për forcimin e çdo vendi duke qenë se janë motorri i ekonomisë së tij (Hillary, 2000, p. 11).

Sektori i NVM-ve është shumë i madh. Në Evropë rreth 99% e të gjitha njësive ekonomike janë në kategorinë e NVM-ve, mundësojnë 2/3 e sektorit privat të punësimit, një nga 2 vendet e punës që hapen, një është nga NVM-të dhe më shumë se gjysma e prodhimit të brendshëm bruto (PBB) në BE është rezultat i aktiviteteve të NVM-ve (Tudor & Mutiu, 2008). Në Mbretërinë e Bashkuar, 99.8% e njësive ekonomike të regjistruara, janë NVM. Vende të tjera anëtare të BE, përfshirë Italinë dhe Spanjën, po t'i referohesh statistikave të vitit 1990, NVM-të zinin 99.96% të numrit të njësive ekonomike dhe norma e punësimit ishte 82.84% në Itali dhe 91.9% në Spanjë (Paoloni, Demartini, Moneva & Cuellar, 1999). Në Poloni, privatizimi i gjerë i bizneseve, i dha një rritje të shpejtë sektorit të NVM-ve të cilat aktualisht përfaqësojnë 99.8% të njësive ekonomike aktive dhe kanë punësuar më shumë se 60% të forcës së punës (Jaruga and Fijalkowska, 2004). Së fundi, Gjermania ka tradicionalisht një sektor të NVM-ve më të madh dhe më influencues se Mbretëria e

Bashkuar. Në Suedi statistikisht tregojnë se janë rreth 58 NVM për 1.000 banorë, gjë që tregon se NVM-të kanë një kontribut shumë të madh në ekonomi (Suhaib Aamir & Umar Farooq, 2010).

Dimensionet e NVM-ve janë të ngjashme në të gjitha vendet e botës por numri i tyre vjen në rritje. Ka disa faktorë që bëjnë të mundur rritjen e numrit të NVM-ve krahasuar me njësitë ekonomike të mëdha. Këta faktorë janë:

- Rritja e teknologjike dhe përparimet;
- Metodatat e prodhimit më fleksibël dhe më moderne;
- Riorganizim dhe reformatim më fleksibël;
- Reduktimi i përmasave të njësive ekonomike të mëdha dhe rënia e burimeve të tyre të jashtme;
- Rritja e sistemit franchising dhe vetëpunësimit (Hillary, 2000, p. 11).

2.2.2 Çfarë janë njësitet ekonomike të vogla dhe të mesme

Nuk ka një përkufizim të veçantë të njësive ekonomike të vogla e të mesme, kryesisht për shkak të shumëllojshmërisë së aktiviteteve që realizojnë këto njësi ekonomike. Ka mënyra të ndryshme për të përkufizuar një NVM; tregues apo aspekte kryesore do të ishin: numri i të punësuarve; totali i aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar; madhësia dhe gama e produkteve; të ardhurat; qarkullimi; tregjet; e kështu me rradhë. Sipas BSNK, njësitet e vogla dhe të mesme mund të ndahen në tre kategori: mikro, të vogla dhe të mesme. Kërkesat kryesore për njësitet ekonomike të vogla dhe të mesme janë:

- Këto njësi ekonomike nuk kanë përgjegjësi publike
- Përgatisin pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme (BSNK, 2010)

Nga përkufizimi më lart del qartë se njësitet ekonomike që kanë përgjegjësi publike janë njësitet ekonomike të orientuara nga tregjet e kapitalit dhe njësitet ekonomike që mbajnë aktive për financim për një grup të gjerë të interesuarish të jashtëm, edhe nëse këto njësi nuk janë të orientuara drejt tregjeve të kapitalit.

Kështu, NVM-të nuk janë as të listuara në bursa dhe as nuk ofrojnë shërbime financiare. NVM-ja është një sipërmarrje që ka vetëm një pjesë të vogël të tregut ku operon, menaxhohet nga pronari ose pjesërisht pronari i saj dhe nuk ka struktura menaxhuese të detajuar. Ato janë ta pavarura në procesin e vendimmarrjes (Bannock, 1981).

Një njësi ekonomike konsiderohet NVM nëse ka këto tre karakteristika:

- Menaxhim të pavarur; zakonisht pronari dhe menaxheri janë i njëjti person;
- Një individ ose një grup i vogël mund të investojë në njësinë ekonomike dhe gjithashtu ta zotërojë atë të gjithën;
- Ka një zonë të lokalizuar të aktivitetit; Si pronari ashtu dhe punonjësit i përkasin të njëjtit komunitet, por tregu jo domosdoshmërisht mund të jetë i vendosur në një komunitet të ngjashëm (Scott & Bruce, 1987).

NVM-të gjithashtu mund të përkufizohen si njësi ekonomike të cilat janë jofiliale, autonome dhe kanë një numër të kufizuar të punësuarish. Ky numër i kufizuar punonjësish është i ndryshëm në vende të ndryshme të botës. Zakonisht numri më i lartë i punonjësve është deri në 250 persona. Megjithatë për disa vende numri më i lartë është 200 persona kurse në SHBA ky numër është 500 persona. Kur një njësi ekonomike ka më pak se 50 të punësuar konsiderohet “e vogël” dhe kur ka

më pak se 10 të punësuar (në pak raste edhe 5 të punësuar) konsiderohet “mikro” (OECD, 2006, p.123). Komisioni Evropian i ndan NVM-të në tre kategori (si tregohet në tabelë):

Tabelë 2.1 Klasifikimi i njësive ekonomike në vendet anëtare të BE

Kategoritë	Nr i të punësuarve	Qarkullimi / Aktiv
Të mëdha	> 250	> € 40 mil / > € 20 mil
Të mesme	< 250	≤ € 40 mil / ≤ € 20 mil
Të vogla	< 50	≤ € 8 mil / ≤ € 4 mil
Mikro	< 10	≤ € 700 mijë / ≤ € 350 mijë
Burimi: Komisioni Evropian 2014 (Direktiva 34/2013, 26.06.2013)		

- Njësitë ekonomike mikro, quhen të tilla nëse plotësojnë 2 nga tre kriteret e përcaktuara: punësojnë më pak se 10 persona; kanë një qarkullim jo më të madh se 700 mijë euro; aktivi në pasqyrën e pozicionit financiar nuk i tejkalon 350 mijë eurot.
- Njësitë ekonomike të vogla, quhen të tilla nëse plotësojnë 2 nga tre kriteret e përcaktuara: punësojnë jo më shumë se 50 persona; kanë një qarkullim jo më të madh se 8 milion euro; aktivi në pasqyrën e pozicionit financiar nuk i tejkalon 4 milion eurot.
- Njësitë ekonomike të mesme quhen të tilla nëse plotësojnë 2 nga tre kriteret e përcaktuara: sipërmarrje që punësojnë jo më shumë se 250 persona; kanë një qarkullim jo më të madh se 40 milion euro; aktivi në pasqyrën e pozicionit financiar nuk i tejkalon 20 milion eurot.

Referuar përmasave të njësive ekonomike, në vitin 2010, një studim që mbulon disa shtete të zhvilluara evropiane jep këto të dhëna bindëse për rëndësinë e NVM-ve në ekonominë e tregut. Njësitë ekonomike me më pak se 250 persona zënë 99.8% të totalit të njësive ekonomike në Evropë, 66.9% të të punësuarve, 57% e qarkullimit dhe 58% e vlerës së shtuar.

Në po këtë vit, njësitë mikro me më pak se 10 të punësuar vlerësohet se janë 92% e totalit të njësive ekonomike, 30% të numrit të të punësuarve, 18% të qarkullimit dhe 22% të vlerës së shtuar.

Njësitë ekonomike të vogla, me më pak se 50 të punësuar zënë 97% të numrit total të njësive ekonomike, 50% të të punësuarve, 37% të qarkullimit dhe 39% të vlerës së shtuar.

Fakti që ka një ndarje mes njësive ekonomike në NVM dhe të Mëdha lidhet me faktin se kanë karakteristika të ndryshme, pa përjashtuar padiskutim dhe ngjashmëritë. Për ilustrim p.sh, menaxhimi në njësitë ekonomike të vogla ka të bëjë më shumë me krahun e punës krahasuar me njësitë ekonomike të mëdha. E kundërta është në rastin kur, njësitë ekonomike të mëdha kanë më shumë mundësi dhe aftësi për të siguruar kapital. Lippit dhe Oliver kanë përshkruar me detaje disa prej dallimeve dhe ngjashmërive:

2.2.2.1 Dallimet në nevojat për raportim mes njësive të vogla e të mesme dhe njësive të mëdha

Lippitt dhe Oliver kanë diskutuar disa prej dallimeve mes njësive të mëdha dhe të vogla “Big GAAP, Little GAAP: Financial Reporting in the small business Environment”. Sugjerimi i përcaktimit të të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyra të ndryshme, sipas përmasave të njësisë ekonomike është një nga dallimet mes njësive të mëdha dhe të vogla. Këta autorë tregojnë se në bizneset e vogla, rëndësia e investitorëve dhe e kreditorëve mund të jetë relativisht e ndryshme krahasuar me ato të biznesve të mëdha (Lippitt & Oliver, 1983, p. 57).

Nga një studim i bërë janë marrë disa përshkrime ku në fakt, shumë pak informacion duket se është thelbësor për nga natyra e që i përket NVM-ve dhe atyre të mëdha, pasi pjesa tjetër lidhet kryesisht me interesat vetjake financiare. Referuar raportimit financiar, gjejmë tre ndryshime mes NVM-ve dhe njësive ekonomike të mëdha: interesat e pronësisë në njësitë e vogla e të mesme; menaxhimi i tyre dhe të interesuarit e jashtëm si p.sh, kreditorët, furnitorët etj. (Lippitt & Oliver, 1983, p. 54).

Në këtë studim, ka mjaftueshëm shpjegime lidhur me faktin se përse pronarët e njësive të vogla e të mesme janë më pak të diversifikuar krahasuar me njësitë e mëdha. Shumica e investitorëve në njësitë e mëdha konsiderohen financiarisht të ndryshëm pasi ata reduktojnë riskun e tyre të tregut; ata priren të rrisin portofolin e tyre duke blerë aksione në njësi ekonomike të ndryshme. Prandaj, aksionerët janë kryesisht të fokusuar në atë pjesë të informacionit financiar i cili është i vlefshëm për përcaktimin e riskut të tregut për portofolin dhe më pak të interesuar për informacionin periodik rreth riskut të përgjithshëm. Nga ana tjetër, në shumicën e njësive të vogla e të mesme, kapitali është i investuar nga një person i vetëm. Çelësi i suksesit për rritjen e një njësie, sidomos asaj të vogël është një angazhim më i madh financiar i pronarit për të mbajtur kontrollin e situatës. Si rezultat, pronarët e njësive të vogla e të mesme janë më shumë të interesuar për riskun e përgjithshëm krahasuar me riskun e tregut i cili është një risk sistematik (Lippitt & Oliver, 1983, p. 54, 55).

Shumë studime kanë arritur në përfundimin se, si pasojë e vëmendjes ndaj pronësisë, tregjet e kapitalit për njësitë e mëdha janë më të “mëdha” përse i përket burimeve të financimit për njësitë e vogla e të mesme. Tregjet e “vogla” financiare janë më pak efikente dhe efektive pasi palët pjesëmarrëse mbështeten në cilindo informacion kontabël që është i mundshëm për t’u siguruar. Në njësitë e vogla e të mesme, shumica e vendimeve financiare, bazohen tek pronësia dhe për shkak të raporteve financiare jo shumë të përshtatshme, ndryshimet në këtë pronësi mund të bëhen të shpeshta (Lippitt & Oliver, 1983, p. 55).

Drejtuesit e njësive të vogla e të mesme nuk janë shumë të varur në vendimet e tyre nga informacioni financiar formal, krahasuar kjo me njësitë e mëdha, pasi në njësitë e vogla e të mesme një ose dy individë mund të monitorojnë dhe realizojnë të gjithë menaxhimin e njësisë (zakonisht vetë pronari). Pronari apo menaxheri angazhohet në shumë role dhe përgjegjësi menaxhuese duke u dhënë atyre mundësinë që të njohin pothuajse çdo aspekt të aktivitetit e në këtë mënyrë duke i bërë ata të pavarur në vendimarrje nga informacioni financiar (Lippitt & Oliver, 1983, p. 55).

Në njësitë e vogla e të mesme, pronari ose menaxheri duke qenë shumë aktiv në menaxhim ka më shumë akses dhe të drejtë të përdorë informacionin e brendshëm krahasuar me një njësi të madhe ekonomike (Lippitt & Oliver, 1983, p. 55).

Shpjegimet lidhur me vendimarrjen kontabël sugjerojnë se në përgjithësi, njësitë e vogla e të mesme ia besojnë atë një kontabilisti të miratuar, gjë që mundëson

një sinkronizim të procedurave dhe pasqyrave mes njësive të vogla e të mesme si dhe krijimin e një standardi profesional të bizneseve që ofrojnë shërbime kontabiliteti. Për pasojë, shtimi i kërkesës për auditimin e këtyre pasqyrave nuk është vlerë e shtuar (Lippitt & Oliver, 1983, p. 55).

Roli i bankave dhe i kreditorëve të tjerë afatshkurtër është shumë i rëndësishëm për njësitë e vogla e të mesme të cilat nuk e kanë të lehtë aksesin në tregjet e kapitalit. Këta dy ofrues fondesh kanë nevojë të organizojnë rregullisht informacionin e marrë nga raportimi financiar. (Lippitt & Oliver, 1983, p. 55).

Kështu, referuar të gjitha aspekteve të sqaruara më sipër arrihet në përfundimin se një pronar i njësie të vogël apo të mesme ka më shumë dijeni dhe informacion rreth attributeve të përgjithshme të menaxhimit të aktivitetit të tij dhe është racionalisht i mirëinformuar rreth industrisë ku është përqëndruar por nga ana tjetër ka shumë më pak informacion p.sh, rreth tregjeve të kapitalit dhe atyre financiare apo industrive konkurruese premtuese siç ndodh me njësitë e mëdha.

2.2.2.2 Ngjashmëritë në nevojat për raportim mes njësive të vogla e të mesme dhe njësive të mëdha

Lippitt dhe Oliver i kanë klasifikuar dallimet mes nevojave për raportim të njësive të vogla e të mesme dhe atyre të mëdha në dy kategori kryesore: *nevoja të brendshme* dhe *nevoja të jashtme* (Lippitt & Oliver, 1983, p. 55). Proceset e brendshme të bizneseve të shumicës së njësive ekonomike janë pothuajse të ngjashme dhe ato përpiqen të performojnë sa më mirë në fusha të tjera të ndryshme (prodhim, marketing, financë, kontabilitet, menaxhim, etj) me qëllim që të arrijnë objektivat e tyre strategjike dhe mbijetesën.

Përmasat e njësisë ekonomike kanë disa ndikime mbi proceset por nuk kanë asnjë ndikim në qëllimin apo kërkesat e këtyre proceseve. Informacioni i brendshëm që kërkohet në procesin e vendimmarrjes dhe atë të kontrollit të inventarëve është pothuajse i ngjashëm në të gjitha njësitë ekonomike. Kështu, bazat e të dhënave primare të të gjitha njësive janë pak a shumë njësor në të gjitha departamentet e tij. Të gjithë të dhënat kontabël që duhen për raportimin financiar dhe konsolidimin e transaksioneve me atë të njësive të tjera janë pothuaj njësor si për njësitë e vogla e të mesme ashtu dhe për ato të mëdha.

Një tjetër ngjashmëri mes kërkesave për raportim të njësive të vogla e të mesme dhe atyre të mëdha është norma e arsyeshme e kthimit mbi investimet e tyre kapitale. Investitorët në njësitë e mëdha dhe investitorët në njësitë e vogla e të mesme janë shumë të interesuar tek fitimi dhe për të fituar është shumë e rëndësishme norma e kthimit. Njësitë e vogla e të mesme nuk do të mund të menaxhonin aktivitetet e tyre dhe nuk mund të jetonin gjatë nëse norma e kthimit në investimet e tyre nuk është në përputhje me pritshmëritë e tyre (Lippitt & Oliver, 1983, p. 55, 56).

Nga ana tjetër ka dhe shumë ngjashmëri të jashtme mes njësive të vogla e të mesme dhe atyre të mëdha. Së pari, në të dyja rastet, pasqyrat financiare janë burimi kryesor i informacionit financiar për përdoruesit e jashtëm. Një tjetër gjë e përbashkët e këtyre njësive është statusi ligjor i tyre. Të drejtat dhe detyrimet ligjore për njësitë ekonomike, si të vogla e të mesme dhe atyre të mëdha, përcaktohen mbështetur në formën e tyre, jo në bazë të përmasave të tyre por me ndonjë përjashtim, bashkëpronësia është bashkëpronësi dhe korporatat janë korporata. Të gjitha njësitë

ekonomike, pavarësisht përmasave, duhet të respektojnë rregullat në fuqi për të prodhuar informacion financiar (Lippitt & Oliver, 1983, p. 56).

2.2.3 Përdoruesit e pasqyrave financiare të mëdha vs. atyre të njësive të vogla dhe të mesme

Në artikullin “New Directions of Financial Reporting within Global Accounting Standards for Small and Medium-sized Entities” nga Lungu, Caraiani and Dascalu, autorët identifikuan përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare. Ndër ata, autorët përmendin investitorët, huadhënësit, furnitorët, të punësuarit, klientët, qeveria me agjencitë e saj si dhe publiku. Në rastin e njësive të vogla e të mesme përdoruesit janë në një farë mënyre të tjerë nga ata të njësive të mëdha; bankat, drejtuesit e njësive dhe zyrat e taksave janë përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të njësive të vogla e të mesme.

Sipas një studimi të kohëve të fundit, venture capitalists⁷ janë përdoruesit e rinj të pasqyrave financiare të NVM-ve (Lungu, Caraiani, & Dascalu, 2007, p. 2). Autorët sugjerojnë se si përdorues të ndryshëm të pasqyrave financiare të NVM-ve mund të përmirësojnë dhe të shtojnë aktivitetet e tyre prej këtyre pasqyrave.

Së pari, bankat përdorin pasqyrat financiare të NVM-ve për të përcaktuar aftësinë e tyre për të kthyer huanë e marrë dhe për të matur përfitueshmërinë, sigurinë dhe aftësinë paguese. Referuar Robin Jarvis, këto pasqyra financiare janë shumë të rëndësishme për bankat në vendimmarrjen e tyre mbi huadhënien si dhe monitorimin e marrëveshjes së huasë.

Së dyti, vetë pronarët përdorin pasqyrat financiare për të përcaktuar shpërblimet, pagat dhe dividendët për të paguar. Gjithashtu, prej këtyre pasqyrave marrin informacion mbi performancën, shpenzimet kapitale, buxhetimin, planifikimin për kreditë dhe format e tjera të financimit. Pronarët i përdorin raportet financiare të NVM-ve për qëllime planifikimi, kontrolli dhe vendimmarrje (Jarvis, 2003, p. 80).

Së treti, zyra e tatim taksave është një përdorues shumë i rëndësishëm i pasqyrave të NVM-ve. Tatim taksat përdorin këto pasqyra për të llogaritur fitimin bruto, për të kontrolluar shpenzimet dhe të ardhurat, shumat e përlllogaritura të tatimit mbi fitimin si dhe për të konfirmuar raportin e auditimit (Lungu, Caraiani, & Dascalu, 2007, p. 2-3).

Nevojat e përdoruesve të informacionit financiar të NVM-ve janë të ndryshme nga ato të përdoruesve të informacionit financiar të njësive të mëdha. Për shembull, aftësia për të gjeneruar flukse pozitive të parasë, përfitueshmëria dhe likuiditeti janë më të rëndësishme dhe të përshtatshme sesa vetë vlera e njësive ekonomike në çdo moment kohe (Riistama & Vehmmanen, 2004).

Në një studim tjetër është argumentuar se rregullat e ndryshme të raportimit luajnë një rol shumë të rëndësishëm në njësitë ekonomike të listuara dhe ato të palistuar. P.sh, në një kërkim të bërë në Australi i cili u drejtohej hartuesve të pasqyrave financiare arrihej në përfundimin se 97% e të anketuarëve ishin në favor të një raportimi të ndryshëm mes këtyre njësive (Holmes, Kent, & Downey, 1991, p. 128).

⁷ Venture capitalists - Kapitalistët që i investojnë fondet e tyre në njësi ekonomike jo të listuara në bursa dhe kërkojnë një kthim shumë të lartë në investimet e tyre

Pasqyrat financiare ligjore nuk rezultojn në vlefshme në vendimmarrjen e pronarëve menaxherë të NVM-ve pasi ata nuk kishin dijeni të mjaftueshme në të kuptuarit e tyre. Ata preferojn kontabilitetin e drejtimit (kostos) dhe një pasqyrë të parashikimit të flukseve të parasë për të mundësuar vendimmarrjen. Natyrshëm u arrit në përfundimin që pasqyrat financiare nuk kanë përdorim praktik për NVM-të (John & Healeas, 2000).

Të tjerë sugjerojnë se pasqyrat financiare të njësive ekonomike të mëdha japin informacion mbi transaksione shumë të komplikuar si dhe kanë të dhëna ekstremisht gjithëpërfshirëse. Si të tilla, këto pasqyra përdoren nga një numër më i madh përdoruesish për një gamë më të gjerë vendimesh, krahasuar me pasqyrat e NVM-ve, të cilat kërkojnë për pasojë një mori shënimesh të përshtatshme shpjeguese (Harvey & Walton, 1996).

2.2.4 Kostot dhe përfitimet e SNRF për NVM

NVM-të kanë një sërë koston dhe përfitimesh prej raportimit financiar. Kostot kryesisht lidhen me përgatitjen e pasqyrave financiare. Kosto e prodhimit të pasqyrave financiare zakonisht varet nga përmasat e njësive ekonomike dhe këto kosto janë proporcionalisht më të larta për njësitë e vogla (Harvey & Walton, 1996). Përfitimet janë të lidhura me monitorimin dhe vendimmarrjen që buron nga pasqyrat financiare. Njësitë ekonomike dhe përdoruesit marrin përfitime më të mëdha nëse monitorimi dhe vendimmarrja mbi pasqyrat financiare është bërë në një mënyrë eficiente dhe efektive. Nëse përfitimet janë më të mëdha sesa kostot kjo nënkupton se rregullat dhe rregullimet e raportimit financiar janë vendosur drejt (Jarvis & Collis, 2003, p. 5).

Rregullatorët, zakonisht qeveritë, e kanë vënë theksin më shumë tek kostot që shoqërojnë pasqyrat financiare krahasuar me përfitimet prej tyre. Për shembull, në vende të ndryshme auditimi i pasqyrave financiare të NVM-ve, është konsideruar si një barrë e panevojshme për NVM-të për shkak të koston për përgatitjen e tyre.

Çdo përfitim që vjen nga auditimi i pasqyrave financiare të NVM-ve është injoruar. Kjo është arsyeja përse në shumë vende, njësitë e vogla janë përjashtuar nga detyrimi ligjor i auditimit të pasqyrave financiare.

Megjithatë, një studim i kryer në Mbretërinë e Bashkuar, provon se auditimi ligjor i pasqyrave financiare për njësitë e vogla ofron përfitime shumë të mëdha për të dyja palët, si për pronarët ashtu dhe për përdoruesit e pasqyrave financiare. Kështu, një numër i madh i pronarëve / menaxherëve të njësive të vogla do të preferojn një auditim ligjor edhe pse kjo nuk është një kërkesë ligjore. Ata qartësisht dallojnë se përfitimet nga auditimi i tejkalojnë kostot. Përfitimet jo gjithnjë janë të dukshme apo të matshme; zakonisht vërehet në numrin dhe diversitetin e përdoruesve, plotësimin e kërkesave të tyre për informacion, besueshmëria, vërtetësia dhe kohshmëria e informacionit financiar (Collis, Jarvis and Skerratt, 2001, p 41-42).

Përfitimet e SNRF për NVM nënkuptojn akses më të mirë drejt kapitaleve; institucionet financiare, kreditorët dhe *venture capitalist* duke financuar përtej kufijve, munden të menaxhojnë më mirë kapitalin e tyre. SNRF për NVM paraqet një fillim të mbarë e të sigurtë të kontabilitetit të atyre njësive ekonomike që veprojnë në më shumë se një juridiksion dhe në këtë mënyrë kostot e raportimit do të ulëshin automatikisht. Për më tepër, cilësia e raportimit financiar do të rritet me ndihmën e standardeve të raportimit financiar. Kostot e mirëmbajtjes së standardeve, në nivel

kombëtar, reduktohen dhe bëhen një mbështetje shumë e madhe për bizneset në rritje që janë gati të hyjnë në tregjet e kapitalit, aty ku kërkohet aplikimi i SNRF-ve të plota.

2.3 SNRF për NVM-të

2.3.1 Vështrim i përgjithshëm

Globalizimi, veçanërisht globalizimi ekonomik është një realitet i padiskutueshëm në ditët e sotme dhe prandaj është shumë me interes informacioni për situatën kulturore, socialekonomike dhe kushtet e burimeve njerëzore të njësive ekonomike. NVM-të kanë qenë shumë të rëndësishme në procesin e globalizimit dhe në forcimin e ekonomisë në mbarë botën, kështu informacioni kontabël i paraqitur nga NVM-të është shumë i rëndësishëm. Duhet të dimë më shumë rreth aspekteve që kanë të bëjnë me NVM-të, të tilla si kush janë përdoruesit e informacionit kontabël, krahasueshmëria dhe harmonizimi i këtij informacioni.

Në këtë kontekst duhet vlerësuar roli i aktorit shumë të rëndësishëm në këtë plan, pra hartuesit/ve të standardeve të kontabilitetit. SNRF për NVM u publikua në Korrik 2009. SNRF për NVM përfaqëson një hap shumë të rëndësishëm drejt konvergjencës globale të praktikave të raportimit financiar të NVM-ve. Ky standard do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare të NVM-ve në të gjithë botën si dhe do të ishte një mundësi më shumë për NVM-të përsa i përket aksesit të tyre në botën e financave dhe financimeve (Neag, Masca & Pascan, 2009, p. 1).

Në vitin 2001, BSNK filloi zyrtarisht procesin e hartimit të një standardi kontabël të përshtatshëm për NVM-të duke patur në konsideratë vendet në zhvillim. Për këtë qëllim u hartua dhe publikua një letër e hapur për diskutim për të cilën u ftuan të japin komentet e tyre profesionistë dhe organizata nga e gjithë bota. Natyrisht, propozimet e bëra i referoheshin elementeve kyç të standardeve të kontabilitetit si njohja, matja, paraqitja dhe shënimet shpjeguese të informacionit në pasqyrat financiare. Drafti i parë i paraqitur i SNRF për NVM u publikua nga BSNK në shkurt 2007, me qëllimin që tu ofrohet njësive ekonomike jo të listuara në bursa një standard jo i komplikuar dhe i lehtë për t'u kuptuar, gjithnjë i mbështetur në parimet e kontabilitetit dhe SNRF-ve të plota ekzistuese.

Mbështetur në këtë draft të publikuar, BSNK ndërmori një testim të tij në një kampion prej 116 NVM të vendosura në 20 vende të ndryshme të botës. Në bazë të komenteve dhe rishikimeve të bëra mbi draftin, si dhe mbështetur në përfundimet e testit, puna e BSNK u bë më e lehtë në përmirësimin dhe thjeshtëzimin e SNRF për NVM, varianti përfundimtar dhe zyrtar i të cilit u publikua në 9 korrik 2009 (BSNK, 2009, p. 6-12).

BSNK më parë kishte konsideruar në parim SNRF-të e plota si të përshtatshme për të gjitha njësitë ekonomike por kjo nuk do të thotë se ky institucion nuk ishte në dijeni të plotë të nevojave të ndryshme të përdoruesve përkatës të informacionit financiar të njësive të mëdha dhe atyre të vogla e të mesme. BSNK vendosi që në misionin e vet ta shtrinte fokusin tek NVM-të në një moment të dytë (BSNK, 2004, pp. 14-15).

BSNK, bashkë me SNRF për NVM, publikoi edhe udhëzuesin për zbatim, lehtësisht i kuptueshëm për përdoruesit e informacionit. Ky udhëzues, së bashku me shembuj numerik i shpjegon më në detaje parimet e standardeve lidhur me njohjen, matjen, vlerësimin e mëpasshëm, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese.

BSNK hartoi SNRF për NVM duke patur parasysh analizën kosto përfitim të këtyre standardeve gjatë përdorimit të tyre nga njësitë ekonomike. Kuptohet që të gjitha parimet lidhur me njohjen, matjen, vlerësimin e mëpasshëm, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese janë thjeshtuar mjaftueshëm krahasuar me SNRF-të e plota. Shumë nga kërkesat për shënimet shpjeguese janë pakësuar dhe shumë çështje që nuk lidheshin me NVM-të janë lënë jashtë (Fitzpatrick & Frank, 2009, p. 50).

BSNK nuk u tërhoq nga vendimi për ta bërë këtë standard më të përshtatshëm dhe të thjeshtë për përdoruesit; dhe gjithashtu punoi mjaftueshëm në publikimin e materialeve trajnuese për këtë standard. Materialet e trajnimit përbëhen nga 35 module. Këto module kanë qenë subjekt rishikimi nga shumë komisione (IASC Foundation Education, 2009, p.1).

2.3.2 SNRF për NVM vs. standardeve lokale të kontabilitetit

BSNK kur publikoi SNRF për NVM, përkufizoi njësitë e vogla e të mesme si njësi ekonomike pa përgjegjësi publike prandaj ato duhet të publikojnë pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme për përdorues të jashtëm. Në këtë kontekst, me përdorues të jashtëm i referohet pronarëve jo menaxherë, kreditorëve aktualë dhe agjensive të kredisë.

SNRF për NVM është e gjerë, e kompletuar dhe gjithëpërfshirëse si dhe përmban rregullimet më të rëndësishme që janë në SNRF-të e plota. P.sh, nënvizon të njëjtat karakteristika kryesore (kuptueshmëria, besueshmëria, rëndësia dhe krahasueshmëria), trajton të njëjtët elemente (të ardhurat, shpenzimet, aktivet, detyrimet dhe kapitalin), të njëjtat kërkesa në paraqitje dhe pse minimumin e tyre, lejimin e raportimit proporcional, etj (Epstein & Jermakoëicz, 2010, p 37).

Vështirësia që lidhet me adoptimin e SNRF për NVM ka të bëjë me problemet e teknikaliteteve të tranzicionit nga standardet lokale drejt SNRF për NVM. Meqenëse NVM-të janë njësi ekonomike të palistuara në bursa, tregjet financiare kanë hartuar rrugë të reja për krijimin e instrumenteve financiare. Këto instrumente duhet t'u sigurojnë NVM-ve financime afatgjata të cilat mund të rifinancohen në tregje pa patur nevojën e listimit formal të tyre në bursa. Probabiliteti është që në të ardhmen e afërt këto instrumente të jenë të disponueshme për ato situata në të cilat tregjet e kapitalit kërkojnë mundësi investimi dhe njësitë e palistuara në Evropë e ofrojnë një shans të tillë. Në situata të tilla, njësive ekonomike të palistuara do t'ju kërkohej të paraqesin pasqyra financiare në përputhje me SNRF-të për NVM duke deklaruar dhe komunikuar një stabilitet financiar dhe ekonomik mjaft tërheqës për investitorët e tregjeve të kapitalit (Epstein & Jermakowicz, 2010, p. 37-38).

Për një tranzicion të suksesshëm nga standardet lokale drejt SNRF për NVM, duhet ndërtuar gjithashtu një marrëdhënie mes procedurave audituese dhe vendimeve të menaxhimit. Objektivat e auditimit burojnë nga SNA⁸ të cilat në vetvete janë një pikë nisje e mirë e procesit të tranzicionit. Rregullimet e detajuara të përfshira në SNA janë procedurat e auditimit. Këto procedura dhe procesi i auditimit përfshin tipe

⁸ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

të caktuara risku; risku i auditimit dhe risku i vetvetishëm janë dy llojet e risqeve që ndikojnë procesin e tranzicionit (Wittsiepe, 2008, p. 62).

Risku i auditimit i referohet papërshtatshmërisë së opinionit të dhënë nga audituesi në raportin e tij për sa i përket përputhshmërisë së raportimit financiar të njësisë ekonomike me standardet e aplikuara. Risku i auditimit mund të ndahet në dy segmente me pasoja të ndryshme: risku i gabimeve në pasqyart financiare dhe risku që audituesi të mos jetë në gjendje të përcaktojë riskun e gabimeve në pasqyra nga përdorimi i procedurave të tepruara të auditimit (Gray & Manson, 2008, p. 173).

Risku i vetvetishëm i referohet riskut të lidhur me karakteristikat e një ngjarje, transaksioni apo gjendje llogarie, të cilat ndikohen nga mjedisi ku operon njësi ekonomike. Me mjedis biznesi kuptohen kushtet e përgjithshme të tregut, ligjet / rregullimet ekzistuese dhe ato të reja, si dhe prirjet e industrisë. Sa më sipër nuk kontrollohen nga menaxhimi i njësisë ekonomike (Gray & Manson, 2008, p. 190-191).

Në të gjitha vendet e BE, NVM-të janë njësi ekonomike të palistuar dhe aplikojnë standardet lokale të kontabilitetit. Kurse njësitë ekonomike të Evropës, të cilat janë të listuara, prej janarit 2005, zbatojnë në mënyrë të detyrueshme SNRF-të e miratuara nga BE. Shqipëria dhe pse nuk është vend anëtar i BE, me ligj ka përcaktuar që njësitë ekonomike të listuara dhe ato të sektorit bankar dhe financiar, të zbatojnë SNRF-të e plota ndërsa të tjerat të zbatojnë SKK⁹-të. Vendet anëtare të BE kanë standardet kombëtare të kontabilitetit dhe ligjin për shoqëritë, disa vende kanë ligjin për kontabilitetin dhe disa vende të tjera e rregullojnë kontabilitetin vetëm përmes ligjit për shoqëritë.

Në përgjithësi ka një mungesë tekstesh shkollore, udhëzues, materiale trajnimi apo software të përshtatshëm për implementimin e standardeve kombëtare. Për këtë arsye brenda një vendi krahasueshmëria e pasqyrave bie pasi kërkesa të ndryshme të standardeve mund të interpretohen ndryshe (Pacter, 2004, p 118).

Sa më sipër është dhe një nga përfundimet në studimin e bërë mbi krahasimin e standardeve të SHBA dhe SNRF për NVM (Munter, Anderson & Mellentine, 2009, p. 5). SNRF për NVM është shumë më i thjeshtë se standardet e SHBA:

- kërkesat për kontabilizimin e instrumenteve financiare kanë më pak kategori dhe janë më pak shtrënguese për të përcaktuar kontabilitetin mbrojtës;
- aktivet afatgjata jomateriale dhe emri i mirë amortizohen përgjatë jetës së tyre të dobishme si dhe testet e zhvlerësimit kërkojnë vetëm kur ka tregues për fakte të tilla;
- ka udhëzime të kufizuara lidhur me njohjen e të ardhurave në industri specifike (në standardet kontabël të SHBA ka udhëzime shumë të detajuara për kontabilizimin e të ardhurave për sektorë të ndryshëm);
- modelet e zhvlerësimit nuk ndryshojnë për aktivet e mbajtura për shitje dhe ato mbeten të njëjta për sa kohë ato janë aktive afatgjata;
- SNRF për NVM kanë shumë më pak kërkesa lidhur me shënimet shpjeguese e gjithashtu më pak të detajuara;
- SNRF për NVM nuk jep udhëzime për sa i takon klasifikimit të instrumenteve financiare në detyrime apo zëra kapitali.

⁹ Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

2.3.3 Përdoruesit e pasqyrave financiare të NVM-ve

BSNK kuptoi se SNRF-të e plota nuk ishin të përshtatshme për t'i shërbyer të gjitha njësive ekonomike pa përjashtim dhe referuar qëllimit global të standardeve të kontabilitetit, NVM-ve, të cilat tejkalojnë me shumëfisha numrin e njësive të listuara, u duhej dedikuar vëmendja e duhur për rregullimin e përshtatshëm kontabël të tyre. Pse duhet një rregullim kontabël global për NVM-të (IASC Foundation Education, 2009, p. 1-2):

- rreth gjysma e NVM kanë hua bankare, dhe bankierët në vendimet e tyre të huadhënies mbështeten në pasqyrat financiare;
- shitësit kanë nevojë për raportim financiar me qëllim që të mundësojnë shitje me pagesë të mëvonshme tek blerës në vende të ndryshme;
- raportet financiare janë të rëndësishme për rankimin e një njësie ekonomike nga agjencitë e ndryshme të kreditimit dhe bankat;
- raportet financiare të NVM-ve përdoren prej furnitorëve kur këta të fundit vlerësojnë perspektivat e marrëdhënieve afatgjata të biznesit;
- raportet financiare i duhen *venture capitalists* kur mbështesin me fonde NVM-të përtej kufijve;
- raportet financiare kërkohen nga investues të huaj që nuk janë drejtpërdrejt të përfshirë në operacionet e përditshme të menaxhimit.

Shumica e përdoruesve të informacionit financiar të NVM-ve, janë të interesuar në informacionin rreth flukseve afatshkurtër të parasë, pozicionit dhe performancës financiare të njësisë në vitin e mëparshëm, mbulimit të interesave dhe trendit të fitimit/ humbjes në vitin e mëparshëm. Përdoruesit e pasqyrave financiare të NVM-ve, ndryshe nga ata të pasqyrave të njësive të listuara, nuk janë të interesuar në flukset, fitim / humbjen apo vlerën e njësisë ekonomike në terma afatgjatë (IASC Foundation Education, 2009, p. 2).

Duke mbajtur parasysh nevojat dhe kërkesat e përdoruesve të pasqyrave financiare të NVM-ve, SNRF për NVM ka rregulla dhe opsione më të thjeshtuara krahasuar me SNRF-të e plota. Disa shembuj që mbështesin sa më sipër janë (Epstein & Jermakowicz, 2010, p. 38):

- Trajtimet lidhur me investimet në aktivet afatgjata materiale lejojnë njësinë ekonomike të zgjedhë ose modelin e vlerës së drejtë (nëse ajo mund të matet me besueshmëri pa shpenzime ekstra) ose modelin e kostos së amortizuar;
- Për matjen e amortizimit dhe zhvlerësimit të ndërtesave dhe makinerive gjithashtu dhe aktiveve afatgjata jomateriale përdoret metoda e kostos së amortizuar ndërsa modeli i rivlerësimit për aktivet afatgjata nuk është i lejuar;
- SNRF për NVM kërkon njohjen e menjëhershme si shpenzim periudhe të kostove të huamarrjes, ndryshe modelit të kapitalizimit të tyre sipas SNRF-ve të plota;
- Sipas SNRF për NVM, ato njësi ekonomike që kontrollohen bashkarisht nuk lejohen të konsolidohen, ndryshe ndodh sipas SNRF-ve të plota;
- Njësive ekonomike që adoptojnë SNRF për NVM u kërkohet që shpenzimet e kërkitimit dhe zhvillimit, sëbashku, të njihen si shpenzime periudhe, ndërkohë që sipas SNRF të plota, shpenzimet e zhvillimit kapitalizohen dhe ato të kërkitimit njihen si shpenzime periudhe.

2.3.4 Një vështrim në brendësi të SNRF për NVM

Tek SNRF për NVM, kërkesat për shënime shpjeguese janë shumë më të thjeshtuara krahasuar me SNRF-të e plota. Shënimet shpjeguese shpesh kërkojnë kryesisht nga të interesuar si bankat apo institucione të tjera financiare. Përsa i përket azhornimit të SNRF për NVM, Bordi i Standardeve vendosi që ky standard të përditësohet një herë në tre vjet (Epstein & Jermakowicz, 2010, p. 38). Nëse një njësi ekonomike mëmë ose një grup i konsoliduar zbaton SNRF-të e plota, atëherë filiali i këtij grupi nuk mund të zbatojë kërkesat e thjeshtuara të dhëna në SNRF për NVM-të. Nuk është e mundur që mëma të përdorë parime të njohjes, matjes dhe rivlerësimit të ndryshme nga ato të filialit të saj pasi nuk do të ishte i mundur konsolidimi i pasqyrave të grupit. (IASC Foundation Education, 2009, p. 13).

BSNK nuk ka përcaktuar kufij sasiorë lidhur me përmasat e njësive ekonomike të mesme dhe të vogla, pasi do ishte thuajse e pamundur një gjë e tillë për shkak të diferencave që ekzistojnë në vende të ndryshme. Juridiksionet vendase vetë mund të përcaktojnë kriteret sasiorë për përcaktimin e njësive të vogla dhe të mesme. Po ashtu, juridiksionet e çdo vendi duhet të përcaktojnë dhe kufijtë e detyrueshëm për kategorizimin e atyre njësive që do të duhet të zbatojnë SNRF-të e plota.

NVM-të të cilat nuk janë njësi me interes publik, ndërtojnë mbi baza vullnetare pasqyra financiare me qëllim të përgjithshëm për përdorues të jashtëm. Këto pasqyra të përgjithshme mundësojnë informacion kuptimplotë për një gamë të gjerë përdoruesish, të cilët supozohet se nuk kërkojnë ndonjë informacion shtesë që plotëson ndonjë nevojë specifike të tyre (IASC Foundation Education, 2009, p. 6-7).

Pasqyra e lëvizjeve të kapitalit, e konkretisht lidhja e saj me pjesën e rezervave tek shënimet shpjeguese, do të ishte me rëndësi vetëm në rastet kur ka transaksione mes pronarëve përveç pagimit të dividendëve. Rivlerësimi në prespektivë i pasurisë nuk është i lejuar, por vlerësimet ekzistuese mund të vlerësohen si një kosto e vlerësuar në çelje. Rregullimet për taksat e shtyra nuk janë përkufizuar në mënyrë të përshtatshme dhe realisht janë shumë problematike për t'u aplikuar por përllogaritja e taksave është pak a shumë e njëjtë për shumicën e njësive ekonomike. Metoda e vlerës së drejtë përdoret për shumë nga instrumentet financiare, p.sh. për derivativët apo huatë e ndryshme me opsionin e parapagimit, e megjithatë shumica e njësive ekonomike do të vazhdojnë edhe për shumë kohë të përdorin modelin e koston së amortizuar (Sleigh-Johnson & Shearer, 2009, p 65).

2.3.5 SNRF e plota vs. SNRF për NVM

SNRF për NVM është përgjithësisht e mbështetur në parimet e SNRF-ve të plota si dhe në kuadrin konceptual. BSNK ka lënë jashtë disa çështje të caktuara apo standarde të cilat konsiderohen si jo të përshtatshme apo të nevojshme për NVM-të. Në këtë mënyrë është reduktuar si numri i standardeve edhe kompleksiteti i tyre. Çështjet e lëna jashtë janë (Munter, Anderson & Mellentine, 2009, p. 4):

- fitimi për aksion (ai kërkohet vetëm nga njësitë me përgjegjësi publike);
- raportimi financiar i ndërmjetëm dhe raportimi i segmentuar;
- aktivet e mbajtura për shitje janë trajtuar njësoj si aktivet e tjera afatgjata për sa i përket zhvlerësimit dhe paraqitjes.

Nevojat e përdoruesve të jashtëm, të tillë si huadhënësit, shitësit, zyra e taksave, etj, janë lënë jashtë SNRF për NVM në shumë prej vendeve. Sidomos në vende të vogla dhe në zhvillim, ky standard krijon probleme për njësitë e vogla përsa i përket aksesit të tyre në kapital dhe për pasojë rrisin koston e kapitalit. Shpesh është problematike edhe cilësia e implementimit të këtij standardi për njësitë e vogla dhe të mesme të cilat nga ligji janë të detyruara të përdorin SNRF e plota (Pacter, 2004, p 118 & 119).

Por ka dhe shumë ngjashmëri mes SNRF-ve të plota dhe SNRF për NVM. P.sh, mund të përgatitet një pasqyrë e vetme e të ardhurave gjithëpërfshirëse ku fitim / humbja e vitit shërben si hapi tranzitor drejt kalimit në pjesën ku paraqiten të ardhurat dhe shpenzimet e tjera ose ndryshe, mund të përgatiten pasqyra të veçanta, ku njëra përfundon me rreshtin e fitim / humbjes së ushtrimit i cili do të jetë për pasqyrën e veçantë të të ardhurave gjithëpërfshirëse si zëri i parë që çel këtë pasqyrë.

Edhe sipas SNRF për NVM ekziston nevoja për të konsoliduar njësitë ekonomike me qëllim të veçantë (NEQV) të cilat kontrollohen nga njësia raportuese (Epstein & Jermakowicz, 2010, p. 37).

Ndërsa disa çështje të tjera si: niveli i rregulluar i çmimit të përgjithshëm në një ekonomi hiperinflacioniste; llogaritjet e vlerës së drejtë për mundësitë e ndryshme të aksioneve dhe aktiveve biologjike; industritë nxjerrëse; raportimi i ndërmjetëm; kontabiliteti i qiradhënësit në kontrata e qirasë financiare; shuma e rikuperueshme e emrit të mirë; fitimi për aksion dhe raportimi segmentar; kontrat e sigurimit; të gjitha këto janë në SNRF-të e plota por janë lënë jashtë SNRF për NVM (Epstein & Jermakowicz, 2010, p. 37).

Modulet e trajnimit të përgatitura nga BSNK për të kuptuar dhe adoptuar SNRF për NVM, paraqesin mënyrën e ndryshme të trajtimit të disa çështje specifike, kur zbatohen SNRF-të e plota dhe kur zbatohen SNRF për NVM. Disa nga këto raste:

- aktivet afatgjata që mbahen për shitje nuk kërkojnë ndonjë klasifikim specifik sipas SNRF për NVM, duhet bërë vetëm një vlerësim për zhvlerësimin e tyre; ndërsa sipas SNRF-ve të plota, aktivet afatgjata të mbajtura për shitje vlerësohen me vlerën më të vogël mes vlerës kontabël të mbartur dhe vlerës së drejtë, minus kostot e shitjes;
- kostot e përcaktuara të shërbimeve në planet e pensioneve njihen menjëherë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas SNRF për NVM; ndërsa sipas SNRF-ve të plota shpenzimi llogaritet dhe njihet mbi bazën e metodës lineare për një periudhë mesatare;
- SNRF për NVM njeh diferencat që vijnë nga këmbimi i monedhave të ndryshme, të cilat janë në formën e investimeve në operacionet jashtë vendit, si zëra të pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe nuk i kalon në fitim humbje me shitjen e tij; ndërsa SNRF-të e plota i konsiderojnë këto investime në fitim humbje vetëm kur aktiviteti shitet;
- Kostot e huamarrjeve, sipas SNRF për NVM trajtohen si shpenzime periudhe; ndërsa sipas SNRF-ve të plota ato kapitalizohen duke shtuar koston e aktivitetit për sigurimin e të cilit është marrë kjo hua;
- Investimet në pjesëmarrje dhe investimet në sipërmarrjet e përbashkëta, të cilat kanë një çmim të publikuar, sipas SNRF për NVM, maten me vlerë të drejtë dhe kalojnë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve; ndërsa sipas SNRF-ve të plota investime të tilla maten duke përdorur modelin e kapitalit neto;
- Njësitë që zbatojnë SNRF për NVM duhet të masin investimet e tyre në aktive afatgjata me vlerën e drejtë duke kaluar përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, gjithnjë nëse vlera e drejtë mund të matet me besueshmëri dhe pa shpenzime shtesë; ndërsa sipas SNRF-ve të plota njësitë ekonomike i kanë njësoj të

aplikueshme të dyja metodat, dhe atë të vlerës së drejtë dhe atë të kostos së amortizuar për matjen e vlerës së investimit në aktive afatgjata;

- Aktivet biologjike sipas SNRF për NVM duhet të maten me vlerë të drejtë vetëm nëse kjo është e fundit është lehtësisht e gjetshme; ndërsa sipas SNRF-ve të plota aktivet bujqësore duhet të maten me vlerë të drejtë pasi ajo mund të gjendet me lehtësi;
- Për trajtimin e tatimit mbi fitimin, sipas SNRF për NVM, meqenëse aplikohen norma të ndryshme për shpërndarjen e të ardhurave, atëherë fillimisht duhen llogaritur taksat aktuale dhe më pas ato të shtyra përsa i përket fitimit të pashpërndarë (IASC Foundation Education, 2009, p. 14).

2.3.6 Faktorët që duhen mbajtur në konsideratë nëse shkohet drejt SNRF për NVM

Përpara se një njësi ekonomike të fillojë të zbatojë SNRF për NVM në hartimin e pasqyrave të saj financiare, menaxhimi duhet të marrë në konsideratë llogaritjen e fizibilitetit në terma të disa faktorëve të caktuar të cilat përcaktojnë suksesin afatgjatë të njësisë ekonomike. Gadishmëria e përdoruesve të këtyre pasqyrave financiare duhet mbajtur e para në konsideratë së bashku me përshtatshmërinë e kohës për tranzicionin nga standardet lokale drejt SNRF për NVM. Gjithashtu, trajnimi i stafeve të njësive ekonomike, në kohë dhe në mënyrën e përshtatshme, është shumë i rëndësishëm, por gjithnjë përpara adoptimit të SNRF për NVM. Informacioni i përgjithshëm por edhe aspekte të veçanta specifike të procesit të tranzicionit si dhe qëllimi i kalimit nga një bazë raportimi në një tjetër, duhet vlerësuar si në baza gjeografike ashtu dhe mbështetur në karakteristikat e njësive ekonomike.

Kontrolli i brendshëm duhet vlerësuar në aspektin sesa do të ndikonte kontrolli i ri tashmë apo modifikimet e sistemit ekzistues të kontrollit në efektivitetin e këtij të fundit. Mënyrat dhe format e reja të komunikimit duhen hartuar në mënyrë të tillë që të minimizojnë surprizat shokuese që vijnë si pasojë e diçkaje krejt të re për investitorët, kreditorët, klientët dhe furnitorët. Për kontrata ekzistuese të marrëveshjeve të huasë apo angazhimeve duhen bërë rinegociime pasi kalimi nga një bazë raportimi tek një tjetër ka efektet e veta në informacionin financiar (Munter, Anderson & Mellentine, 2009, p. 2).

SNRF për NVM janë shumë komplekse për mikronjësitë pasi atyre nuk u shërben një kontabilitet kaq i komplikuar. Një rregullim kaq i detajuar dhe me kaq shumë kërkesa nuk do të ishte i aplikueshëm për njësitë mikro. Ato përfaqësojnë një pjesë të vogël të NVM-ve; institucionet ndërkombëtare (përveç BE) nuk i dallojnë mikronjësitë si një grup i veçantë i NVM-ve. Këto njësi ekonomike mund të kenë mundësinë të organizojnë pasqyrat financiare nëse përdoruesit i kërkojnë ato (Neag, Masca & Pascan, 2009, p 5-7).

Vende të ndryshme kanë ligje dhe taksa të ndryshme, kështu përgatitja e pasqyrave financiare sipas SNRF për NVM mund të ndryshojë nga çfarë kërkojnë autoritetet e taksave. NVM-të të cilat zbatojnë SNRF për NVM mund dhe të mos jenë tërësisht në përputhje me atë që ju kërkohet atyre nga autoritetet e taksave të vendeve të tyre. Këto NVM-të me qëllim që të kënaqin nevojat e autoriteteve të taksave duhet të përgatisin dy sete të ndryshme pasqyrash, njëri përputhet me SNRF për NVM dhe

tjetri me kërkesat e taksave. Manipulimet ose ndryshimet e ligjeve për taksat varen nga autoritetet e taksave dhe këto ndryshime mund të bëhen vetëm nëse janë në të mirë të ekonomisë kombëtare dhe të NVM-ve (BSNK, 2009, p. 7-8).

2.3.7 Opinione lidhur me adoptimin e SNRF për NVM

(Debate mbi nevojën për të patur standard të raportimit financiar për NVM-të dhe përdoruesit e pasqyrave financiare të NVM-ve)

Kur mes palëve të interesuara, sidomos kur përpara KKK, si organizmi i vetëm standard hartues në Shqipëri, ngrihet çështja e adoptimit të SNRF për NVM, argument i parë dhe kryesor që përmendet është interesimi i financuesve të fondeve të NVM-ve për të marrë vendimet e tyre lidhur me huadhënien mbështetur në pasqyrat financiare të hartuara sipas SNRF për NVM.

Ky fakt apo ky interesim i institucioneve të kreditimit ka qenë çështja më fort e theksuar edhe nga BSNK kur vendosi të hartojë dhe publikojë SNRF për NVM. Ndër institucione e kreditimit më të rëndësishme për NVM-të, sipas BSNK, janë bankat prandaj interesimi i tyre për pasqyrat e hartuara sipas SNRF për NVM është shumë i rëndësishëm. Në rradhën e argumenteve, interesimi i pronarëve jomenaxherë të NVM-ve lidhur me adoptimin e këtij standardi do të renditej i fundit, madje pas interesimit të klientëve apo furnitorëve.

Qëndrimi i BSNK për këtë kategori përdoruesish është i qartë: nuk është aspak objektivi i SNRF për NVM të ofrojë informacion për pronarët menaxherë me qëllim që ata të përmirësojnë vendimmarrjen e tyre administrative, (BSNK, 2007). BSNK argumenton bindjen e vet se ky standard nuk ka për objektiv të kënaqë nevojat për informacion të pronarëve menaxherë për faktin se ata janë aq afër dhe të lidhur me biznesin e tyre dhe vendimmarrjen e përditshme sa nuk kanë nevojë për pasqyra financiare të përgatitura sipas standardeve kontabël. Në argumentet e vet sqaron se “NVM në përgjithësi i hartojnë pasqyrat e tyre financiare ose për të përmbushur detyrimin ligjor të dorëzimit të këtyre pasqyrave në organet tatimore ose për ndonjë tjetër rregullator që nuk ka lidhje me letrat me vlerë. Pasqyrat financiare të hartuara për këtë qëllim nuk janë domosdoshmërisht pasqyra për qëllim të përgjithshëm”.

Referuar praktikës shqiptare të të bërit biznes, kjo është mëse e vërtetë. Por gjithashtu është shumë e vështirë ose gati e pamundur që një NVM të mund të hartojë tre lloj pasqyrash financiare, një për pronarët menaxherë, një për organet tatimore dhe një që plotëson kërkesat e një standardi ndërkombëtar të raportimit (Kumtesë J. Bollano, 2010).

Në eksperiencën e vendeve të zhvilluara, njësitë ekonomike të mëdha, duke qenë të listuara kërkojnë dhe gjejnë likuiditete tek blerësit potencialë të aksioneve të tyre në bursa, ndërsa njësitë ekonomike jo të listuara gjejnë një rrugë tjetër. Në Shqipëri është fakt që nuk ekziston bursa por në përgjithësi shumica e njësive ekonomike të mëdha janë filiale të njësive ekonomike të huaja të listuara në bursa. Ndërsa për njësitë ekonomike të vogla e të mesme, ashtu si dhe në çdo vend të botës, mundësia më e mirë për të siguruar likuiditete është huaja bankare, së pari sepse nuk ka një treg ku ato të negociojnë aksionet e tyre dhe së dyti pasi aksesit në huatë bankare është relativisht i lehtë dhe i arritshëm. Pra në mungesë të sigurimit të

kapitalit në një mënyrë tjetër, banka mbetet opsioni më i mirë në të gjitha këndvështrimet.

Parë në një optikë tjetër, arsyeja që motivon një individ të nisë një aktivitet pra të krijojë një njësi ekonomike, është pikërisht dëshira e tij të mund të shijojë frytet e fitimeve që vijnë nga ky aktivitet. Ndonjëherë fryt i biznesit mund të jetë siguria ekonomike individuale, ndonjëherë nevoja për të fituar respektin e të tjerëve, por më së shumti është e lidhur me nevojën për vetë vlerësim. Të treja këto nevoja njerëzore plotësohen kryesisht nga të ushtruarit të kontrollit të plotë të mjedisit të punës (Lean, J., and Tucker, J., 2001). Nga ky këndvështrim, është e lehtë të kuptohet përse një pronar i një njësie të vogël ose të mesme e ka të vështirë të pranojë ta ndajë kontrollin e tij mbi njësinë ekonomike duke pranuar të tjerë të hyjnë si burime kapitalesh. Pagesa e interesave për huatë bankare është shumë më e lehtë për t'u pranuar krahasuar me futjen e personave të tjerë në pronësinë dhe kontrollin mbi aktivitetin dhe biznesin.

2.3.7.1 Pozicionimi aktual lidhur me implementimin e SNRF për NVM

Publikimi i SNRF për NVM përfaqëson një arritje të suksesshme të një pune 5 vjeçare për BSNK. Megjithatë legjitimiteti i BSNK për të hartuar këto norma dhe parime ka qenë subjekt debatesh edhe pas publikimit të tyre. Graham Holt, korrigjues në kurset e kualifikimit ndërkombëtar ACCA dhe një nga lektorët kryesorë të kontabilitetit dhe financës në Universitetin Metropolitan të Biznesit në Manchester (Graham Holt, 2009) thotë se këto parime janë organizuar në këtë standard në një mënyrë të tillë, me rradhë sipas çështjeve, që të jetë lehtësisht i përdorshëm nga përgatitësit dhe përdoruesit e pasqyrave financiare.

SNRF për NVM dhe SNRF e plota janë kuadro raportimi të veçanta dhe të dallueshëm nga njëri tjetri por me baza të njëjta. Standardi për NVM-të për nga natyra nuk është një set i ndërtuar krejt i pavarur. Ai mbështetet në koncepte të njohura dhe parime gjerësisht të përhapura dhe në këtë mënyrë lejon kalimin më të lehtë të NVM-ve drejt SNRF-ve të plota në një fazë të dytë nëse një ditë ajo bëhet njësi ekonomike e listuar.

Në vendimin që u mor për të bërë modifikimet e SNRF, që të hartohet një variant i thjeshtuar i saj, pra SNRF për NVM, u mbajtën parasysh nevojat e përdoruesve dhe si dhe kostot apo barra që u shtohet këtyre njësive të vogla nëse do të zbatonin SNRF-të e plota. Lehtësimi i disa kriterëve të njohjes dhe matjes që janë tek SNRF e plota kishte pikërisht si qëllim reduktimin e këtyre kostove dhe kësaj barre raportimi.

NVM-të ndjekin strategji krejt të ndryshme nga ato të njësive të mëdha. Strategjitë e tyre janë të lidhura kryesisht me mbijetesën dhe qëndrueshmërinë dhe jo me rritjen apo maksimizimin e fitimit. Funksioni i kujdestarit shpesh mungon në njësitë e vogla dhe të mesme madje kontabilisti luan rolin e agjentit ndërmjetës mes pronarit të njësisë dhe bankës, kjo e fundit si burim financimi.

Standardi gjithashtu ka një gjuhë të thjeshtuar në formulim e paragrafëve dhe shembujve shpjegues. Në mungesë të udhëzimeve të qarta për një çështje të caktuar, një NVM mundet, por nuk është e detyrueshme, të referohet në kërkesat dhe udhëzuesit përkatës të SNRF-ve të plota, për çështje të ngjashme. Aktualisht SNRF për NVM shoqërohet nga një udhëzues i plotë për implementimin e tij.

Graham Holt, sugjeron që SNRF për NVM u hartua si përgjigje e një kërkesë ndërkombëtare nga vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim për të patur një standard kontabël të përbashkët dhe rigoroz për NVM-të i cili të jetë shumë më i lehtë për t'u zbatuar krahasuar me SNRF-të e plota. Ky standard duhet të sigurojë një krahasueshmëri të përmirësuar të pasqyrave financiare në sy të përdoruesve. Gjithashtu, standardi për NVM-të duhet të rrisë besimin e përgjithshëm tek raportimi i NVM-ve dhe në të njëjtën kohë të ulë koston e nevojshme në “mirëmbajtjen” e standardeve kombëtare përkatëse.

2.3.7.2 Përdoruesit e pasqyrave financiare në këndvështrimin e standard hartuesve dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë

EFRAG (Grupi Këshillimor Evropian për Raportimin Financiar) nuk bëri komente (as deri sot) për SNRF për NVM. Por mund të interpretohet qëndrimi i tij kur u publikua SNRF për NVM, si më poshtë:

- a) Përdoruesit e pasqyrave të NVM-ve në përgjithësi kërkojnë një raportim financiar më pak kompleks e më pak të sofistikuar meqenëse ata janë më pak të orientuar nga tregjet e kapitalit;
- b) Meqenëse përdoruesit e pasqyrave të NVM-ve kanë burime të kufizuara për t'u thelluar në një analizë të thellë të pasqyrave financiare, ata e vlerësojnë shumë standardizimin në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare;
- c) Përdoruesit e pasqyrave të NVM-ve kanë prirje ta përdorin informacionin e këtyre pasqyrave më shumë për të vlerësuar cilësinë e menaxhimit (efektivitetin e strategjive, performancën, etj) sesa për të marrë vendime të tilla si blerja, shitja apo mbajtja e kuotave të tyre të kapitalit;
- d) Fokusi i përdoruesve të pasqyrave financiare të NVM-ve është vlerësimi i aftësisë së njësisë ekonomike për të gjeneruar flukse pozitive të parasë në rrjedhën normale të biznesit, në periudha afatshkurtra dhe afatgjata, me qëllim që të shlyejnë detyrimet e tyre në kohën e duhur.

Federata Evropiane e Ekspertëve Kontabël (FEE) bëri disa komente lidhur me SNRF për NVM duke sqaruar kështu pozicionin e saj lidhur me këtë standard. “Bruksel, 9 korrik 2009 – FEE përgëzon BSNK si hartuesi i standardeve ndërkombëtare, për publikimin e këtij standardi të ri për NVM-të. FEE dëshiron të kontribuojë në debatin mbi rolin që do të luajë në Evropë standardi për NVM-të” (FEE, 2009). Ky standard ka për qëllim të plotësojë kërkesat e përdoruesve por duke balancuar kostot dhe përfitimet në këndvështrimin e hartuesit të pasqyrave. BSNK ka zhvilluar këtë standard në përgjigje të kërkesës për thjeshtësimin e SNRF-ve të plota, për të qenë i përdorshëm nga njësitë jo të listuara. FEE mbështet standardet e raportimit financiar me cilësi të lartë e të mbështetura në parime për faktin se ato promovojnë qëndrueshmërinë dhe transparencën si dhe ndihmojnë njësitë ekonomike t'i përgjigjen në mënyrën e duhur të gjitha zhvillimeve të reja në praktikën e biznesit. Në këtë drejtim, FEE e përshëndet SNRF për NVM-të. Njësitë ekonomike, përfshirë ato të vogla dhe të mesme me aktivitete përtej kufijve, degët dhe filialet e tyre do të përfitojnë nga thjeshtësimi i raportimit financiar duke qenë se do të përdorin të njëjtin standard dhe kuadër konceptual e në këtë mënyrë do të flitet e njëjta gjuhë kontabël në të gjitha vendet e përfshira. Përdorimi i SNRF për NVM do t'u jepte hartuesve kombëtarë të standardeve mundësinë për të mos hartuar dhe përditësuar standarde kombëtare. Në nivel kombëtar kjo do të thotë reduktim i një kostoje të ndjeshme. FEE

beson se Direktiva Evropiane e Kontabilitetit nuk do të jetë një pengesë për vendet anëtare që të lejojnë përdorimin e SNRF për NVM. Zbatimi ose jo i këtij standardi në Evropë do të jetë gjithnjë i lidhur me kërkesat e tregut për raportimin financiar dhe jo i penguar nga ligjvënësit. Për ligjvënësit është vetëm një teknikalitet amendimi i Direktivës, ndërsa për tregjet është një zgjidhje e pranuar bashkërisht, gjë që kërkon më shumë kohë.

2.3.8 Një studim i Komisionit Evropian lidhur me adoptimin e SNRF për NVM në Evropë

Sipas një studimi të Komisionit Evropian, hartuesit dhe përdoruesit e informacionit financiar në të gjithë Evropën janë ambivalent rreth prezantimit të SNRF të ri për NVM -të. Të anketuarit në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe ata në Holandë, Spanjë, Danimarkë dhe Irlandë, u bashkuan me shumicën e fortë prej 13 vendesh që do të favorizonte miratimin e standardeve të reja të NVM-ve, ndërsa nëntë vendet kundërshtuese përfshijnë Gjermaninë, Francën dhe Italinë dhe Belgjikën. Një shumicë e ngushtë (11 kundrejt 10) e autoriteteve publike dhe të hartuesve të standardeve në Evropë mendonin se SNRF për NVM nuk ishte i përshtatshëm për përdorim të gjerë në të gjithë kontinentin.

Përfitimet e SNRF për NVM-të

Mbështetësit e SNRF për NVM-të theksuan avantazhet për krahasimin e pasqyrave financiare të përgatitura në juridiksione të ndryshme, të cilat do të nxisnin zhvillimin e mëtejshëm të tregtisë ndër-kufitare, aktivitetet e bashkimit / blerjes dhe uljen e kostos në rritje të financave. Për njësitë ekonomike që vepronin me filiale në shtete të ndryshme anëtare të BE-së, standardi i NVM-ve do të lehtësonte përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara pasi nuk do të ishte më nevoja për të njehsuar trajtimet kombëtare të kontabilitetit. Shpenzimet e auditimit do të uleshin, gjithashtu. Zhvillimi i një kuadri të përbashkët arsimor për kontabilistët rreth standardit mund të hapte rrugën për më shumë lëvizshmëri të kontabilistëve dhe të shërbimeve të auditimit brenda shteteve të BE-së. Mbështetësit shtojnë se duke qenë se SNRF për NVM, është më e lehtë për t'u aplikuar se SNRF-të e plota të BE, kompanitë mund ta adoptojnë atë si një hap të rëndësishëm drejt listimit publik.

Të meta

Kundërshtarët ndaj zbatimit të SNRF për NVM-të në Evropë, theksojnë kompleksitetin e standardit, veçanërisht për njësitë ekonomike të. Për ato njësi që operojnë vetëm në një vend dhe të cilat nuk kanë nevojë për krahasueshmërinë ndërkufitare, barra shtesë e imponuar nga standardi do të jetë më e madhe se përfitimet e mundshme. SNRF për NVM-të nuk është e përshtatshme për menaxhimin e brendshëm, argumentuan ata dhe aplikimi i saj do të rriste koston e përgatitjes dhe auditimit të pasqyrave individuale të njësive ekonomike. Rritja e kërkesave për shënimet shpjeguese potencialisht mund të vërë ato njësi që e kanë adoptuar këtë standard, në një disavantazh ndaj njësive ekonomike që përdorin rregulla më pak të rrepta të mbajtjes së kontabilitetit.

Për të miratuar këtë rregullim të ri të raportimit financiar, njësitë ekonomike dhe kontabilistët e tyre do të duhet të ristrukturojnë proceset e brendshme, duhet të trajnojnë stafin në sistemet e reja të kontabilitetit dhe të prodhojnë riparaqitje të informacionit krahasues. Shumë njësi ekonomike të vogla që nuk kanë ekspertizën e kontabilitetit do të duhej të merrnin ndihmë profesionale gjatë procesit të adoptimit të SNRF për NVM-të. Këto kosto fillestare adoptimi do të përsëriteshin sa herë standardi do rishikohej, vinte në dukje raporti i KE. Komplexiteti në rritje do të shtonte koston e auditimeve dhe njësitë ekonomike do të kishin nevojë për ndihmë të vazhdueshme për të ushtruar gjykime në fusha të tilla komplekse si përjashtimi nga taksat dhe përcaktimi i vlerësimit të drejtë të tregut në aktivet dhe detyrimet e pensioneve. Kërkesat e standardit në këto fusha, do të prodhonin pasqyra financiare më pak të kuptueshme për lexuesin e zakonshëm.

Referuar marrëdhënieve të ngushta midis tatimeve, shpërndarjes së fitimit dhe regjimeve kontabël në disa shtete anëtare, gjykohet se njësitë ekonomike do të duhet të përgatisin një grup të veçantë pasqyrash për tatimet.

Palët kundërshtarë në këtë studim ranë dakord për faktin se SNRF për NVM do të ishte më e përshtatshme për njësitë e mëdha dhe të mesme, për grupe ndërkombëtare dhe filialet e atyre njësive të cilat raportojnë me SNRF të plota.

Sipas pikëpamjeve të kundërshtarëve të standardit, ky i fundit kujdeset kryesisht për ofruesit e kapitalit aksionar e jo për audiencat e tjera të NVM-ve, si kreditorët tregtarë, autoritetet tatimore, pronarët dhe punonjësit, të cilët janë më familiarë me regjimet aktuale kombëtare.

Në të dy frontet teknike dhe politike, megjithatë, do të jetë nevoja të ketë një mekanizëm të ngjashëm evropian aplikimi, si në rastin e SNRF-ve të plota, për të të siguruar përputhjen e SNRF për NVM-të me direktivën evropiane të kontabilitetit. Siç vë në dukje raporti, do të ishte e palogjikshme të lejohej vendet anëtare të adoptonin SNRF e plota evropiane të miratuara për njësitë e listuara, e të mos lejohej përdorimi i SNRF për NVM nga njësitë jo të listuara.

2.3.9 Qëndrime dhe fakte mbi adoptimin e SNRF për NVM në shtetet e zhvilluara Evropiane

Studimi i bërë nga MAZARS¹⁰, në bashkëpunim me EFRAG, mbi një kampion prej 1.500 NVM që e zhvillojnë aktivitetin e tyre në Evropë, kishte në fokus të vlerësonte qëndrimin e këtyre njësive ekonomike lidhur me konvergjencën e standardeve lokale me standardet ndërkombëtare, mënyrën si ata e shikonin prespektivën e një seti të përbashkët të raportimit financiar dhe shkallën e përgatitjes së këtyre njësive ekonomike për të asimiluar këto zhvillime. Pyetësori u zhvillua në 6 shtete evropiane (Francë, Gjermani, Itali, Hollandë, Spanjë dhe Mbretëri e Bashkuar).

****Shumica e NVMve në Evropë janë shumë në favor të adoptimit të një seti të përbashkët standardesh kontabiliteti në mbarë Evropën*

Shumica e njësive ekonomike (më shumë se 80% në secilin prej 6 vendeve të BE) pavarësisht madhësisë së tyre, janë në favor të konvergjencës së standardeve kombëtare të kontabilitetit me standardet ndërkombëtare. Megjithatë qëndrimi i tyre

¹⁰ <file:///C:/Users/edi/Downloads/IFRS+for+SMEs.pdf>

në lidhje me statusin e konvergjencës është, në raste të caktuara, pjesërisht jo në përputhje me rrethanat aktuale. Kështu, në Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar, më shumë se 30% e njësive ekonomike konsiderojnë se konvergjenca duhet të iniciohet ndërsa ajo është duke u zhvilluar tashmë mirë, madje shumë mirë. Në Holandë dhe Gjermani, në të kundërtën, njësitë ekonomike duket se e dinë se procesi i konvergjencës tashmë ka filluar. Procesi i konvergjencës është kështu mjaft i mirë në këto dy vende, edhe pse shkalla e progresit drejt konvergjencës ndryshon në mes tyre (ka përparuar mirë në Holandë, është ende vetëm duke filluar në Gjermani).

Për më tepër, një shumicë e madhe e NVM-ve evropiane mbështesin miratimin e një seti të përbashkët të standardeve të kontabilitetit, qoftë në mënyrë të detyrueshme ose jo të detyrueshme. Ky është veçanërisht rasti mes NVM-ve italiane, spanjolle, holandeze dhe franceze.

Thënë kjo, ata që janë në favor të një seti të përbashkët të standardeve të kontabilitetit janë të ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë në mes të NVM-ve në favor të miratimit të detyrueshëm (ky është rasti në Itali, Spanjë dhe Holandë) dhe ata që favorizojnë miratimin fakultativ. Nuk është befasi, shumica e njësive të vogla (në mes 20 dhe 49 punëtorë) janë në favor të qasjes të fundit. Të tjerët (më shumë se 50 punonjës) janë të ndarë në mënyrë të barabartë për miratim në mes të qasjeve të detyrueshme dhe fakultative.

Ndërkohë që ekziston një konsensus në lidhje me një set të përbashkët të standardeve të kontabilitetit, arsyet e njësive ekonomike për të mbajtur këtë qëndrim ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Më shumë se 60% e NVM-ve franceze, italiane dhe spanjolle identifikojnë si përfitimet kryesore që ata presin nga konvergjenca:

- nevojën për të këputur lidhjen midis rregullave tatimore dhe atyre të kontabilitetit; dhe
- mundësinë për të qenë në gjendje t'u sigurojnë të gjitha palëve të jashtme një set të vetëm të pasqyrave;

Megjithatë, njësitë ekonomike spanjolle dhe italiane, në përmasa të ngjashme, janë të interesuara edhe në përmirësimin e krahasimit me konkurrentët e tyre, dhe uljen në kostot e financimit, që do të rezultojë nga vendosja e një seti të përbashkët të standardeve të kontabilitetit. Shumica e këtyre njësive ekonomike gjithashtu presin të shohin përfitimet lidhur me zhvillimin e marrëdhënieve ndërkufitare me partnerët e huaj (klientët, furnizuesit, partnerët komerciale).

Dy të tretat e njësive ekonomike britanike dhe gjermane konsiderojnë, nga ana e tyre, se një set i përbashkët i standardeve të kontabilitetit në radhë të parë do të përmirësojë menaxhimin dhe komunikimin e brendshëm në kuadër të biznesit të tyre. Shumica e NVM-ve në të gjitha vendet identifikojnë zvogëlimin e kostove të financimit dhe rritjen e aftësisë konkurruese si dy nga përfitimet e konvergjencës.

Nga ana tjetër, NVM-të nuk duket të jenë të motivuara veçanërisht nga përfitimet që një set i përbashkët i standardeve të kontabilitetit mund të sjellë në drejtim të lehtësimit të negociatave për shitjen e bizneseve. Vetëm NVM-të italiane konsiderojnë se miratimi i një seti të përbashkët të standardeve të kontabilitetit do të jetë pozitiv në këtë drejtim (56%).

NVM-të me qëndrim më pozitiv ndaj miratimit të një seti të përbashkët të standardeve të kontabilitetit janë ato të cilat i kanë shumë të qarta përfitimet nga një set i përbashkët. Ky konstatim vlen pavarësisht madhësisë së njësive ekonomike.

Kjo pikëpamje pozitive në lidhje me miratimin e një seti të përbashkët të standardeve të kontabilitetit nuk do të thotë megjithatë se NVM-të nuk janë në dijeni të disavantazheve të mundshme të konvergjencës.

Kështu, gati 60% e NVM-ve spanjolle dhe më shumë se 2/3 e NVM-ve të

anketuara në pesë vende të tjera konsiderojnë se vështirësitë do të dalin në drejtim të interpretimit dhe se kostoja e përgatitjes së regjistrave kontabël dhe pasqyrave financiare ka të ngjarë të rritet. Njësitë ekonomike gjermane, spanjolle dhe holandeze konsiderojnë në mënyrë të veçantë se ato do të duhet të kërkojnë një numër më të madh të personelit të kualifikuar. Ato, së bashku me njësitë ekonomike italiane, gjithashtu konsiderojnë se sidomos kostot e auditimit të jashtëm dhe kontabilitetit do të rriten meqenëse konvergjenca mund të favorizojë njësitë ekonomike të mëdha ndërkombëtare.

Përtej çështjeve të diskutuara më sipër, perceptimet ndryshojnë, duke reflektuar statusin e proceseve të ndryshme të hartimit të standardeve të kontabilitetit në vende të ndryshme. Kështu, britanikët dhe njësitë ekonomike holandeze janë të vetmet të cilat kryesisht nuk do të deshën një rritje të padëshirueshme në nivelin e informacionit të botuar.

Në të njëjtën kohë, njësitë ekonomike gjermane dhe britanike kryesisht i tremben humbjes së ndikimit që mund të vijë nga zgjidhjet në fushën e standardeve të kontabilitetit të marra në nivel evropian. Nuk është e mundur të thuhet nëse kjo mungesë relative shqetësimi në vendet e tjera ndërmjet NVM-ve vjen si rezultat i besimit më të madh në proceset vendimmarrëse evropiane në këto vende, ose për shkak se ata ndjejnë se hartuesit e standardeve në Francë, Itali, Hollandë dhe Spanjë aktualisht nuk i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme pikëpamjeve të tyre!

Së fundi, vendet Latine shqetësohen më shumë rreth faktit që duhet të vënë shumë informacion në dispozicion të publikut (56% në Francë, 60% në Itali, 62% në Spanjë). Madhësia e ndërmarrjes nuk ka ndonjë ndikim të veçantë në këto rezultate.

Ku qëndron sot raportimi financiar?

****Raportimi financiar është kryesisht i orientuar drejt nevojave të autoriteteve të taksave, bankave dhe aksionerëve*

NVM-të Evropiane ndajnë pikëpamjen se furnizuesit e tyre, klientët dhe punonjësit janë, më së shumti, përdoruesit marginalë të raportimit të tyre financiar.

Në të gjitha vendet e marra në studim, katër përdoruesit kryesorë të raportimit financiar janë bankat, organet tatimore, aksionarët dhe menaxhimi i njësisë ekonomike. Megjithatë dallime shumë të konsiderueshme ekzistojnë midis vendeve të ndryshme. Në Francë, Hollandë, Spanjë dhe Gjermani, organet tatimore janë të përfshira në tre përdoruesit kryesorë të raportimit financiar, përkatësisht nga 73%, 76%, 85% dhe 86% e njësive të anketuara.

Megjithatë, në Britaninë e Madhe, vetëm 47% e njësive ekonomike të përfshira në studim i konsiderojnë organet tatimore si një nga tre përdoruesit primar.

Gjithashtu bankat, të cilët janë identifikuar si burimi kryesor i financave të NVM-ve në të gjashtë vendet, konsiderohen të jenë përdorues shumë të rëndësishëm, në veçanti në Itali, Gjermani dhe Britani të Madhe ku madje ishin renditur si numri 1 ndër përdoruesit, me një rezultat prej 92% në Itali, 86% në Gjermani, 85% në Spanjë, 81% në Hollandë, 71% në Britani të Madhe dhe 70% në Francë.

Madhësia e njësive ekonomike ka një shkallë të caktuar të ndikimit mbi këto perceptime. Ajo ndikon në rëndësinë relative të bankave dhe aksionerëve - bankat mbeten përdoruesit primar për 84% të njësive ekonomike me më pak se 250 punonjës ndërsa kjo shifër bie në 76% për njësitë ekonomike me më shumë se 250 punonjës. Në të njëjtën kohë, përgatitja e pasqyrave për aksionerët bëhet më e rëndësishme për njësitë ekonomike më të mëdha (58%), ndërsa aksionarët janë të përfshirë vetëm mes

tre përdoruesve kryesore të pasqyrave financiare për 42% të njësive ekonomike me më pak se 50 punonjës.

****Në shumicën e rasteve, bankat / kreditorët kërkojnë përveç pasqyrave financiare vjetore, buxhetet dhe parashikimet e flukseve monetare*

Niveli i informacionit financiar të kërkuar nga bankat / ofruesit e tjerë të fondeve (përveç pasqyrave financiare vjetore) ndryshon nga njëri vend në tjetrin.

Vetëm një e katërta e njësive ekonomike franceze (26%) raportuan se kishin patur kërkesa të tilla, por më shumë se gjysma e NVM-ve britanike (53%), Gjermane (52%) dhe italiane (50%) i kishin ofruar këto informacione shtesë. Shumica e kërkesave për informacion shtesë janë për buxhetet dhe parashikimet e fluksit të mjeteve monetare, me përjashtim në Francë dhe Spanjë, ku pasqyra e llogaritjes së tatimit mbi fitimin është kërkuar me prioritet (respektivisht 83% dhe 71%). Bankat italiane vendosin prioritetin më të lartë në pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare (82%), përveç kërkesave për buxhetet dhe parashikimet e rrjedhës së parasë.

NVM-të treguan se, në përgjithësi, informacioni i kërkuar nuk është përgatitur posaçërisht për këtë palë së tretë, por është tashmë në dispozicion në librat dhe regjistrat kontabël të njësisë. Shifrat duket se e konfirmojnë këtë deklaratë pasi përqindjet e deklaruara janë në përputhje me praktikat buxhetore dhe ato të të parashikimit të raportuara, si nga origjina gjeografike dhe sipas madhësisë së njësisë ekonomike.

Është Standardi i propozuar për NVM-të i përshtatshëm për njësitë ekonomike në Evropë?

****Falë konsultimeve të kryera përpara publikimit të draftit të publikuar, krijohet ideja dhe bindja se BSNK identifikoi korrektësisht të gjitha nevojat kontabël të NVM-ve. Në fakt kish qenë e nevojshme të bëheshin...*

Në kuadër të konsultimeve të kryera para publikimit të draftit të standardit, BSNK mblodhi shumë komente dhe informacion përmes përgjigjeve dhënë për letrën e diskutimit. Të njëjtën gjë bëri dhe përmes tryezave të rrumbullakëta. Ky proces konsultimesh i mundësoi BSNK të bënte rregullimet e duhura në fushëveprimin e transaksioneve që do të pasqyrohen në llogaritë kontabël të NVM-ve. Një konfirmim i parë dhënë nga studimi është se një pjesë e konsiderueshme e NVM-ve janë njësitë ekonomike prind të grupeve (sidomos në Spanjë, Itali dhe Mbretërinë e Bashkuar) dhe në këtë mënyrë duhet të përgatisin pasqyrat e konsoliduara. Përfshirja e paragrafëve në lidhje me konsolidimin dhe kombinimet e biznesit është pra plotësisht e përshtatshme në një standard që synon NVM-të. Anketa gjithashtu konfirmoi se, në disa vende, angazhimet e pas-punësimit për punonjësit janë një praktikë shumë e hasur, veçanërisht në Gjermani (63%), por edhe në Britani të Madhe (54%). Prandaj është e nevojshme të sigurohet trajtimi i tyre kontabël.

Konfirmim i tretë i siguar nga studimi: shumica e NVM-ve i nënshtrohen një procesi buxhetimi. Si rezultat, ata duhet të kenë të disponueshme të dhëna që mundësojnë parashikimin pasi duhet të përcaktojnë vlerën në përdorim të aktiveve afatgjata materiale për qëllimet e testit të zhvlerësimit.

Më shumë se 80% e NVM-ve përgatisin buxhetet, por vetëm një pakicë përgatisin plane afatmesme në kërkim të një parashikimi të mundshëm për të paktën deri në tre vjet (2-3%). Vetëm 69% e NVM-ve me më pak se 50 punonjës përgatisin buxhetet kundrejt 85% në rastin e njësive ekonomike të mëdha.

Cilësia e procesit të buxhetimit ndryshon: 2/3 e njësive ekonomike franceze, spanjolle dhe holandeze, kryejnë vetëm një parashikim për vitin në tërësi, pa përgatitur një analizë më të hollësishme në muaj ose në tremujorë, ndërsa gjysma e njësive ekonomike britanike dhe gjermane janë më të avancuar në këtë fushë, sidomos në drejtim të parashikimeve të rrjedhës së parësë.

NVM-të britanike janë dukshëm të ndryshme nga homologët e tyre kontinentalë në atë se 2/3 e tyre rifreskojnë parashikimet e tyre çdo muaj apo tremujor, ndërsa më pak se 60% e NVM-ve franceze dhe gjermane bëjnë rifreskime në këto intervale.

Një bazë kryesore, edhe pse rudimentare, veçanërisht në Francë, është në fuqi për kryerjen e testeve për zhvlerësimin e aktiveve material afatgjata. Kërkesat e këtyre testeve duhet megjithatë të thjeshtohen (në krahasim me SNRF e plota), veçanërisht në drejtim të afatit për të cilën duhen bërë parashikimet meqenëse pjesa më e madhe e njësive ekonomike nuk kanë shifra buxhetore përtej tre ose më shumë viteve të ardhshëm. Drafti i BSNK-së në këtë mënyrë do të duhet të ndryshohet në këtë pikë për të lejuar NVM-të të përdorin vlerën në përdorim në testet për zhvlerësim dhe jo vetëm vlerën e drejtë.

Konfirmim i katërt dhënë nga studimi është se 38% e NVM-ve franceze dhe deri në 50% të NVM-ve holandezë kanë politika mbrojtëse (hedging policies). Rreziqet e normave të interesit janë ato të cilat janë të mbrojtura më shpesh (1/4 e NVM-ve britanike dhe holandeze, 1/3 e atyre spanjolle), e ndjekur nga rreziqet e monedhës (1/5 ose më shumë e njësive britanike, holandeze, spanjolle dhe italiane) dhe, së fundi, rreziqet e ndryshimeve në çmimet e mallrave (rreth 10% në çdo vend, përveç në Spanjë dhe Hollandë). Instrumentet mbrojtëse të përdorura më së shpeshti janë shitjet dhe blerjet me kontrata forward, megjithatë edhe kontratat swap janë përdorur gjithashtu. Kontratat “options” janë përdorur më pak, por niveli i përdorimit gjithësesi mbetet i konsiderueshëm (10% në Francë, 17% në Mbretërinë e Bashkuar, 8% në Gjermani, 24% në Itali, 13% në Spanjë dhe 14% në Hollandë).

Draft standardi do të përfitonte nga të qenit (i) i kompletuar sa i përket mbrojtjes së rreziqeve të ndryshimeve në çmimet e mallrave dhe (ii) i ndryshuar për të lejuar kontabilitetin mbrojtës kur janë përdorur opsionet si instrument mbrojtës.

Në fund, anketa tregoi se shumë NVM i kanë blerë AGJM me kontrata të qirasë financiare (1/3 e NVM-ve britanike dhe gjermane dhe 40% e atyre franceze) dhe se sigurimi i financimeve përmes shitjes së llogarive arkëtueshme është është i konsiderueshëm (rreth 10% në çdo vend).

Standardi i ardhshëm duhet t'i marrë në konsideratë këto karakteristika të ndryshme për të siguruar, së pari, që një pjesë e borxhit financiar të NVM-ve të mos mbetet sistematikisht jashtë bilancit dhe, së dyti, që thjeshtimi i kushteve për çregjistrim në kontekstin e shitjes së llogarive të arkëtueshme të mos dëmtojë cilësinë e pasqyrave financiare të paraqitura.

Cilat do të ishin impaktet e SNRF për NVM në vendet ku do të adoptohej?

****Ashtu si dhe në grupet e listuara, adoptimi i SNRF për NVM do të ndikonte në mënyrën si menaxhohen këto njësi ekonomike*

Shifrat e kontabilitetit janë përdorur si bazë për kontrollin dhe menaxhimin në shumicën e njësive ekonomike të anketuara. Si rezultat, informacioni i kontabilitetit financiar përgatitur në përputhje me SNRF për NVM-të në do të përdorej në të gjithë njësinë ekonomike. Në treguesit e tyre të menaxhimit, NVM-të janë të interesuara kryesisht:

- në fitimin operativ (veçanërisht në Francë dhe në një masë edhe më të madhe në Gjermani, Itali dhe Hollandë); dhe
- tek shitjet (në Mbretërinë e Bashkuar në veçanti).

Gjithnjë e më shumë po përdoret qasja financiare e "kthimit nga investimet", pothuajse nga 1/3 e njësive ekonomike britanike dhe hollandeze, ndërkohë që vetëm një numër i vogël njësish e përdorin këtë tregues në Francë dhe Gjermani (më pak se 10%). Madhësia e njësive ekonomike nuk ka ndikim në këtë drejtim. Miratimi i një seti të përbashkët të standardeve të kontabilitetit ndoshta do të ketë një ndikim në përkufizimin e treguesve të menaxhimit, veçanërisht të fitimit operativ, për shkak të zhvillimeve në standardet e kontabilitetit në fushën e paraqitjes të pasqyrave financiare - veçanërisht pasqyrën e të ardhurave (për shembull, eliminimi i kategorisë së zërave të jashtëzakonshëm).

Megjithatë shumica e NVM-ve gjermane (53%) rregullojnë treguesit e tyre të kontabilitetit për qëllime të kontrollit dhe menaxhimit (përfshijë fitimet dhe humbjet e përcaktuara për shembull), ndërsa vetëm një pakicë e NVM-ve franceze dhe britanike (një e treta), dhe madje edhe më pak ato në Spanjë (më pak se 20%) bëjnë një gjë të tillë. Më pak se gjysma e NVM-ve të anketuara e kanë konsideruar, ose filluar ta konsiderojnë këtë gjë, duke bërë ndryshimet përkatëse në këtë drejtim.

• Një e treta e NVM-ve nuk kanë kontabilitet të veçantë menaxherial ose nuk mbajnë regjistrime kontabël për kontabilitetin menaxherial të cilat të jenë krejtësisht të ndara nga llogaritë e kontabilitetit financiar. Kjo përqindje arrin 38% në Gjermani dhe 43% në Holandë. NVM-të britanike dhe italiane e deklarojnë veten të jenë më të përparuara në këtë drejtim. Gjithashtu, madhësia e njësive ekonomike është faktor diferencues: 44% e NVM-ve me më pak se 50 të punësuar nuk kanë një sistem të kontabilitetit menaxherial, ndërsa kjo përqindje bie në 30% për ata me 50 ose më shumë punëtorë.

****Nismat për trajnime do të duhej fillimisht të orientoheshin për stafet e njësive ekonomike...*

Pothuajse të gjitha NVM-të përgatisin vetë pasqyrat e tyre individuale, veçanërisht në Spanjë (98%), dhe më shumë se gjysma e njësive ekonomike në studim përgatisin vetë pasqyrat e tyre të konsoliduara. Përqindja e NVM-ve me më pak se 50 të punësuar që përgatisin vetë pasqyrat e tyre financiare është megjithatë vetëm 76%, në krahasim me mbi 85% për njësitë e tjera. Njësitë e vogla kanë më shumë gjasa për të nën-kontraktuar ofrues të shërbimeve të kontabilitetit për përgatitjen e pasqyrave të tyre të konsoliduara (21% kundrejt 11% për njësitë e tjera). Shumica e NVM-ve kanë një staf të departamentit të kontabilitetit prej 2 deri në 5 persona. Nuk është për t'u habitur që rezulton në kontabilitet që niveli i kualifikimit të stafit të kontabilitetit

është i lidhur me madhësinë e njësisë ekonomike.

Për njësitë e vogla, adoptimi i një seti të përbashkët të standardeve të kontabilitetit ka të ngjarë që, të paktën në fillim, të rrisë shpenzimet për të siguruar shërbime të jashtme të kontabilitetit për përgatitjen e pasqyrave individuale dhe të konsoliduara. Nuk duket e mundur që miratimi i një seti të përbashkët të standardeve të kontabilitetit të modifikojë praktikën e NVM-ve në fushën e kontabilitetit. Në Francë, në veçanti (54%), dhe në një masë më të vogël në Britaninë e Madhe dhe në Gjermani (45%), funksioni i kontabilitetit (ose i ofruesit të shërbimit) është përgjegjës për funksionin e kontrollit dhe menaxhimit të njësisë ekonomike.

2.4 Kuadri teorik

Kuadri teorik i këtij punimi është një përmbledhje e asaj që është thënë në literaturë. Në bazë të këtij kuadri teorik, do të ndërtohen pyetësorët dhe intervistat. Analiza do të bëhet mbi gjetjet empirike duke krahasuar këto gjetje me atë çka është shkruar në literaturë dhe teori.

Ajo që vërehet në literaturën ndërkombëtare ekzistuese, është se SNRF për NVM është një set standardesh globale të kontabilitetit që rrisin cilësinë e pasqyrave financiare duke rritur krahasueshmërinë e tyre. Në shumë vende evropiane, NVM-të zbatojnë standardet lokale të kontabilitetit. Edhe në Shqipëri, NVM-të prej vitit 2008 zbatojnë standardet kombëtare të kontabilitetit. Teoria sugjeron që SNRF për NVM do të rrisë cilësinë dhe krahasueshmërinë e raportimit financiar të NVM-ve gjë që e bën informacionin financiar më të besueshëm dhe të krahasueshëm globalisht.

Pasqyrat financiare me cilësi dhe krahasueshmëri të lartë i japin NVM-ve mundësinë e aksesit në financime edhe nga burime të ndryshme (Neag, Masca & Pascan, 2009). Kur çdo vend harton pasqyra mbështetur në standardet e veta lokale, kjo gjë e çënon krahasueshmërinë në nivel global pasi kërkesa të ndryshme në vende të ndryshme interpretohen në mënyra të ndryshme (Pacter, 2004).

Sipas teorisë së përmendur më sipër, përdoruesit më kryesorë të pasqyrave financiare të NVM-ve janë bankat, shitësit, agjencitë e kreditimit, huadhënësit e ndryshëm, venture capitalists, investitorët, pronarët, autoritetet e taksave dhe agjencitë qeveritare (Pacter, 2004; IASC Foundation Education, 2009; Neag, Masca & Pascan, 2009; Lippitt & Oliver, 1983). Këta përdorues janë kryesisht të interesuar për një informacion të përgjithshëm financiar mbi njësinë ekonomike dhe nuk kanë ndonjë kërkesë specifike lidhur me këtë informacion (IASC Foundation Education, 2009). Ata janë të interesuar për pozicionin dhe performancën financiare si dhe ndryshimet në pozicionin financiar mbi të cilin ata mbështesin vendimet e tyre ekonomike (Epstein & Jermakowicz, 2010).

Standardet e ndryshme të kontabilitetit e bëjnë të vështirë për përdoruesit që të kuptojnë dhe krahasojnë raportet e ndryshme financiare (IASC Foundation Education, 2009). Përdoruesit e pasqyrave financiare të NVM-ve janë të ndryshëm nga përdoruesit e pasqyrave financiare të njësive të mëdha të listuara pasi ata kanë nevojë dhe kërkesa të ndryshme (Lippitt & Oliver, 1983). Në teori thuhet se SNRF për NVM, përveç se synon rritjen e cilësisë së informacionit, harmonizimin dhe krahasueshmërinë e tij për përdoruesit e ndryshëm, zbatimi i tij mund të rrisë eficiencën e tregut dhe të ulë koston e sigurimit të kapitalit (Mirza, Holt & Orrell, 2008).

Përfitimet që vijnë nga zbatimi i SNRF për NVM nuk mund të kufizohen vetëm në përfitimet që kanë huadhënësit dhe investitorët; edhe palë të tjera si ato që kërkojnë të gjenerojnë kapital nga tregjet përfitojnë nga zbatimi i SNRF për NVM në terma të reduktimit të koston së pajtueshmërisë dhe uljes së pasigurisë e cila në vetvete ndikon në koston e sigurimit të kapitalit (IASC Foundation Education, 2009). Kosto e kapitalit do të jetë më e ulët si pasojë e një reagimi pozitiv të investitorëve të njësive ekonomike evropiane drejt adoptimit të SNRF për NVM, gjë e cila çon në një cilësi më të lartë të raportimit financiar (Armstrong, Barth, Jagolinzer & Riedl, 2008). Norma e kthimit mbi kapitalin e investuar është shumë e rëndësishme si për NVM ashtu dhe për njësitë e listuara, pasi vendimet mbi aktivitetet e tyre janë ngushtësisht të lidhura me koston e kapitalit (Lippitt & Oliver, 1983).

Pronarët e njësive ekonomike kërkojnë pasqyra financiare për të analizuar shpenzimet kapitale, buxhetin, planet e borxheve dhe financimeve si dhe për të mundësuar kontrollin dhe vendimmarrjen (Jarvis, 2003, p. 80). Me qëllim që të tërheqë interesin e investitorëve të tregjeve të kapitalit, një njësi ekonomike duhet të hartojë pasqyra financiare sipas SNRF për NVM të cilat ofrojnë informacion mbi financat dhe qëndrueshmërinë e njësive ekonomike (Epstein & Jermakowicz, 2010).

Teoria sugjeron se SNRF për NVM mbështetet në parimin e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara si dhe në parimin e vijimësisë. Së bashku, këto parime konsiderohen si supozimet bazë për paraqitjen e vërtetë dhe të sinqertë të informacionit në pasqyrat financiare (Mirza, Holt & Orrell, 2008).

Kalimi nga SNRF e plotë në SNRF për NVM, do t'i bëjë pasqyrat financiare të njësive të vogla dhe të mesme më globale, të kuptueshme dhe transparente (Aras & Croether, 2008). Seksionet e SNRF për NVM janë hartuar me karakteristikat e kuptueshmërisë, besueshmërisë, rëndësisë dhe krahasueshmërisë, karakteristika të cilat kërkojnë nga BE përpara se SNRF për NVM të miratohet si e detyrueshme për zbatim (Armstrong, Barth, Jagolinzer & Riedl, 2008).

Teoria pranon se adoptimi i SNRF të plotë ose qoftë dhe i SNRF për NVM, është kosto në kohë dhe burime për çdo njësi ekonomike, madje një kosto më e madhe se ajo e pritshme (Street and Jr. Needles, 2009). Tranzicioni do të jetë një barrë e rëndë për njësitë ekonomike meqenëse në shumë raste ato do të duhet të përballen me risqe të ndryshme dhe do t'u duhet të harxhojnë më shumë punë dhe kohë por përse jo edhe të paguajnë para ekstra për shërbime plus që duhet të marrin nga ekspertët kontabël apo kontabilistët e miratuar. Është provuar në teori që kosto e kalimit nga një set në një set tjetër raportimi është më e ulët në ato vende që kanë një kulturë të standardeve të harmonizuara dhe anasjelltas (Taylor, 2009).

Autorë të ndryshëm arrijnë në përfundimin teorik se investitorët e njësive ekonomike evropiane do të reagojnë negativisht nëse NVM-të e vendeve të tyre do të duhet të adoptojnë SNRF për NVM për shkak të ndryshimeve rajonale të ekonomive në vende të ndryshme të botës, për shkak se ata e konceptojnë zbatimin e SNRF për NVM me ndikim negativ në cilësinë e raportimit financiar në nivel lokal, si dhe kanë frikë se do të jetë më e madhe kosto e kalimit drejt SNRF për NVM sesa përfitimet që vijnë prej saj (Armstrong, Barth, Jagolinzer & Riedl, 2008).

Kosto dhe përfitimet e hartimit të pasqyrave financiare variojnë sipas përmasave dhe tipit të njësive ekonomike, që do të thotë se kostot janë më të larta për njësitë e vogla (Harvey & Walton, 1996). Nga ana tjetër BSNK deklaroi se në hartimin e SNRF për NVM ka mbajtur shumë në konsideratë raportin kosto përfitim të zbatimit të këtij standardi (IASC Foundation Education, 2009).

Nga këndvështrimi i përfitimeve, teoria pranon që raportet financiare të përgatitura në përputhje me SNRF për NVM do të ishin të një cilësie shumë më të

lartë. Por kostot fillestare të tranzicionit do të ishin aq të larta sa do të bënin të neglizhoheshin edhe përfitimet, kështu thotë Taylor kur krahasoi vlerën e shtuar nga zbatimi i SNRF për NVM dhe koston e adoptimit të saj (Taylor, 2009). Besohet në teori, se përdoruesit e raporteve financiare të njësive të vogla do të kishin përfitime të mëdha gjatë monitorimit dhe vendimmarrjes në biznesin e tyre kur pasqyrat janë hartuar në një mënyrë efektive dhe eficiente (Jarvis & Collis, 2003).

Teoria sugjeron që njësitë ekonomike kur përgatisin pasqyrat e tyre financiare sipas SNRF për NVM, ato e përfshijnë veten e tyre në cilësinë dhe karakteristikat e Përgjegjësisë Sociale të Korporatave. Njësitë ekonomike duhet ta ndjejnë në mënyrë vullnetare nevojën për t'u përfshirë në karakteristikat e PSK por çështjet që hasin njësitë ekonomike kur bëjnë një gjë të tillë janë: balanca e nevojave dhe pritshmërive të palëve të interesit, çështjet e qëndrueshmërisë dhe mënyrave të raportimit dhe së fundi, justifikimi i aktiviteteve se cilat mund të jenë shoqërisht më të përgjegjshme (Aras & Croëther, 2008).

Teoria pranon se falë kompleksitetit të ngjarjeve dhe transaksioneve, si dhe trajtimeve të përshtatshme sipas SNRF për NVM, do të duhet që një kontabilist të ketë njohuri si në çështjet e biznesit dhe në ato të ekonomisë. Teknikalitetet e standardit dhe aplikimi në një mënyrë të saktë të tij kërkon që kontabilisti të ketë gjithashtu njohuri të mira edhe në çështje dhe aspekte të legjislacionit dhe etikës (Aras & Croëther, 2008). Nga një këndvështrim ligjor, standardet e mbështetura në rregulla janë shumë më të preferuara nga kontabilistët krahasuar me standardet e mbështetura në parime, për vetë faktin se nuk u duhet të bëjnë gjykime të vetat kur nuk gjejnë rregulla të qarta në standardet e kontabilitetit (Shortridge & Myring, 2004).

Sipas teorisë, pronarët (menaxherë ose jo menaxherë) në njësitë e vogla dhe të mesme janë më aktiv në menaxhimin e njësive pasi ata janë shumë të përfshirë në të, pra kanë më shumë të drejta të përdorin informacionin e brendshëm krahasuar me njësitë ekonomike të mëdha. Kjo afërsi me menaxhimin i bën pronarët më të pavarur nga raportet financiare në vendimmarrjet e tyre mbi aktivitetin e biznesit (Lippitt & Oliver, 1983).

Bankat përdorin pasqyrat financiare të NVM-ve për të kuptuar aftësinë e tyre për të kthyer mbrapsht huanë dhe për të përcaktuar përfitueshmërinë, sigurinë dhe likuiditetin. Sipas Robin Jarvis, për bankat këto pasqyra financiare janë shumë të përdorshme në vendimet e tyre mbi huadhënien si dhe në monitorimin e marrëveshjeve të huasë (Jarvis, 2003). Shumë NVM kanë ose kërkojnë të marrin hua nga bankat dhe për këtë qëllim bankat mbështeten në pasqyrat financiare për të përcaktuar më pas termat e kredisë apo normat e interes të saj (IASC Foundation Education, 2009).

Teoria pranon që autoritetet e taksave janë një nga përdoruesit më të mëdhenj të pasqyrave financiare të NVM-ve. Këto autoritete i përdorin pasqyrat financiare për të llogaritur fitimin bruto, shpërblimet e drejtuesve, llogaritjet e taksave, shpenzimet totale si dhe për të kontrolluar nëse shpenzimet e marra në llogaritje janë ato të lejuara (Lungu, Caraiani, & Dascalu, 2007). Në vende të ndryshme ka legjislacione të ndryshme taksash dhe pasqyrat financiare të hartuara në përputhje me SNRF për NVM jo gjithnjë mund të përputhen me to. Në situata të tilla, njësitë ekonomike që do të adoptojnë SNRF për NVM duhet të përgatisin dy sete të ndryshme raportesh financiare, njëri në përputhje me SNRF për NVM dhe tjetri në përputhje me kërkesat e legjislacionit të tatim taksave. Ndryshimet në legjislacionin e taksave mund të bëhen vetëm prej autoriteteve qëndrore dhe vetëm nëse janë në interes të ekonomisë kombëtare dhe vetë njësive ekonomike (BSNK, 2009).

KAPITULLI 3 - METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Ky kapitull do të përshkruajë metodologjinë e përdorur në këtë punim. Në këtë kapitull do të përshkruhen tipet e metodave të zgjedhura për mbledhjen e të dhënave dhe analizat nga një perspektivë e caktuar, si dhe arsyet përse u zgjodhën këto metoda në morinë e metodave të tjera alternative. Gjithashtu, do të zenë vend në këtë kapitull dhe diskutimet mbi zgjedhjen e subjektit të studimit, paragjykimet, perspektiva, qasja e kërkimit, konceptimi i kërkimit dhe metodat e mbledhjes së të dhënave për këtë studim.

3.1 Zgjedhja e subjektit të punimit

Zgjedhja e subjektit të këtij studimi u mbështet në çështjen e diskutueshme mbi adoptimin e SNRF për NVM në Shqipëri. BSNK ka debatuar dhe diskutuar gjatë për hartimin e një standardi të veçantë për njësitë e vogla dhe të mesme dhe përfundimisht publikoi në korrik 2009 SNRF për NVM. Ndërsa në Shqipëri për këtë grup njësisish ekonomike, që prej vitit 2008, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka publikuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të hartuara në koherencë me standardet e plota të kontabilitetit dhe raportimit financiar (SNK / SNRF).

SNRF-të e plota, që prej vitit 2005, u bënë të detyrueshme në Bashkimin Evropian, por për një segment të caktuar njësisish ekonomike, për ato të listuara në bursë. Nuk ka një rregullim të tillë të detyrueshëm për NVM-të, pra SNRF për NVM nuk është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të tilla njësi ekonomike, brenda Bashkimit Evropian. Por përdoruesit e jashtëm të këtyre pasqyrave në këto vende, që përfshijnë pronarët jomenaxherë, kreditorët e tjerë dhe agjensitë e kreditimit, kërkojnë pasqyra financiare të përshtatshme për vendimmarrjen e tyre dhe u'a lënë organizmave të profesionit të gjejnë zgjidhjet e duhura.

Në vendet e Bashkimit Evropian, njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme kanë një set të caktuar standardesh lokale të kontabilitetit të cilat përdoren për hartimin e pasqyrave ekonomike të NVM-ve që operojnë brenda territoreve kombëtare të këtyre vendeve. Këto standarde lokale kanë qenë të hartuara dhe të përdorura efektivisht për për të përmbushur qëllimin e pasqyrave financiare, atë të sigurimit të një informacioni të saktë e cilësor që mundëson kontrollin dhe vendimmarrjen. Por, krahasueshmëria e informacionit financiar të këtyre pasqyrave është e limituar vetëm brenda kufijve të çdo shteti.

Është e vërtetë se njësitë ekonomike të listuara kanë një rreth më të gjerë përdoruesish të informacionit kontabël, brenda dhe jashtë vendit. Janë më të shumtë kreditorët, investitorët e të tjerë të interesuar, që kanë nevojë për një informacion më të shumtë, më të detajuar, më të kualifikuar, me qëllim të krijimit të një pamje dhe dijenie më të thellë të pozicionit dhe performancës financiare. Por me globalizimin e ekonomisë rritet interesi për akses në financa ndërkombëtare dhe investime në vende të tjera edhe për njësitë e mesme, ndoshta jo ato të vogla.

Në këtë rast, mendimi apo debati rreth të cilit unë dua të arrij në një përfundim, është fakti nëse njësitë ekonomike pa përgjegjësi publike në Shqipëri, janë të interesuar dhe a kanë përgatitjen e duhur për t'u përshtatur me një ndryshim të kuadrit të raportimit, gjithnjë nëse kjo do të konsiderohet një prurje pozitive në nivel teknik

për kushtet aktuale të vendit tonë. Sa më lart, është arsyeja përse kam zgjedhur këtë subjekt specifik për studimin tim.

3.2 Paragjykimet

Me qëllim që përfshirja në një studim të jetë objektive, patjetër duhet që të ketë një fazë të mëparshme të shfaqjes së interesit për subjektin apo fushën në fjalë. Kjo përfshirje e mëhershme ndihmon në zgjedhjen e metodave të përshtatshme si dhe instrumenteve për mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre. Të qenurit i panjohur me fushën ku kërkon të bësh një studim specifik të bën konfuz dhe rrezikon të zgjedhësh objektiva që nuk lidhen mes tyre apo me fushën e studimit. Një gjë e tillë krijon premisat që të mos kesh shumë të qartë nga t'ia fillosh e për më tepër të mos arrish në rezultatet përfundimtare.

Përcaktimi i objektivave nuk është një detyrë e thjeshtë, dhe për qëllime të këtij punimi më është dashur të kaloj përmes shumë diskutimeve me veten dhe të tjerë kolegë apo profesorë të mi, me qëllim që të specifikoj qartë objektivat e këtij studimi. Kështu që objektivi që kam përcaktuar është qasja e njësive ekonomike në terma të gadishmërisë dhe përgatitjes së tyre në drejtim të adoptimit të një seti të ri standardesh, atë të SNRF për NVM, në hartimin e pasqyrave financiare. Nga ana tjetër, sa vlerë e shtuar, në kuptimin e cilësisë së vendimarrjes së përdoruesve të informacionit financiar, është adoptimi i SNRF për NVM.

Si autor i këtij punimi, vij me një background tërësisht të lidhur me objektivin e studimit. Shkollimi universitar dhe pasuniversitar janë në fushën e kontabilitetit, punësimet e mia në fillimet e karrierës kanë qenë si hartuese e pasqyrave financiare ndërsa prej disa vitesh kontribuoj në një tjetër dimension, gjithnjë të lidhur me kontabilitetin, si pjesë e stafit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, organizmi i vetëm në Shqipëri që harton Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Pavarësisht se si hartuese pasqyrash financiare nuk kam patur rastin të hartoj pasqyra sipas SNRF për NVM, por vetëm me SKK, zotëroj mjaftueshëm dije në nivel teorik madje dhe si lektore apo trajnere për këtë standard, në universitetet dhe shoqatat profesionale në Shqipëri.

Pikërisht, në këtë periudhë kur unë jam e angazhuar me kohë të plotë si staf i KKK dhe sidomos kur ky organizëm është i përfshirë në një projekt të Bankës Botërore me synim përmirësimin e raportimit financiar të njësive ekonomike, mora nxitjen të thelloj dijet e mia dhe të punoj për këtë çështje kaq të debatuar në nivel botëror, nëse është rasti dhe momenti që edhe Shqipëria të adoptojë SNRF për NVM.

Padiskutim, që në hapat e parë të idesë time për të zgjedhur këtë subjekt për studimin, i jam referuar shumë artikujve të publikuar në gazeta dhe revista shkencore të njohura në fushën e kontabilitetit. Një ndihmesë shumë e madhe kanë qenë materialet shkencore profesionale të publikuara në websitet e organizmave ndërkombëtare profesionale dhe shoqërive ndërkombëtare të auditimit. Meqenëse ky standard, apo diskutimi për adoptimin e tij është relativisht i ri për tregun shqiptar, më lindi ideja e vlerësimit të reagimit të njësive ekonomike ndaj këtij standardi dhe cila do të ishte qasja më e mirë për adoptimin e tij. Interesimi im u rrit më shumë kur nga kërkime paraprake në libraritë online të institucioneve tona arsimore nuk gjeta ndonjë studim të mirëfilltë për këtë çështje. Pra, ajo për të cilën kërkoj një përgjigje në këtë studim është nëse përmirësohet raportimi financiar dhe bashkë me të, vendimet ekonomike të përdoruesve të informacionit financiar, nga adoptimi i SNRF për NVM,

por duke e parë të lidhur këtë përfitim me gadishmërinë dhe përgatitjen profesionale të përgatitësve të pasqyrave financiare. Për të qenë më specifike në kërkimin tim rreth qasjes së këtyre njësive ndaj SNRF për NVM zgjidha të mbledh të dhëna vetëm në njësitë ekonomike që operojnë në Shqipëri, në rrethet më të mëdha urbane.

3.3 Perspektiva

Në një studim të Eriksson dhe Wiedersheim-Paul (1997), cituar në (Arey dhe David 2008), p.7) perspektiva tregon këndvështrimin rreth problemit të kërkimit nga dimensione të ndryshme me mundësinë e zgjedhjes së dimensionit më të përshtatshëm për problemin në të cilin një studim fokusohet. Gjykimi individual ka shumë rëndësi në zgjedhjen e perspektivës pasi ka të bëjë me mënyrën se si individi e sheh realitetin dhe se si ai e percepton atë nga perspektiva të ndryshme.

Disiplina dhe fusha e studimit të një individi ka shumë rëndësi për faktin se e pajis individin me njohuritë e nevojshme për të realizuar një kërkim të mirë duke bërë zgjedhjen e duhur të perspektivës. Pra, sa më sipër forcon idenë se gjërat mund të perceptohen ndryshe nga individë të ndryshëm për shkak të dijeve dhe ekspertizës së tyre të mëparshme.

Çështja që unë kam zgjedhur të elaboroj në punimin tim, do të shihet nga një perspektivë kontabël dhe akademike, meqenëse punimi do të mbështetet në teori kontabiliteti dhe akademike. Megjithatë SNRF për NVM mbulon si perspektivën e brendshme dhe atë të jashtme, kryesisht unë do ta shoh punimin nga një perspektivë e jashtme dhe vetëm në disa pjesë të saj nga një perspektivë e brendshme.

3.4 Filozofia e kërkimit

Filozofia e kërkimit është shumë e rëndësishme për të zgjedhur konceptimin e duhur të kërkimit i cili mundëson arritjen e përfundimeve. Ka dy filozofi kërkimi: filozofia *epistemologjike* dhe ajo *ontologjike*.

Epistemologjia ka të bëjë me studimin e dijes. Termi ‘Epistemology’ vjen nga Greqishtja e vjetër, [Epistemo – do të thotë "dije, të kuptuarit", dhe - logos, do të thotë "studimi i"). Epistemologjia është degë e filozofisë që merret me natyrën dhe qëllimin e dijes e gjithashtu njihet ndryshe si “teoria e dijes”. Me pak fjalë kjo degë e filozofisë shpjegon *çfarë* është dija dhe *si mund të përfitohet* ajo si dhe shkallën në të cilën një subjekt apo një entitet mund të njihet. Shumë debate në këtë fushë fokusohen në analizimin e natyrës së dijes dhe marrëdhënien e saj me konceptet e lidhura me të si: e vërteta, besimi dhe justifikimi. Termi epistemologji u prezantua për herë të parë nga filozofi skocez James Frederick Ferrier (1808–1864).

Epistemologjia përshkruan mënyrën si mund të mësojmë rreth botës, pra si mund të studiojmë mbi realitetin. Më pas, kjo degë e filozofisë ndahet në dy pjesë: pozitivizmi dhe interpretivizmi (fenomenologjia).

Pozitivizmi është të studiuarit e një realiteti shoqëror dhe përtej, që do të thotë si mund të interpretohet bota sociale si një shkencë natyrore. Ndërsa interpretivizmi është e kundërta e pozitivizmit dhe ka të bëjë me element të tillë si vlerat dhe normat.

Qëndrimi subjektiv i kërkuesit dhe i gjithë komunitetit të kërkuesve është shumë i rëndësishëm në interpretimin e realitetit (Bryman & Bell, 2007).

Në anën tjetër, ontologjia, apo supozimet ontologjike i referohen subjektit të ekzistencës. Ontologjia si degë e filozofisë merret me studimin filozofik të natyrës së të qenurit, të bërit, ekzistencës ose realitetit, si dhe me kategoritë kryesore të qenieve dhe marrëdhëniet e tyre. Tradicionalisht, e renditur si dega më e madhe e filozofisë, që quhet ndryshe edhe metafizika, ontologjia interesohet për çështje të tilla si: çfarë entitetesh ekzistojnë ose thuhet se ekzistojnë, dhe për mënyrën si mund të grupohen brenda një hierarkie, e më pas vjen një nënndarje në përputhje me të përbashkëtat dhe ndryshimet me tyre. Pra, ontologjia trajton natyrën e botës dhe qenieve njerëzore në kontekstin social (Bryman & Bell, 2007). Kjo degë vetë ndahet në: objektivizëm dhe konstruktivizëm.

Objektivizmi është një theksim normativ që pohon se fenomenet shoqërore dhe kuptimi i tyre kanë një ekzistencë të pavarur nga aktorët shoqërorë (Bryman & Bell, 2007).

Konstruktivizmi si qëndrim, pranon se fenomenet shoqërore dhe kuptimi i tyre mund të realizohen nga aktorët shoqërorë, pra realiteti i botës sociale ndërtohet dhe nuk mund të ekzistojë jashtë tyre (Bryman & Bell, 2007).

Në studim, për supozime epistemologjike kam marrë qëndrimin **interpretivist** dhe për supozimet ontologjike kam mbajtur qëndrimin **konstruktivist**.

Arsyeja është se në studim do të investigohet në çfarë shkalle ligjvënësit, njësitë ekonomike dhe përdoruesit e informacionit financiar duan të adoptojnë SNRF për NVM dhe cili është reagimi pro / kundër këtij propozimi. Sipas qasjes *interpretiviste*, mbështetur në normat dhe vlerate mia, do të identifikoj dhe interpretoj qasjen e të gjithë aktorëve të përmendur ndaj standardit të NVM. Qëndrimi *konstruktivist*, sipas supozimit ontologjik, do të më mundësojë si kërkues të realizoj rezultatet përfundimtare pas analizimit të dijeve të fituara.

Gjykimi subjektiv i të anketuarëve dhe të intervistuarve në shprehjen e qëndrimeve të tyre do të jetë shumë i rëndësishëm për mua duke lehtësuar detyrën e interpretimit të fakteve dhe ngritjes së opinioneve.

3.5 Qasja e kërkimit

Qasja e kërkimit ka të bëjë me rrugën në të cilën mblidhen të dhënat për të formuluar më pas përgjigjen për pyetjen e kërkimit (Saunders et al., 2000). Filozofia e kërkimit zakonisht mbështetet në interpretimet e kërkuesit të të dhënave, fakteve dhe njohurive. Është thjesht rruga që bëjmë gjatë kërkimit për të zhvilluar njohuritë dhe dijet, më shumë se sa thellimi në to, pra jo diçka që shpreh mendimin tuaj (Saunders et al., 2000). Kështu që implementimi i metodave të përshtatshme për arritjen e një baze të shëndoshë për studimin është thelbësore për çdo lloj kërkimi.

Dy janë çështjet kryesore që orientojnë përgjigjen mbi qasjen e kërkimit. Së pari, për çfarë forme teorie flitet në studim dhe së dyti, nëse janë mbledhur të dhënat e nevojshme për të testuar ose për të ngritur një teori (Bryman & Bell, 2007).

Sipas Bryman & Bell, qasjet e kërkimit mund të ndahen në tre tipe të ndryshme: induktive, deduktive dhe abduktive. Në qasjen deduktive zhvillohet fillimisht struktura konceptuale dhe teorike (modeli) e më pas ai testohet nga të dhënat empirike. Në këtë qasje përdoren hipotezat testuese për të nxjerrë rezultatet dhe përfundimet. Zakonisht, kjo qasje të çon nga e përgjithshmja tek specifika dhe të

dhënat mblidhen për të testuar teorinë. Sipas kësaj qasje, teoria zhvillohet nga vëzhgimet e realitetit empirik dhe të gjitha gjetjet lidhen me kërkimin e fakteve se cili është realiteti (Bryman & Bell, 2007). E thënë më drejtpërdrejt, deduksioni përfshin një proces në të cilin:

Teoria $\Longrightarrow$ Vëzhgimet / Gjetjet

Sipas induksionit gjejmë lidhjen e kundërt:

Vëzhgimet / Gjetjet $\Longrightarrow$ Teoria

Dhe në fund, abduksioni është kombinimi i të dyjave, qasjes deduktive dhe asaj induktive. Më thjesht ai paraqitet sipas skemës:

Vëzhgimet / Gjetjet $\Longrightarrow$ Teoria $\Longrightarrow$ Vëzhgimet / Gjetjet
ose
Teoria $\Longrightarrow$ Vëzhgimet / Gjetjet $\Longrightarrow$ Teoria

Në punim përdoret qasja abduktive. Fillimisht ky studim fillon me teorinë rreth SNRF-ve, NVM-ve dhe më pas të SNRF për NVM-të. Mbështetur në këto teori zhvillohet kuadri teorik i cili do të më ndihmojë të krijoj modelin e anketës dhe të intervistës. Analiza e gjetjeve empirike do të testohet kundrejt kuadrit teorik dhe në mbështetje të kësaj analize do të nxirren dhe konkluzionet e këtij studimi. Nëse gjetjet empirike do të jenë në linjë me kuadrin teorik do të thotë që nuk gjeneron ndonjë teori e re. Do të ishte kontribut teorik fakti nëse gjetjet empirike nuk do të vërtetonin teorinë ekzistuese dhe arsyet për këtë jepen nga të anketuarit dhe të intervistuarit për të mbështetur qëndrimet dhe opinionet e tyre për të refuzuar disa vëzhgime/gjetje të veçanta.

3.6 Konceptimi i kërkimit

Në teori ka disa tipe të ndryshme të konceptimit apo hartimit të një kërkim (Bryman & Bell, 2007, p. 39). i:

- *Konceptimi historik (Historical Research Design)* – qëllimi është të mbledhë, verifikojë, sintetizojë prova për të përcaktuar faktet që mbrojnë ose që hedhin poshtë hipotezën/at e ngritura. Ky konceptim përdor burimet primare, burime dytësore dhe shumë prej burimeve cilësore të të dhënave të tilla si artikujt, punimet shkencore, të dhënat zyrtare, raporte të ndryshme, etj. Kufizimi është se burimet duhet të jenë të dyja autentike dhe të vlefshme.


- *Konceptimi sipas një rasti studimi (Case and Field Research Design* - quajtur ndryshe hulumtim etnografik, përdor vëzhgime të drejtpërdrejta për të dhënë një pamje të plotë të një rasti që është duke u studiuar. Kjo është e dobishme kur nuk dihet shumë në lidhje me një fenomen. Përdor disa subjekte.
- *Konceptimi përshkrues ose i mbështetur mbi pyetësorë (Descriptive or Survey Research Design)* – tenton të përshkruajë dhe të shpjegojë kushtet aktuale duke përdorur shumë subjekte dhe pyetësorët për të përshkruar plotësisht një fenomen. Metodologjia e anketimit dhe pyetësorëve është një nga më të përdorurat për kërkim shkencor. Ka shumë avantazhe për vetë shkallën e gjerë të përfshirjes së palëve të interesit.
- *Konceptimi korelativ ose prospektiv (Correlational or Prospective Research Design)* - një përpjekje për të shqyrtuar marrëdhëniet e më pas për të bërë parashikime. Përdor disa tregues me dy ose më shumë variabla për secilin.
- *Konceptimi shkaksor krahasimor ose një post analizë e fakteve të ndodhura (Causal Comparative or Ex Post Facto Research Design)* – përpiqet të shqyrtojë marrëdhëniet shkak pasojë ku tashmë shkaqet ekzistojnë dhe nuk mund të manipulohen. Ky konceptim nënkupton që të përdoret gjithçka që tashmë ekziston për të shikuar prapa dhe për të shpjeguar se pse.
- *Konceptimi i zhvillimit të serive kohore (Developmental or Time Series Research Design)* – nënkupton se të dhënat janë mbledhur në momente të caktuara në kohë të shkuar. Theksi vihet mbi modelet kohore, rritjeve ose ndryshimeve gjatësore.
- *Konceptimi eksperimental (Experimental Research Design)* – është më i përshtatshëm në mjedise të kontrolluara të tilla si laboratorët. Sipas këtij konceptimi përzgjidhen në mënyrë të rastësishme subjektet, po ashtu dhe grupet. Më pas përpiqet të shqyrtojë marrëdhënien shkak pasojë për shkaqe që mund të manipulohen për të prodhuar lloje të ndryshme të efekteve. Për shkak të kërkesës së përzgjedhjes së rastit, ky konceptim mund të jetë i vështirë për tu realizuar në botën reale (jo laboratorike).
- *Konceptimi pothuaj eksperimental (Quasi Experimental Research Design)* – i përafrohet konceptimit eksperimental, por nuk ka një grup kontrolli. Ka më shumë mundësi të ketë gabime në rezultatet e eksperimentit.

Ky studim do të konceptohet sipas *konceptimit përshkrues ose të mbështetur mbi pyetësorë dhe intervista (Descriptive or Survey Research Design)*, pra i kryqëzuar. Ndryshe quhet studim i konceptuar si një anketim social. “Konceptimi i kryqëzuar përfshin mbledhjen e të dhënave në më shumë se një rast në një moment të caktuar kohe me qëllim sigurimin e një baze të dhënash sasiore dhe cilësore në lidhje me një ose më shumë çështje, të cilat më pas analizohen për të gjetur pikat e takimit të tyre” (Bryman & Bell, 2007, p. 55). Kur një numër i konsiderueshëm rastesh kqyren në një moment të caktuar kohe atëherë mund të konsiderohet një studim.

Në këtë konceptim të studimit, janë përdorur pyetësorët dhe intervistat për rastet e ndryshme të NVM-ve. Variacioni në përgjigje është shumë i vlefshëm dhe mund të arrihet vetëm nëse shqyrtohen një numër i konsiderueshëm rastesh. Po ashtu, edhe mbledhja e të dhënave mbyllet në një moment të caktuar kohe. Padyshim që për

pyetësorët dhe intervistat, është besimi që të anketuarit dhe intervistuarit kanë vullnetin t'i përgjigjen pyetjeve dhe të kthejnë përgjigje në kohën e parashikuar.

Përmes këtyre të dhënave do të sigurohen gjetje të vlefshme që do të ndihmojnë në sigurimin e përgjigjeve të pyetjeve të studimit. Duke përdorur këtë konceptim shqetësimi dhe interesimi im do të jetë për kampionin e zgjedhur për anketim dhe intervistim. Në përzgjedhje do të mbaj në konsideratë faktin që kampioni i marrë në studim të jetë përkatës dhe i rëndësishëm për popullatën e përgjithshme. Pra pika e fortë e këtij studimi derivon nga prezantimi i rasteve të ndryshme, të cilat do të dalin nga reagimet e ndryshme të NVM-ve ndaj adoptimit të SNRF për NVM në Shqipëri.



Figurë 3.1 – Konceptimi i punimit

3.7 Strategjia e kërkimit

Dy metodat kryesore që aplikohen në përgjithësi nga kërkuesit në punimet e tyre janë: *metoda sasiore* dhe *metoda cilësore*. Secila prej tyre ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi metodat që implikohen në kërkim për mbledhjen e të dhënave (Kekwle, de Weerd-Nederhof, Cervai and Borelli, 2009).

“Kërkimi sasior fokusohet kryesisht në ndërtimin e një baze të dhënash sasiore dhe të dhënat sasiore janë një regjistrim sistematik i numrave që dalin nga kërkimi duke përdorur procesin e matjes dhe sipas një strukture të caktuar” (Ray Kent, 2007).

Kërkimi cilësor është një metodë që përdoret në disiplina akademike të ndryshme. Përmes kësaj metode, kërkuesit synojnë të kuptojnë më thellë sjelljen e individëve apo të shoqërisë si dhe arsyet e qëndrimit të tyre. Metoda cilësore investigon “përse” dhe “si” merret një vendim, jo “çfarë”, “ku” dhe “kur” merret një vendim. Në këtë metodë kampionet e përzgjedhur të studimit janë më të vegjël dhe më të fokusuar se ato të përzgjedhur në metodat sasiore.

Nga një pikëpamje konvencionale, metoda cilësore prodhon informacion vetëm mbi rastet e marra në studim dhe konkluzionet e përgjithshme janë vetëm propozime (pohime informuese). Më pas përdoren metodat sasiore për të provuar në mënyrë

empirike çdo hipotezë të kërimit (Denzin, Norman K. & Lincoln, Yvonna S. (Eds.), 2005).

Në studim do të përdoren të dyja strategjitë e kërimit, kërkiti cilësor përta i përket opinioneve të përdoruesve të pasqyrave financiare dhe të ekspertëve të fushës (për pasojë do të përdoren intervista të gjysmë-strukturuara për mbledhjen e të dhënave) dhe kërkiti sasior përta i përket mbledhjes së të dhënave mbi disa variabla të tjerë përcaktues të mbështetjes së pohimit të punimit. Përzgjedhja e metodës cilësore u bë për disa arsye:

- *Së pari*, pjesë e interesit tim në këtë punim janë qëndrimet, pasi përmes intervistave synoj të gjeneroj një përfundim teorik. Paraprakisht do të skicoj një pamje të qartë të asaj që kërkoj në studim duke përdorur këtë metodë;
- *Së dyti*, si pjesë e një kërkiti abduktiv, të gjitha aspektet e studimit janë konceptuar me kujdes përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave me qëllim që fazat e mëtejshme të studimit të mund të realizohen me sukses;
- *Së treti*, në këtë studim interesi im është i lidhur me subjektivitetin dhe mundësinë për të “hyrë në brendësi” të eksperiencave të realitetit njerëzor;
- *Së katërti*, në punim, synoj një përfshirje nga afër të të intervistuarve, rasti i përdoruesve të informacionit financiar dhe akademikëve. Kjo është e mundur vetëm përmes metodës cilësore. Në metodat sasiore kërkuessit nuk përfshihen në qëndrimet e të intervistuarve apo anketuarëve, madje në shumicën e rasteve nuk kanë fare kontakte me ta.
- *Së fundmi*, është një instrument shumë i mirë për të udhëhequr një kërkit të gjerë tregu, konkretisht vlerësimin e dobishmërisë së adoptimit të SNRF për NVM në vendin tonë.

Përzgjedhja e metodës sasiore u bë për arsyet e mëposhtme:

- *Së pari*, kampioni i përzgjedhur nga përgatitësit e pasqyrave financiare është i madh, 381 hartues të pasqyrave financiare dhe nuk është e mundur që me këtë kampion të bësh intervista ballë për ballë, prandaj është më efektiv përdorimi i pyetësorëve me pyetje të mbyllura për të mbledhur në fund të dhëna sasiore.
- *Së dyti*, një pjesë e analizës së punimit mbështetet në analizën e njohur në ekonomi, atë të modelit kosto / përfitim. Për të bërë këtë lloj analize janë të domosdoshëm tregues sasiore.
- *Së treti*, përputhja logjike e përfundimeve të arritura nga kërkiti cilësor me atë sasior, do të ishte një garanci e mirë për vlefshmërinë e punimit.

3.8 Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave është procesi i “shfrytëzimit” të burimeve nga ku do të mblidhet informacioni përkatës i cili do të përdoret për të siguruar përgjigjet e kërimit. Burimet nga ku do të mblidhen të dhënat janë parësore dhe dytësore. Burimet parësore u referohen burimeve nga ku mblidhen të dhënat origjinale për problemet e identifikuar të studimit. Të dhënat parësore përfshijnë vëzhgimet, krahasimet, anketat në formë pyetësorësh si dhe intervistat e drejtpërdrejta. Ndërsa të dhënat dytësore janë ato që mblidhen nga kontributet e të tjerëve në kërkime të ngjashme apo të ndryshme. Burimet dytësore të të dhënave përfshijnë librat, revistat,

artikujt apo websitet, të gjitha këto kur trajtojnë të njëjtin subjekt specific (Ghauri & Gronhaug, 2005, p. 91-102).

Mbledhja e të dhënave në këtë studim filloi nga burimet dytësore, mbi bazën e të cilave është ndërtuar kuadri teorik. Fillova fillimisht me leximin e një literature të shkruar dhe nga leximi më rezultoi se jo vetëm kishte shumë interes për subjektin e zgjedhur nga unë për studim por më bindi më tepër në përcaktimin e objektivave kyç të studimit. Të gjithë pikërisht ato burime dytësore që kanë lidhje të ngushtë me studimin është një aktivitet shumë specifik dhe në një farë mënyrë është një punë e vështirë pasi duhet të ndjekësh sipas një logjike të caktuar një punë të bërë në vazhdimësi.

Të dhënat dytësore që përdora si pika referimi në këtë studim kryesisht i gjeta duke shfrytëzuar internetin. Përmes tij munda të vë në dispozicion shumë libra, artikuj, revista, materiale zyrtare të institucioneve rregullatore të shteteve të ndryshme, etj. Përsa i përket të shkruarit të kësaj doktrature, një nga burimet dytësore më të rëndësishme kanë qenë librat elektronik që më janë vënë në dispozicion në një prej kurseve të shkollës së doktoraturës.

Për mbledhjen e të dhënave primare kam punuar në dy drejtime. Burimi i parë janë matricat krahasuese të cilat shërbyen më pas për të hartuar pyetësorët dhe intervista që ishin burimi i dytë primar i të dhënave. Me të intervistuarit kam realizuar intervista gjysëm të strukturuar. Intervistat gjysëm të strukturuar të japin mundësinë të bësh një sërë pyetjesh për çështje të ndryshme specifike të cilat lindin qoftë edhe gjatë intervistimit. (Bryman & Bell, 2007). Gjatë intervistimit u bënë pyetje me fund të hapur për t'ju dhënë më shumë mundësi të intervistuarve të shprehnin qëndrimet e tyre dhe arsyet përkatëse. Në intervistat gjysëm të strukturuar rrada sipas të cilës bëhen pyetjet mund edhe të ndryshojë, por është e preferueshme të mbahen gjurmët e pyetjeve sipas të njëjtës rrade si në udhëzuesin e intervistës (Bryman & Bell, 2007). Udhëzuesin ua dërgova të intervistuarve disa ditë përpara intervistës formale kështu që të intervistuarit patën një ide më të qartë lidhur me pyetjet po gjithashtu dhe me përgjigjet lidhur me qëndrimin e tyre. Udhëzuesi u ndërtua në një mënyrë të tillë që të mund të strukturohej në dy pjesë. Pjesa e parë përmbante të dhëna lidhur me vetë intervistuesin si p.sh, detyra që mban, eksperiencia, etj. Ndërsa pjesa e dytë ishin pyetjet lidhur me çështjen që shtron për zgjidhje ky studim.

Me kampionin e përdoruesve të informacionit financiar, bankat, pronarët, tatimorët dhe akademikët, zgjodha intervistat ballë për ballë pasi i gjykoj më të preferuara në raport me tipe të tjera intervistimesh, p.sh, ato telefonike, pasi komunikimi ballë për ballë ofron më shumë konfidencë dhe kuptueshmëri mes të dy palëve. Në këto lloj intervistash paqartësitë për pyetjen apo për përgjigjen marrin zgjidhje në çast.

Në këto lloj intervistash, gjestet plotësojnë shumë mirë përgjigjen e të intervistuarit. Nga vetë formulimi, theksimi, renditja e mendimit, etj, mund të kuptohet akoma më shumë për përgjigjen e dhënë. Intervista u ndërtua e tillë që të gjeneronte maksimumin e mundshëm madje edhe të detajeve të përgjigjeve të dhëna nga të intervistuarit për përgjigjet e intervistës (Bryman & Bell, 2007).

Intervistat u zhvilluan në mjedise shumë të përshtatshme, për të dyja palët. Gjithashtu, për të intervistuarit u respektua me shumë përpikmëri kodi i etikës, sidomos kur bëhet fjalë për anonimin. Përdorimi i të dhënave do të bëhet duke ruajtur anonimin e të intervistuarit. Pyetjet kishin në fokusin e tyre vetëm aspekte profesionale dhe aspak nuk kishin për qëllim të vinin në vështirësi të intervistuarin. Të dhënat më pas u regjistruan në mënyrë të strukturuar në formate të caktuara duke krijuar kështu bazën e të dhënave të përgjigjeve. Këto të dhëna do të organizohen dhe

formalizohen në një format specifik të shkrimit të një teze, kështu që nuk është e nevojshme të rithuhet fjalë për fjalë përgjigjet e të intervistuarve. Kohëzgjatja e intervistave ishte nga 30 deri në 60 minuta.

Ndërsa përsa i përket pyetësorit, afati i pritjes së përgjigjeve ishte 60 ditë. Adresat për shpërndarjen online të pyetësorit u mundësuan nga shoqatat dhe organizmat profesionalë në vendin tonë.

3.9 Përzgjedhja e kampionit

Pjesa përfaqësuese e popullatës njihet si kampion dhe zgjedhja e duhur e tij është vendimtare në besueshmërinë e përfundimeve të një studimi (Bryman and Bell, 2007). Ky studim fokusohet në vlerësimin e përfitueshmërisë së përgjithshme nga adoptimi i SNRF për NVM duke e parë të lidhur këtë edhe me gadishmërinë e NVM-ve në Shqipëri për një reformë të tillë. Në këtë rast, kampioni përbëhet nga përdorues të informacionit financiar, hartues të tij, por përfshin gjithashtu edhe përfaqësues të administratës tatimore dhe akademikë të fushës.

Përdorues të informacionit financiar, të përzgjedhur në punim janë bankat e nivelit të dytë në cilësinë e ofruesve të fondeve, pronarët jo menaxherë në rolin e vendimarrësve të vendimeve ekonomike për njësinë ekonomike, përfaqësues të organeve tatimore të cilët janë përdorues të këtij informacioni financiar me një qëllim të caktuar, atë të mbledhjes së të ardhurave për arkën e shtetit dhe gjithashtu akademikët në cilësinë e kërkuesve shkencorë dhe edukatorëve profesionalë të gjeneratave të profesionistëve.

Përgatitësit e pasqyrave financiare janë burimi kryesor për mbledhjen e të dhënave lidhur me shkallën e gadishmërisë së NVM-ve për kalimin drejt SNRF për NVM, e lidhur kjo gadishmëri me shkallën e përgatitjes dhe kualifikimit të tyre. Edhe audituesit do të konsiderohen si kampion në këtë studim pasi ata bashkëpunojnë shumë ngushtë me NVM-të si ofrues dhe këshillues në shërbimet e kontabilitetit.

Akademikët do të përzgjidhen si pjesë e kampionit për faktin se janë ata që pajisin studentët me dije të thella e të mjaftueshme për të kuptuar standardet e ndryshme të kontabilitetit dhe ata mund të bëjnë një analizë të mirëfilltë e të detajuar në bazë të një literature shkencore, gjithnjë nga një këndvështrim akademik. Do të përpiqem të realizoj të paktën 5 intervista me akademikë të mirënjohur të Universiteteve shqiptare me qëllim që të maksimalizoj kriterin cilësor të punës kërkimore.

Baza për përzgjedhjen e kampionit, të secilit grup përbërës të tij, do të jetë e ndikuar edhe nga kufizimet në termat e kostos dhe përfitueshmërisë.

Për përzgjedhjen e kampionit përdoren dy lloj teknikash, përzgjedhja probabilitare ose ndryshe, përzgjedhja rastësore, e cila është një teknikë ku përllogaritet probabiliteti i zgjedhjes së kampionit dhe përzgjedhja joprobabilitare, që nga vetë emërtimi, tregon se nuk bëhet ndonjë përllogaritje e tillë por kjo e fundit kërkon shumë kujdes nëse zgjidhet si teknikë për t'u përdorur. Teknikat probabilitare janë të përshtatshme për studime në një shkallë të gjerë përfaqësimi ndërsa teknikat joprobabilitare shpesh janë më të përdorshme për kërkime të thelluara cilësore fokusi i të cilëve është të kuptojnë fenomene komplekse. Disa teknika joprobabilitare janë:

- **Përzgjedhja aksidentale / e përshtatshme** – ku anëtarët e popullatës përzgjidhen mbështetur në lehtësinë për të mbërritur tek ata. Këta kampionë zakonisht shoqërohen me koeficientë gabimi pasi një kërkues në mënyrë jo të qëllimshme përzgjedh disa të intervistuar dhe jo disa të tjerë që mund të ishin po aq ose edhe më të rëndësishëm (Lucas 2012);

- **Përzgjedhja me paragjykim / e qëllimshme** – ku kërkuesi e zgjedh kampionin me bindjen e tij se kush mund të jetë një i anketuar ose i intervistuar i përshtatshëm për studimin e tij. Zakonisht kjo teknikë zgjidhet kur numri i njerëzve që kanë kaq ekspertizë në këtë fushë janë disi të limituar;

- **Përzgjedhja ortek** – ku intervistuesi i parë i referohet një miku. Miku i tij gjithashtu i referohet një miku të vet dhe kështu vijon. Këta kampionë zakonisht kanë koeficient gabimi sepse përbëhen nga njerëz që kanë lidhje shoqërore zinxhir mes tyre (Berg 2006);

- **Rasti përjashtimor** – ku kërkuesi merr në studim raste që ndryshojnë në thelb nga përmbajtja me kuadrin dominues (një rast i veçantë i përzgjedhjes së qëllimshme);

- **Rasti studimor** – ku kërkuesi kufizohet vetëm në një grup, zakonisht me karakteristika të ngjashme ose i një përmase të vogël;

- **Kuotat e posaçme** – Caktohet fillimisht një kuotë (p.sh, 70% të ketë moshën 35-40 vjeç) dhe kërkuesi është i lirë të zgjedhë këdo deri sa të plotësohet kuota;

Në këtë punim, kam aplikuar si teknika të përzgjedhjes së kampionit dy prej teknikave joprobabilitare:

- *Përzgjedhja me paragjykim / e qëllimshme*, për përzgjedhjen e përdoruesve të informacionit financiar;

- *Përzgjedhja aksidentale / e përshtatshme*, për përzgjedhjen e përgatitësve të pasqyrave financiare.

Arsyeja për përzgjedhjen e teknikës së qëllimshme është se për përdoruesit e informacionit financiar kisha paraprakisht në mendje grupet ku do të bëja përzgjedhjen. Përdoruesit e informacionit financiar në kuadrin teorik janë të përcaktuar. Përsa i përket bankave iu drejtova konkretisht të 16 bankave të nivelit të dytë që operojnë në Shqipëri. Përsa i përket pronarëve jo menaxherë në mënyrë paragjyquese përzgjodha njësi ekonomike të sektorëve të veçantë që në bindjen time organizonin një kontabilitet dhe raportim financiar serioz. Ndërsa përsa i përket zyrtarëve tatimorë, numri i tyre është i limituar prandaj bëra një përzgjedhje duke patur si kriter raportin e drejtpërdrejtë që këta zyrtarë kishin me analizën dhe përdorimin e informacionit financiar në të përditshmen e punës së tyre. Për akademikët, e vetmja zgjidhje ishte zgjedhja me paragjykim pasi ashtu si dhe në fusha të tjera, ka gjithnjë ekspertë të fushës udhëheqës të opinionit. Profesorët e marrë në intervistë janë njerëz me kontribut të rëndësishëm dhe dijeni të thella lidhur me kontabilitetin dhe raportimin financiar.

Kurse, arsyeja përse zgjidha teknikën rastësore për përzgjedhjen e NVM-ve ishte se ato kanë një shpërndarje të madhe nga shoqëritë me një pronar deri tek njësitë e mesme, nga 4 të punësuar deri në 100 të punësuar, njësi me kapital vendas si dhe njësi me kapital të përbashkët, etj. Duke iu referuar kompleksitetit dhe kufizimeve të

hasura në zgjedhjen e kampionit në një popullatë kaq të madhe, përzgjedhja rastësore u zgjodh sepse ofron lehtësi gjatë kërimit për mbërritjen e NVM-ve. Për një përmblidhje të sa më sipër, kampioni do të ndahet në tre grupe të mëdha.

- *Grupi i parë janë përdoruesit e informacionit financiar (bankat e nivelit të dytë, pronarët jo menaxherë dhe përfaqësuesit e organeve tatimore)*
- *Grupi i dytë janë përgatitësit e pasqyrave financiare*
- *Grupi i tretë janë akademikët*

Kampioni do të ndahet në tre grupe pasi entitetet përbërëse vijnë nga fusha të ndryshme, gjë që ndikon në opinionet e tyre. Grupimi i kampionit në një të vetëm do të komplikonte analizimin e të dhënave dhe do të ishte e vështirë të arrihej në konkluzione të pagabueshme.


3.10 Modeli i vendimmarrjes

Pasi të arrihet në konkluzionet e punimit, të cilat do të japin përmblidhtazi përfundimet për secilin prej argumenteve të marra në analizë, përmes një modeli të vendimmarrjes cilësore (matrica 2 përmasore e opsioneve) do të formulohet edhe rekomandimi kryesor i punimit. Rekomandimi kryesor do të jetë një nga katër alternativat e ndërtuara në matricën e vendimit. Në modelin e përzgjedhur të vendimmarrjes, opsionet që kryqëzohen janë:

Opsioni 1 - “A duhet adoptimi i SNRF për NVM?”, dhe

Opsioni 2 - “A është i mundur ky adoptim sot?”.

Prej këtyre opsioneve janë formuar më pas katër alternativat e mundshme për rekomandim:



Figurë 3.2 – Modeli cilësor i vendimmarrjes

3.11 Kriteri i cilësisë

Në një kërkim, qëndrueshmëria apo cilësia e kërkimit është shumë e rëndësishme për të përcaktuar vlerën e fakteve (Ritchie and Lewis, 2005). Në vlerësimin e një studimi ka dy kritere të cilësisë: siguria dhe vlefshmëria. Ka dhe kritere të tjera alternative të propozuara nga Lincoln and Guba (1985) për vlerësimin e cilësisë së një studimi: besueshmëria dhe vërtetësia (si citohet në Bryman and Bell, 2007, p.411). Këto koncepte janë shumë të ngjashme me dy të parat. Prandaj në këtë studim jam përpjekur gjithnjë të siguroj besueshmërinë dhe vërtetësinë e kërkimit.

Besueshmëria: Në çmuarjen e besueshmërisë së një kërkimi përdoren katër kritere të tjera shtesë: kredibiliteti, transferueshmëria, siguria dhe konfirmueshmëria. (Bryman and Bell, 2007, p.411).

- **Kredibiliteti:** Kredibiliteti shkon paralel me vlefshmërinë e brendshme. Përcaktimi i kredibilitetit të gjetjeve përfshin sigurinë se kërkimi është realizuar dhe mbështetur në qasjet e praktikave të mira si dhe sigurinë se gjetjet e kërkimit do t'u jepen të tjerëve të cilët do të gjykojnë nëse kërkimi është i kuptueshëm dhe i vlefshëm për shoqërinë (Bryman and Bell, 2007, p. 411). Reagimi për miratimin e kërkimit është një perspektivë e rëndësishme për kredibilitetin e tyre. Për të marrë këtë miratim, gjetjet e kërkimit ndahen me të tjerë që marrin pjesë në këtë kërkim për të marrë prej tyre konfirmimin se ata kanë të njëjtin kuptim për atë që shkruhet në analizimin e të dhënave empirike.

- **Transferueshmëria:** Transferueshmëria shkon paralel me vlefshmërinë e jashtme. Kjo ka të bëjë me faktin nëse gjetjet e kërkimit mbeten të vërteta edhe në kontekste të tjera apo në të njëjtin kontekst por në një kohë tjetër (Lincoln and Guba, 1985, p 316). Transferueshmëria e këtij kërkimi në Shqipëri do të jetë e vlefshme por s'mund të thuhet e njëjta gjë për transferueshmërinë e tij në vende të tjera.

- **Siguria:** Siguria shkon paralel me seriozitetin. Siguria do të thotë seriozitet në mbajtjen e të gjitha shënimeve dhe regjistrimeve për çdo fazë të procesit të kërkimit (Bryman and Bell, 2007, p.414). Në kërkimin tim, do të ruaj të gjitha shënimet apo regjistrimet që nga formulimi i problemit, referencat, literatura e shfletuar, intervistat e bëra, e gjithçka tjetër. Kjo arshivë e kërkimit e bën atë serioz, pra të sigurtë.

- **Konfirmueshmëria:** Konfirmueshmëria shkon paralel me objektivitetin. Konfirmueshmëri nënkupton që kërkimi drejtohet në mënyrën e duhur gjithashtu që të tjerë të angazhuar në kërkim do të sillen me mirëbesim (Bryman and Bell, 2007, p.414). Qëllimi i kërkimit tim është të vëzhgojë përshtatshmërinë e adoptimit të SNFR për NVM në Shqipëri dhe për këtë qëllim do të mbledh të dhënat e nevojshme përmes intervistave dhe pyetësorëve të gjysëm strukturuar dhe do të identifikoj rezultatet të cilat i japin përgjigje pyetjes së kërkimit. Këto pyetësorë janë më parë të konsultuar edhe me kolegë të tjerë nëse ato arrijnë të zbulojnë të dhënat që kërkoj dhe më pas u shpërndanë tek të intervistuarit. Gjithashtu për të siguruar ndonjë gabim (bias) apo pasaktësi të informacionit, intervistën e zhvillova në tre kategori të ndryshme të intervistuarish: analistë kredish, investitorë dhe përfaqësues tatimorë. Po ashtu u intervistuan dhe akademikë të fushës por në një kontekst tjetër. Pyetjet ishin formuluar thjesht dhe qartë. Në rast të ndonjë pyetje më komplekse, ajo u shoqërua

me komunikim të drejtpërdrejtë. Sa më sipër, bën që konfirmueshmëria e kërimit të jetë e lartë.

Autenticiteti: Cilësia e një kërkit varet shumë dhe nga kriteri i autenticitetit. Me autenticitetet në këtë rast të kuptojmë vërtetësinë me të cilën paraqiten këndvështrimet e ndryshme të kuadrit shoqëror. Për qëllime të autenticitetit, opinionet e intervistuesve të mbledhura përmes pyetësorëve apo intervistave, u janë dhënë dhe një herë mbrapsht atyre për të konfirmuar përgjigjet e transkriptuara apo të interpretuara.

3.12 Konsideratat etike

Etika në përgjithësi përkufizohet si tërësia e kodeve dhe udhëzimeve që çdo kërkues duhet të ndjekë në studimin e tij. Etika është e lidhur me normat, vlerat dhe përgjegjësitë shoqërore të njësive ekonomike. Meqenëse ky do të jetë në pjesën më të madhe një studim cilësor dhe do të përdoren për analizë kryesisht të dhëna primare, është përgjegjësi e imja të mbaj standarde të larta të etikës përgjatë gjithë procesit. Çështjet e etikës nuk duhen injoruar pasi lidhen drejtpërdrejt me integritetin e kërimit (Bryman dhe Bell, 2007) dhe është e vetmja mënyrë për të punuar me ndershmëri dhe përgjegjshmëri. Literatura e përdorur gjatë studimit, si librat, gazetatat shkencore apo burime të tjera janë cituar në mënyrën e duhur me qëllim që të evitohet plagjarizmi.

Gjithashtu gjatë punimit janë mbajtur shumë parasysh katër fushat e parimeve etike të klasifikuara nga Diener dhe Grandall (si është cituar në Bryman dhe Bell, 2007): dëmtim të pjesëmarrësit, mungesë e pëlqimit, thyerje të privacisë dhe mashtrim. Të gjithë këta faktorë joetik janë përjashtuar duke treguar një kujdes shumë të veçantë. Takimet me të intervistuarit janë bërë me dakordsinë e tyre për momentin dhe kohëzgjatjen e bisedës. Identiteti i tyre mbahet anonim përderisa ata do të kërkojnë të kundërtën. Personalisht jam plotësisht dakord me qëndrimin e Bryman dhe Bell (2007) se gjatë një kërkit është shumë e dëshiruar që kërkuesi të jetë i vetëdijshëm për sa i përket çështjeve të etikës pasi vetëm kështu do të arrijë në vendime të plota dhe mirinformuara.

KAPITULLI 4 - GJETJET EMPIRIKE

Në këtë kapitull do të paraqiten shoqëruar me analiza dhe interpretime të shkurtra, gjetjet empirike të cilat u siguruan si rezultat i shfrytëzimit të disa burimeve. Këto burime mundësuan të dhëna parësore dhe dytësore. Ndër burimet e të dhënave parësore janë **matricat krahasuese, pyetësorët dhe intervistat** ndërsa burime të të dhënave dytësore janë publikime të organeve zyrtare vendase dhe të huaja për Shqipërinë, gjithashtu edhe **botime shkencore** të studiuesve të ndryshëm apo organizmave profesionalë të huaj me një reputacion ndërkombëtar në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Kapitulli do të ndahet në tre seksione për të dhënë të ndara gjetjet cilësore dhe sasiore nga secili prej burime primare.

4.1 Gjetjet empirike nga matricat krahasuese

4.1.1 Gjetjet nga matrica mes SKK-ve dhe SNRF për NVM

Në aneksin 9 paraqitet matrica krahasuese e ndërtuar me synimin për të krahasuar paragrafët përkatës të SKK 1 dhe paragrafëve përkatës të SNRF për NVM të seksioneve 2, 10 dhe 32 të saj. Kjo paraqitje, ku lidhen horizontalisht paragrafët e të dy seteve që kanë përmbajtje të njëjtë ose të ngjashme, të krijon mundësinë e analizës së dallimeve dhe ngjashmërive qoftë në formë qoftë në përmbajtje. Kam gjykuar që është më e lehtë në studim vendosja në kollonën e parë të paragrafëve të SKK-ve pasi edhe për lexuesin shqiptar me njohuri në fushën e kontabilitetit, është një paraqitje më familiare që të jep mundësinë e ndjekjes së analizës. Nga analiza e matricës gjejmë disa statistika interesante por jo vetëm aq. Më të rëndësishëm janë argumentet cilësore që jepen shkurtimisht në kollonën “Komente” të matricës.

Duke parë statistikën e matricës, ndër 104 paragrafë të SKK 1, vërehet se 19 prej tyre nuk kanë ndryshime as në formë as në përmbajtje me ato të SNRF për NVM, 69 paragrafë të SKK 1 nuk e gjejnë paragrafin përkatës në SNRF për NVM, 39 paragrafë të SNRF për NVM nuk e gjejnë paragrafin përkatës në SKK 1 dhe 15 paragrafë të SKK 1 do të kishin nevojë për ndonjë riformulim me qëllim saktësimin më të mirë të disa kërkesave. Ndërsa nëse bëhet një analizë cilësore e përmajtjes së paragrafëve, dallimet kryesore janë:

- a) në SKK 1 mungon koncepti i të ardhurave gjithëpërfshirëse (të ardhurat dhe fitimet e realizuara dhe ato të parealizuara gjatë periudhës);
- b) në SKK 1 mungon një kërkesë për shënime shpjeguese (shih pg 32.10 të SNRF për NVM);
- c) në SKK 1 ka 6 paragrafë ku ka dallime të terminologjisë me atë ndërkombëtare të raportimit financiar;
- d) Ndër termat që nuk gjen të përbashkët në dy kuadrot e raportimit është termi “pasiv” sepse në literaturën ndërkombëtare të kontabilitetit, përfshirë SNRF për NVM, përdoret termi “detyrim”;

Sipas të njëjtës metodologji kam ndërtuar matricat për të gjitha SKK-të e tjera duke çiftuar paragrafët përkatës (nëse ka patur) dhe duke konstatuar kështu mungesat respektive nga njëri kuadër raportimi në tjetrin. Për efekte të lehtësisë së të kuptuarit, në kapitullin e gjetjeve empirike, për SKK-të e tjera do të paraqes vetëm dallimet e rëndësishme të evidentuara për të thelluar diskutimin mbi rëndësinë e këtyre dallimeve në kapitullin pasardhës.

SKK 2 “Paraqitja e pasqyrave financiare” (seksionet 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të SNRF për NVM)

- a) Terminologjia dhe përkufizimet kanë ndryshime, por që nuk prekin thelbin e konceptit;
- b) Është shumë i sqaruar koncepti i vijimësisë në paragrafët e SNRF për NVM;
- c) Pg 3.9 i SNRF për NVM ka disa kërkesa shtesë krahasuar me SKK 2 për të shpjeguar moszbatimin e parimit të vijimësisë;
- d) Pg 3.16 i SNRF për NVM ofron më shumë detaje për hartuesit e pasqyrave financiare lidhur me kuptimin e konceptit të materialitetit;
- e) Pg 5.4/5/6 japin kërkesat për paraqitjen e pasqyrës së vetme të të ardhurave gjithëpërfshirëse, koncept që mungon tek SKK-të;
- f) SNRF për NVM ka të tjera emërtime për pasqyrat financiare;
- g) SKK-të nuk e kanë pjesë të tyre konceptin e monedhës funksionale prandaj paragrafi 7.12 i SNRF për NVM nuk gjen vend;
- h) SKK nuk shprehen për rubrikën ku duhet të paraqiten dividendët dhe interesat e paguar në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare;
- i) Në paragrafët e tjerë më së shumti dallimet janë çështje të formulimeve gjuhësore;

SKK 3 “Instrumentet financiare” (seksionet 11 dhe 12 të SNRF për NVM)

- a) Fusha e zbatimit të SKK3 është më e gjerë se ajo e seksionit 11 të SNRF për NVM por lë jashtë disa zëra që trajtohen në seksionin 12 të SNRF për NVM (seksionet 11 dhe 12 të SNRF për NVM mbulojnë instrumentet financiare);
- b) Ato që përjashtohen nga fusha e zbatimit të SKK 3 nuk janë plotësisht ato çka përjashtohen në seksionin 11 të SNRF për NVM;
- c) Në SKK 3 mungojnë shembuj të instrumenteve financiare të thjeshtë apo të përbërë;
- d) Koncepti i matjes fillestare të instrumenteve financiare jepet më i qartë në formulimin sipas SNRF për NVM;
- e) Në SKK 3 mungojnë shembuj të matjes fillestare të instrumenteve financiare, që gjenden në SNRF për NVM;
- f) Në SNRF për NVM, modeli i vlerësimit të mëpasshëm të instrumenteve financiare është vetëm ai i kostos së amortizuar, në dallim nga SKK 3 ku lejohet edhe modeli i vlerës së drejtë;
- g) SNRF për NVM, përmes pg 11.35 jep më shumë udhëzime lidhur me regjistrimin e kolateralit jo në mjete monetare;
- h) Në SKK 3 ka paragrafë që mungojnë tek SNRF për NVM, që trajtojnë çështjet e faktoringut të kërkesave për t’u arkëtuar dhe veprimet e riblerjes;
- i) Seksioni 12 i SNRF për NVM është përfshirë në SKK 3 por jo i qartë dhe i organizuar me udhëzime të mjaftueshme;

- j) SNRF për NVM ka ndjeshëm më pak kërkesa për shënime shpjeguese;
- k) Në paragrafët e tjerë më së shumti dallimet janë çështje të formulimeve gjuhësore;

SKK 4 “Inventarët” (seksioni 13 i SNRF për NVM)

- a) SKK 4, në dallim nga SNRF për NVM nuk parashikon përjashtime aq të plota nga fusha e zbatimit;
- b) Në SNRF për NVM nuk përdoret më termi ‘vlera neto e realizueshme’ por thjesht përkufizimi i plotë i saj, që është i njëjtë me atë të dhënë në SKK 4;
- c) Në SKK 4 nuk është parashikuar trajtimi kontabël i blerjeve të inventarëve në kushtet e pagesave të shtyra në afate;
- d) Në paragrafët e tjerë më së shumti dallimet janë çështje të formulimeve gjuhësore;

SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” (seksionet 16, 17, 18, 25 dhe 27 të SNRF për NVM)

- a) Në SKK 5 nuk trajtohen aktivet afatgjata materiale të investuara;
- b) Përkufizimi i kostove të huamarrjes është më i “varfër” se përkufizimi sipas SNRF për NVM;
- c) Në SKK 5 nuk ka një kërkesë të mirëfilltë për pjesët e këmbimit dhe pajisjet e tyre, për rastet kur ato trajtohen si aktive afatgjata materiale;
- d) Në SKK 5, shpenzimet e zhvillimit trajtohen si aktive afatgjata jomateriale. Në SNRF për NVM ato trajtohen si shpenzime periudhe;
- e) Ndryshe nga SNRF për NVM, për shpenzimet e interesit (kostot e huamarrjes) ka dy trajtime alternative. Nëse sipas SNRF për NVM këto kosto njihen si shpenzime periudhe, sipas SKK 5 është dhe trajtimi alternativ, ai i kapitalizimit të tyre në koston e aktivit të kualifikuar për të cilin është marrë huaja që prodhon këtë kosto interesi;
- f) Në SKK 5 lejohen dy trajtime alternative për vlerësimin e mëpasshëm të aktiveve afatgjata materiale, modeli i koston dhe modeli i rivlerësimit. Ndërsa në SNRF për NVM i vetmi model i lejuar është ai i koston;
- g) Në SNRF për NVM emri i mirë amortizohet për 10 vite ndërsa sipas SKK 5 ai testohet për zhvlerësim;
- h) Në SNRF për NVM ka më shumë kërkesa dhe udhëzime lidhur me përcaktimin e jetës së dobishme dhe llogaritjes së amortizimit për të dyja llojet e aktiveve, materiale dhe jomateriale;
- i) Në SNRF për NVM ka më shumë kërkesa dhe udhëzime lidhur me njohjen e një aktivit afatgjatë jomaterial;
- j) SNRF për NVM ka disa paragrafë që përmbajnë udhëzime për çregjistrimin e AAM dhe AAJM;
- k) Shënimet shpjeguese, me përjashtim të atyre lidhur me aktivet e investuara, janë pothuaj njësoj;
- l) Në paragrafët e tjerë më së shumti dallimet janë çështje të formulimeve gjuhësore;

SKK 6 “Provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara” (seksioni 21 i SNRF për NVM)

- a) Matja e provizioneve trajtohet më e detajuar në SNRF për NVM;
- b) Në SNRF për NVM nuk ka paragrafë që mbulojnë provizionet për pensionet, si në SKK 6 (pg 37-39);
- c) Sipas SNRF për NVM kërkohen më shumë shënime shpjeguese lidhur me provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara;
- d) Në paragrafët e tjerë më së shumti dallimet janë çështje të formulimeve gjuhësore;

SKK 7 “Kontabilizimi i qirave” (seksioni 20 i SNRF për NVM)

- a) Në dallim nga SKK 7, SNRF për NVM parashikon në kërkesat e seksionit përkatës edhe një paragraf ku saktësohen disa përjashtime nga fusha e zbatimit të atij seksioni;
- b) Paragrafët e tjerë ndryshojnë më së shumti në formulim, pra çështje forme dhe jo përmbajtje;

SKK 8 “Të ardhurat” (seksioni 23 i SNRF për NVM)

- a) Përkufizimet sipas SNRF për NVM janë më të zgjeruara;
- b) SKK 8 nuk ka ndonjë udhëzim për matjen e arkëtimeve të shtyra në kohë;
- c) Në SKK 8 nuk ka udhëzime për format e reja të shfaqura të të bërit biznes, siç është p.sh, rasti i lëshimit të kartave të besnikërisë për klientët;
- d) SNRF për NVM ka udhëzime më të thjeshta dhe të detajuara për metodën e fazës së përfundimit;
- e) Ka një organizim më të mirë të seksionit përkatës të SNRF për NVM, referuar ndarjes së qartë të udhëzimeve për shitjen e mallrave, ofrimin e shërbimeve, kontrata e ndërtimit dhe metodën e fazës së përfunduar;
- f) Në paragrafët e tjerë më së shumti dallimet janë çështje të formulimeve gjuhësore;

SKK 9 “Kombinimet e bizneseve” dhe SKK 14 “Trajtimi kontabël i shoqërive të kontrolluara dhe pjesëmarrjeve” (seksionet 9, 14, 15 dhe 19 të SNRF për NVM)

- a) Vërehet një ndarje e qartë mes çështjeve të kombinimit të bizneseve dhe atyre të investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta, krahasuar me dy SKK-të përkatëse, ku del nevoja e një riorganizimi paragrafësh;
- b) Në SKK 9 mungojnë kërkesa të detajuara, si në seksionet përkatëse të SNRF për NVM, lidhur me përcaktimin e termit kombinim biznesi dhe trajtimin kontabël të konsolidimit të pasqyrave financiare;
- c) Në dallim nga SKK 9, tek SNRF për NVM, një blerësi në një kombinim biznesi nuk i kërkohet më të bëjë analiza të vështira të çmimit të blerjes;
- d) Mungojnë në SKK 9 kërkesa dhe udhëzime për regjistrimin e detyrimeve të kushtëzuara në një kombinim biznesi;
- e) Në SKK 9 kërkohet testi i zhvlerësimit për emrin e mirë, ndryshe nga kërkesat e SNRF për NVM ku emri i mirë amortizohet;

- f) SKK 9 ndryshe nga SNRF për NVM ka disa kërkesa dhe udhëzime për aplikimin e metodës së përshtatur të blerjes së njësive ekonomike që janë në kontroll të përbashkët;
- g) Në SKK 9 nuk ka udhëzime për pasqyrat financiare të kombinuara siç është parashikuar në paragrafët përkatës të SNRF për NVM;
- h) Në SKK 14 mungon një përkufizim për ‘njësitë ekonomike me qëllim të veçantë’;
- i) Në SNRF për NVM ka kërkesa dhe udhëzime të posaçme për rastet kur një shoqëri mëmë është e lejuar të mos hartojë pasqyrat e konsoliduara;
- j) Në SKK 14 nuk lejohet, ndryshe nga SNRF për NVM, përdorimi i vlerës së drejtë për investimet në pjesëmarrje;
- k) Shënimet shpjeguese të paragrafëve përkatës të SNRF për NVM janë më të detajuara krahasuar me ato të SKK 9 dhe SKK 14;
- l) Në paragrafët e tjerë më së shumti dallimet janë çështje të formulimeve gjuhësore;

SKK 10 “Grantet dhe format e tjera të ndihmës” (seksioni 24 i SNRF për NVM)

- a) Kërkesat e SKK 10 janë të ndryshme nga ato të SNRF për NVM për faktin se janë më të shumta, më të detajuara dhe me më shumë nënndarje;
- b) SNRF për NVM nuk parashikon llojet e granteve të ndara në grante në para apo aktive të tjera materiale dhe jomateriale;
- c) Në SNRF për NVM, kusht për njohjen e grantit në të ardhura është vetëm plotësimi i performancës duke mos marrë në konsideratë amortizimin e aktivitet material apo shpenzimet për t’u përballuar nga granti i marrë;
- d) Në SKK 9, ka paragraf të posaçëm për arkëtimet në formë granti për të përballuar humbje të periudhave të mëparshme, gjë që nuk parashikohet në SNRF për NVM;

SKK 11 “Tatimi mbi fitimin” (seksioni 29 i SNRF për NVM)

- a) SKK 11 nuk është standard i detyrueshëm si SKK e tjera; njësia ekonomike inkurajohet por nuk detyrohet për zbatimin e tij;
- b) Në SKK 11, ndryshe nga SNRF për NVM, nuk ka paragrafë që në mënyrë të posaçme mbulojnë trajtimin kontabël të tatim fitimit aktual dhe tatim fitimit të shtyrë;
- c) Ndryshe nga SNRF për NVM, standardi jep udhëzime për njohjen e aktiveve dhe detyrimeve tatimore për rastet e kombinimeve të bizneseve dhe aktiveve që mbahen me vlerë të drejtë;
- d) Në paragrafët e tjerë më së shumti dallimet janë çështje të formulimeve gjuhësore;

SKK 12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimeve” (seksioni 30)

- a) Në SKK 12 nuk ka udhëzime për konceptin e monedhës funksionale dhe rrjedhimisht të mjedisit ekonomik primar;
- b) Në këtë logjikë, në SKK 12 mungojnë udhëzime për rastet kur monedha raportuese është e ndryshme nga monedha funksionale;
- c) Në SKK 12 mungojnë udhëzime për investimet në një njësi ekonomike të huaj por megjithatë në paragrafë të tjerë është trajtuar njohja e diferencave që vijnë nga përkthimi i operacioneve ekonomike në monedhë të huaj;
- d) Në paragrafët e tjerë më së shumti dallimet janë çështje të formulimeve gjuhësore;

SKK 13 “Aktivet biologjike” (seksioni 34 i SNRF për NVM)

- a) Fusha e zbatimit të SNRF për NVM përfshin edhe marrëveshjet konçesionare;
- b) Në SKK 13, ndryshe nga SNRF për NVM, modeli i lejuar i matjes së aktiveve biologjike është vetëm ai i kostos; SNRF për NVM lejon dhe modelin alternativ atë të vlerës së drejtë nëse kjo e fundit gjendet lehtësisht pa kosto shtesë;
- c) Në SKK 13 ka disa udhëzime që mungojnë në SNRF për NVM lidhur me zhvlerësimin dhe çregjistrimin e aktiveve biologjike;
- d) Në paragrafët e tjerë më së shumti dallimet janë çështje të formulimeve gjuhësore;

Nga ballafaqimi i paragrafëve në të 14 matricat përkatëse, vërehet se disa seksione të SNRF për NVM nuk gjejnë zbatim në 14 SKK-të tona. Këto seksione janë:

Seksioni 1 “Njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme”

Seksioni 22 “Detyrimet dhe kapitali neto”;

Seksioni 26 “Pagesat e bazuara në aksione”;

Seksioni 28 “Përfitimet e punonjësve”;

Seksioni 31 “Hiperinflacioni”;

Seksioni 33 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura”;

4.1.2 Gjetjet nga matrica mes SKK-ve dhe Direktivës së Kontabilitetit në BE

Në këtë kapitull, në formën e një table paraqiten të përmbledhura për sa janë konstatuar si dallime në trajtimin kontabël mes të tre rregullimeve kontabël, SKK-të, SNRF për NVM dhe Direktiva e Kontabilitetit në BE (Dir 34/2013/EU). Analiza e këtyre dallimeve për të kuptuar cili prej dy seteve të tjera është më afër rregullimeve sipas Direktivës, bëhet në kapitullin 5.

Tabela 4.1 Përmbledhje nga matrica e dallimeve mes SKK –ve dhe Direktivës së BE-së

Çështja në diskutim	Statusi në Direktivë	Statusi në SKK	Statusi në SNRF për NVM
Transaksionet e kontrolluara ose ndryshe transferimet e interesave pjesëmarrëse brenda grupit	Kontabilizohen me metodën e bashkimit të interesave	Nuk lejohet metoda e bashkimit të interesave por kërkojnë të përdoret metoda e blerjes	Njësoj si në SKK
Pjesëmarrjet përfshihen në konsolidim	përmes metodës së kapitalit	përmes metodës së kapitalit dhe metodës së	përmes metodës së kapitalit, koston dhe

		kostos	vlerës së drejtë
Aktivitet ose aktivitetet e kontrolluara bashkërisht	 të konsolidohen proporcionalisht	 të konsolidohen me integrim të plotë	Njësoj si në SKK
Palët e lidhura	Ka përkufizim sipas SNRF –ve të plota	Mungon Përkufizimi	Ka përkufizim sipas SNRF –ve të plota
Pasqyrat financiare	Ka vetëm 2 pasqyra të detyrueshme. U lejon vendeve anëtare të kërkojnë pasqyra shtesë	Kërkon 4 pasqyra dhe shënimet shpjeguese	Kërkon 4 pasqyra dhe shënimet shpjeguese
Formatet e pasqyarve financiare		Më të thjeshtuarar se ato të Direktivës por pa ndryshime në zërat kryesorë	Më të plota se në SKK 2 por të njëjtët zëra kryesorë
Të ardhurat nga dividendët	Kur e ardhura nga dividendi është më e madhe se shuma e arkëtuar, diferenca paraqitet si zë i kapitali	Mungon	Nësoj me Direktivën
Trajtimi kontabël i grupeve	Parashikon udhëzime për konsolidimin e grupeve	Mungon	Mungon
Kufizimet në transferimin e fondeve	Ka udhëzim të veçantë	Mungon	Ka udhëzim të veçantë
Shënime shpjeguese shtesë lidhur me:			
të dhëna (emri, adresa e zyrës, grupi) për filialet, pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta;	PO	JO	JO
trajtimin e taksave të zërave që bëjnë pjesë tek lëvizjet në rezervat e rivlerësimit;	PO	JO	PO
për vlerën e mbetur të aktiveve afatgjata, sa do të kish qenë kjo vlerë nëse këto aktive nuk do të kishin qenë rivlerësuar ndonjëherë;	PO	PO	PO
detyrime të pagueshme për	PO	JO	JO

më vonë se 5 vjet si dhe për të gjitha llojet e borxheve që mbulohen nga letra me vlerë të lëshuara nga njësia ekonomike të jepet natyra dhe forma e tyre;			
të dhëna për numrin mesatar të të punësuarve gjatë vitit nga njësitet ekonomike që janë konsoliduar proporcionalisht;	PO	JO	JO
paradhënie ose grante që u jepen stafëve drejtuese të njësisë mëmë nga vetë mëma ose filiale të saj;	PO	JO	JO
instrumentat financiare që mbahen me vlerë kontabël në rast se kjo vlerë tejkalon vlerën e drejtë të tyre;	PO	JO	PO
arsyet përse nuk zvogëlohet kjo vlerë kontabël përfshirë shpjegime mbi natyrën e evidencës që mbështet gjykimin se vlera kontabël do të rikuperohet;	PO	JO	PO
numrin mesatar të punonjësve të ndarë sipas kategorive, dhe nëse nuk janë bërë detajime në PASH, në shpjegime të jepen të ndara pagat, sigurimet dhe pastaj pensionet.	PO	JO	JO
numrin dhe vlerën nominale, ose në mungesë të vlerë nominale të jepet vlera kontabël për aksion të regjistruara gjatë periudhës ushtrimore brenda limitit të kapitalit të autorizuar;	PO	JO	PO
numrin dhe vlerën nominale, ose në mungesë të vlerës nominale të jepet vlera kontabël për aksion për çdo klasë;	PO	JO	PO
eksistencën e ndonjë	PO	JO	JO

çertifikate pjesëmarrëse, obligacioni të konvertueshëm, garanci, opsione ose të drejta apo letra të tjera me vlerë të ngjashme si dhe të jepen të dhëna për numrin e tyre dhe të drejtat që ato mbajnë;			
---	--	--	--

4.2 Gjetjet empirike nga pyetësorët

Interpretimi i pyetësorëve do të bëhet në kapitullin përkatës të analizave dhe diskutimeve ndërsa në këtë kapitull do të paraqiten gjetjet nga pyetësorët:

- profili i personave të përzgjedhur në kampion lidhur me kualifikimin e tyre si dhe formën ligjore të ushtrimit të profesionit;
- të dhënat primare të mbledhura nga pyetësorët;

Pyetësori kishte synim të grumbullonte një feedback lidhur me përgatitjen profesionale të profesionistëve të praktikës, në zbatueshmërinë e SKK-ve, në cilësinë e hartuesve të pasqyrave financiare si dhe opinione lidhur me gadishmërinë e tyre për të kaluar në një regjim të ri të raportimit financiar. Për shpërndarjen e pyetësorit u përdorën adresat elektronike të të anketuarëve të siguruara nga shoqatat profesionale dhe organizma të tjerë ku ata aderojnë. Afati për pritjen e përgjigjeve ishte 60 ditë.

4.2.1 Profili i pjesëmarrësve në anketim përmes pyetësorit

Pyetësori iu dërgua 381 individëve që kontribuojnë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Këta individë, mbështetur në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", mund ta ushtrojnë profesionin e tyre si të punësuar në njësitë ekonomike ose të ofrojnë shërbime kontabiliteti dhe auditimi me kontratë. Për profesionin e audituesit, organizmi profesional ku ata aderojnë është Instituti i Ekspertëve Kontabël (IEKA) ndërsa kontabilistët e miratuar dhe ata të diplomuar aderojnë në shoqatat profesionale si Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë (SHKFSH), Instituti i Kontabilistëve të Miratuar (IKM) dhe Shoqata e Kontabilistëve të Miratuar (SHKM).

Adresat elektronike për shpërndarjen e pyetësorëve u mundësuan më së shumti nga këto organizma profesionalë. Në zhvillimin e pyetësorit kontribuo i IEKA me 223 adresa elektronike të anëtarëve të saj, IKM me 76 adresa të anëtarëve të saj dhe pjesa tjetër ishin 82 adresa elektronike të profesionistëve kontabël, ekonomistë apo kontabël të miratuar, që ishin në bazën e të dhënave të njëres prej shoqërive më të mëdha të huaja të auditimit, në Shqipëri. Prej këtyre 381 adresave elektronike, 24 rezultuan jo të rregullta ose të mbyllura ndërsa 357 adresat e tjera ishin funksionale dhe kështu në

total morën dijeni për pyetësin 357 persona. Në fund, 141 prej pyetësorëve u kthyen, pra rreth 40% e të anketuarëve iu përgjigjën kërkesës për të bashkëpunuar, ndër to 4 pyetësorë kishin shumë pak përgjigje ndërsa 137 pyetësorë ishin plotësuar në mbi 60% të tyre. Prej këtyre të fundit, 91 pyetësorë kishin përgjigje për pjesën më të madhe të pyetjeve.

Në totalin prej 141 pyetësorëve të plotësuar, pyetjes lidhur me profesionin e tyre iu përgjigjën 137 persona dhe rezultoi që mes tyre 83 janë ekspertë kontabël të regjistruar (61%), 29 janë kontabilistë të miratuar (21%), 17 janë ekonomistë të diplomuar (12%) dhe 8 kanë zgjedhur opsionin “Tjetër” (6%), duke treguar punësimin e tyre. Segmenti “Tjetër” përbëhet nga 2 lektorë universiteti, 6 të punësuar në shoqëri auditimi.

4.2.2 Gjetjet e pyetësorëve

Pyetësi u konceptua me 61 pyetje të ndara në pesë seksione:

- *Seksioni i parë* mbledh të dhëna për vetë njësitë ekonomike. Këtij seksioni i'u përgjigjën në secilën pyetje 137 të anketuar;

- Në kampion rezultoi se njësitë ekonomike kanë respektivisht një shpërndarje sipas shifrës së afarizmit: 23% me më pak se 50 milion lekë, 40% në kufijtë 50 – 250 milionë lekë dhe 37% e tyre mbi 250 milionë lekë;
- Sipas numrit të të punësuarve shpërndarja është: 3% e njësive kanë mbi 50 të punësuar, 93% e tyre kanë nga 5-50 të punësuar dhe vetëm 4% e tyre kanë më pak se 5 të punësuar;
- Referuar vlerës së aktivit, ato kanë një shpërndarje: 7% e tyre kanë një aktiv të bilancit më pak se 10 milionë lekë, 50% e tyre një aktiv 10-100 milionë lekë, 34% e tyre kanë një aktiv 100 – 250 milionë lekë dhe vetëm 9% kanë një aktiv më të madh se 250 milionë lekë;
- Të klasifikuara njësitë sipas llojit të sipërmarrjes, gjendet kjo shpërndarje: 82% e tyre janë me kapital vendas, 15% janë me kapital të huaj dhe vetëm 3% janë njësi me kapital të përbashkët;
- Ndërsa shpërndarja sipas standardeve të kontabilitetit që këto njësi zbatojnë gjendet kjo shpërndarje: 94% e tyre zbatojnë SKK 1-14, 2% zbatojnë SNRF-të e plota dhe 4% zbatojnë SKK 15, standardin për mikronjësitë.

- *Seksioni i dytë* mbledh të dhëna personale për hartuesit e pasqyrave financiare të këtyre njësive ekonomike. Këtij seksioni i'u përgjigjën në secilën prej pyetjeve 137 të anketuar;

- Shpërndarja sipas grupmoshave në këtë kampion është: 19% e tyre deri në 35 vjeç, 47% nga 35 – 45 vjeç, 31% nga 45 – 55 vjeç dhe 3% mbi moshën 55 vjeç;
- Të klasifikuar përgatitësit e pasqyrave sipas arsimit dhe kualifikimit të mëtejshëm, kanë këtë shpërndarje: 2% janë me arsim të mesëm, 52% kanë arsim të lartë, 26% kanë mbaruar studimet pasuniversitare nivel Master, 16% kanë fituar diplomën ndërkombëtare ACCA dhe 4% kanë fituar diplomën tjetër ndërkombëtare CPA;

- Qasja si e ushtrojnë profesionin këta përgatitës pranë njësive ekonomike është: 12% e ushtrojnë si ekonomistë të thjeshtë, 21% si kontabilistë të miratuar, 61% si auditues që ushtrojnë të drejtën e ligjshme për të hartuar pasqyra financiare në njësitë që nuk auditojnë dhe 6% janë të punësuar në administratë shtetërore por që angazhohen me kohë të pjesshme pranë këtyre njësive ekonomike;
- Përsa i përket shpërndarjes së kampionit sipas viteve të eksperiencës në profesion, gjendet se: 5% kanë më pak se 5 vite eksperiencë, 63% e kampionit ka nga 5 – 15 vite eksperiencë dhe 32% ka mbi 15 vite eksperiencë;
- Ndërsa sipas qëndrimit që ky kampion përfaqësues i përgatitësve të pasqyrave financiare ka për filozofinë e standardeve, shpërndarja është: 66% e tyre janë në favour të standardeve të mbështetura në rregulla dhe 34% janë në favour të standardeve të mbështetura në parime.

- *Seksioni i tretë* është tërësisht i fokusuar në grumbullimin e të dhënave mbi kuptueshmërinë dhe cilësinë e zbatueshmërinë e SKK-ve nga ana e këtyre hartuesve të pasqyrave financiare;

Për gjetjet e seksionit të tretë të pyetjeve (shih Aneks 8) ka një analizë të thelluar në kapitullin 5, prandaj për të mos patur përsëritje do të mjaftohem në këtë kapitull të jap disa nga gjetjet e këtij seksioni që nuk janë objekt i analizës së mëtejshme.

- Në SKK 3, tre nga katër pyetjet e bëra kanë një shkallë saktësie mbi 65% ndërsa e katërta ka 100% përgjigje të gabuara; (numri i reagimeve minmax 96-121);
- Për SKK 4, dy prej pyetjeve kanë një shkallë të lartë saktësie dhe dy të tjerat shkallë shumë të lartë pasaktësie; (numri i reagimeve minmax 129-137);
- SKK 5, të katërta pyetjet kanë përqindje të lartë të përgjigjeve të gabuara; (numri i reagimeve minmax 131-136);
- SKK 6, dy pyetje gjithsej, njëra saktësi 50% tjetra saktësi 34%;(numri i reagimeve minmax 96-134);
- SKK7, të treja pyetjet kanë një shkallë saktësie nën 50%;(numri i reagimeve minmax 91-96);
- SKK 8, në të treja pyetjet dominon ndjeshëm përgjigja e gabuar; (numri i reagimeve minmax 99-122);
- SKK 9, katër pyetje ku tre prej tyre kanë një shkallë saktësie shumë më të vogël se 50% dhe vetëm njëra pyetje i përgjigjet nivelit 50% të përgjigjeve të sakta; (numri i reagimeve minmax 32-65);
- SKK 10, njëra pyetje ka 74% të përgjigjeve të sakta ndërsa 2 pyetjet e tjera janë nën një nivel 40% të saktësisë; (numri i reagimeve minmax 41-85);
- SKK 11, këtij standardi i janë përgjigjur vetëm 33 të anketuar. Të dyja pyetjet kanë një shkallë saktësie mbi 60%;
- SKK 12, njëra pyetje me 8% saktësi dhe pyetja tjetër 72% saktësi; (numri i reagimeve minmax 131-134);
- SKK 13, të treja pyetjet kanë përgjigje me shkallë saktësie mbi 60%; (numri i reagimeve minmax 82-87);
- SKK 14, 3 pyetje që kanë saktësi të përgjigjeve në nivele 58%, 43% dhe 88%; (numri i reagimeve minmax 33-39)

Standardet që kanë nivelin më të ulët të reagimit janë SKK 9, 11 dhe 14.

- *Seksioni i katërt* mbledh, përmes pyetjeve të mbyllura, opinione të përgatitësve për përdoruesit e pasqyrave financiare që ata gjenerojnë;

- Pyetjes lidhur me listimin e përdoruesve të pasqyrave financiare dhe shkallës së përdorimit të këtyre pasqyrave në vendimmarrje, kampioni prej 118 reaguesve u përgjigj: përdorues *të shpeshtë* janë institucionet financiare, tatimorët dhe këshillat mbikqyrës; përdorues *jo të shpeshtë ose “ndonjëherë”* nuk ka dominancë; të gjithë përdoruesit e tjerë të mundshëm të listuar janë përzgjedhur si *të rrallë* ose *“asnjëherë”* pra joekzistent;
- Sipas qëndrimit të kampionit lidhur me setin që ata respektojnë në raportimin financiar, reaguesit (132 gjithsej) janë të shpërndarë: 61% i referohen rregullimit fiskal, 31% i referohen rregullimeve sipas SKK-ve dhe vetëm 8% kanë prioritet interesin e pronarëve;
- Referuar opinionit të tyre nëse mbështeten pronarët jomenaxherë në vendimmarrje tek pasqyrat financiare që ata gjenerojnë për njësinë ekonomike, mes 129 reagimeve gjendet kjo shpërndarje: 3% janë të mendimit absolutisht Po, 8% thonë shpesh, 18% thonë ndonjëherë, 43% thonë rrallë dhe 28% thonë absolutisht jo;
- Nëse mbështetet kontrolli dhe menaxhimi tek pasqyrat financiare, përfaqësuesit e kampionit, 131 reagues gjithsej, dhanë këto përgjigje: 37% thanë Po dhe 63% thanë Jo;
- Shpërndarja sipas qëndrimit të përgatitësve mbi dijeninë që kanë pronarët për setin e raportimit financiar që zbaton njësia ekonomike, shpërndarja e 116 reaguesve është: 10% thonë se pronarët kanë mjaftueshëm informacion, 21% mendojnë se pronarët dinë pak mbi setin e raportimit financiar dhe 69% thanë se pronarët nuk e kanë aspak idenë se cili është seti i raportimit financiar i zbatueshëm në njësinë e tyre;
- Lidhur me aftësinë profesionale të tatimorëve (referuar njohjes së SKK-ve) përgatitësit e pasqyrave, 128 reagues, kishin këto qëndrime: 13% e tyre i konsideronin tatimorët shumë të përgatitur në drejtim të SKK-ve, 38% i konsideronin me aftësi të kënaqshme dhe 49% e kampionit ishte i mendimit që tatimorët nuk kishin aspak dijeni për SKK-të dhe zbatueshmërinë e tyre;
- A janë tatimorët të interesuar që bashkë me kontrollin e llogaritjes së tatim fitimit, të kontrollojnë dhe cilësinë e zbatimit të SKK-ve, kampioni në këtë rast 132 reagues, pati këtë qëndrim: 2% thanë se tatimorët janë shumë të interesuar të shohin zbatueshmërinë e standardeve, 7% thanë që ky interesim është në nivel të mjaftueshëm, 295 thanë që tatimorët interesohen pak për zbatueshmërinë e SKK-ve dhe 62% thanë që tatimorëve nuk u intereson ky aspekt i rutinës së punës së bizneseve;
- Nëse kërkojnë apo jo informacione shtesë, bankat dhe institucionet e tjera të ofrimit të financimeve, përveç pasqyrave financiare, përgatitësit, 104 që reagues, thanë: 65% thanë se kjo ndodh *ndonjëherë* ndërsa 94% thanë që bankat *gjithnjë* kërkojnë informacione shtesë.

- *Seksioni i pestë* është tërësisht i fokusuar në mbledhjen e një evidence të mjaftueshme për të kuptuar shkallën e gadishmërisë së këtyre përgatitësve për të kaluar nga SKK-të drejt raportimit financiar me SNRF për NVM;

- Kampioni, 116 reagues, në lidhje me njohjen e SNRF për NVM kishte shpërndarjen: 79% e tyre kishin dijeni se ekziston një standard i tillë ndërsa 21% e tyre nuk kishin dëgjuar ndonjëherë për të;
- Prej atyre 92 reaguesve që kishin dëgjuar për SNRF për NVM, vetëm 15% ndjeheshin profesionalisht gati për të kaluar drejt SNRF për NVM;

- Ata që kishin dëgjuar për SNRF për NVM, e gjykonin atë si një opsion më të mirë se SKK-të në masën rreth 32% (29 nga 92) dhe arsyet përse e gjykojnë të tillë, kanë këtë shpërndarje: 13 të anketuar nga 29 që u përgjigjën (44%) e gjejnë këtë standard më të thjeshtë, 5 të anketuar nga 29, 7 nga 29 udhëhiqen nga opinioni i investitorëve, mendojnë se rrit cilësinë e pasqyrave financiare, 1 i anketuar mendon se është i vlefshëm kur njësia kërkon financime të huaja dhe 4 nga 29 mendojnë se është opsion më i mirë SNRF për NVM pasi njësitë e tyre kanë pritshmëri për t'u kthyer shpejt në njësi të mëdha ekonomike;
- Të pyetur a ishin të gatshëm pronarët të investonin në trajnimin e stafit dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për adoptimin e SNRF në njësinë ekonomike, përgjigje dhanë vetëm 54 nga 137 të anketuarit që reagues. Ndër këta 54 të anketuar që reagues për këtë pyetje, 5 thanë Po (9%) dhe 49 thanë Jo (91%);
- Pyetjes lidhur me një vlerësim të kostove fillestare të adoptimit të SNRF për NVM iu përgjigjën 93 nga 137 të anketuar, të cilët dhanë këto vlerësime: 23% e tyre i vlerësonin kostot fillesatre deri në 200 mijë lekë, 72% i vlerësonin këto kosto nga 200 – 400 mijë lekë dhe 5% mbi 400 mijë lekë;
- Ndërsa për kostot në vijim, pas atyre fillestare, reagues përsëri 93 nga 137 të anketuar por shpërndarja ishte: 40% i vlerësonte ato deri në 50 mijë lekë çdo vit, 56% i vlerëonte këto kosto në limitet 50 – 200 mijë lekë dhe 4% thanë se këto kosto mund të jenë mbi 200 mijë lekë në vit.

4.3 Gjetjet e intervistave me përdoruesit e informacionit financiar dhe akademikët e fushës

Si instrument kërkimi, për sigurimin e të dhënave primare nga katër grupe më të vogla zgjedha intervistat e drejtpërdrejta. Për këto grupe u përzgjedh intervista jo vetëm për faktin që mund të mbërriheshin më lehtësisht për të organizuar intervistat por më e rëndësishmja është se në këto grupe ishte më efektive pyetja e hapur dhe gjysëm e hapur. Opinioni i të intervistuarve shoqëruar me argumente do të krijonte një bindje më të fortë mbi përfundimet. Grupet e përzgjedhura për intervista ishin:

- Bankat e nivelit të dytë dhe shoqëritë e lizingut, në cilësinë e përdoruesve të informacionit financiar (16 njësi) dhe shoqëritë e lizingut (5 njësi);
- Përfaqësues të administratës tatimore në cilësinë e përdoruesve të informacionit financiar (4 përfaqësues);
- Pronarë jo menaxherë, në cilësinë e përdoruesve të informacionit të gjeneruar nga pasqyrat (10 sipërmarrës);
- Akademikë në cilësinë e edukatorëve të brezave të profesionistëve dhe njëkohësisht kërkues shkencorë (5 akademikë).

4.3.1 Gjetjet nga intervistat me analistët e kredive të bankave të nivelit të dytë

Numri i institucioneve që sigurojnë financim për NVM-të në Shqipëri është i kufizuar. Siguruesit e financimit duhet të regjistrohen në bankën qendrore dhe lista e tyre është identifikuar përmes ëbsite-it të bankës qendrore në adresën më poshtë:

1. Për Regjistrin e Bankave:
http://www.bankofalbania.org/ëeb/Commercial_Bank_Register_50_2.php
2. Për Regjistrin e Subjekteve Financiare Jo-Banka:
http://www.bankofalbania.org/ëeb/Non_Bank_Entities_Register_5320_2.php

Duke qenë se bankat sigurojnë financimin kryesor për njësitë ekonomike, sidomos për NVM-të, është e rëndësishme që ato të bëjnë të njohur informacionin që mungon në pasqyrat financiare të njësive ekonomike, dhe gjithashtu të kenë më shumë dijeni rreth asaj çfarë presin nga këto njësi kur shqyrtojnë informacionin e tyre financiar. Për këtë arsye pyetjet e bëra në intervista ishin përgatitur për të përcaktuar se sa të dobishme janë pasqyrat financiare për bankat dhe çfarë mund të bëhet, sipas bankave, për të përmirësuar dobinë e tyre.

Pyetjet e përdorura në intervistë ishin kryesisht pyetje të hapura duke qenë se kërkoja të zbuloja çfarë opinionit kishin bankat për sa më sipër. Pyetjet ishin rreth vlerës së përgjithshme të pasqyrave financiare, por dhe për të kuptuar nëse ka fusha të veçanta kontabël të një interesi të veçantë për bankat dhe shoqëritë e lizingut. Modeli i pyetësorit për intervistat është bashkëngjitur si shtojcë në këtë punim.

Tabela 4.2 – Pjesëmarrja në anketim sipas institucioneve financiare


KATEGORIA	Kampioni (nr njësive)	Numri i përgjigjeve	Shkalla e pjesëmarrjes
Banka	16	14	87%
Shoqëri lizingu	5	5	100%
TOTALI	21	19	90%

Të pyetur nëse i përdorin pasqyrat financiare të audituara të hartuara sipas SKK-ve, rreth 52% e të anketuarëve u përgjigjën PO. Kështu gati gjysma e të anketuarëve pohuan se pasqyrat financiare të hartuara sipas SKK-ve nuk kanë luajtur rol të rëndësishëm në vendimet për huadhënie të institucioneve financiare. Arsyet e dhëna për mospërdorimin e pasqyrave financiare mund të kategorizohen si më poshtë:

1. Pasqyrat Financiare nuk janë përgjithësisht në përputhje me SKK-të;
2. Pasqyrat Financiare nuk janë shifrat “e vërteta”;

“Shifrat e vërteta” ishin problem për një pjesë të mirë të zërave të pasqyrave financiare. Sipas të intervistuarve më të hasura ishin mbivlerësimi i aktiveve (inventarëve, klientëve dhe mjeteve monetare), nënvlerësimi i detyrimeve (furnitorëve dhe huave afatgjata), mbivlerësimi i të ardhurave dhe nënvlerësimi i shpenzimeve.

Pjesa më e madhe e institucioneve financiare (95%) pohuan se bilanci dhe pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve ishin të dobishme, por më pak se 50% e tyre mendonin se as pasqyra e fluksit të parasë dhe as pasqyra e ndryshimeve në kapital nuk ishin të dobishme. Përgjigjet janë përmbledhur në Grafikon 1.




Grafiku 4.1- Përqindja e Institucioneve Financiare që raportuan se komponentët e pasqyrave financiare janë të dobishme

Institucionet financiare raportuan se në shumë raste pasqyra e fluksit të parasë mungon në setin e pasqyrave financiare dhe si rezultat shumica e bankave përgatisin pasqyrat e tyre të fluksit të parasë si pjesë e procedurave të tyre të huadhënies.

Rreth 80% e institucioneve financiare raportuan se ndërsa ata besonin se shënimet shpjeguese duhet të jenë një burim i rëndësishëm informacioni, në shumicën dërrmuese të rasteve shënimet shpjeguese nuk përfshihen në pasqyrat financiare dhe në rast se janë aty, mungon përmbajtja e informacionit.


Institucionet financiare në përgjithësi mendonin se pasqyra e ndryshimeve në kapital nuk është e rëndësishme për vendimet e tyre.

Rezultate në dukje kontradiktore u morën në lidhje me raportet e audituesve të pasqyrave financiare: një total prej 84% e të anketuarëve pohuan se ata mbështeteshin në raportin e audituesit, por 74% pohuan se një auditim i kualifikuar nuk do të ndikonte në vendimin e tyre për huadhënie. Siç ilustron Grafiku 2, rezultoi se rreth 95% e të anketuarëve rrallë ose asnjëherë nuk kishin hasur opinione të kualifikuara të audituesve në pasqyrat financiare të hartuara sipas SKK-ve.



Grafiku 4.2: Përqindja e frekuencës së Raporteve të Kualifikuara të Audituesve

Vetëm 21% e institucioneve financiare të pyetura e vlerësuan të kuptuarit e SKK-ve si të mirë, edhe pse asnjë prej tyre nuk e vlerësoi të kuptuarin si të dobët. Në dallim nga kjo, 58% e institucioneve financiare e vlerësuan të kuptuarin e SKK-ve nga klientët e tyre si të dobët dhe me vetëm 5% (vetëm një institucion) që e vlerësoi të kuptuarin e SKK-ve nga klientët e tyre si të mirë.



Grafiku 4.3- Perceptimi i bankave për të kuptuarit e SKK-ve nga klientët

Kur u pyetën se çfarë mund të bënte Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për të përmirësuar të kuptuarin e SKK-ve nga ana e institucioneve financiare, përgjigjet që u morën mund të klasifikohen si më poshtë:

1. Trajnimet do të ishin të dobishme;
2. Një udhëzues në zbatim të SKK-ve do të ishte i dobishëm;
3. Përfshirja e bankave në grupet e punës të KKK;
4. Duhet të konsultohet KKK para se bankat të bien dakord për kurrikulën e trajnimit;
5. KKK duhet të nxisë përmes shoqatave përmirësimin e trajnimit të NVM-ve

Të pyetur për adoptimin e SNRF për NVM, të gjithë përfaqësuesit e institucioneve bankare të intervistuar ishin skeptikë për faktin nëse do të rriste apo jo cilësinë e pasqyrave financiare. Për bankat dhe shoqëritë e lizingut, deri më sot nuk ishte paraqitur ndonjëherë problemi nëse ishin respektuar apo jo parimet e standardeve por a ishin shifrat në pasqyrë të vërteta. Prandaj asnjë prej të intervistuarve nuk ishte në favor të idesë së raportimit me një set tjetër. Në asnjë rast, pranuan ata, pasqyrat nuk janë i vetmi burim i informacionit. Jemi të interesuar, thanë ata, të mbledhim edhe shumë informacion tjetër shtesë nga njësia ekonomike, së pari për të kryqëzuar dhe kuptuar të vërtetën e përafërt të shifrave dhe së dyti për të kuptuar çfarë qëndron pas tyre. Të pyetur nëse shënimet shpjeguese të SNRF për NVM do të kënaqnin kërkesat e tyre në vlerësimin e kredive, thanë se ishin shumë të interesuar për shënime shpjeguese por për hir të së vërtetës pranuan se nuk kishin marrë pranë institucioneve të tyre trajnimet e duhura për të njohur dhe kuptuar pasqyrat sipas SNRF për NVM.

4.3.2 Gjetjet nga intervistat me përfaqësues tatimorë

Intervistat u kryen në mjedise formale, pranë zyrave të tyre dhe intervistat u zhvilluan në formë bisedash me secilin prej individëve të intervistuar. Pyetjet, në

pjesën më të madhe ishin të parashikuara, megjithatë të tjera lindnin gjatë bisedave, gjithnjë në funksion të qëllimit kryesor të intervistës.

Meqenëse paraprakisht kisha evidentuar dallimet mes SKK-ve dhe SNRF për NVM, pyetjet kishin për qëllim gjithashtu edhe të krijonin idenë se çfarë ndikimi do të kishte implementimi i këtyre ndryshimeve të raportimit financiar në arkën e shtetit, meqenëse një nga agjentët kryesorë për mbledhjen e të ardhurave në buxhet është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Seksioni i parë i intervistës synonte të kuptonte përgatitjen profesionale të tatimorëve në drejtim të SKK-ve. Seksioni i dytë synonte të kuptonte rëndësinë e pasqyrave financiare në vendimarrjen e tyre për llogaritjen e tatim taksave të pagueshme nga subjektet tatimore. Seksioni i tretë synonte të kuptonte nëse përbën interes kalimi drejt SNRF duke e parë atë në këndvështrimin e kostove dhe përfitimeve për buxhetin e shtetit.

Fillimisht, me pyetjet e para kërkoja të kuptoja sa të mirëinformuar dhe të kualifikuar ishin nëpunësit tatimorë lidhur me SKK-të. Gjithashtu, kërkoja të kuptoj nëse institucioni bënte trajnime të nëpunësve të tij në drejtim të standardeve të kontabilitetit, të paktën të atyre drejt për drejt të lidhur me kontrollin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare. Në të gjitha intervistat përgjigja rreth përgatitjes profesionale mbi SKK-të ishte pozitive, ku vlerësimi subjektiv për shkallën e njohjes së SKK-ve nga tatimorët kalonte një vlerësim mbi 7 në shkallën nga 1 në 10. Ndërsa pyetjes së dytë, të katërt të intervistuarit iu përgjigjën negativisht. Që prej fillimit të zbatimit të SKK-ve, pra viti 2008, institucioni nuk kishte kryer më trajnime dhe kualifikime të vazhdueshme të nëpunësve të vet lidhur me SKK-të.

Pyetjes së tretë se a ndodh që tatimorët të përfundojnë në çështje gjyqësore me subjektet, dhe këto gjyqe të përfundojnë në dëm të tatimorëve, kjo për shkak të interpretimeve të gabuara të standardeve apo mos marrje parasysh të trajtimeve kontabël sipas standardeve, të intervistuarit ishin shumë të rezervuar. Në mënyrë indirekte apo të nënkuptuar, përgjigjet të çonin në një përfundim jo të kënaqshëm megjithëse përgjegjësia më shumë i lihej individit, pra kishte raste edhe largimesh nga puna për paaftësi të disa inspektorëve tatimorë.

Në kushtet kur me të intervistuarit ishte rënë paraprakisht dakord për privacinë e individit, kishte raste të daljeve jashtë kornizave dhe pranohej se inspektorët tatimorë jo gjithnjë janë individë me profil profesional dhe etik të lartë. Tre nga katër të intervistuarit problemin më të madh e shikon tek paaftësia dhe etika e inspektorëve dhe jo tek legjislacioni tatimor, të cilin e vlerësonin në harmoni me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe standardet e kontabilitetit. Megjithatë, të katërt e pranuan se aktet e kontrollit në mbi 95% të rasteve nuk përfundonin me gjoba për shkak të moskuptimit të standardeve nga njëra apo tjetra palë, por nga një qëndrim i përgjithshëm jo korrekt i biznesit për të manipuluar pasqyrat financiare me qëllim pakësimin e detyrimeve tatimore.

Pyetjes tjetër se a kishte një punë të mirëfilltë profesionale të specialistëve tatimorë kur hartohej ligji i tatimit mbi të ardhurat, e sidomos tek neni i shpenzimeve të panjohura, përgjigjet ishin të katërta në linjë me njëra tjetrën. Shpenzimet e panjohura në përcaktimin e tyre mbanin parasysh kriterin e minimizimit të atyre shpenzimeve që së pari mund të linin vend për abuzime dhe kriteri i dytë ishte lidhja e tyre me të ardhurat kryesore nga aktiviteti.

Pra parimet dhe udhëzimet kontabël të standardeve nuk ishin fokusi ose objekti për t'u ndjekur. Kështu, në intervista të katër tatimorët përmendën pse provizionet, zhvlerësimet e inventarëve, borxhet e këqija dhe shpenzimet e interesit mbahen në kontroll përmes përqindjeve ose dokumentave të tjerë ligjorë konfirmues

dhe nuk i lihet dorë e lirë gjykimit profesional të profesionistëve të praktikës. Ndërsa përsa i përket rivlerësimeve të pronës, të cilat u prezantuan si koncept i ri me standardet e 2008, qëndrimi për të mos përfshirë të ardhurat nga rivlerësimi ashtu si dhe shpenzimet e amortizimit apo zhvlerësimit të pjesës së rivlerësuar të pronës, mbështetej në justifikimin se jo vetëm se nuk lidhej drejtpërdrejt me të ardhurat kryesore të aktivitetit por linte vend për shumë abuzime të cilat mund të kishin efekte të ndjeshme në të ardhurat e realizuara nga tatimet. I vetmi ndryshim që u pranua në 2008 nga legjislacioni fiskal, i cili është në linjë me standardet e kontabilitetit, është njohja e diferencave të konvertimit të zërave materialë në shpenzimet e periudhës kur ato ndodhin.

Me grupin e dytë të pyetjeve, synohej të kuptohej sa përdorehin treguesit e pasqyrave financiare për llogaritjet e të ardhurave të parashikuara për t'u mbledhur për llogari të buxhetit. Të katërt iu përgjigjën me një PO të fortë kësaj pyetje me argumentin se nuk kishin asnjë mundësi tjetër apo bazë tjetër llogaritjesh përveç pasqyrave financiare të njësive ekonomike. Pavarësisht faktit se sa të besueshme mund të jenë këto pasqyra financiare, gjithësesi mbeten i vetmi burim i të dhënave financiare për zyrën e tatimeve. Në vlerësimin e tyre, elementet më të manipuluar ishin pa diskutim ato që gjeneronin detyrime për tatime dhe taksa.

Ndërsa grupit të tretë të pyetjeve, që kishin të bënin me interesimin ose jo të tatimorëve për të ndryshuar regjimin e raportimit financiar, tatimorët nuk iu përgjigjën pothuaj njësoj, si ndodhi me dy grupet e para të pyetjeve. Duke patur paraprakisht të gatshme listën e ndryshimeve më të rëndësishme të SKK-ve me SNRF për NVM, pyetjet e këtij seksioni ishin më të drejtpërdrejta dhe teknike.

Pyetjes së parë, a i plotësojnë pasqyrat financiare të hartuara sipas regjimit aktual të raportimit financiar, të gjitha kërkesat për informacion të tatimorëve, dy nga të intervistuarit iu përgjigjën me Po dhe dy të tjerët me Jo. Përgjigjet Po i referoheshin faktit se pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve e kombinuar me raportimin shtesë të siguruar nga FDP (formulari i deklarimit të pasurisë) mjaftonte për të bërë të gjitha kryqëzimet e duhura si për efekte kontrolli edhe për efekte vendimmarrje. Ndërsa dy të intervistuarit e tjerë që dhanë përgjigjen JO, sollën si argument mungesën e cilësisë së pasqyrës së shënimeve shpjeguese. Sipas tyre, njësitë ekonomike akoma nuk kanë kuptuar rëndësinë e kësaj pasqyre apo më keq akoma nuk dinë çfarë përmban kjo pasqyrë e për pasojë nuk e gjenerojnë të tillë që të plotësojnë kërkesat e tatimorëve si për kontroll ashtu dhe për vendimmarrje.

Pyetjes së dytë, a përbën interes për tatimorët nëse ndryshon regjimi i raportimit, 3 prej të intervistuarve ishin të një qëndrimi skeptik duke argumentuar se përsëri do të kishte shpenzime të panjohura e kjo do ta bënte legjislacionin tatimor indiferent ndaj kërkesave të reja të raportimit financiar. Ndërsa i intervistuari i katërt pati një qëndrim të favorshëm por duke argumentuar se një regjim tjetër raportimi financiar do të ishte i mirëpritur nëse thjeshtonte kërkesat dhe udhëzimet apo më shumë akoma ishte i bazuar në rregulla më shumë sesa në parime, me qëllim të afronte dhe përmirësonte cilësinë e kontrollit tatimor. Duke qenë se të dyja palët, subjekti tatimor dhe inspektori tatimor, do të kishin përpara tyre rregulla, komunikimi mes tyre do të ishte më i fokusuar dhe nuk do të linte vend për interpretime.

Për pyetjen e tretë, a ka kosto, monetare dhe intelektuale, kalimi drejt një regjimi tjetër të raportimit financiar, intervistuesit patën të njëtin qëndrim ose më saktë dhanë pothuaj të njëjtët argumente. Në opinionin e tyre, çdo ndryshim i ligjeve fiskale kërkon një procedurë burokratike pra kërkon kohë dhe burime njerëzore të investuara në këtë proces. Në rradhë të parë duhet bërë një studim fizibiliteti për të parë koston apo përfitimin nga këto ndryshime. Më pas duhet një burokraci normale

që kërkon kohë dhe kosto në burime njerëzore për të bërë të gjitha rregullimet përkatëse të akteve dhe nënakteve ligjore që preken prej këtyre ndryshimeve dhe më pas duhen një seri trajnimesh për tatimorët për t'u njohur me ndryshimet. Por të gjitha këto janë mëse të pranueshme gjithësesi nëse raporti kosto përfitim për buxhetin e shtetit është pozitiv.

Për të kuptuar më pas nëse ata e konsideronin proces me përfitim kalimin drejt SNRF për NVM, pyetjet vijuese merrnin në konsideratë të gjitha dallimet thelbësore të evidentuara nga matrica krahasuese. Të pyetur nëse përbënte interes çështja e njohjes së shpenzimeve të zhvillimit në shpenzime periudhe ndryshe nga më parë ku njihej si aktiv afatgjatë jomaterial, të gjithë të intervistuarit thanë se sido të parashikohej në standarde për fiskun do të kishte përsëri një rregullim duke vendosur tavan të sipërm të shpenzimit të lejuar për periudhën. Për trajtimin e koston së huamarrjes si një shpenzim periudhe, u dhanë të njëjtat argumente si për shpenzimet e zhvillimit. Ato duhen kapitalizuar pasi rëndojnë buxhetin e shtetit në mënyrë iracionale. Për çështjen e emrit të mirë, nëse do të ishte mirë të bëhej një ndryshim, pra të mos testohej për zhvlerësim por të amortizohej, të gjithë pranuan versionin e dytë, i cili ishte më shumë një rregull sesa një parim dhe së pari mund të kontrollohej më lehtë dhe së dyti nuk mund të ishte objekt manipulimi në periudha të catuara. Për çështjen e pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse, asnjë prej tyre nuk kishte informacionin e duhur për të shprehur më pas një opinion, për faktin se koncepti i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse është krejtësisht i ndryshëm nga koncepti i fiskut për të ardhurat e periudhës. Për çështjen e matjes së aktiveve biologjike me vlerë të drejtë, asnjë prej tyre nuk ishte dakord për faktin se njohja me vlerë të drejtë i jep dorë subjektit të rrisë shpenzimet e amortizimit, gjë që bie ndesh me politikat fiskale. Për më tepër gjykonin që do të ishte një çështje subjektive për sa kohë nuk ka bursa bujqësore për të patur çmime referimi që do të shërbenin në një farë mënyre edhe për kontrollin tatimor. Të pyetur për ndryshime të mundshme në standardin e grandeve, që do të thotë njohjen e grandit në të ardhura në momentin kur plotësohet kushti i performancës, qëndrimi ishte i favorshëm pasi së pari ishte në linjë me politikën fiskale të njohjes së shpejtë të të ardhurave dhe së dyti ulte barrën e kontrollit tatimor.

Së fundi, të pyetur nëse standardet tona, SKK-të, duheshin zëvendësuar me SNRF për NVM për qëllime të njehsimit të gjuhës së raportimit me atë ndërkombëtar tatimorët thanë se ishte një hap i panevojshëm. Argumentet që dhanë ishin të ndryshme. Një përgjigje argumentonte se SNRF për NVM edhe pse kishin ato pak ndryshime me SKK-të nuk do të siguronin pasqyra më transparente për faktin se shënimet shpjeguese aktualisht nënvlerësohen nga njësitë ekonomike. Një përgjigje tjetër argumentoi se do të ishte e tepërt që për çështje forme dhe formulimi të krijohej në treg një klimë qoftë dhe fiktive e rritjes së vështirësisë së hartimit të pasqyrave financiare. Përgjigja tjetër argumentoi se nuk është koha për ndryshime të mëdha për faktin se vetëm 6 vjet më parë gjithçka ishte përmbysur krejtësisht me hyrjen në fuqi të SKK-ve. Përgjigja e katërt sillte si argument faktin se cili do set raportimi të përdorej, për sa kohë bizneset tona janë kaq të vogla krahasuar me ato ndërkombëtare, nuk janë pasqyrat ato që përmirësojnë klimën e biznesit por politikat e tatim taksave në përgjithësi. Madje në përgjigjen e tij shprehu qëndrimin se për NVM politikat e taksimit duhet të jenë të ndryshme nga ato të njësitë të mëdha që gjë e bën raportimin financiar të NVM jo çështje interesi për tatimorët.

Të pyetur nëse ishin në favor të ndryshimeve të pjesshme të standardeve apo për kalimin drejt një standardi të ri ndërkombëtar, të katërt ishin në favor të standardeve kombëtare dhe përditësimit të tyre të vazhdueshëm.

4.3.3 Gjetjet nga intervistat me pronarë jo menaxherë

Intervistat e zhvilluara me pronarët jo menaxherë të njësive ekonomike ishin strukturuar sipas disa përfundimeve të rëndësishme të arritura në kuadrin teorik prandaj dhe gjetjet do t'i paraqes sipas këtij organizimi. Duke qenë se këta individë parapëlqyen të ruanin privacinë e tyre, për të evituar konfuzionin e lexuesit do t'u vendos atyre emra fiktivë por duke ju siguruar se këta persona janë realë dhe bizneset e tyre janë biznese me reputacion shumë të mirë në vendin tonë.

4.3.3.1 SNRF për NVM vs. SKK-ve

Në përgjigje të pyetjes së parë e cila ishte në lidhje me llojin e standardeve të kontabilitetit të ndjekura nga NVM-të në Shqipëri, përgjigja e Luanit (sipërmarrës në fushën e ndërtimit), ishte korrekte kur tha se NVM-të në Shqipëri përdorin prej 6 vitesh tashmë SKK-të. Parimet e këtyre standardeve njihen mirë tashmë, sipas opinionit të Luanit. Sipas Besnikut (sipërmarrës në fushën e konfeksioneve), NVM-të në Shqipëri përdorin SKK-të, por për sa kishte ai njohuri ato nuk janë shumë të ndryshme nga SNRF-të e plota pasi parimet bazë të njohjes dhe të paraqitjes janë në të shumtën e rasteve të njëjta. Artani (sipërmarrës në fushën e industrisë përpunuese agroushqimore), tha se standardet e kontabilitetit ishin mëse të mjaftueshme për të kënaqur kërkesën e tij për informacion, pasi ajo që i interesonte ishte shuma e llogaritur e detyrimeve tatimore. Megjithatë, edhe pse nuk i njihte mirë SKK-të, kishte dëgjuar nga stafi i tij që ishin të vështira dhe shumë ndryshe nga kërkesat e tatimoreve. Drita (sipërmarrëse në industrinë e prodhimit të këpucëve) tha se biznesi që ajo drejton bën pasqyra të rregullta (nënkuptonte tatimore). Në përgjigjet e saj nuk kishte asnjë referencë të standardeve të kontabilitetit. Ajo dinte që përpara disa vitesh kishte punësuar në biznesin e saj një profesionist të shkolluar jashtë vendit pasi në treg nuk kish gjetur dikë që njihte ligjin e ri të kontabilitetit që kishte hyrë në fuqi në atë periudhë. Drita nuk ishte në dijeni për çfarë bëhej fjalë konkretisht lidhur me risitë e kontabilitetit në vitin 2008. Gjoka (sipërmarrës i një klinike shëndetësore, iniciativë private) tha se pasqyrat tatimore në biznesin e tij bëheshin në përputhje me ligjet e tatimeve dhe për këtë ishte shumë i bindur. Bindja e tij mbështetej në faktin se në tre kontrollet e fundit tatimore nuk kishte marrë asnjë gjobë. Gjoka tha se 20% të aksioneve të biznesit i kishte një investitor i huaj i cili në fakt ndiqte më nga afër stafin e kontabilitetit. Gjoka më shumë kërkonte informacione për drejtimin, që sipas Gjokës ishin shumë bashkëkohore pasi përgatiteshin me një software të blerë jashtë shtetit.

Pyetjes se cili ishte opinioni i njësive ekonomike lidhur me avantazhet e adoptimit të SNRF për NVM në Shqipëri, Besniku u përgjigj se nuk kishte dijeni për ekzistencën e një standardi ndërkombëtar. Sipas tij kjo çështje nuk duhej diskutuar me pronarët e njësive ekonomike por me kontabilistët dhe audituesit të cilët do të punonin me pasqyrat financiare. Shpjegimit tim se një set global standardesh rrit mundësinë e ardhjes së investitorëve të huaj, Besniku iu përgjigj pozitivisht por përsëri shprehu opinionin e tij se për Shqipërinë ishte akoma herët një ambicie e tillë e sidomos për NVM-të. Sokoli, të njëjtës pyetje iu përgjigj me një pyetje tjetër: “Kur është parashikuar të bëhet ky kalim?”. Interesimi i tij lidhej me faktin se një standard prej 250 faqesh (informacion që e mësoi nga mua) do të donte shumë kohë të kuptohej nga

profesionistët dhe kishte rriskun e gabimeve të mëdha në vitet e para, që në terma financiarë mund të nënkuptonte edhe gjoba për njësitë ekonomike. Ndërsa për Gjokën, pavarësisht faktit që sillte avantazhe në rrafshin e marrëdhënieve me partnerë të huaj (potencialë), adoptimi do të konsiderohej i dështuar që pa filluar pasi tatimorët nuk do kuptonin pse njësia kishte bërë pasqyra të tjera nga ato të një viti më përpara. Sipas Mozës (sipërmarrëse në tregtinë e produkteve të akcizës) fakti që standardi ndërkombëtar rrit krahasueshmërinë e pasqyrave financiare nuk përbënte interes pasi ajo e shikonte biznesin e saj të lidhur dhe të përqëndruar vetëm brenda Shqipërisë dhe nuk synonte financime apo investitorë të huaj që t'i bashkoheshin biznesit të saj. Në opinionin e saj shprehej qartë ideja se çdo ndryshim i ri në kontabilitet do të sillte ndryshime edhe të fiskut e kështu ishte mundësia që të formulohej ndonjë paketë fiskale akoma më shtrënguese për natyrën e biznesit të saj. Meqenëse Drita nuk dinte shumë për të rejtat e ligjit të kontabilitetit, kuptohet që preferoi të mos përgjigjej për pyetjen lidhur me SNRF për NVM dhe mundësinë e adoptimit të saj. I vetmi shqetësim i saj ishte nëse do të gjente përsëri dikë që të kuptonte dhe zbatonte këtë rregullim të ri pasi kish qenë e vështirë edhe herën e parë të gjente dikë të kualifikuar. Sipas Sajmirit (sipërmarrës në fushën e tregtisë me shumicë të pajisjeve elektroshtëpiake), i cili kishte mbaruar studimet në Fakultetin e Ekonomisë, nuk ishte gjë e re të dëgjonte për SNRF-të megjithëse për SNRF për NVM nuk kishte informacion. Ajo që e shqetësonte Sajmirin ishte fakti se SNRF-të ishin aq komplekse dhe shoqëroheshin me aq shumë shënime shpjeguese sa do të bëhej i vështirë përdorimi i tyre për qëllime të vendimarrjes. Sajmiri ishte i qëndrimit që pasqyrat duhej të gjeneronin një informacion minimalist me qëllim që të kuptoheshin nga sa më shumë pronarë, të cilët jo domosdoshmërisht duhej të kishin mbaruar fakultetin ekonomik. Prandaj nuk ishte në favor të adoptimit të ndonjë standardi ndërkombëtar për shkak të kompleksitetit të informacionit të paraqitur në pasqyrat e ndërtuara mbi to. Joana (sipërmarrëse në industrinë e shërbimit hotelier) e cila kishte përfunduar studimet në fakultetin e ekonomisë së UAMD-së, ishte e shqetësuar për një fakt tjetër. Ajo ishte në favor të zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe pse nuk ishte shumë e vetëdijshme cilat mund të ishin përfitimet konkrete, por zbatimi i tyre të ishte i detyrueshëm për një numër më të kufizuar njësisish. Pra me fjalë të tjera, Joana ishte e mendimit që qoftë SKK-të apo qoftë SNRF për NVM, duhej të zbatoheshin për njësi shumë më të mëdha ekonomike, të paktën duke filluar nga një kufi i poshtëm i xhiros mbi 50 apo 100 milion lekë dhe të punësuar mbi 50 persona. Në bindjen e saj njësitë ekonomike nën treguesit e mësipërm duhet të mbanin regjistra kontabël sipas kontabilitetit me bazë monetare dhe të respektonin regjimin fiskal. Në opinionin e saj, kufijtë e poshtëm dhe të sipërm të njësive ekonomike që kanë detyrimin të zbatojnë SKK-të (shifra e afarizmit nga 10 mil deri në 1.250 mil) dhe që për të cilat shtrohet diskutimi i zbatimit të SNRF për NVM, kanë një diferencë jo logjike e për pasojë për disa njësi zbatimi i SKK-ve është “torturë” (termi që përmendi Joana) dhe për disa të tjera është përfitim për arsyet që pranohen në teori (sqaroi ajo). Sipas Sokolit (sipërmarrës në fushën e tregtisë së prodhimeve ushqimore) për njësitë ekonomike shqiptare, sidomos ato që konsiderohen të vogla, nuk shtrohet fare në diskutim çështja e globalizimit. Në opinionin e tij një njësi ekonomike me një numër mesatar të punësuarish shumë më pak se 50 persona nuk mund të aspirojë globalizimin pasi nuk do të mund të përfitonte nga ekonomia e shkallës (term që ai përmendte shumë shpesh gjatë intervistës). Sipas tij, në kushtet kur globalizimi nuk është një aspiratë e momentit nuk ka arsye përse të ndryshojë regjimi i raportimit i cili në fakt i shërben njësive që kanë pikërisht këtë qëllim. E konsideron barrë të panevojshme kalimin në një regjim të ri, i cili për më tepër kërkon shumë shënime shpjeguese për

transaksionet, që në fakt janë transaksione shumë gjenuine (i referohet krahasimit me tregjet ndërkombëtare dhe llojeve të kontratave të bizneseve në vendet e zhvilluara evropiane). Sipas Gjokës, ajo çfarë zhvillon NVM-të nuk janë standardet e raportimit por politikat lehtësuese të qeverisë në fushën e taksave dhe lehtësirave të tjera të biznesit. Ai shprehet i bindur dhe pa rezerva se një standard më i mirë nuk i bën NVM “të shesin më shumë pica”. Sokoli ishte i idesë se globalizimi nuk mund të jetë motivi për kalimin nga një regjim në një regjim tjetër raportimi por thjeshtësia dhe lehtësia e përdorimit të një regjimi të ri mund të ishte motiv dhe nxitës më i fortë. Në kushtet kur vetë SNRF për NVM është më i zgjeruar se SKK-të atëherë është një investim që në vend të na bëjë mirë na bën keq, thotë ai. Në përgjigjen e tij e krahason SNRF për NVM me një model të ri celularësh duke argumentuar se një teknologji komplekse nuk do të ishte e preferuar për ata që e duan celularin për shërbimet bazë të telefonisë. Sipas Mozës nuk ka pse shtrohet çështja e globalizimit, sipas Dritës, NVM-të nuk kanë pse të futen në këtë proces se nuk ka çfarë u zgjidh një standard apo ligj i ri kontabël, ndërsa sipas Sajmirit ai mendon se NVM-të në Shqipëri në 99 % të tyre, nuk e kanë idenë se çfarë është SNRF për NVM-të. Sipas Fuatit (sipërmarrës në shërbimet e sinjalistikës rrugore), fakti që njësitë ekonomike të vogla e të mesme, kanë sot mundësinë të zgjedhin, do të ishte rasti të zgjidhnin SNRF për NVM, për vetë argumentin e fuqishëm të rritjes së krahasueshmërisë. Fuati kishte një qëndrim pozitiv ndaj standardeve universale pavarësisht se mendonte që dita kur do të ndjeheshin efektet pozitive do të ishte disi e largët. Ky qëndrim i tij lidhej me faktin se kufijtë e xhiros dhe numri i të punësuarve në biznesin e tij po arrinin limitet për zbatimin e detyrueshëm të SNRF-ve të plota. Për këtë arsye Fuati ishte në favor të SNRF për NVM për faktin se e afronte stafin e tij një hap më shumë drejt SNRF-ve të plota. Pra e konsideronte një kurs përgatitor për stafin e tij periudhën kur do të zbatonte SNRF për NVM.

Të pyetur për opinionin e tyre lidhur me zbatimin e detyrueshëm apo të vullnetshëm të SNRF për NVM, Besniku u përgjigj se NVM-të nuk kanë përpara tyre një nevojë për të zgjidhur, do të duhej të bëheshin gati vetëm nëse një faktor i jashtëm, si psh, qeveria, do t'i detyronte të zbatonin SNRF për NVM. Besniku u shpreh se detyra e rregullatorëve në fakt është të mendojnë për më të mirën, por më të mirën të mos e vendosin në tavolinat e zyrave por duke marrë dhe mendimin e NVM-ve të cilat do të kenë barrën të përballojnë kalimin nga një regjim në një tjetër. I pyetur më shumë për këtë çështje Gjoka tha se shteti mund të vendoste çfarë të donte por jo “t’u binte në qafë bizneseve në këtë moment të vështirë” pasi për Gjokën ky kalim do të kishte edhe shumë kosto të tjera. Sipas Fuatit, ai ishte i vetëdijshëm se shumë pak NVM ishin në pozitat e biznesit të tij prandaj ishte shumë i ulët interesi për të kaluar drejt SNRF për NVM. Sokoli u shpreh i sigurtë se nëse së bashku do të bënim 100 telefonata atë ditë me pronarë të NVM-ve nëpër Shqipëri, të cilat do të ishin në shifrat e afarizmit 10 – 500 mil lekë, ndoshta dhe më shumë, anjëra prej tyre nuk do të kishte dijeni për SNRF për NVM por dhe pse do t’u tregonim anët e mira të saj përsëri nuk do të ishin të gatshëm pasi nuk e shohin një proces në interes të biznesit të tyre. Edhe Moza ishte e bindjes se NVM-të nuk janë gati të kalojnë në një standard ndërkombëtar, kur kanë vetëm pak vite që po aplikojnë standarde të panjohura më parë për to, rasti i SKK-ve që zëvendësuan Planin e Përgjithshëm Kontabël. Drita u shpreh se biznesi i saj dhe të gjitha njësitë ekonomike që operojnë në të njëjtin sektor me biznesin e saj, nuk po kërkojnë standarde të reja por ulje të taksave e kështu që nuk kanë asnjë interes të ndryshojnë kurs. Sajmiri ishte i mendimit se ndryshimi i regjimit të raportimit financiar do të ishte me leverdi vetëm për bizneset që ofrojnë shërbime kontabiliteti dhe auditimi dhe për asnjë NVM tjetër.

Thënë këtë, ai theksoi me forcë se një standard i ri është kosto shtesë për biznesin pasi duhet të paguajë më shumë këta ofrues shërbimesh kontabiliteti të cilët kanë privilegjin të jenë në kontakt me zhvillimet ndërkombëtare në profesion më përpara se të tjerët. Pra ai ishte i bindur se më shumë këtë kalim në një regjim të ri e kërkonte një lob i caktuar dhe jo nevoja për rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes së përdoruesve të informacionit financiar. Gjoka, ndër të tjera tha se SNRF për NVM duhet të jetë e lejuar për t'u përdorur dhe jo e detyrueshme. Me këtë shprehje e vinte theksin tek fakti që zbatimi i SNRF për NVM duhet të jetë një nevojë e brendshme më shumë se sa një imponim nga jashtë. Ai ishte mëse i bindur që SNRF për NVM e njihnin shumë pak persona të cilët ishin të lidhur me profesionin, ndërsa drejtorët, pronarët apo të punësuarit ishin akoma pa asnjë informacion në këtë drejtim.

Të pyetur në fund se nëse janë ata që vendosin për setin e raportimit, cilin prej tyre do të zgjidhnin, Besniku u përgjigj se preferonte SKK-të jo pse i njihte në detaje por për faktin që kalimi drejt një regjimi të ri do të kërkonte kosto shtesë të shprehur në dije shtesë, kohë pune shtesë dhe investime të tjera në para për rroga personeli më të kualifikuar dhe përshtatje të sistemeve ekzistuese të raportimit dhe kontrollit brenda njësive ekonomike. Dhe nëse do të duhej të zgjidhnin mes SNRF-ve të plota dhe SNRF për NVM padyshim që do të zgjidhnin SNRF për NVM. Besniku ishte i mendimit se përpara se një standard të bëhet i detyrueshëm duhet të kalohet në një fazë tranzitore ku njësitë ekonomike të kenë kohën dhe mundësinë të bëjnë një kalim të butë drejt regjimit të ri. Padiskutim që duhet një periudhë kohe për të trajnuar dhe kualifikuar stafet e kontabilitetit në mënyrën e duhur për më tepër që duhet kohë për t'u shkëputur nga një praktikë të cilën e ke bërë për disa vite rresht dhe për të cilën ke krijuar simpatinë dhe konsideratën tënde. Sipas Fuatit ai preferon SNRF për NVM sepse ka ambicie të rritet por nuk mendon se të tjerët kanë të njëjtën ambicie si ai. Sokoli preferon SKK-të pasi i gjykon më të thjeshta, tashmë familiare për mjedisin e biznesit e për më tepër nuk është gati të investojë para të tjera në këtë proces. Moza përsërit qëndrimin e saj që SKK-të plotësojnë shumë mirë nevojat e njësive ekonomike dhe nëse duhet t'i përafrojmë pasqyrat tona me ato ndërkombëtare do të mjaftonin disa amendime të SKK-ve. Drita nuk shprehu asnjë qëndrim në lidhje me preferencën e saj pasi nuk i njihte këto standarde. Sajmiri i gjykon shumë të parakoshme SNRF për NVM.

4.3.3.2 Karakteristikat e SNRF për NVM

Të pyetur për cilësinë dhe krahasueshmërinë e pasqyrave financiare të NVM-ve, karakteristika që do të përmbushen me adoptimin e SNRF për NVM, Besniku u përgjigj se ky fakt do të kishte vlerë nëse në të gjithë botën do të zbatohesh një standard i vetëm dhe nëse të gjitha njësitë ekonomike do të kishin interes të globalizoheshin. Gjithashtu, ai ishte i mendimit që cilësia dhe krahasueshmëria e pasqyrave financiare rritej nga kopetencat e stafit dhe etikës së tyre në hartimin e pasqyrave financiare. Në opinionin e tij cilësia e pasqyrave nuk ishte variabël i varur i setit të standardeve të përdorur nga njësia ekonomike. Sipas Fuatit një standard global e rrit cilësinë dhe krahasueshmërinë, teorikisht dhe praktikisht. Megjithatë ngre një pikë dyshimi përse shtetet e mëdha janë kaq skeptike për ta bërë të detyrueshëm në çdo vend SNRF për NVM-në. Pra ruan një rezervë se mos teoria dhe praktika në një moment nuk do të ecin në binarë paralel. Sipas Artanit, që pas viteve 90'e deri në 2008, kontabilistët kishin në dorë një libër me rregulla kontabël që i ndihmoi ata të bëheshin

profesionistë të aftë. Në ato vite biznesi lulëzoi. Kush mund të thotë që ishin rregulla të këqia, shprehet ai. I ndryshuam standardet por biznesi nuk eci dhe më përpara, të paktën që nga viti 2008, insistoi ai. Prandaj në fund e mbylli me një përgjigje të prerë se nuk është cilësia e pasqyrave financiare që zhvillon biznesin por klima e biznesit, lufta ndaj korrupsionit dhe konkurrencës së pandershme. Asnjë prej këtyre dy faktorëve, sipas Artanit nuk luftohet nga standardet e kontabilitetit. Sipas Sokolit problemi duhet parë duke i ndarë NVM-të në dy grupe: grupin e NVM-ve që nuk zbatojnë standarde (pra nuk ndërtojnë pasqyra financiare sipas SKK-ve) dhe grupin e atyre që zbatojnë rigorozisht standardet. Të parat e kanë të vështirë të sigurojnë fonde në tregjet formale të financimit dhe kreditimit, pra konsiderohen jashtë sistemit financiar. Grupi i dytë është në sistem dhe gjen më lehtë fonde dhe financime. Sokoli e thëllon argumentin e tij duke thënë se për njësi ekonomike që kanë nevojë për financime është i domosdoshëm zbatimi i standardeve por cilin set të standardeve të përdorin këtë fakt e përcakton ambicia e tyre. Nëse kërkojnë financime jashtë Shqipërisë, nëse synojnë shkrirjen apo bashkimin me shoqëri të huaja dhe nëse synojnë të listohen në bursa atëherë të zgjedhin SNRF për NVM. Në këtë zgjedhje të tyre, cilësia dhe krahasueshmëria e shtuar e pasqyrave do të ishte një kredit më shumë për këto njësi ekonomike. Moza në përgjigjen e saj është e vetëdijshme për çështjen e krahasueshmërisë por jo të cilësisë së shtuar të pasqyrave nëse kalohet drejt SNRF për NVM. Por ajo ngre dyshimin se sot njësitë ekonomike të vogla e të mesme po përpiqen të ulin kostot dhe jo të rrisin krahasueshmërinë e pasqyrave financiare. Drita konfirmon qëndrimin e saj duke thënë se e rëndësishme është të respektohen kërkesat e fiskut të cilat shoqërohen me gjopa nëse shkelen dhe jo standardet sepse investitorët e huaj nuk nisen nga pasqyrat por nga interesat dhe kthimet e investimit kur vendosin të transferojnë fonde në një vend të huaj. Sajmiri insiston se janë rregullat ato që rrisin cilësinë dhe jo parimet. Parimet lënë vend për interpretime dhe nuk mund të sigurojnë krahasueshmërinë. Ai është i mendimit se nëse duhet të ndryshojmë diçka, ndryshimi duhet të jetë drejt rregullave dhe jo drejt parimeve, pra jo drejt SNRF për NVM. Gjoka shpreh me rezerva mendimin se cilësia dhe krahasueshmëria e pasqyrave janë domosdoshmëri për përdoruesit e informacionit. Sipas tij SNRF për NVM mund të rrisë në teori krahasueshmërinë, por rrit aq shumë kompleksitetin e pasqyrave sa pronarët të cilët jo domosdoshmërisht janë të shkolluar, zor se do të merrnin vendime të mira kur nuk do të kuptonin se si kanë dalë ato numra në pasqyra.

Pyetjes se a i përgjigjet realiteti shqiptar i biznesit përfundimit teorik që standardet e harmonizuara rrisin eficienten e tregjeve dhe reduktojnë koston e sigurimit të kapitalit, Besniku iu përgjigj pozitivisht. Edhe të gjithë të tjerët iu përgjigjën pozitivisht por gjithnjë duke iu referuar shpjegimeve teorike. Në realitet, asnjë prej tyre nuk priste që zbatimi i standardeve të harmonizuara të rriste eficienten e tregut. Investitorët e huaj në Shqipëri janë shumë pak dhe kryesisht të fokusuar në industritë elitare si institucionet financiare, energjitika, apo telefonja. Në fusha të tjera të biznesit janë investitorët vendas ata që kanë investuar fondet e tyre prandaj harmonizimi global i regjimit të raportimit financiar nuk përbën interes praktik, tha Besniku. Referuar uljes së koston së sigurimit të kapitaleve përsëri të gjithë të intervistuarit kishin të njëjtin qëndrim. Bankat në Shqipëri nuk të mbështesin me fonde sepse pasqyrat janë ndërtuar mbi këtë apo atë standard por mbi ecurinë e biznesit dhe aftësinë paguese të cilat i vlerësojnë edhe në mënyra alternative. Pra seti i standardeve nuk redukton riskun dhe koston e sigurimit të financimit. Për më tepër të gjithë ishin të paqartë si mund të vlerësohej ulja e riskut apo koston së sigurimit të financimeve kur ofruesit e fondeve nuk janë të shumtë dhe vështirë se biznesi ka alternativa të shumta e të mund të zgjedhë apo të krahasojë kostot e financimit.

Të pyetur nëse SKK-të tona i kanë karakteristikat e kuptueshmërisë, rëndësisë, besueshmërisë dhe krahasueshmërisë, të gjithë u përgjigjën se nuk kishin kopetencat e duhura për të dhënë këtë përgjigje. Besueshmërinë e lidhnin kryesisht me faktin e manipulimit me dashje të shifrës së afarizmit duke faturuar çmime fiktivisht më të ulta ose duke siguruar fatura fiktivisht më të fryra të shpenzimeve. Rëndësia dhe materialiteti nuk ishin të njohura për ta ndërsa kuptueshmërinë e lidhnin me faktin se sa të detajuara ishin shënimet shpjeguese, të cilat i shikon tërësisht në funksion të zyrës së tatim taksave dhe jo të vedimmarrjes së tyre. Për arsyet më sipër, gjykonin se adoptimi i SNRF për NVM nuk do të përmirësonte apo përkeqësonte karakteristikat e kuptueshmërisë, rëndësisë dhe besueshmërisë.

Pyetjes lidhur me ndikimin e cilësisë së pasqyrave në minimizimin e asimetrisë së informacionit mes njësive ekonomike dhe palëve të interesuara, Besniku, Artani dhe Gjoka iu përgjigjën pozitivisht. Në të kuptuarit e tyre, cilësia e pasqyrave varej nga përgatitja e stafit më shumë se nga seti i standardeve por gjithësesi mbetej fakt që cilësia e pasqyrave ul riskun e asimetrisë. Moza, Drita, Sokoli dhe Joana nuk ishin të interesuar për këtë çështje pasi vendimet e tyre të biznesit i merrnin më shumë mbështetur në raportet e brendshme që gjeneronte stafi i kontabilitetit dhe menaxheri. Absolutisht ata ishin të mendimit që cilësia e pasqyrave financiare nuk ftonte apo largonte investitorët e huaj për sa kohë pasqyrat financiare nuk publikohen apo rankohen nëpër bursa. Investitorët, nëse ka të tillë, i zgjidhin marrëveshjet e biznesit duke kërkuar dhe duke bërë analiza të treguesve të marrë në mënyra të tjera nga vetë bizneset. Çfarëdo të shkruhet në shënimet shpjeguese, ata kurrësesi nuk besojnë se një investitor apo ofrues fondesh do të mbështetet aty për të marrë vendimet e rëndësishme të së nesërme. Në qëndrimin e tyre, ata janë të bindur se investitorët as nuk i referohen pasqyrave financiare pasi janë të bindur që çdo njësi ekonomike ka shumë gjëra të pashkruara e të patreguara nëpër pasqyrat financiare, cildo qoftë regjimi i raportimit financiar.

4.3.3.3 Analiza kosto / përfitim e SNRF për NVM

Pyetjes nëse do t'i kushtonte NVM-së kohë dhe para' adoptimi i SNRF për NVM, Besniku iu përgjigj me një Po të fortë. Sipas tij NVM-të nuk e kanë ekspertizën e nevojshme në këtë moment për të kaluar drejt SNRF për NVM prandaj do të duhet të paguajnë shërbime kontabiliteti jashtë njësive ekonomike. Së dyti do të duhet të trajtojnë stafin e tyre ose të punësojnë dikë tjetër më të kualifikuar për të vazhduar më tej në vite punën e bërë fillimisht nga shoqëritë që ofrojnë shërbime kontabiliteti dhe në fund do të duhet të përshtasin disa sisteme të ngritura për kontrollin, që mund të jenë software ose dokumente të prodhuar në formë manualesh. Pra për Besnikun kosto shihej e lidhur si me vështirësinë e zbatimit për herë të parë ashtu dhe përshtatjen në përgjithësi të sistemeve të ngritura. Fuati, Sokoli, Drita dhe Gjoka ishin të të njëjtit mendim gjithashtu. Moza shprehu qartë qëndrimin e saj duke thënë se kurset e trajnimit të stafit janë të kushtueshme dhe në këtë moment pothuaj asnjë NVM nuk do të ishte e gatshme për të bërë këtë investim, sidomos kur përfitimet, nëse ka, janë në një kohë të mëvonshme. Sipas Sajmirit, nuk do të mund të kalonte pa kosto adoptimi i SNRF për NVM, pasi kështu kishte qenë për të gjitha njësitë ekonomike të mëdha në Shqipëri në momentin kur për ato u bënë të detyrueshme SNRF-të e plota. Sikur vetëm koha e investuar, thotë Sajmiri, për të plotësuar të gjitha kërkesat për shënime shpjeguese, të matej në para', përsëri është

një kosto për njësitë sidomos ato të vogla. Gjoka në fakt ishte më optimist në qëndrimin e tij duke u shprehur se kostot pavarësisht peshës që do të kishin në bilancin e vitit, do të bëheshin vetëm një herë e më pas në vitet që vijnë stafi do të vetëperfeksionohet sepse do t'i konsideronte operacione rutinë.

Kur u pyetën nëse përfitimet në fazat e ardhshme nga zbatimi i SNRF për NVM do të tejkalonin kostot për adoptimin e saj, Besniku tha se nuk mund të jepte një përgjigje të sigurtë për këtë çështje. Një sistem nuk mundet kurrësesi të vlerësohet vetëm në teori, është praktika ajo që tregon sa i saktë ka qenë vlerësimi teorik. Besniku u shpreh se ndërsa kostot e adoptimit maten shumë thjeshtë, përfitimet vështirë se mundën të identifikohen e për më tepër të maten. Sipas mendimit të tij shanset që SNRF për NVM të përmirësojë treguesit e biznesit të NVM-të në Shqipëri, të paktën në këtë moment kohe, janë shumë të vogla. Fuati, i cili në fakt ishte në favor të adoptimit të SNRF për NVM sepse kishte ambicien të ishte në pak vite pronari i njësie ekonomike të madhe, lidhur me këtë pyetje sërish u përgjigj që përfitimet priten të jenë shumë afatgjatë në raport me kostot që janë në maksimumin e tyre për të paktën dy vitet e para. Sokoli shprehu opinionin që vetëm një njësi ekonomike që ka interesin të listohet në bursa mundet të “shijojë” përfitimet e SNRF-ve, të tjerat vetëm kosto do të përballojnë. Pra e vetmja gjë që ndjehet janë kostot, e në këtë mënyrë s'mund të thuhet dot nëse përfitimet do të tejkalojnë ndonjëherë kostot e investuara, tha Sokoli. Drita, në opinionin e saj ishte më konkrete duke thënë se i duhen të paktën 10 vjet një njësi ekonomike të kuptojë nëse ka vepruar mirë apo keq prandaj nuk është pikërisht momenti i mbijetesës së njësive ekonomike momenti i duhur për të menduar cili do të jetë rezultati pas 10 viteve. Artani është kategorik në opinionin e tij duke thënë se për njësitë e vogla ka vetëm kosto ndërsa për të mesmet vjen një moment në kohë kur përfitimet do të fillojnë të ndjehen dhe këtë fakt e lidh me integrimin në BE të Shqipërisë dhe lëvizjen e lirë të kapitaleve brenda kufijve Evropianë. Sipas Gjokës, një njësi ekonomike e vogël nuk do të ketë asnjëherë prioritet standardet e kontabilitetit por do të mundohet gjithnjë të respektojë rregullimet sipas fiskut.

Pyetjes nëse NVM-të dhe stafi i tyre do ta përballonin me forcat e veta kalimin nga një regjim në një tjetër apo do të kërkonin konsulencë jashtë njësisë ekonomike, Besniku ishte i bindur për mundësinë e dytë. Një përballim me forca të brendshme do të kishte më shumë kosto thotë Besniku për faktin se do të merrte shumë kohë kontrolli dhe korrigjimi i gabimeve të mundshme. Sipas Besnikut, Mozës, Gjokës, Fuatit dhe Artanit do të ishte më e mirë të merrej një shërbim kontabiliteti jashtë njësisë ekonomike ndërsa të intervistuarit e tjerë ishin në favor të idesë që të punësonin një person shtesë në departamentin e kontabilitetit i cili të kishte aftësinë, eksperiencën dhe vullnetin për të përballuar këtë tranzicion. Megjithatë pronarët e njësive më të mëdha në këtë kampion ishin në favor të krijimit të një stafi të qëndrueshëm plotësuar me rekrutime të reja kurse ata të njësive ekonomike më të vogla ishin në favor të kontraktimit të shërbimeve jashtë njësisë.

4.3.3.4 Përgjegjësia shoqërore e njësive ekonomike

Të pyetur nëse mënyra si paraqiteshin pasqyrat financiare a mbante në një farë mënyre parasysh edhe kriterin e përgjegjësisë shoqërore të njësisë (PSK¹¹), asnjë prej

¹¹ PSK – Përgjegjësia sociale e Korporatave

tyre nuk dha një përgjigje të saktë. Disa prej tyre kuptonin me PSK respektimin e të gjitha rregullave të vendosur nga rregullatorët kombëtarë ndërsa disa të tjerë nënkuptonin vetëm pagesat e rregullta për detyrime tatimore dhe të kontributeve. Në asnjë përgjigje nuk trajtohej përgjegjësia sociale si një detyrim moral dhe etik i njësisë ekonomike për të dhënë në shënime shpjeguese informacione të ndryshme, jo detyrimisht financiare, që ndihmonin publikun dhe të gjithë palët e interesuara të kuptojnë më shumë rreth mjedisit dhe rrethanave në të cilat aktiviteti ishte zhvilluar.

4.3.3.5 Standardet e mbështetura në parime vs. standardeve të mbështetura në rregulla

Të pyetur nëse SKK-të janë standarde të mbështetura në rregulla apo parime asnjë prej të intervistuarve nuk ishte në gjendje të jepte një përgjigje. Të gjithë kërkuan më shumë shpjegime për këto përcaktime dhe megjithatë nuk dhanë dot një qëndrim të qartë. Të gjithë ishin të mendimit që janë më të mirë standardet me rregulla pasi nuk lënë shumë vend për “të gabuar”.

Në të kuptuarit e tyre, me gabime nënkuptonin rrëshqitjen nga rregullimet e fiskut. Drita ishte e mendimit se po të kishin standardet rregulla ajo do të mund të kuptonte më mirë përmbajtjen e pasqyrave sepse rregulli do të ishte i qartë. Fuati ishte i mendimit që parimet bëjnë që punonjës të ndryshëm të stafit të kenë qëndrime të ndryshme dhe kjo do të vështirësonte punën mes tyre. Sajmiri mendonte se rregullat mundësojnë dhe kontrollojnë më të mirë. Artani ishte skeptik i parimeve madje shprehu bindjen se manuali i kontabilitetit që përdorej deri para vitit 2008 ishte aq i qartë sa dhe pronarët pa arsimin përkatës e kishin të qartë se çfarë ishte pasqyruar në pasqyrat financiare.

Ajo që i bashkonte të gjithë të intervistuarit lidhur me këtë çështje ishte qëndrimi se pavarësisht nëse SKK-të ishin të mbështetura në rregulla apo parime ky fakt nuk ndryshonte gjë në punën e përditshme të kontabilistëve në njësitë e tyre ekonomike. Para së gjithash ata do të ishin të kujdesshëm të respektonin rregullat fikse fiskale e më pas do të mendonin për rregullat apo parimet e standardeve.

4.3.3.6 Përdoruesit e pasqyrave financiare

Në përgjigje të pyetjes së kush janë përdoruesit e tjerë të pasqyrave financiare të njësive ekonomike ku ata janë pronarë, Besniku u shpreh se më së shumti përdoruesit janë brenda njësisë ekonomike, ndërsa të jashtëm mund të jenë vetëm bankat dhe institucionet e kreditimit. Në gjykimin e tij Bordi i Drejtorëve ishte më i interesuar për pasqyrat brenda njësisë ekonomike ndërsa tek përdoruesit e jashtëm shtoi me rezerva edhe qeverisjen vendore ose qëndrore, por i referohej rasteve të tenderave publikë. Sipas Fuatit bankat ishin përdoruesi kryesor i pasqyrave. Sokoli i ndante përdoruesit në dy grupe: shteti (zyra e tatim taksave) dhe privatët (bankat dhe shoqëritë e lizingut). Moza tha të njëjtën gjë si Fuati, duke përmendur autoritetet shtetërore dhe kreditorët e fondeve. Të gjashtë të intervistuarit të tjerë ishin të mendimit se pasqyrat financiare bëheshin vetëm për zyrën e tatim taksave pasi me kreditorët dhe me investitorët përdoreshin raporte të tjera për vlerësimin e

marrëdhënieve. Ata shprehën shumë sinjerisht shqetësimin se biznesi sot përgatit 2 deri në 3 palë pasqyra ku njëra palë bëhet për tatimorët dhe të tjerat për bankën ose aksionerët, sipas kërkesës.

Të gjithë të intervistuarit dhanë të njëjtën përgjigje për pyetjen se ku mbështeten më së shumti pronarët / aksionerët, pra ata vetë, në vendimet e tyre. Përgjigjet të përmbledhura në një të vetme do të ishin: "...për pronarët / aksionerët rëndësi më të madhe kanë raportet narrative sesa pasqyrat financiare, qofshin dhe ato jo të përgatitura për zyrën e tatimeve".

Të pyetur nëse është e vërtetë se pronarët e njësive ekonomike të vogla janë më pak të varur në vendimmarrje nga pasqyrat financiare, Besniku iu përgjigj duke sjellë disa argumente për ta konfirmuar dhe një herë këtë pohim. Ai shpjegoi se në një njësi ekonomike me një pronar dhe që menaxhohet prej tij, pasqyrat nuk janë burimi i informacionit. Ai është në brendësi të gjithçkaje që ndodh në të përditshmen e njësive ekonomike prandaj për vendime nuk pret të gjenerohen raportet apo pasqyrat financiare. Pra Besniku e shikon varësinë e vendimmarrjes tek pasqyrat vetëm për njësitë e mesme ku menaxherët janë të ndryshëm nga pronari / ët. Edhe Gjoka u shpreh se njësitë ekonomike të vogla absolutisht s'e kanë nevojë për pasqyrat financiare kur marrin vendimet e tyre. Fuati tha se pasqyrat bëhen një herë në vit dhe kjo nuk mjafton për pronarin që të marrë vendime. Më shumë se pronarit, pasqyrat i duhen investitorëve të cilët nuk integrohen në aktivitetin e njësive. Një pronar që është i lidhur përditë me njësinë kërkon informacion të përditshëm nga kontabiliteti dhe të paktën një herë në tre muaj kërkon një raport në format pasqyrash ose jo për të ditur ecurinë e shifrave. Sokoli pa rezerva tha se më shumë di kontabilisti për njësinë sesa pronari. Duke e zgjeruar më shumë opinionin e tij tha se pronari nga pasqyrat nuk kupton aq sa për të marrë vendime operative. Pasqyrat shërbejnë për të marrë vendime strategjike ose të paktën afatmesme. Pasqyrat nuk e zgjidhin menaxhimin e përditshëm. Prandaj shtoi ai pasqyrat mjafton të bëhen për tatimorët dhe pjesa tjetër nuk kanë shumë interes përjashtuar rastin kur ka investitorë të huaj apo duan të listohen nëpër bursa. Mundësinë e financimeve nga jashtë Sokoli e përjashtonte. Moza dhe Drita në kundërshtim me Besnikun i shikojnë pasqyrat në funksion të përdoruesve të jashtëm dhe aspak të përdoruesve të brendshëm. Ndër përdoruesit e jashtëm përmenden tatimorët dhe bankat. Sipas mendimit të tyre, përdoruesit e brendshëm përdorin lloje të tjera informacionesh për të marrë vendimet e përditshme apo afatgjata.

Pyetjes nëse SNRF për NVM do të lehtësonte punën e bankave në marrjen e vendimeve, Besniku iu përgjigj se një gjë e tillë mund të ishte e mundur vetëm nëse specialistët e bankave janë më të trajnuar për të kuptuar këtë standard. Gjithashtu shtoi se për faktin që bankat në Shqipëri janë filiale të bankave të huaja, ato do ta kenë më të lehtë të sigurojnë ndihmë nga mëmat në manualët e analizave të riskut pasi do të duhet të analizojnë mbi pasqyra të ndërtuara mbi të njëjtat standarde si dhe të atyre të vendeve të mëmës. Por megjithatë këto mundësi ishin të vakëta prandaj qëndrimi i Besnikut nuk ishte shumë në favor të një përgjigje pozitive. Sipas Fuatit, bankat marrin dhe shumë informacione shtesë dhe për më tepër bëjnë vetë disa lloje të tjera llogaritjesh dhe kryqëzimesh që në një farë mënyrë e bëjnë jo relevant setin e standardeve të përdorura. Sokoli me pak ironi tha se për bankat mund të ishte një lehtësim por deri sa të shkonin në bankë njësitë ekonomike do të kishin "vdekur" në përpjekjen e tyre për të bërë pasqyra të sofistikuar me SNRF për NVM. Moza dhe Drita u shprehën se vetëm nëse kërkon financime nga një institucion ndërkombëtar ke interesin të zbatosh një standard ndërkombëtar, në të kundërt standardet lokale e bëjnë më së miri punën e tyre. Sajmiri ishte i mendimit se një gjë e tillë mund të ndodhë ose

mund të jetë efektive, por në një periudhë afatgjatë. Sot për sot bankat janë mëse të mjaftuara me pasqyrat që përgatit biznesi, nëse ato janë të vërteta dhe kanë informacione shpjeguese të mjaftueshme sipas kërkesave që një ofrues fondesh ka. Sipas Gjokës, një bankë ofron hua mbështetur në personalitetin dhe emrin e mirë të pronarit dhe të vetë njësive ekonomike (apo në bazë të marrëdhënieve personale) dhe aspak mbështetur në pasqyrat financiare. Ato janë dokumenta formale në dosjen e aplikantit, u shpreh Gjoka.

Të pyetur nëse autoritetet e taksave kanë nevojë për pasqyra financiare për llogaritjen e taksave, Besniku tha se tatimorët kanë shumë nevojë për to. Madje sipas Besnikut, sa më i lartë të jetë kufiri i poshtëm për auditimin e njësive ekonomike aq më i madh është interesimi i tatimorëve për këto pasqyrat financiare. Fuati ishte i mendimit se në kushtet e një asimetrie informacioni mes njësive ekonomike dhe tatimorëve, do ishte mirë që pasqyrat financiare të mos përdoreshin për qëllime të llogaritjes së taksave madje as për kontrollin e detyrimeve tatimore. Fuati thotë që njësia ekonomike është në brendësi të pasqyrave ndërsa tatimori jo dhe për këtë arsye vështirë se mund të kuptojnë njëri tjetrin. Njësitë ekonomike, sipas Fuatit duhet të paraqesin pranë zyrës së taksave vetëm pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe shënime shpjeguese për zërat e kësaj pasqyre. Shpjegimet duhen bërë për atë pjesë të pasqyrës dhe për ato zëra që kanë një trajtim të ndryshëm, referuar nga njëra anë standardit dhe nga ana tjetër rregullimit fiskal. Sipas Sokolit, pasqyrat financiare u shërbejnë tatimorëve jo vetëm për të parë të ardhurat dhe shpenzimet por dhe lëvizjet e kapitalit pasi aty ka shumë vend për abuzime sidomos me tatimin mbi dividendët. Gjithashtu edhe pasqyra e flukseve të parasë u shërben tatimorëve pasi është një mjet për të kuptuar nëse njësia ekonomike ka raportuar saktësisht qarkullimin e saj apo e ka fshehur për qëllime të uljes së tatimit mbi fitimin. Por Sokoli gjykon që kontrolli i këtyre pasqyrave nuk duhet bërë sipas rregullimeve fiskale por sipas standardeve ose e thënë më qartë, Sokoli shprehet që do të ishte në ndihmë të biznesit nëse fisku i shkon pas standardeve dhe jo anasjelltas. Drita dhe Sajmiri janë në kundërshtim me idenë që tatimorët kanë nevojë për pasqyrat për të bërë llogaritjet e tyre pasi ata mendojnë se më së shumti tatimet paravendosen në tavolinat e disa burokratëve mediokër dhe sa herë që ata nuk realizojnë planin e kompensojnë diferencën me gjopa ndaj njësive ekonomike pa u inrteresuar për cilësinë dhe vërtetësinë e pasqyrave financiare. Gjoka thotë se tatimorët kanë akses në librat e njësive ekonomike kur dhe sa herë të duan. Prandaj nuk ka pse të jetë e detyrueshme paraqitja e pasqyrave financiare një herë në vit, apo më keq akoma të aplikohen gjopa të rënda për raste vonesash.

4.3.3.7 *Statusi i zbatueshmërisë së standardeve*

Pyetjes nëse njësitë i zbatojnë standardet vullnetarisht apo të detyruara, Besniku iu përgjigj se janë të detyruar. Megjithatë, tha ia, gjopa ligji i kontabilitetit nuk ka por kontabilistët tanë tashmë i kanë mbyllur ciklet e trajnimeve dhe janë familiarizuar me SKK-të. Duke qeshur tha se me siguri ata i kanë harruar rregullimet e vjetra. Fuati tha se pavarësisht detyrimit për të zbatuar standardet, jo të gjitha janë të zbatueshme. Sa më e vogël një njësi aq më pak standarde aplikon. Pra standardet janë sa të detyrueshme aq dhe vullnetare, në qëndrimin e Fuatit. Sipas Gjokës, asnjë njësi ekonomike nuk do të dëshironte barriera por ligji është i detyrueshëm për të gjithë. Megjithatë, vazhdon Gjoka të argumentojë, për sa kohë ligji për kontabilitetin nuk ka

sanksione, biznesi nuk është nën presion. Pra sipas Gjokës, bizneset janë angazhuar në një farë mënyre vullnetarisht të zbatojnë SKK-të. Drita pyetjes i përgjigjet me pyetje: “Po pa standarde fare, çfarë pasqyrash do të kishin përgatitur njësitë ekonomike?”. Dhe i jep përgjigje pyetjes së vet duke konfirmuar për të disatën herë se bizneset bëjnë të detyruar vetëm pasqyrat tatimore, të tjerat nuk i interesojnë fare. Artani thotë se fakti që njësia ekonomike ku ai është pronar nuk zgjodhi por u këshillua nga audituesi për zbatimin e standardeve të reja, në vitin 2008, atëherë kjo do të thotë se standardet janë të detyrueshme dhe jo vullnetare. Gjithashtu nuk janë pika e referencës për të kuptuar si shkojnë punët e biznesit. Në këtë kuadër, Gjoka shtron shqetësimin se a do të prodhohet dot një standard që njësitë do të angazhohen vullnetarisht ta zbatojnë?

Pyetjes se cili do të ishte qëndrimi i NVM-ve nëse adoptimi i SNRF për NVM do të ishte i detyrueshëm dhe i menjëhershëm, Besniku iu përgjigj shkurt duke përdorur termin “katastrofë”. Pavarësisht, tha ai se në të ardhmen mund të burojnë dhe përfitime teorike, sot për sot, madje për të paktën dhe 20 vite, NVM-të shqiptare nuk duhen ngarkuar me barrën e kalimit drejt ndonjë regjimi tjetër raportues. Çdo ndryshim është kosto, e mbylli ai komentin e tij. Sokoli përdori metaforën “si të ushqesh me liko ftoi një beb të sapolindur”. Të gjithë e dimë që likoja e ftoit është shumë e mirë por një fëmijë gjiri nuk e kapërcen kurrësesi. Ai e konsideron SNRF për NVM të vështirë, të madh, të parakohshëm dhe më shumë një tekë për t’u dukur në sy të ndërkombëtarëve sesa për të ftuar investitorët e huaj. Drita ishte e mendimit se kur ky standard të ishte i detyrueshëm për çdo shtet të Evropës, atëherë të diskutohej dhe në Shqipëri çështja e adoptimit. Ajo nuk kishte besim se ky standard përmirësonte treguesit e zhvillimit të njësive ekonomike dhe të vetë tregut gjithashtu.

Pyetjes se cila mund të ishte mënyra për t’iu përafruar raportimit financiar global përmes SNRF për NVM, të gjithë u përgjigjën se nuk kanë një propozim sot. Vendimi më i mirë është të thjeshtohen sa më shumë të jetë e mundur standardet aktuale dhe të fillohet me prezantimin e SNRF për NVM në qarqe profesionistësh për ta filluar ngadalë një proces të paktën 10 vjeçar të familiarizimit me regjimin e ri që pritët të dominojë në Evropën e pas disa viteve.

4.3.4 Gjetjet nga intervistat me akademikë të fushës

Intervista me akademikët e fushës u krye në mjedis joformal për të krijuar një klimë të lirshme diskutimi dhe për të marrë maksimumin e argumenteve në mbështetje të opinioneve të dhëna. Përzgjedhja e akademikëve u bë mbi kriterin e njohjes publike të tyre, pra të rolit dhe kontributit real që këta akademikë kanë dhënë në drejtim të shkencës së kontabilitetit dhe mësimdhënies së kësaj lënde nëpër shkolla.

Në kampionin e vogël të akademikëve u përzgjedhën dy lektorë të nderuar të kontabilitetit në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, një lektor i kontabilitetit në Fakultetin e Ekonomisë pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, një lektor kontabiliteti nga Fakulteti i Ekonomisë të Universitetit Jo Publik “Universiteti Evropian i Tiranës” dhe një lektor i kontabilitetit në Shkollën e Lartë Jo Publike “Marin Barleti”. Të pesë këto personalitete në fushën e arsimit të lartë kanë merita të paçmuara përsa i përket kërkimit shkencor dhe teksteve serioze në fushën e kontabilitetit por dhe angazhimit të tyre në reformat e bëra në Shqipëri qoftë në fushën e kontabilitetit qoftë në reformat në arsimin e lartë.

Për realizimin e intervistës zgjidha që të pestë të intervistuarit të ishin në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë duke e zhvilluar kështu takimin si një tryezë të rrumbullakët ku rrihej mendimi akademik. Intervista u konceptua në tre seksione. Seksioni i parë lidhej me kërkimin e opinionit të tyre në drejtim të adoptimit të SNRF për NVM të argumentuar mbështetur në avantazhe dhe disavantazhe. Seksioni i dytë kërkonte të shkonte më në thellësi të problemit duke kërkuar një opinion nëse kurikulat tona të kontabilitetit mund të përgatisin profesionistë të praktikës të gatshëm për të asimiluar këto zhvillime në fushën e raportimit financiar. Seksioni i tretë synonte të mblidhte opinione mbi afatet dhe kosto e mundshme për t'u përballuar për një proces normal të adoptimit të SNRF për NVM. Për lehtësi të lexuesit sërish të intervistuarve do t'u jepet një emër i cili nuk është identiteti i tyre i vërtetë. Pyetjet ishin të njëta për të gjithë dhe diskutimet e tyre i mbaja shënim në formën e minutave të takimit. Më pas nga transkriptimi i tyre dolën gjetjet si në vijim të ndara në tre seksione.

Disa ditë përpara realizimit të intervistës, u kisha vënë në dispozicion të intervistuarve, një përmbledhje të shkurtër të përfundimeve të pyetësorit të bërë me përgatitësit e pasqyrave financiare, me qëllim që diskutimet të bëheshin mbi një realitet sado i pakëndshëm ai të ishte.

4.3.4.1 Avantazhet / disavantazhet nga adoptimi i SNRF për NVM

Pyetjes lidhur me avantazhet e adoptimit të SNRF, të gjithë të intervistuarit ishin dakord dhe renditën me lehtësi disa avantazhe. Theksin kryesisht e vunë tek rritja e cilësisë së pasqyrave financiare referuar faktit që SNRF për NVM duke qenë një pronë intelektuale e një organizmi shumë profesional ishte ndërtuar dhe do të mirëmbahej gjithnjë sipas të njëjtave standarde të profesionalizmit, etikës dhe interesit publik. Nuk kishin për qëllim të paragjykonin organizmat vendase përgjegjëse për standartet e kontabilitetit, por për ta eksperiencia mbetet gjithësesi një thesar i çmuar.

Një avantazh tjetër i përmendur në intervistë ishte dhe krahasueshmëria e shtuar e pasqyrave të hartuara me SNRF për NVM. Profesorët i referoheshin këtu mundësisë së shkëmbimit të kapitaleve mes vendeve të ndryshme dhe e gjykonin të domosdoshme këtë globalizim të raportimit financiar. Fakti që në pak vite bizneset tona, thanë ata, kanë kaluar nga tregti të vogla me kioska në investime gjigande dhe bashkëkohore, dhe e gjitha kjo në 20 vite, është premisë sipas tyre që në 10 vitet që vijnë shumë njësi ekonomike shqiptare të synojnë të listohen në bursa prandaj zbatimi i SNRF për NVM përpara këtij hapi të madh, është një ndihmë për të lehtësuar koston e tranzicionit drejt SNRF-ve të plota. Në diskutim u pa si avantazh, qoftë dhe me një shtrirje modeste territoriale, shtrirja e adoptimit të SNRF në të njëjtën kohë në Kosovë dhe në Shqipëri. Ky proces do të lehtësonte, në mos në nivel evropian, por të paktën rajonal, marrëdhëniet e biznesit mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Pa diskutim që mbështetën me forcë argumentin e përdoruesve të pasqyrave financiare. Sidomos në drejtim të bankave, akademikët ishin të bindur që adoptimi i SNRF do të ishte një avantazh në drejtim të lehtësimit të kredidhënies. Duke qenë se bankat kanë në hierarkinë e tyre personel të huaj, është më e lehtë për ta, në cilësinë e vlerësuesve të riskut të kredidhënies, të bëjnë përllogaritje mbi pasqyra të ndërtuara sipas një standardi ndërkombëtar, thanë të intervistuarit. Avantazhi tjetër i përmendur prej tyre ishte thjeshtësia e standardit të NVM-ve. Ata të gjithë në fakt kishin patur rastin ta studionin këtë standard që në fazat kur akoma ishte draft në website-n e

BSNK dhe kishin konstatuar me kohë se në thelb standardi kishte një parim shumë të rëndësishëm, atë të thjeshtimit të numrit të alternativave të lejuara.

Të pyetur nëse do të përmirësonte adoptimi i këtij standardi cilësinë e vendimmarrësve pronarë jomenaxherë, të gjithë ishin skeptikë pasi në gjykimin e tyre pronarët dhe sipërmarrësit shqiptarë akoma nuk ishin në gjendje të përdornin këto pasqyra si lëndë e parë për vendimmarrjen. Për ta vendimmarrja mbi pasqyrat ishte akoma në faza gjenuine. Ndërsa për menaxherët ata ishin të bindur që pasqyrat janë të rëndësishme, por nën zë pranuan që realiteti shqiptar gjeneron në të shumtën e rasteve 2 palë pasqyra, një për shtetin dhe një për privatin. Në këto kushte nuk bie vlera e pasqyrave finciare në vetvete si instrument por besimi tek informacioni që ato përmbajnë.

Të pyetur për disavantazhet e adoptimit të standardit, në nivel teorik u përmend faktori psikologjik. Duke qenë se, argumentuan ata, kanë vetëm 6 vite që profesionistët dhe përdoruesit kanë nëpër duar një set krejt të ndryshëm nga çfarë kishin parë dhe mësuar deri në 2008, atëherë është shumë shpejt të bëjmë përmbysje të mëdha. Por duke sqaruar që kjo përmbysje është vetëm në dukje prandaj efekti është psikologjik. Në dijeninë e tyre parimet bazë të SKK-ve dhe SNRF-ve nuk ndryshojnë aq sa për të krijuar probleme reale për njësitë ekonomike.

Një tjetër disavantazh tjetër është se shënimet shpjeguese të SNRF për NVM janë relativisht më të zgjeruara se ato në SKK dhe kjo do të ishte vetëm barrë për hartuesit dhe jo përfitim për përdoruesit të cilët pikë së pari nuk kanë besimin se pasqyrat thonë të vërtetën.

Një tjetër disavantazh është fakti se SNRF për NVM mirëmbahet nga të tjerë dhe problematika të reja që mund të shfaqen në biznesin shqiptar nuk do të mund të integrohen në kuadrin e raportimit financiar në mënyrë të vullnetshme.

4.3.4.2 Përshtatshmëria e kurikulave universitare me zhvillimet ndërkombëtare të raportimi financiar

Të pyetur për kurikulat universitare, profesorët sa mbrojtën aq dhe kritikuan kurikulat universitare. Sot është fakt i njohur, thanë ata, që cilësia e mësidhënies në shkollat e larta e për më tepër cilësia e teksteve universitare ka një rënie të ndjeshme. Në një nga përgjigjet e të intervistuarve ky diskutim u përqëndrua kryesisht në faktin se nuk ka më nëpër universitete filtra të mirëfilltë për vlerësimin e teksteve të botuara dhe së dyti sepse në kundërshtim me etikën, teksti universitar shikohet si një mundësi përfitimi komercial për interesa individuale.

Duke qenë se vinin nga universitete të ndryshme, 4 universitete me emër në vendin tonë, sillnin me vete dhe eksperiencë kurikulare të ndryshme. Megjithatë, ishin të një mendje që studentët tanë nuk po pajisen me dije për praktikën, të paktën në fushën e kontabilitetit. Megjithëse kurikulat kanë brenda tyre module të standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar, i kanë më së shumti formalisht dhe teorikisht. Në kurikula janë të parashikuara orët e praktikës por në fakt ato nuk zhvillohen. Tekstet janë më së shumti një kopje e keqe e autorëve të huaj dhe në nivel shumë teorik.

Mungojnë tekste të ushtrimeve dhe situatave praktike që zgjojnë arsyetimin. Të gjithë ishin të mendimit që standardet e mbështetura në parime kërkojnë shumë gjykim profesional dhe pikërisht kjo mungon në auditoret tona. Pra kurikulat janë

shumë bashkohore kur arshivohen në sekretaritë e Fakulteteve por praktika mësimore dhe tekstet bazë që shoqërojnë kurikulat janë larg të qenurit profesionalë, referuar gjithnjë raportimit financiar. Tekstet, nuk përditësohen për ndryshimet që ndodhin në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar ndërkombëtar. Në të katër kurikulat e kontabilitetit, për të cilat ata ishin në dijeni, thanë se nuk ishin parashikuar njohuri për SNRF për NVM. Në nivel bachelor, në të katër Universitetet e përfaqësuara në tryezë, kishte module të posaçme të SKK-ve ndërsa në nivel master trajtoheshin standardet ndërkombëtare, por ato të plota.

Nuk mbetën jashtë diskutimit edhe lektorët e lëndës së kontabilitetit financiar. Sipas opinionit të të intervistuarve, ishin të paktë ata lektorë që investonin në rritjen e tyre profesionale, duke marrë pjesë në konferenca apo telekonferenca. Ishin akoma më të paktë ata që ndërmerrnin punime shkencore serioze. Sipas të intervistuarve, në auditorë nuk krijohet klima e një lënde sa teorike dhe aq praktike, përmes aplikimeve praktike por zhvillohet si të ishte një lëndë aritmetike ku dy plus dy bëjnë gjithnjë katër. Për këtë mangësi të orës së mësimi, të intervistuarit ngarkonin me përgjegjësi si procesin e rekrutimit dhe atë të kualifikimit të vazhdueshëm të lektorëve.

U pranua nga të gjithë fakti që kur studentët tanë regjistrohen për të marrë provimet online të ACCA gjenden me të papriturën e një teksti i cili nuk ka asgjë të përbashkët me atë çfarë ata kanë marrë dije në shkollë. Kjo tregon, thanë ata, se kurikulat, tekstet dhe lektorët janë, kush më shumë e kush më pak, fajtorë të “përfundimeve të pyetësorit” të shpërndarë tek përgatitësit e pasqyrave financiare.

4.3.4.3 Kosto e adoptimit të SNRF për NVM

Të pyetur rreth mundësisë së adoptimit të SNRF referuar shkallës së përgatitjes së profesionistëve të praktikës nga njëra anë por dhe të vlerësimit paraprak që ata i bënë kurikulave, teksteve dhe lektorëve nëpër universitete, nga ana tjetër, të intervistuarit ishin të mendimit që është një opsion i parakohshëm. Kalimi drejt një regjimi tjetër, sado pak ndryshime thelbësore që të ketë, kërkon kohën e tij të familiarizimit. Nëse i paraprihet adoptimit të SNRF për NVM me një periudhë të paktën 5 vjeçare trajnimesh dhe studimesh, thanë ata pothuaj në një mendje, tranzicioni do të jetë shumë i zbutur dhe kostot fillestare do të jenë minimale. Ata e shikonin edukimin e profesionistëve aktualë dhe potencialë në dy drejtime: përmes trajnimeve dhe kualifikimeve profesionale që organizohen nga organizmat profesionalë në vendin tonë dhe nga ana tjetër duke e shtrirë teorinë dhe praktikën e raportimit financiar ndërkombëtar për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme nëpër modulet e kurikulave universitare.

Meqenëse janë më të shumtë në numër ata që e ushtrojnë profesionin se kontabilistët që do të dalin nga bankat e shkollës në këto 3 apo 5 vite, fillimisht vëmendja iu kushtua më shumë trajnimeve dhe kualifikimeve të vazhdueshme të profesionistëve të praktikës. Të intervistuarit ishin të mendimit se duhen të paktën 3 vite për të mundësuar mbulimin e plotë të të gjitha moduleve të trajnimit, në të gjitha rrethet, për të gjithë anëtarëve e organizmave profesionale në vendin tonë. Sipas tyre problemi nuk qëndron tek formalizmat, sepse ato kapërcehen duke bërë një përkthim të shpejtë të moduleve të trajnimit për SNRF për NVM që është e publikuar dhe e aksesueshme nga të gjithë në faqen zyrtare të BSNK. Në gjykimin e tyre pjesa më e madhe e kohës duhet për formulimin e manualeve dhe udhëzuesve mbi zbatimin e SNRF për NVM duke iu referuar shembujve dhe praktikave të vendit tonë. Këto

materiale të përgatitura me seriozitet profesional mund t'u vihen në dispozicion profesionistëve dhe pastaj shoqëruar këto tekste edhe me trajnime të posaçme, e bëjnë të thjeshtë kapërcimin e vështirësisë së paraqitur.

Për brezat e rinj të profesionistëve problemi u trajtua në një këndvështrim tjetër. Në gjykimin e tyre një student në fund të studimeve në ciklin bachelor, dega kontabilitet, duhet të jetë në gjendje të kuptojë dhe interpretojë kërkesat xhenerike të standardeve ndërkombëtare për NVM, të atyre më të përdorura në praktikën e biznesit. Në ciklet më lart duhet pastaj të perfeksionohet gjykimin profesional dhe të njihen trajtime më të veçanta dhe specifike të standardeve të ndërkombëtare të caktuara, SNRF –të e plota. Ky korrigjim i kurikulave në këto vite do të bënte që në momentin e adoptimit të SNRF-ve, të plota apo të përshtatura për NVM-të, studentët e sotëm, profesionistët e nesërm, t'ia evitonin bizneseve barrën e trajnimeve fillestare të stafeve të tyre të kontabilitetit. Ky orientim, thanë akademikët, zgjidh jo vetëm çështjen e brendshme të cilësisë së profesionistëve të praktikës por njëkohësisht nuk ngre më për diskutim çështjet e standardizimit dhe harmonizimit të raportimit financiar pasi armata e re e profesionistëve i ka hedhur bazat e saj që në fazën shkollore.

Pyetjes se cila mund të jetë një kosto e përafërt e trajnimit të një profesionisti, mendimet ishin të ndryshme. Kosto lidhej me qasjen e ndjekur për trajnimet. Nëse gjithçka do të fillonte me hartimin e manualeve dhe udhëzuesve në zbatim të SNRF për NVM dhe pastaj të vijohej me trajnime, kosto është më e ulët pasi shumë gjëra zgjidhen nga kontakti me tekstin dhe kërkohet më pak investim në burime njerëzore dhe logjistike për të organizuar trajnime. Një individ, tha një nga profesorët, i cili paraprakisht ka në dorë një material në gjuhën shqipe me shpjegime dhe interpretime nga praktika vendase, kërkon shumë më pak orë në dispozicion për seanca trajnimi. Cilado të jetë kosto e prodhimit të një manuali apo udhëzuesi të tillë, kosto për lexues është fare e papërfillshme.

Kurse, qasja tjetër, ajo e përdorimit në seancat e trajnimit të moduleve të publikuara nga BSNK, të cilat për hir të së vërtetës, thanë të intervistuarit, kanë nevojë për lektorë të aftë që të kuptohen, është qasje më e kushtueshme. Në disa llogaritje paraprake ata vlerësuan se duhen organizuar të paktën 30 seanca trajnimi 3 orëshe për të mbuluar të 35 modulet e trajnimit, teori dhe praktikë. Çdo pjesëmarrës do të duhet të përballojë një shpenzim prej të paktën 100.000 mijë lekë (ndoshta dhe më shumë) për të marrë dijet bazë mbi SNRF për NVM sipas kësaj qasjeje. Nga eksperiencia e tyre, sot individit nuk është i gatshëm të investojë shuma të tilla në funksion të kualifikimit të vijueshëm personal prandaj do të jetë në rastin më të mirë një kosto e përballueshme nga biznesi dhe në rastin më të keq do të hiqet dorë nga trajnimet. Kjo e dyta pastaj ka koston e saj në mënyrë indirekte për mbulimin e gabimeve të kontabilistëve kur të zbatohet tek njësitë ekonomike.

Të pyetur cilat mund të jenë disa kosto të tjera shtesë, fillestare ose të vazhdueshme, për biznesin nëse do të vendoset të adoptohet SNRF për NVM, secili nga të intervistuarit dha opinionin e tij. Në mënyrë të përmblodhur këto kosto shtesë grupohen në kosto lidhur me përshtatjen e manualeve të drejtimit mbi kontrollin e njësisë ekonomike (kosto fillestare), të paktën çdo tre vjet trajnime shtesë të stafit për ndryshimet që pëson SNRF (kosto e vijueshme), kosto e kontraktimit të një zyre konsulence në fillim për të asistuar stafin në rideklarimin e pasqyrave financiare (kosto fillestare) dhe kosto e marrjes në punë të një profesionisti më të kualifikuar i cili do të ketë eksperiencë në zbatimin e SNRF sidomos përse i përket realizimit të pasqyrës së shënimeve shpjeguese (kosto e vijueshme). Asnjë prej të intervistuarve nuk ishte në gjendje të bënte një vlerësim të këtyre kostove por gjithësesi nuk i

gjykonin si aq përcaktuese në pranimin ose rrëzimin e mundësisë së adoptimit të SNRF për NVM.


Në fund intervista u mbyll me një pyetje provokative. Iu kërkua të intervistuarve të japin një përgjigje lidhur me pyetjen nëse është apo jo momenti i duhur dhe është apo nuk është i domosdoshme për ekonominë tonë dhe nxitjen e biznesit ndërmarrja e hapit të madh të adoptimit të SNRF për NVM. Prof A u përgjigj se për të paktën 5 vite nuk mundemi dhe për të paktën 10 vite nuk është e domosdoshme. Prof B tha se për të paktën 3 vite nuk mundemi dhe asnjëherë nuk ka për të qenë e domosdoshme sepse SKK-të e kryejnë shumë mirë funksionin e tyre. Dobishmëria do të jetë marxhinale. Prof C tha se për të paktën 5 vjet nuk mundemi por do të jetë së shpejti e nevojshme të paktën për marrëdhëniet me investitorët e vendeve të rajonit. Prof D tha se për 10 vjet nuk bëhemi gati megjithëse nevoja e saj do të ndjehet edhe më parë se 10 vjet. Prof G tha se profesionistët me mundësitë që atat kanë të aksesojnë teknologjinë e informacionit, mund të bëhen të gatshëm edhe për një vit, kuptohet me kosto dhe sforcë por ai nuk shihte arsye përse të bëhej një hap i tillë për të paktën 10 vitet e ardhshme ose për të paktën aq kohë sa nuk jemi vend anëtar i BE.

KAPITULLI 5 - ANALIZA DHE DISKUTIME

5.1 Qasja e arsyetimit logjik për analizën

Ky kapitull mbështetet në analizën e gjetjeve empirike të kapitullit të mëparshëm dhe në kontekstin e kuadrit teorik të paraqitur në kapitullin e dytë të këtij punimi. Analiza dhe diskutimet e këtij kapitulli do të jenë drejtpërdrejt të lidhura me vlerësimin e (pa)përshtatshmërisë së adoptimit të SNRF për NVM duke ekzaminuar gjithçka është gjetur përmes matricave krahasuese, pyetësorëve, intervistave dhe dokumenteve të tjera të shfrytëzuar në këtë punim.

Përpara se të fillohet me analizën në mënyrë skematike kam ndërtuar qasjen e arsyetimit logjik. E interpretuar nga e djathta në të majtë, skema më ndihmon të kuptoj përgjigjen për pyetjen kryesore të kërkimit.



Figurë 5.1 – Qasja e arsyetimit logjik

Nëse diskutohet për të adoptuar një standard të ri ndërkombëtar duhet të marrin përgjigje pyetjet “A duhet?” edhe “A mundemi?”. Këto përgjigje janë rezultat i një analize që i bëhet të gjithë aktorëve dhe faktorëve të procesit të adoptimit. Ndër faktorët kam arsyetuar si vendimtarë aspektin politik, teknik dhe ekonomik, përfshirë faktorët kulturorë si kultura e raportimit dhe edukimi, ndërsa si aktorë të procesit kam konsideruar nga njëra anë përgatitësit e pasqyrave financiare dhe nga ana tjetër përdoruesit e këtyre pasqyrave. Duke qenë se faktorë shumë përcaktues, përveç atij ekonomik, të qëndrimit të përgatitësve të pasqyrave dhe përdoruesve të tyre, janë

kultura dhe edukimi, kam kërkuar opinion edhe nga akademikët duke i konsideruar ata faktorë ndikues, edhe pse jo të drejtpërdrejtë, në krijimin e terrenit të përshtatshëm për asimilimin e risive në fushën e raportimit financiar ndërkombëtar.

Pyetjen “*A duhet?*” e kam parë të lidhur me aspektin politik dhe teknik ndërsa pyetjen “*A mundemi?*” e kam parë të lidhur me aspektin teknik dhe aspektin ekonomik.

Pasi të kem evidencën e arsyeshme për t’i dhënë përgjigjen pyetjeve më sipër, do të arrij në një nga rekomandimet e mundshme:

- *Alternativa 1* - Adoptim i plotë i SNRF për NVM në terma afatshkurtër
SNRF për NVM është vlerë e shtuar për raportimin financiar dhe palët e përfshira janë të gatshme dhe të vullnetshme ta zbatojnë atë;

- *Alternativa 2* - Asnjë veprim;
SNRF për NVM nuk është vlerë e shtuar për raportimin financiar dhe palët nuk janë gati dhe të vullnetshme për ta zbatuar atë;

- *Alternativa 3* - Harmonizim i SKK-ve me SNRF për NVM në terma afatshkurtër, për aq sa përbën interes për realitetin shqiptar;
SNRF për NVM, në seksione të veçanta të saj ndikon në përmirësimin e raportimit financiar në Shqipëri por palët e interesuara nuk janë të gatshme sot ta zbatojnë atë të plotë;

- *Alternativa 4* - Rikonsiderim i çështjes në terma afatmesëm
SNRF për NVM nuk është vlerë e shtuar për raportimin financiar dhe palët e interesuara nuk janë të gatshme ta zbatojnë atë;

5.2 Analiza edhe diskutime mbi aspektin politik

Në aspektin politik e kam trajtuar analizën të lidhur me vullnetin e ligjvënësve për të adoptuar ose jo SNRF për NVM. Nëse vullneti politik është në favor të këtij procesi pastaj faktorët e tjerë kalojnë në plan të dytë. Analiza ime merr të mirëqenë faktin që ligjvënësit patjetër kanë një listë prioritetesh si më poshtë:

- a) Çështjet e integritimit evropian;
- b) Impaktin në nxitjen e investimeve të huaja;
- c) Shtimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit;

5.2.1 Çështjet e integritimit evropian

Po t’i referohemi Progres Raporteve të Komisionit Evropian, për vitet 2011, 2012 dhe 2013 gjejmë vetëm nga një paragraf të shkurtër për çështjet e kontabilitetit dhe raportimit. Në progres raportin 2011 (Albania 2011 Progress Report, pg 33)¹²

¹² http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/al_rapport_2011_en.pdf

thuhet se Shqipëria ka bërë shumë pak progres në drejtim të raportimit financiar pasi nuk është arritur transpozimi i Direktivës 4 dhe 7 të BE.

Në progres raportin 2012 (Albania 2012 Progress Report, pg 35)¹³ thuhet përsëri se Shqipëria ka bërë shumë pak progres në drejtim të raportimit financiar pasi nuk është arritur transpozimi i Direktivës 4 dhe 7 të BE. Megjithatë vihet në dukje fakti që SNRF –të e plotë janë të detyrueshme edhe në Shqipëri pa u shprehur se për cilat njësi ekonomike ato janë të detyrueshme.

Në progress raportin 2013 (Albania 2012 Progress Report, pg 22)¹⁴ thuhet se ka filluar një përpjekje drejt harmonizimit të legjislacionit kontabël me *acquis* të BE dhe nuk përmendet asgjë lidhur me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

****Nga sa më sipër kuptohet që në çështjet e integritetit prioritet merr harmonizimi i kuadrit tonë të raportimit financiar me atë të BE dhe jo më standardet ndërkombëtare të raportimit. Sot në BE standardi për NVM-të nuk është i detyrueshëm për vendet anëtare. Prandaj çështja e adoptimit është irelevante sa i përket çështjes së integritetit të Shqipërisë në BE.*

5.2.2 Nxitja e investimeve të huaja

Për të kuptuar nëse kalimi në një regjim të ri të raportimit financiar, pra të hartimit të pasqyrave financiare me SNRF për NVM, nxit apo jo investimet e huaja, i referohem gjetjeve në kapitullin e mëparshëm, gjatë intervistave me përdoruesit e pasqyrave financiare, konkretisht me pronarët jomenaxherë. Në përgjigjet e tyre ka një qëndrim kundër lidhur me adoptimin e SNRF për NVM kur diskutohet lidhur me avantazhin që krahasueshmëria e pasqyrave financiare me ato të vendeve të tjera lehtëson vendimmarrjen e investitorëve të huaj për të sjellë kapitalet e tyre në Shqipëri. Të gjithë shprehen se sot investitorët e huaj janë të interesuar për industritë elitare si institucionet financiare, energjitika, telefonja dhe ndonjë sektor i industrisë së rëndë, të cilat në fakt raportojnë aktualisht me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, SNRF-të e plotë. Pra është i pajustificuar adoptimi i SNRF për NVM për pjesën tjetër të njësive ekonomike nëse kriter janë nxitjet e investimeve të huaja.

Duke marrë në konsideratë faktin se 109.677¹⁵ njësi ekonomike që janë në Shqipëri, të kategorizuara si mikro, të vogla dhe të mesme, kanë një numër të punësuarish deri në 50 persona dhe vetëm 1.406 prej tyre kanë mbi 50 të punësuar, atëherë diskutimi për SNRF për NVM bëhet jo i rëndësishëm. Me një vlerësim të përfartë (pasi nuk ka të dhëna në asnjë institucion sesa janë njësitë ekonomike në Shqipëri që zbatojnë SNRF-të e plotë) se rreth 200 njësi ekonomike zbatojnë SNRF-të, atëherë diskutimi për njësi që mund të ishin interesante për investitorë të huaj që do të ishin të interesuar të merrnin vendime mbi pasqyra të hartuara me SNRF për NVM ngushtohet për një numër shumë modest njësish ekonomike, rreth 1.200 njësi gjithsej.

¹³ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/al_rapport_2012_en.pdf

¹⁴ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/al_rapport_2013.pdf

¹⁵ Shih Aneks 1

****Pra nga analiza rezulton se përfitimi nga adoptimi i SNRF për NVM, parë në këndvështrimin e thithjes së investimeve të huaja praktikisht është i parëndësishëm në terma të ekonomisë kombëtare. Nga ana tjetër, adoptimi i SNRF për NVM do të ishte kosto për rreth 110 mijë njësitë e tjera ekonomike. Kështu që në terma kombëtarë, kostot do të ishin më të mëdha se përfitimet, referuar vetëm kriterit të nxitjes së investimeve të huaja.*

5.2.3 Ndikimi në të ardhurat në buxhetin e shtetit

Për të analizuar çështjen e të ardhurave të shtuara ose jo në buxhet i referohem dallimeve mes SKK-ve dhe SNRF-ve dhe ndikimit të tyre në llogaritjen e fitimit tatimor. Dallimet kryesore mes SKK-ve dhe SNRF për NVM kanë të bëjnë me disa politika kontabël të vlerësimit të mëpasshëm të elementeve të pasqyrave financiare. Më poshtë do t'i analizoj ato njëra pas tjetrës sipas SKK-ve:

SKK 3 – Instrumentet financiare

Sipas SKK 3 ato mund të paraqiten në pasqyrat financiare në fund të vitit me modelin e koston së amortizuar ose me modelin e vlerës së drejtë. Modeli i vlerës së drejtë është kategorikisht i përjashtuar nga llogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve tatimore. Adoptimi i SNRF për NVM nuk do të kishte asnjë ndikim në llogaritjen e fitimit tatimor pasi është në linjë me rregullimet aktuale fiskale. Sipas SNRF për NVM instrumentet financiare njihen në pasqyra vetëm me modelin e koston së amortizuar.

SKK 4 – Inventarët

Mes SKK 4 dhe SNRF për NVM, seksionit përkatës të tij, nuk ka asnjë ndryshim të politikave dhe vlerësimeve kontabël gjë që nënkupton se adoptimi i SNRF për NVM nuk do të sjellë ndryshime në llogaritjen e fitimit tatimor.

SKK 5 – Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale

- Sipas SNRF për NVM, shpenzimet e zhvillimit trajtohen si shpenzime periudhe dhe jo si aktive afatgjata jomateriale. Ky fakt nënkupton rëndim të shpenzimeve të periudhës raportuese gjë që shkon në kundërshtim me parimin e kuadrit fiskal. Prandaj ky dallim nuk do të përbënte interes për buxhetin e shtetit.
- Sipas SNRF për NVM kostot e huamarrjes njihen si shpenzime periudhe, sipas SKK 5 është dhe trajtimi alternativ, ai i kapitalizimit të tyre në koston e aktivit të kualifikuar për të cilin është marrë huaja që prodhon këtë kosto interesi. Edhe në këtë rast, nga adoptimi i SNRF për NVM do të rëndoheshin shpenzimet e periudhës raportuese dhe do të cënohej fitimi kontabël.
- Në SKK 5 lejohen dy trajtime alternative për vlerësimin e mëpasshëm të aktiveve afatgjata materiale, modeli i koston dhe modeli i rivlerësimit. Ndërsa në SNRF për NVM i vetmi model i lejuar është ai i koston. Në këtë rast SKK 5 e përfshin rregullimin sipas SNRF për NVM por fisku i ka përjashtuar të ardhurat dhe shpenzimet nga rivlerësimet, prandaj ky ndryshim do të ishte indiferent për llogaritjen e të ardhurave në buxhet.
- Në SNRF për NVM, emri i mirë amortizohet për 10 vite ndërsa sipas SKK 5 ai testohet për zhvlerësim. Në kushtet kur fisku ka vendosur një koeficient limit për

amortizimin e aktiveve afatgjata jomateriale (deri në 15 % në vit mbi vlerën kontabël të mbetur), është indiferent fakti nëse zbatohen SKK-të apo SNRF për NVM.

SKK 6 – Provizionet,

SKK 7- Qiratë

SKK 8 – Të ardhurat

Këto standarde nuk kanë asnjë dallim të politikave ose vlerësimeve kontabël dhe rrjedhimisht nuk krijojnë asnjë diferencë në llogaritjen e fitimit tatimor. Përsëri është indiferent për të ardhurat në buxhet fakti se cili nga setet e standardeve është i zbatueshëm nga njësitë ekonomike.

SKK 9 “Kombinimet e bizneseve”

Në SKK 9 kërkohet testi i zhvlerësimit për emrin e mirë, ndryshe nga kërkesat e SNRF për NVM ku emri i mirë amortizohet. Përsëri jemi në rastin kur SKK-të janë më të gjera se SNRF për NVM por trajtimi alternativ nuk është i marrë në konsideratë nga fisku. Përsëri në këto kushte adoptimi i SNRF nuk do të sillte ndryshime të llogaritjeve të fitimit tatimor.

SKK 10 “Grantet dhe format e tjera të ndihmës”

SKK 10 i trajton grantet si të ardhura të shtyra dhe i amortizon ato (i njëh si të ardhura të periudhës) njësh me shpenzimet që bëhen për qëllimin e përfitimit të grantit. SNRF për NVM i njëh grantet në të ardhura njësh me plotësimin e kushtit të performancës. Ky është një ndryshim që do të sillte përfitime në buxhetin e shtetit pasi e gjithë shuma e grantit do të ishte pjesë e llogaritjes së fitimit kontabël në periudhën raportuese.

SKK 11 - “Tatimi mbi fitimin”

Ky standard është plotësisht në harmoni me seksionin përkatës të SNRF për NVM pavarësisht se është jo i detyrueshëm për zbatim.

SKK 12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimeve”

Mes dy seteve të raportimit nuk ka ndryshime të politikave apo vlerësimeve kontabël. Edhe fisku, ashtu si këto dy standarde, diferencat e konvertimit të zërave monetarë i njëh si zëra të pasqyrës së fitimit. Adoptimi i SNRF për NVM nuk do të sillte ndryshime në buxhetin e shtetit.

SKK 13 “Aktivet biologjike”

Në SKK 13 i vetmi model i lejuar i vlerësimit të mëpasshëm është modeli i kostos së amortizuar ndërsa në SNRF për NVM lejohet edhe trajtimi alternativ, ai i vlerës së drejtë. Por nisur nga fakti që fisku nuk njëh të ardhura dhe shpenzime tatimore që vijnë nga vlerësimet e aktiveve, atëherë adoptimi i SNRF nuk do të kishte efekte fiskale.

SKK 14 “Trajtimi kontabël i shoqërive të kontrolluara dhe pjesëmarrjeve”

Në SKK 14 nuk lejohet, ndryshe nga SNRF për NVM, përdorimi i vlerës së drejtë për investimet në pjesëmarrje. Edhe në këtë rast vlen i njëjti arsyetim, cilido set standardesh që të përdoret, fisku ka kufizuar përmes të ardhurave dhe shpenzimeve të panjohura, ato që vijnë nga rivlerësimet e aktiveve.

****Në përfundim të analizës për ndikimin që mund të ketë SNRF për NVM mbi të ardhurat në buxhet, arrihet në përfundimin që përjashtuar efekteve pozitive që sjell*

njohja e granteve në të ardhura me plotësimin e kushtit të performancës, të gjitha dallimet e tjera me SKK-të nuk kanë ndikim ose ndikojnë në uljen e tatim fitimit të llogaritur.

Dhe në fund të analizës për aspektin politi të çështjes së adoptimit të SNRF për NVM, që ka të bëjë me vullnetin e politikëbërësve, përfundimi im është:

**** Adoptimi i SNRF për NVM nuk do të ishte një vlerë e shtuar për çështjet e integritit të Shqipërisë në BE, nuk do të ishte vlerë e shtuar referuar treguesve të të ardhurave në arkën e shtetit nga detyrimet për tatim fitimin dhe do të ishte një vlerë e shtuar pothuaj e papërfillshme nëse i referohemi mundësive për nxitje të investitorëve të huaj, pasi numri i njësive që mund të paraqesin interes është shumë i ulët.*

5.3 Analiza në aspektin teknik

5.3.1 Dallimet mes SKK-ve dhe SNRF për NVM

Në këtë seksion të kapitullit do të analizohen të gjitha gjetjet e matricës krahasuese me objekt evidentimin e dallimeve mes SKK-ve dhe SNRF-ve. Gjetjet nuk do të përsëriten por do të analizohen në dritën e vlefshmërisë së tyre për realitetin shqiptar si dhe të vlerës së shtuar (nëse ka) lidhur me përmirësimin e cilësisë së pasqyrave financiare. Përfundimet e analizës nuk do të jepen për çdo dallim të evidentuar por do të grupohen në fund të çdo standardi sipas rëndësisë dhe peshës specifike.

Si parathënie e analizës lidhur me dallimet mes SKK-ve dhe SNRF për NVM duhet thënë se të dy këto sete kanë të përbashkët faktin që mbështeten në parime dhe derivojnë nga SNRF-të e plota. Pra dallimet mes tyre nuk priten të jenë ekzistenciale por çështje të ndonjë politike apo vlerësimi të ndryshëm kontabël të elementeve të pasqyrave financiare. Një pohim i tillë konstatohet dhe në tabelën përmbledhëse të gjetjeve nga matrica krahasuese, gjetje të cilat në vijim do të analizohen në këndvështrimin e krahasimit teknik të një seti në favor të setit tjetër.

Tabela 5.1 Gjetjet kryesore të dallimeve mes SKK-ve dhe SNRF për NVM

Çështja	Trajtimi sipas SKK	Trajtimi sipas SNRF për NVM	Komente
Koncepti i të ardhurave gjithëpërfshirëse	Mungon	Trajtohet	Koncept bashkëkohor
Koncepti i monedhës funksionale	Mungon	Trajtohet	Kërkon rregullim ligjor
Paraqitja e dividendëve dhe interesave të paguar në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare	Mungon	Trajtohet	I nevojshëm
Modeli i vlerësimit të	Modeli i kostos së	Modeli i kostos së	Vlen të

mëpasshëm të instrumenteve financiare	amortizuar. Lejohet edhe modeli i vlerës së drejtë	amortizuar minus ndonjë zhvlerësim	thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Trajtimi kontabël i blerjeve të inventarëve në kushtet e pagesave të shtyra në afate	Mungon	Trajtohet	I nevojshëm
Trajtimi i aktiveve afatgjata materiale të investuara	Mungon	Trajtohet	I nevojshëm
Trajtimi i shpenzimeve të zhvillimit	Trajtohen si aktive afatgjata jomateriale	Trajtohen shpenzime periodhe	Vlen të thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Trajtimi i kostove të huamarrjes	Kapitalizohen në koston e aktivit	Trajtohen si shpenzime periodhe	Vlen të thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Trajtimi i vlerësimit të mëpasshëm të aktiveve afatgjata materiale	Modeli i koston së amortizuar. Lejohet modeli i rivlerësimit	Modeli i koston së amortizuar minus ndonjë zhvlerësim	Vlen të thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Emri i mirë	Testohet për zhvlerësim	Amortizohet në 10 vite	Vlen të thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Provizionet për pensionet	Trajtohen shkurtimisht	Mungojnë	Vlen të thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Matja e të ardhurave të shtyra në kohë	Mungon	Trajtohet	I nevojshëm
Çmimi i blerjes në një kombinim biznesi	I komplikuar	Nuk kërkohet	Vlen të thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Aplikimi i metodës së përshtatur të blerjes së njësive ekonomike që janë në kontroll të përbashkët;	I lejuar	I ndaluar	Vlen të thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Rastet kur mëma nuk ndërton pasqyra të konsoliduara	Mungojnë	Trajtohen	Nuk vlen të rëndohet
Vlerësimi i mëpasshëm për investimet në pjesëmarrje;	Modeli i koston	Modeli i koston. Lejohet modeli i vlerës së drejtë	I panevojshëm
Format e granteve	Trajtime të	Trajtim i njëjtë	Vlen të

	ndryshme		thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Kushti për njohjen e grantit në të ardhura	Sipas përdorimit	Me plotësimin e kushtit të performancës	Vlen të thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Aktivet / detyrimet tatimore	Jo të detyrueshme	Të detyrueshme	I nevojshëm
Aktivet / detyrimet tatimore në një kombinim biznesi	Trajtohen	Mungon	Vlen të thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Aktivet / detyrimet tatimore për aktivet që mbahen me vlerë të drejtë	Trajtohen	Mungon	Vlen të thjeshtohet sipas SNRF për NVM
Marrëveshjet koncesionare	Mungon	Trajtohen	I nevojshëm
Vlerësimi i aktiveve biologjike	Modeli i kostos	Modeli i kostos. Modeli i vlerës së drejtë	I nevojshëm

SKK 1 – “Kuatridhjetë për përgatitjen e pasqyrave financiare”

SKK 2 “Përqendrimi i pasqyrave financiare”

E reja që sjell SNRF për NVM në seksionet përkatëse që lidhen me SKK 1 dhe SKK 2 është pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Kjo pasqyrë përgatitet në dy mënyra, zgjedhja është vullneti i njësisë ekonomike. Mënyra e parë është ajo e një pasqyre të përbërë nga pasqyra tradicionale e fitimit dhe një pasqyrë tjetër, ajo e të ardhurave gjithëpërfshirëse, e cila fillon me rresht të parë atë të fitimit të llogaritur në rreshtin e fundit të pasqyrës së fitimit. Pasqyra e dytë përmban të gjitha të ardhurat (termi në anglisht – income) që nuk janë pjesë e të ardhurave nga aktiviteti i shfrytëzimit por nga rivlerësimet e aktiveve ose nga përkthimi i monedhës së përdorur në operacionet e huaja.

Mënyra tjetër është ajo e një pasqyre të vetme ku në linjë vertikale renditen fillimisht zërat e të ardhurave dhe shpenzime që llogarisin fitimin e periudhës e më pas vazhdohet me të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse që u sqaruan më sipër.

Të ardhurat gjithëpërfshirëse paraqiten në një pasqyrë të veçantë ose në seksion të veçantë për faktin se nuk janë pjesë e llogaritjes së fitimit të periudhës por evidentohen për qëllime të transparencës sepse japin informacion tek përdoruesit e pasqyrave financiare për të ardhura të pritshme në një periudhë të afërt.

Në SKK 1 dhe SKK2 gjithashtu vërehet nevoja për përmirësime të terminologjisë që për hir të së vërtetës i përgjigjen termave të SNRF-ve të plota të vitit 2002 që shërbyen si bazë për ndërtimin e SKK-ve. Prej 2002 shumë terma kanë ndryshuar prandaj SKK-të në këtë drejtim vlen të përmirësohen.

Në SKK 2 ka më pak sqarime lidhur me konceptin e vijimësisë dhe të materialitetit por ky fakt nuk çënon të kuptuarit drejt të këtyre koncepteve.

Në SKK 2 mungon koncepti i monedhës funksionale por më shumë sesa rregullim përmes standardit ky fakt duhet të përbëjë një amendim ligjor pasi në ligjin për kontabilitetin është parashikuar vetëm monedha raportuese.

Në SKK 2 mungon një kërkesë e rëndësishme e SNRF për NVM lidhur me paraqitjen në pasqyrën e lëvizjes së mjeteve monetare të dividendëve dhe interesave të paguar. Kjo çështje nuk prek thelbin e qenësisë së standardit por përsëri është e nevojshme për hartuesit e pasqyrave financiare dhe përdoruesit në veçanti.

Përsa i përket SKK 1 dhe SKK 2 nuk evidentohen dallime të rëndësishme apo për më tepër që të përmbysin thelbin e standardit. Prezantimi i një pasqyre të re në funksion të transparencës, përmirësimi i terminologjisë për ta bërë atë më bashkëkohore dhe disa plotësime të kërkesave për dy apo tre paragrafë nuk do ta bënë të domosdoshëm adoptimin e SNRF për NVM, gjithnjë referuar SKK 1 dhe SKK 2.

SKK 3 “Instrumentet financiare”

Seksioni 11 dhe 12 i SNRF të marra së bashku janë të përfshirë në SKK 3 por në mënyrë jo shumë të organizuar dhe sidomos për pjesën e instrumenteve të përbërë financiarë. Gjithashtu SKK 3 ka mangësi lidhur me shembuj konkretë të instrumenteve financiarë, të thjeshtë apo të përbërë. Ka dhe disa dallime të tjera si psh, ka një formulim jo shumë të qartë të paragrafëve në SKK 3, ka më pak kërkesa për shënime shpjeguese dhe nuk ka të evidentuar qartë cilët instrumente përjashtohen nga fusha e zbatimit. Deri këtu nuk kemi të bëjmë me dallime të rëndësishme thelbësore pasi nuk lidhen me politika apo vlerësime kontabël. Ajo që përbën interes është fakti se SNRF për NVM e lejon modelin e vlerës së drejtë si model alternativ vetëm për instrumentet e përbërë, ndërsa për ata të thjeshtë lejon vetëm modelin e kostos së amortizuar minus zhvlerësimin. Ky lehtësim është i nevojshëm dhe i domosdoshëm në SKK 3 pasi duke konsideruar që në 111.083 njësi ekonomike, 99.782 prej tyre kanë më pak se katër të punësuar, kjo tregon se këto biznese janë të vogla dhe fare të vogla e nuk vlen t’u kërkohej për zbatim disa kërkesa dhe parime që janë praktikisht të pazbatueshme ose që kthehen në të tilla në praktikën e përditshme. Edhe nga krahasimi i SKK 3 me SNRF për NVM nuk del vevoja e zëvendësimit të setit të raportimit financiar.

SKK 4 “Inventarët”

Ky standard është i vetmi që nuk ka asnjë ndryshin nga seksioni 13 “Inventarët” i SNRF për NVM. Në kushtet kur nuk kasnjë ndryshim, në përmbajtje dhe në formë, ai nuk mund të jetë pjesë e ndonjë analize që synon evidentimin e dallimeve.

SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”

Ky standard është një nga ato standardet ku u evidentuan dallime të shumta me seksionet përkatëse të SNRF për NVM. Do të konsiderohen të një rëndësie më të vogël dallimet që kanë të bëjnë me disa kërkesa të SNRF për NVM që janë të artikuluar më mirë (çështje formulimi gjuhësor) krahasuar me paragrafët e SKK 5,

mungesat e paragrafëve për trajtimin kontabël të pjesëve të këmbimit dhe amortizimit të tyre, mungesa e disa kërkesave dhe udhëzimeve të detajuara shtesë në raport me SKK 5 lidhur me çregjistrimin e AAM dhe AAJM-ve, apo disa raste të shënimeve shpjeguese që mungojnë në SKK 5.

Por, ndërsa sa më sipër janë të një rëndësie dytësore, dallimet e tjera konsiderohen të rëndësishme. Në SKK 5 mungon koncepti, e për rrjedhojë trajtimi kontabël, i aktiveve të investuara (*investment properties*). Sot ka mjaft njësi ekonomike që e realizojnë këtë lloj biznesi të dhënies me qira të aktiveve që i disponojnë përmes blerjes ose kontratave të qirave financiare. Këto njësi ekonomike e kanë me të vërtetë të rëndësishëm këtë rregullim në SKK 5.

Fakti që shpenzimet e zhvillimit dhe kostot e huamarrjeve nuk kapitalizohen por trajtohen si shpenzime periodike në SNRF për NVM, është një dallim tjetër i rëndësishëm por nga intervistat dhe pyetësorët kuptohet që si përgatitësit ashtu dhe përdoruesit e pasqyrave (pronarët dhe tatimorët) janë indiferentë ndaj këtij dallimi pasi të gjithë këta aktorë priren drejt respektimit të rregullimit fiskal i cili ashtu si është sot në fuqi i ka limituar shpenzimet e lejuara nga amortizimi i shpenzimeve të zhvillimit dhe kostot e interesit. Prandaj thënë sa më sipër ky dallim bëhet i parëndësishëm në një vend ku kultura e raportimit është kulturë tatimore.

Dallimi tjetër, ai i modelit të rivlerësimit që në SKK 5 është i lejuar dhe sipas SNRF për NVM nuk është i lejuar, do të ishte një thjeshtim i mirë por për sa kohë inkurajohet edhe nga SKK 5 edhe nga tatimorët modeli i kostos, modeli tjetër është një “shtojcë” e SKK 5 por që nuk sjell efekte në ekonomi. Për ato pak njësi që kanë pronarë të huaj të cilët në vendet ku janë kanë lirinë të përdorin modelin e vlerës së drejtë, do të ishte me interes vazhdimi me SKK 5 për faktin se e kanë më të lehtë punën e konsolidimit të pasqyrave në vendin e tyre. Për efekte tatimore ata përdorin SKK 11 – Tatimi mbi fitimin për të përputhur kërkesat tatimore me ato kontabël.

Në të njëjtën linjë me argumentin e dhënë për modelin e rivlerësimit të AAM-ve shkon dhe testimi për zhvlerësim i Emrit të Mirë. Është e vërtetë që SNRF për NVM e thjeshton punën duke e amortizuar EM por dhe realiteti i biznesit të njëjtën gjë është duke bërë. Në lidhje me emrin e mirë, i njohur në pasqyrën financiare si AAJM, njësitë aplikojnë tavanin tatimor të amortizimit që të evitojnë zbatimin e SKK 11. Pra SKK 5 zbatohet njësoj si të ishte seksioni përkatës i SNRF për NVM ku trajtohet amortizimi i emrit të mirë, por jo për 10 vite por me 15% çdo vit mbi vlerën e mbetur.

Thënë sa më sipër, dallimet janë të rëndësishme por vetëm nëse kultura e raportimit financiar nuk do të ishte ajo që konstatohet tek pyetësorët dhe intervistat. Në kushtet e një kulture tatimore të raportimit financiar, edhe pse SNRF për NVM do të ishte me interes për njësitë ekonomike sepse ofron disa thjeshtime të politikave të vlerësimit, fakti që nuk do të zbatohet sepse bie në kundërshtim me kërkesat e fiskut, e bën jo të nevojshëm kalimin drejt SNRF për NVM.

SKK 6 “Provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara”

SKK 7 “Kontabilizimi i qirave”

SKK 8 “Të ardhurat”

Këto tre standarde janë të njëjtë në përmbajtje me SNRF për NVM por kanë disa ndryshime jo thelbësore të cilat kanë të bëjnë me ndonjë detaj më shumë të kërkesave të SNRF për NVM si p.sh, trajtim më i zgjeruar i provizioneve dhe matjes së tyre, më shumë kërkesa për shënime shpjeguese për provizionet dhe aktiv/pasivet e

kushtëzuara, disa përjashtime nga fusha e zbatimit në rastin e standardit të qirave, udhëzime shtesë për matjen e arkëtimeve të shtyra në kohë, udhëzime për trajtimin kontabël të kartave të besnikërisë dhe disa udhëzime më të thjeshta e më të detajuara për zbatimin e metodës së fazës së përdorimit. Nga ana tjetër, SKK kanë disa paragrafë më shumë se SNRF për NVM që trajtonë provizionet për pensione. Megjithatë, të gjitha këto dallime nuk e bëjnë të domosdoshëm, madje as të nevojshëm kalimin drejt SNRF për NVM.

SKK 9 “Kombinimet e bizneseve”

SKK 14 “Trajtimi kontabël i shoqërive të kontrolluara dhe pjesëmarrjeve”

Këto dy standarde kur i kam analizuar i kam parë së bashku pasi janë të krahasueshëm më të njëjtët seksione të SNRF për NVM. Edhe këtu dallimet ndahen në dy grupe, të formës dhe të përmbajtjes. Dallime të formës janë ato që kanë të bëjnë me riformulime gjuhësorë, një ndarje më e qartë e dy standardeve tona nga njëri tjetri sepse kanë edhe mbivendosje, vërehen detaje dhe udhëzime më të shumta për disa kërkesa mbi kombinimin në rastin e SNRF për NVM, ka një lehtësim në kërkesën ndaj blerësit për të bërë një analizë të çmimit të blerjes në një kombinim biznesi, ka një trajtim të shkurtër krahasuar me SNRF për NVM lidhur me detyrimet e kushtëzuara, në SKK tona mungon një përkufizim i qartë për pasqyrat e kombinuara, nuk parashikohet në SKK kur mëma mund të përjashtohet nga detyrimi për pasqyra të konsoliduara dhe shënimet shpjeguese të SNRF për NVM janë më të zgjeruara.

Përsa i përket përmbajtjes, që gjithnjë e lidh me politikën kontabël të njohjes, matjes dhe vlerësimit të elementeve të pasqyrave financiare, ekzistojnë dy dallime thelbësore. Sipas SNRF për NVM emri i mirë amortizohet ndryshe nga SKK-të ku testohet për zhvlerësim. Kjo kërkesë e rëndon njësinë ekonomike sepse i kërkon vlerësime të shumta paraprake për të marrë vendimin për zhvlerësim dhe pyetësori tregon se më së shumti njësitë ekonomike e amortizojnë atë sipas normave të fiskut. Prandaj SNRF për NVM ka një trajtim më të thjeshtë e më të përshtatshëm. Ndërsa në të kundërt shkon dallimi tjetër i cili sipas SKK nuk lejon modelin alternativ të matjes me vlerën e drejtë të investimeve në pjesëmarrje. Ky fakt e bën SKK më të lehtë për t’u përdorur nga njësitë ekonomike sidomos edhe në kushtet kur përdoruesit e pasqyrave financiare në vendin tonë janë më skeptikë në drejtim të vlerësimit me vlerë të drejtë të elementeve të pasqyrës financiare.

Duke i vënë në balancë dy dallimet, njëri prej tyre bën SKK-të më të thjeshta dhe tjetri bën SNRF për NVM më të thjeshtë. Megjithatë, analiza shkon përtej asaj që perceptojnë si të thjeshtë apo të vështirë bizneset, por në faktin se këto dy standarde janë shumë pak të njohur e të përdorur në praktikën e biznesit shqiptar dhe këtë e mbështesin edhe të dhënat e pyetësorëve. Për pyetjet lidhur me SKK 9 kanë dhënë përgjigje 23– 47% të të anketuarëve dhe për SKK 14 numri i përgjigjeve vijon nga 24 – 28% të të anketuarëve. Për sa kohë këto dy standarde kanë një zbatueshmëri të ulët në vendin tonë, është i parakohshëm apo i panevojshëm kalimi drejt SNRF për NVM, gjithnjë referuar këtyre dy standardeve.

SKK 10 “Grantet dhe format e tjera të ndihmës”

Ky standard ka dallim shumë thelbësor. SKK 10 ka kërkesa dhe udhëzime të shumta lidhur me format e ndryshme të granteve të marra, duke i klasifikuar në grante

të marra në para, në aktive të amortizueshme dhe të paamortizueshme dhe grupi i tretë i granteve të marra për të mbyllur shpenzime (humbje) të periudhave të mëparshme. Për çdo grup ka politika të ndryshme të njohjes së të ardhurave nga grantet. Ndërsa SNRF për NVM nuk bën përcaktime dhe klasifikime të tilla. Në SNRF për NVM përcaktohet se grantet njihen në të ardhura me plotësimin e kushtit të performancës, ndërkohë trajtohen si të ardhura të shtyra.

Ky dallim qartazi tragon se SNRF për NVM, seksioni përkatës i granteve, është më i thjeshtë në përdorim se SKK 10. Ky thjeshtësim është një vlerësim në favor të adoptimit të SNRF për NVM.

SKK 11 “Tatimi mbi fitimin”

Seksionet e SNRF për NVM sjellin shumë pak të reja që nuk janë parashikuar në SKK 11, si psh disa paragrafë më të zgjeruar për trajtimin e tatim fitimit aktual si dhe në të kundërt nuk kanë disa paragrafë që lidhen me llogaritjen e tatim fitimeve të shtyra për aktive që mbahen me vlerë të drejtë. Këto dallime nuk janë aspak thelbësore dhe nuk kanë ndikim në cilësinë apo transparencën e shtuar të pasqyrave financiare.

SKK 12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimeve”

Ky standard nuk ka ndryshime thelbësore me seksionin përkatës të SNRF për NVM por mungon këtu një përkufizim i monedhës funksionale, që ashtu si është analizuar për SKK 1 dhe SKK 2, kjo mungesë kërkon më parë një rregullim ligjor. Gjithashtu, në SKK 12 nuk ka një trajtim të konceptit të investimeve në njësi ekonomike të huaja por është parashikuar trajtimi kontabël i diferencave të konvertimit që vijnë si pasojë e transaksioneve në njësinë ekonomike të huaj. Si dhe në standardet e tjera ka mjaftueshëm dallime të tjera që janë çështje të riformulimit gjuhësor.

Këto dallime nuk e bëjnë SNRF për NVM të domosdoshme madje as të nevojshme në kuptimin e trajtimit të diferencave të të kurseve të këmbimit.

SKK 13 “Aktivet biologjike”

Si shikohet edhe tek gjetjet, SKK 13, në dallim nga seksionet përkatëse të SNRF për NVM nuk trajton marrëveshjet konçesionare të cilat në fakt janë forma të reja të zhvilluara në biznesin shqiptar në vitet e fundit. Për sqarim, SNRF për NVM në të njëtin seksion ku trajton aktivet biologjike trajton më vete edhe marrëveshjt koncesionare, prandaj mund të thuhet se këto marrëveshje nuk i mungojnë SKK 13 por setit të standardeve në përgjithësi.

Një tjetër dallim i rëndësishëm është modeli i vlerësimit të mëpasshëm të aktiveve biologjike. Sipas SKK 13 përdoret vetëm modeli i kostos së amortizuar minus zhvlerësimin ndërsa SNRF për NVM lejon edhe përdorimin e modelit të vlerës së drejtë.

Këto dy ndryshime janë me rëndësi të jenë pjesë e raportimit financiar në vendin tonë prandaj në këtë rast është më i vlefshëm zbatimi i kërkesave të SNRF për NVM në lidhje me aktivet biologjike. Por ndërsa modeli i vlerës së drejtë nuk do të

ishte i aplikueshëm për sa kohë bizneset përpiqen të respektojnë rregullimet fiskale, marrëveshjet koncesionare patjetër që duhet të jenë pjesë e rregullimeve në standardet e raportimit financiar. Në fund të analizës për SKK 13 arrij në përfundimin që nuk është i domosdoshëm apo i nevojshëm adoptimi i SNRF për NVM për këtë standard të marrë në diskutim por do të ishte i domosdoshëm një amendim i SKK 13 për të përfshirë edhe marrëveshjet koncesionare.

Në fund të analizës për çdo standard rezulton se të dy setet kanë të përbashkët filozofinë, pra janë standarde të mbështetura në parime dhe derivojnë nga SNK / SNRF –të e plota por:

- SNRF për NVM është një standard më i madh në numër seksionesh;
- SNRF për NVM ka shënimet shpjeguese më të shumta;

Megjithatë disa prej dallimeve të konstatuara nëse përfshihen në SKK-të aktuale e mundësojnë jo vetëm përafrimin e kuadrit tonë të raportimit me atë ndërkombëtar por gjithashtu lehtësojnë dhe barrën e raportimit për NVM-të. Dallimet që realizojnë sa më sipër janë:

Shtesa:

Prezantimi i pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse;
Matjen e aktiveve biologjike me vlerë të drejtë;
Trajtimin e aktiveve të investuara;
Trajtimin e marrëveshjeve koncesionare;
Trajtimin e pasqyrave të konsoliduara;

Thjeshtime:

Instrumentet financiare të vlerësohen vetëm me koston e amortizuar;
AAM të mos rivlerësohen;
Shpenzimet e zhvillimit të njihen si shpenzime periudhe;
Kostot e huamarrjes të njihen si shpenzime periudhe;
Emri i mirë të amortizohet;

Deri tani është marrë në konsideratë dallimi mes SKK-ve dhe seksioneve përkatëse në SNRF për NVM por nga matricat krahasuese evidentohet dhe një fakt tjetër i rëndësishëm për analizën. Në SNRF janë 6 seksione të cilat nuk gjejnë standarde apo paragrafë të njëjtë ose të ngjashëm me ato të SKK-ve për nga subjekti. Kështu vlefshmëria e tyre në kushtet e realitetit shqiptar do të shihet e shkëputur nga SKK-të.

Seksioni 1 “Njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme” nuk do të sillte ndonjë risi për raportimin financiar pasi klasifikimi i tyre bëhet në një ligj të veçantë por është me vlerë të artikulohet në kuadrin tonë të raportimit (ligji apo standardet) përkufizimi i një NVM në kuptimin e raportimit financiar. Pra nuk gjejmë në kuadrin tonë përkufizimin klasik të NVM-së sipas BSNK që e ka përcaktuar NVM “....të gjitha ato njësi ekonomike që nuk kanë përgjegjësi publike dhe që ndërtojnë pasqyra financiare me qëllim të përgjithshëm për përdorues të jashtëm”. Një amendim i tillë në SKK tona është i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për të vazhduar me SKK-të.

Seksioni 22 “Detyrimet dhe kapitali neto” është një zgjerim i çështjeve të instrumenteve financiarë të përbërë që mund të jenë detyrime ose instrumentë kapitali.

Meqenëse në tregun shqiptar këto forma të përbëra e të komplikuar të transaksioneve financiare brenda njësive ekonomike si:

- *Shitja e opsioneve, të drejtave dhe garancive (Sale of options, rights and warrants);*
- *Kapitalizimi apo emetimi i bonuseve në aksione dhe ndarja e aksioneve (Capitalisation or bonus issues of shares and share splits);*
- *Instrumentet e borxhit të konvertueshëm ose instrumentet financiare të ngjashme të përbërë (Convertible debt or similar compound financial instruments);*
- *Aksionet e thesarit (Treasury shares);*
- *Interesi jo-kontrollues dhe transaksionet në aksione të një filiali të konsoliduar (Non-controlling interest and transactions in shares of a consolidated subsidiary)*

janë të panjohura ose në faza shumë shumë të hershme, atëherë adoptimi i SNRF për NVM nuk do të sillte një përmirësim të cilësisë së pasqyrave aktuale ose më saktë të thuhet që nuk është një nevojë apo kërkesë aktuale për biznesin shqiptar.

Seksioni 26 “Pagesat e bazuara në aksione” është formë e panjohur e biznesit shqiptar. Sot bizneset shqiptare nuk aplikojnë forma të kompesimit të detyrimeve me furnitorët për mallra dhe shërbime përmes emetimit të aksioneve të reja. Për më tepër është i panjohur një transaksion biznesi i tillë ku punonjësit kompensohen për shpërblimet e tyre me aksione të njësisë ekonomike dhe njëkohësisht të vazhdojnë të jenë të punësuar. Seksioni përkatës i SNRF për NVM ka udhëzime për njohjen, matjen dhe vlerësimin e mëpasshëm shumë të komplikuar për realitetin e biznesit në Shqipëri. Në analizë mbaj gjithnjë parasysh statistikën e njësive ekonomike, ku mbi 105.017 njësi ekonomike (gjithsej 111.083) kanë deri në 10 të punësuar.

Seksioni 28 “Përfitimet e punonjësve”, është aktualisht janë interesit të njësive ekonomike jo vetëm për shkallën shumë të lartë të vështirësisë së aplikimit por dhe për faktin se në Shqipëri nuk kemi skema pensionesh private për të cilat njësitet ekonomike kanë detyrime në bazë të kontratave të lidhura me punonjësit për përfitime afatshkurtra, afatgjata dhe ato pas përfundimit të kontratës së punës.

Po kështu, lidhur me seksionin 31 “Hiperinflacioni”, është i panevojshëm rëndimi i raportimit financiar në vendin tonë me një standard që nuk i përgjigjet kushteve aktuale të tregut dhe biznesit në Shqipëri. Nëse duhet të flasim në terma afatgjatë mund dhe të jetë pjesë e raportimit financiar por me një probabilitet shumë të vogël, afër zeros që të jetë i përdorshëm. Për më tepër që ky standard të jetë i aplikueshëm kërkohet amendimi ligjor ai i përgatitjes së pasqyrave financiare në monedhë funksionale, e ndryshme nga monedha raportuese.

Seksioni 33 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura” është një standard që do të rëndonte barrën e raportimit financiar pasi ka kërkesa të shumta lidhur me shënimet shpjeguese në rastin e palëve të lidhura. Është një standard tërësisht i lidhur me transparencën por nuk është prioritet për momentin. Po t’i referohemi gjetjeve nga pyetësorët me bankat, çështja themelore është se pasqyrat nuk thonë të vërtetën tek shifrat. Kjo gjë i bën ato jo shumë të besueshme e të përdorshme prandaj do të ishte ironi të kërkonim shënime të plota shpjeguese për palët e lidhura kur nuk është i zgjidhur problemi i të vërtetës me shifrat.

****Në fund të analizës së standardeve kombëtare vs. SNRF për NVM arrij në përfundimin se adoptimi i plotë i SNRF për NVM, në aspektin teknik nuk është një përmirësim cilësor i raportimit financiar. Të gjitha dallimet që unë i kam konsideruar të rëndësishme dhe që janë shumë pak në numër mund të integrohen lehtësisht në SKK-tona. Ashtu si shprehen dhe ekspertët e opinionit, këto ndryshime nuk do të hasnin në resistencë nga njësitë ekonomike pasi nuk krijojnë efekte psikologjike negative të barrës së shtuar të raportimit financiar.*

5.3.2 Dallimet mes SKK-ve dhe Direktivës së Kontabilitetit në BE

Në aneksin 2 është paraqitur matrica krahasuese e SKK-ve dhe Direktivës së Kontabilitetit të BE (Dir 34/2013/EU). Pas krahasimit të të gjithë paragrafëve, në shënimet e mia, kam krijuar logjikën e grupeve për të lehtësuar analizën dhe për t'u fokusuar tek problemi kryesor i punimit. Në grupin e parë kam klasifikuar dallimet që jo domosdoshmërisht kërkojnë reflektim në kuadrin tonë ligjor. Në grupin e dytë kam përfshirë dallimet që kërkojnë amendime ligjore dhe në grupin e tretë ato që prekin kërkesat e standardeve të kontabilitetit. Në matricën e paraqitur janë evidentuar vetëm dallimet sipas grupit të fundit, pra ato që kanë lidhje me kërkesat e standardeve. Në analizën më poshtë interes nuk përbën dallimi me Direktivën si dallim në vetvete, por nëse ky dallim është present edhe në rastin e SNRF për NVM duke kuptuar kështu cili prej dy seteve është më afër kërkesave të Direktivës. Më poshtë janë listuar dallimet kryesore shoqëruar me analizën përkatëse.

1. Direktiva kërkon që njësitë ekonomike të përgatisin pasqyra të konsoliduara nëse plotësojnë kushtet për një gjë të tillë por transaksionet e kontrolluara ose ndryshe transferimet e interesave pjesëmarrëse brenda grupit të kontabilizohen me metodën e bashkimit të interesave, ku vlera kontabël e aksioneve të një njësie të eliminohet kundrejt përqindjes korresponduese të kapitalit. SKK-të nuk lejojnë metodën e bashkimit të interesave por kërkojnë të përdoret metoda e blerjes dhe gjithashtu SKK 9 nuk parashikon një rimatje të vlerës së emrit të mirë kur kjo e fundit transferohet tek një njësi tjetër e grupit. Këto dy dallime me Direktivën janë thelbësore por duke qenë se janë të njëtat politika dhe trajtime si edhe në SNRF për NVM, nuk është dallim që ndihmon në përgjigjen që dua të arrij në punim.
2. Direktiva kërkon që pjesëmarrjet të përfshihen në konsolidim përmes metodës së kapitalit. SKK 9 lejon dy metoda: kapitali dhe kosto. SNRF për NVM ka tre alternativa: modeli i koston, modeli i kapitalit neto dhe modeli i vlerës së drejtë. Thënë kjo kuptohet që SKK 14 është më afër Direktivës së BE krahasuar me SNRF për NVM.
3. Direktiva kërkon që aktivet ose aktivitetet e kontrolluara bashkërisht të konsolidohen proporcionalisht ndërsa SKK-të nuk e lejojnë metodën proporcionale. I njëjti trajtim si në SKK është edhe sipas SNRF për NVM.
4. Direktiva kërkon shumë shënime shpjeguese si më poshtë:

- a) Shënime shpjeguese shtesë lidhur me të dhëna (emri, adresa e zyrës, grupi) për filialet, pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta;
- b) Shënime shpjeguese lidhur me trajtimin e taksave të zërave që bëjnë pjesë tek lëvizjet në rezervat e rivlerësimit;
- c) Direktiva kërkon që në shënimet shpjeguese të jepet informacion për vlerën e mbetur të aktiveve afatgjata, sa do të kish qenë kjo vlerë nëse këto aktive nuk do të kishin qenë rivlerësuar ndonjëherë;
- d) Direktiva kërkon të jepen shpjegime për detyrime të pagueshme për më vonë se 5 vjet si dhe për të gjitha llojet e borxheve që mbulohen nga letra me vlerë të lëshuara nga njësia ekonomike të jepet natyra dhe forma e tyre;
- e) Direktiva kërkon të jepen në shënime shpjeguese të dhëna për numrin mesatar të të punësuarve gjatë vitit nga njësiti ekonomike që janë konsoliduar proporcionalisht;
- f) Direktiva kërkon që të jepen shpjegime për paradhënie ose grante që u jepen stafëve drejtuese të njësisë mëmë nga vetë mëma ose filiale të saj;
- g) Direktiva u kërkon vendeve anëtare të limitojnë kërkesat për shënime shpjeguese të njësive të vogla deri në atë sa parashikon direktiva, jo më shumë;
- h) Direktiva kërkon të jepen shpjegime për instrumentat financiarë që mbahen me vlerë kontabël në rast se kjo vlerë tejkalon vlerën e drejtë të tyre;
- i) Direktiva kërkon të shpjegohen arsyet përse nuk zvogëlohet kjo vlerë kontabël përfshirë shpjegime mbi natyrën e evidencës që mbështet gjykimin se vlera kontabël do të rikuperohet;
- j) Shpjegime mbi numrin mesatar të punonjësve të ndarë sipas kategorive, dhe nëse nuk janë bërë detajime në PASH, në shpjegime të jepen të ndara pagat, sigurimet dhe pastaj pensionet.
- k) Shënime shpjeguese për numrin dhe vlerën nominale, ose në mungesë të vlerë nominale të jepet vlera kontabël për aksion të regjistruara gjatë periudhës ushtrimore brenda limitit të kapitalit të autorizuar;
- l) Kur ka më shumë se një klasë aksionesh, të shpjegohet lidhur me numrin dhe vlerën nominale, ose në mungesë të vlerës nominale të jepet vlera kontabël për aksion për çdo klasë;
- m) Të jepen shpjegime për ekzistencën e ndonjë certificate pjesëmarrëse, obligacioni të konvertueshëm, garanci, opsione ose të drejta apo letra të tjera me vlerë të ngjashme si dhe të jepen të dhëna për numrin e tyre dhe të drejtat që ato mbajnë;

Disa nga shënimet shpjeguese që kërkohen në Direktivë nuk janë as në SKK dhe as në SNRF për NVM. Disa të tjera i takojnë atyre seksione të SNRF për NVM që nuk gjejnë reflektim në standardet tona për të cilët u bë dhe analiza e rëndësisë së tyre në realitetin shqiptar. Ndërsa disa shënime shpjeguese të tjera janë në SNRF për NVM por jo në paragrafët e SKK. Por pavarësisht fakteve të dhëna më sipër, shënimet shpjeguese nuk ndryshojnë kursin kontabël të një regjimi të raportimit financiar por padiskutim rrisin transparencën e pasqyrave. Megjithatë nuk janë një faktor përcaktues në vendimin e adoptimit të SNRF për NVM sepse kjo hapësirë mes dy seteve mbulohet me disa amendime të shënimeve shpjeguese të standardeve përkatëse;

5. Palët e lidhura në SKK jepen me shembuj por pa një përkufizim. Ndërsa Direktiva ka huazuar përkufizimin e SNRF-ve të plota të miratuara në BE, përkufizim i cili është i njëjtë edhe në SNRF për NVM. Edhe ky dallim nuk është thelbësor por mund të plotësohet përmes rishikimit të SKK-së përkatëse duke shtuar përkufizimin;

6. Lidhur me pasqyrat financiare, Direktiva u lejon vendeve anëtare që përjashtuar njësitë e vogla, mund t'u kërkojnë njësive të tjera edhe pasqyra shtesë. SKK-të tona ashtu si SNRF për NVM parashikon vetëm katër pasqyra financiare shoqëruar me shënime shpjeguese dhe asnjë pasqyrë tjetër shtesë;

7. Formatet e pasqyrave financiare sipas SKK-ve janë më të thjeshtuara se ato të paraqitura në Direktivë. Pasqyrat sipas SNRF janë më afër formatit të Direktivës. Megjithatë zërat kryesorë dhe çfarë përfshihet në to, nuk kanë dallime në të tre dokumentet në analizë;

8. Në SKK 14 nuk ka një kërkesë si në Direktivë që përcakton se: “Kur e ardhura që njihet nga dividendët është më e madhe se dividendët e arkëtuar, diferenca të transferohet në rezerva të pashpërndashme në pasqyrën e lëvizjes së kapitalit”; Në SNRF për NVM kjo kërkesë është e dhënë. Megjithatë ky dallim nuk është një kontraditë mes SKK-ve dhe SNRF për NVM por një mungesë lehtësisht e korrigjueshme tek SKK-të.

9. Direktiva kërkon që aktivet dhe detyrimet që gjejnë vend më shumë se një herë në PF të paraqiten të ndara ose të shpjegohen tek shënimet. Tek SKK 7 në fakt nuk kërkohet një gjë të tillë për ndarjen e detyrimeve të qirasë financiare në afatshkurtra dhe afatgjata. Një kërkesë e tillë nuk është e artikuluar as në SNRF për NVM.

10. Nuk parashikohen në SKK 9 por Direktiva kërkon që:

- Njësia ekonomike mëmë dhe të gjitha filialet e saj të konsolidohen pavarësisht ku janë të regjistruara dhe operojnë filialet;
- Grupet e vogla të përjashtohen nga konsolidimi, përjashtuar rastin kur një nga filialet është njësi me interes publik;

Këto kërkesa nuk janë të artikuluar në mënyrë të posaçme as në SKK dhe as në SNRF për NVM. Por në të dy setet kërkohet që pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të përfshijnë të gjitha njësitë e kontrolluara të shoqërisë mëmë. Ndërsa për grupet nuk ka udhëzime të veçanta në asnjërin prej dy seteve të raportimit.

11. Në SKK 9 nuk parashikohen përjashtime kur aktivitetet e saj kryhen në vende ku juridiksioni nuk e lejon transferimin e mjeteve monetare (Direktiva nuk detyron të bëhet konsolidim nëse ka kufizime afatgjata të konsiderueshme). SNRF është në linjë me Direktivën për këtë kërkesë.

****Nga analiza e mësipërme konstatohet se dallimet mes SKK-ve dhe Direktivës së Kontabilitetit në BE, lidhur me politikat kontabël, janë të njëjta me ato që janë edhe mes SNRF për NVM dhe Direktivës. Në këto kushte, nuk është vlerë e shtuar drejt harmonizimit me Direktivën, adoptimi i një regjimi tjetër të raportimit financiar, konkretisht të SNRF për NVM.*

5.3.3 Përgatitja profesionale dhe gadishmëria e përgatitësve të pasqyrave financiare për të kaluar në një set të ri raportimi financiar

Për të analizuar shkallën e përgatitjes profesionale të përgatitësve të pasqyrave financiare do të shfrytëzohen gjetjet e paraqitura në kapitullin 4, pra përgjigjet e marra nga pyetësi i bërë me këta përgatitës.

5.3.3.1 Analiza e profilit të kampionit

Gjatë analizës së pyetësorëve më shumë se të arsyetoj për rezultatet e drejtpërdrejta që merren nga grafikët, do të përpiqem të kombinoj rezultatet e pyetjeve mes tyre.

Pyetësorit i dhanë përgjigje 83 EKR, 29 KM, 17 kontabilistë në njësi dhe 8 persona të tjerë të cilët rezultojnë specialistë me diplomë në kontabilitet por të punësuar në institucione publike.

Shpërndarja e tyre sipas shifrës së afarizmit (në milion lekë) është:

Shifra e afarizmit Profesioni	2 – 10	10 – 50	51 – 250	251 - 700
EKR			32	51
KM		7	22	
Kontabilist	2	15		
Tjetër	2	6		

Shpërndarja e tyre sipas llojit të sipërmarrjes është:

Sipërmarrje Profesioni	Vendase	E huaj	E përbashkët
EKR	63	16	4
KM	24	5	
Kontabilist	17		
Tjetër	8		

Shpërndarja e tyre sipas standardeve të kontabilitetit që aplikon njësia është:

Standardet Profesioni	SKK 15	SKK 1- 14	SNRF të plota
EKR		80	3
KM		29	
Kontabilist	3	14	
Tjetër	2	6	

Shpërndarja e tyre sipas filozofisë së standardeve është:

Filozofia Profesioni	Parime	Rregulla
EKR	31	46
KM	12	13
Kontabilist	6	11
Tjetër		8

Shpërndarja e tyre sipas edukimit shkollor dhe shkencor është:

Edukimi Profesioni	I mesëm	I lartë	Master	ACCA	CPA
EKR		51	8	18	6
KM		13	12	4	
Kontabilist		4	13		
Tjetër	2	3	3		

Shpërndarja e tyre sipas grupmoshave është:

Grupmosha Profesioni	Deri 35	35 – 45	45 – 55	Mbi 55
EKR	4	44	33	2
KM	10	14	4	1
Kontabilist	9	4	3	1
Tjetër	3	2	2	1

Kjo analizë e kryqëzuar e disa të dhënave personale demografike, u bë paraprakisht për të kuptuar pritshmëritë për përgjigjet e pyetësorë. Pritshmëritë në fillim ishin shumë të larta sepse adresat për të dërguar pyetësorët u morën nga organizmat profesionalë dhe shoqëritë e auditimit, ku aderojnë apo punësohen profesionistë të përgatitur dhe kualifikuar. Kampioni në studim është relativisht elitare sepse është një kampion ku 60% e tij ka kualifikimin më të lartë profesional (auditues 83 / 137), ku 17% ka kualifikimin të huaj (24 / 137), ku 66% e tij është shkolluar pas viteve '90 kur ndryshoi krejtësisht teoria ekonomike në vendin tonë (90 / 137 janë të moshës deri në 45 vjeç), ku 94% e zbaton SKK 1-14 (129 / 137) dhe ku 77% hartojnë pasqyra financiare për njësi ekonomike me shifër afarizmi vjetor mbi 50 milion lekë (105 / 137).

5.3.3.2 Analiza e përgjigjeve lidhur me kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë e SKK -ve

Gjithsej u hartuan 37 pyetje që kërkonin të evidentonin shkallën e përgatitësve të pasqyrave financiare lidhur me kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë e pasqyrave financiare. Pyetjet u ndanë në grupe të vogla sipas standardeve, SKK (3 – 14). Për të ndihmuar lexuesin, analizën do ta rendis sipas grup pyetje për çdo standard.

SKK 3 – “Instrumentet financiare” (4 pyetje)

Pyetjes lidhur me matjen në njohje të instrumenteve financiarë 78% e kampionit iu përgjigj saktë ndërsa pyetjes lidhur me vlerësimin e mëpasshëm të këtyre instrumenteve asnjë nuk iu përgjigj saktë. Fakti që të gjitha përgjigjet e pyetjes së dytë shkojnë për koston e amortizuar kjo do të thotë se praktikisht të gjithë përgatitësit në fund të vitit respektojnë rregullimin fiskal për elementet e pasqyrave financiare.

Ndërsa për sa i përket atij 22% të kampionit që u përgjigj se matja në njohje bëhet me vlerën e drejtë, gjykoj që i janë referuar vlerës së drejtë të shumës së paguar për blerjen e instrumenteve financiarë. Megjithatë kjo e fundit është një analizë e pambështetur pasi nuk i jam drejtuar edhe një herë kampionit në studim për qartësime të mëtejshme lidhur me pyetjen e pare. Pyetësi nuk ta jep këtë mundësi për t'u thelluar më tej.

Dy pyetjet e tjera nuk kanë të bëjnë me politikat kontabël por duan të evidentojnë nëse standardi njihet lidhur me fushën e zbatimit të tij dhe të kërkesave specifike. Më së shumti këto pyetje nuk e marrin përgjigjen nga praktika e përditshme e biznesit në realitetin shqiptar por nga të studiuarit teorik të standardit. Dhe në fakt arsyetimi mbështetet edhe nga shifrat. Përgjigjet e sakta 48 nga 72 për pyetjen e tretë

janë dhënë prej 19 profesionistëve me kualifikim të huaj ACCA, 4 me kualifikim të huaj CPA, 25 me kualifikim master. Ndërsa përgjigjet e sakta për pyetjen e katërt, 83 nga 121, janë dhënë nga 21 profesionistë me ACCA, 5 me CPA, 32 me Master, dhe pjesa tjetër arsim i lartë.

Për pyetjet që nuk gjejnë shpesh zbatim në praktikë janë përgjigjur saktë profesionistët që padiskutim u është dashur t'u nënshtrohen provimeve për standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar në nivele mbi bachelor.

SKK 4 - "Inventarët" (4 pyetje)

Përsëri për këtë standard u hartuan dy pyetje që lidhen me praktikën e përditshme dhe dy të tjera që hasen më rrallë ose njihen më shumë në nivel teorik. Pyetja e parë që kërkon si maten inventarët në njohje, ka marrë 129 përgjigje të sakta nga 137. Pyetja e tretë se me çfarë vlere paraqiten inventarët në pasqyrë, ka marrë vetëm 28 përgjigje të sakta nga 135 dhe nga përgjigjet e gabura (107/135), 79 prej tyre kanë përgjigje modelin e kostos. Përsëri ky rezultat të çon në përfundimin që hartuesit priren të respektojnë rregullimet tatimore dhe nuk janë të interesuar çfarë parashikon standardi kontabël.

Ndërsa pyetja e dytë që interesohet të kuptojë se në ç'masë njihet nga përgatitësit se ku paraqiten inventarët afatgjatë të mbajtur për shitje, i janë përgjigjur saktë 116 nga 132 profesionistë. Përsëri për të thelluar analizën se çfarë formimi kanë patur ata që kanë dhënë përgjigjen e saktë, më rezulton se dominojnë ata me kualifikim më të lartë arsimor ose profesional. Konkretisht 116 profesionistët që kanë dhënë përgjigjen e saktë janë 28 me ACCA dhe CPA, 34 me Master dhe 54 të tjerë me arsim të lartë.

Pyetjes së katërt që kërkon të testojë nëse njihet nga profesionistët se sa shpesh testohen inventarët për zhvlerësim, përgjigjet janë orientuar përsëri drejt fiskut pasi 73 nga 129 kanë thënë se inventarët nuk **testohen** për zhvlerësim. Është e vërtetë që 41 nga 129 kanë dhënë përgjigjen e saktë por gjithësesi mbetet një nivel shumë i ulët i dijes mbi standardet, vetëm 31 %. Përsëri nga analiza kuptohet që përgjigjet kanë shkuar drejt opsionit "asnjëherë" pasi sipas fiskut zhvlerësimi i inventarëve është një rregullim kontabël që prodhon shpenzime të panjohura dhe si i tillë nuk zbatohet prej njësive ekonomike.

SKK 5 – "AAM dhe AAJM"

Për këtë standard tre nga të katër pyetjet e ndërtuara janë ngushtësisht të lidhura me praktikën e përditshme kontabël të njësive ekonomike.

Pyetjes së parë, relativisht më teorike si përgjigje, i'u përgjigjen saktë 44 nga 131 (33.5%). Përsëri nga kryqëzimet e të dhënave rezulton se përgjigjet e sakta i kanë dhënë 20 profesionistë me ACCA, 4 me CPA, 18 të tjerë me mastër dhe 2 me arsim të lartë, ku nga të 44 gjithsej, 39 janë EKR dhe 5 KM. Për këtë pyetje e thellova analizën duke kryqëzuar edhe të dhënat për grupmoshat. Mosha deri në 45 vjeç i takonte 28 prej përgjigjeve të sakta. Kjo tregon se është më i lartë probabiliteti që të rinjtë të azhurnohen më shumë me literaturën ndërkombëtare dhe kombëtare në lidhje me kontabilitetin dhe raportimin financiar.

Pyetjes së dytë, të tretë dhe të katërt, në përqindjet respektive 61%, 53% dhe 59%, i janë përgjigjur gabim, por gabim sipas standardeve dhe saktë sipas rregullimit fiskal. Kjo tregon dhe një herë prirjen për t'u orientuar nga rregullimet fiskale.

Në fakt është optimiste e dhëna që të paktën 47% e profesionistëve e dinë që ekziston, edhe pse e aplikueshme vetëm teorikisht, mënyra alternative e rivlerësimit. Por është shumë pak premtues ky fakt sepse SKK 5 konsiderohet si një standard absolutisht i përdorshëm nga njësitë ekonomike dhe një tregues më i vogël se 50% për një standard bazë të bën të besosh se standardet e tjera njihen shumë më pak. Megjithatë analiza vazhdon.

SKK 6 – “Provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara”

Për standardin e provizioneve kam ndërtuar vetëm 2 pyetje. Pyetja e parë që kërkon më shumë njohuri teorike ka vetëm 72 përgjigje të sakta nga 134 pra 53% por ky fakt zbehet shumë në përgjigjet e pyetjes së dytë. Këtu vetëm 44 përgjigje janë të sakta nga 131 gjithsej, pra 33.5%. Por pyetja e dytë ka shumë ndikim nga rregullimi fiskal i cili nuk parashikon vlerësime të shumave sipas vlerës së tyre aktuale. Në këtë rast ka dominuar praktika kontabël dhe jo teoria e standardeve. Pra jemi në kushtet e dominancës së rregullimeve fiskale.

SKK 7 – “Kontabilizimi i Qirave”

Për të testuar dijen për këtë standard kam hartuar tre pyetje, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me praktikën e biznesit. Së pari vërehet që nga 137 profesionistë që janë angazhuar të plotësojnë këtë pyetësor, këtij grupi pyetjesh i janë përgjigjur respektivisht 96, 96 dhe 91 persona. Kjo shifër tregon se kanë dijeni për këtë standard rreth 70% e kampionit. Si tregues është optimist por saktësia e përgjigjeve brenda është e ulët. Çështja e matjes në njohje të aktiveve të dhëna/marra me qira financiare njihet në një masë jo më të madhe 50% ndërsa pyetja e tretë ka një përqindje saktësie më të madhe për faktin se ka trajtim të njëjtë me atë të fiskut. Saktësia për përgjigjet e pyetjes së tretë është 61% (56 nga 91).

SKK 8 – “Të ardhurat”

Të tre pyetjet e SKK 8 kanë interes për të përditshmen e biznesit. Të treja çështjet që mbulohen nga këto pyetje kërkojnë përditë një zgjidhje nga njësia ekonomike. Pritshmëria për saktësinë e përgjigjeve ishte e lartë por faktet janë krejt ndryshe. Përgjigja e saktë është dhënë 31 herë nga 122, pra 25% dinë që të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar. Pjesa tjetër, përgjigjet e gabuara 81 nga 122, dinë që të ardhurat maten me vlerën aktuale 4 nga 122 ndërsa të tjerët 87 nga 122 dinë se të ardhurat njihen me vlerën e faturës. Kjo përgjigje e alternativës së tretë që zë 71% të përgjigjeve gjithsej është fakt bindës se hartuesit e pasqyrave financiare nuk ushtrojnë absolutisht gjykim profesional por dinë mirë rregullat e fiskut. Ata dinë që sa paraqitet në FDP është e ardhur tatimore e njohur dhe për pjesën tjetër nuk shqetësohen. Në të njëjtën logjikë janë dhe përgjigjet për pyetjen e dytë. Për këtë pyetje 63% e profesionistëve kanë thënë se të ardhurat nga shërbimi njihen kur lëshohet fatura dhe jo mbi metodën e fazës së përfunduar. Duke qenë se fisku

arsyeton mbi dokumentin tatimor, edhe përgatitësit nuk shqetësohen për vlerësime të fazës së përfunduar por në fund të shërbimit bëjnë një faturë përmbledhëse dhe në atë moment njohin të ardhurat nga shërbimi. Ky është një shtrembërim shumë i rëndë i standardit të të ardhurave. Përfundimisht kjo çështja e standardit del në plan të dytë nga përgjigjet e dhëna në pyetjen e tretë. Rreth 53% e përgjigjeve, shkojnë në linjë me rregullimin fiskal, që nuk ka të bëjë fare me atë të standardit dhe vetëm 29% janë të sakta. Pjesa prej 18% gjithësesi është e gabuar por prap në linjë me logjikën e fiskut ndaj shpenzimeve të shpërndara në sa më shumë vite.

SKK 9 – “Kombinimet e bizneseve”

Në realitetin shqiptar kombinimet e bizneseve nuk janë një fenomen i përhapur, madje haset rrallë dhe këtë e tregon dhe përqindja e profesionistëve që janë angazhuar në pyetjet rreth standardit të kombinimit të bizneseve. Përgjigje kanë ardhur për katër pyetjet respektivisht në masën 30%, 23%, 47% dhe 47%. Për të kuptuar më mirë karakteristikat e grupit që është përgjigjur analiza tregoi se ky grup sërish kishte në përbërje profesionistë me kualifikim arsimor dhe profesional më të lartë. Numrat thonë një fakt të pakundërshtueshëm. Këtë standard e njohin, shumë apo pak, vetëm ata që i janë nënshtruar provimeve profesionale në vitet e fundit. Saktësia e përgjigjeve respektivisht shkon në masën 50%, 43%, 63% dhe 67%. Nuk ka shpjegim tjetër përveçse të pranohet që ky standard njihet në nivel teorik në një masë shumë të vogël por dijet teorike nuk konfondohen, prej ata që e kanë lexuar, me rregullimet fiskale pasi nuk është një standard që gjen zbatim në praktikën fiskale. Sipas fiskut, njësitë ekonomike nuk dorëzojnë në tatime pasqyrat financiare të konsoliduara por vetëm ato individuale.

SKK 10 – “Grantet dhe format e tjera të ndihmës”

Ky standard mbulohet nga tre pyetje që në fakt kanë të bëjnë me praktikën kontabël të regjistrimeve por numrat tregojnë se këtij standardi i janë përgjigjur pak profesionistë. Pyetjes së dytë i janë përgjigjur 30% e kampionit, pyetjes së tretë 46% dhe pyetjes së parë 62%. Pyetja e dytë në fakt është koncept teorik që mesa tregon pyetësori haset pak në praktikë, në të kundërt do të ishin përgjigjur më shumë profesionistë. Në vlerësimin e saktësisë së përgjigjeve, pyetja e parë ka një përqindje të ulët, 31 nga 85 pra vetëm 36%. Pjesa tjetër e përgjigjeve 47 nga 85 shkon drejt përgjigjes së gabuar, opsionit të gabuar se granti njihet me vlerën që ai ka patur në librat kontabël të njësisë që jep grantin. Ky koncept është në përputhje me rregullimin fiskal dhe prandaj nuk është befasues rezultati i përgjigjeve. Pyetja e tretë ka një saktësi më të lartë të përgjigjeve në masën 74%. Ky nivel saktësie është disi i shkëputur nga mesatarja e përgjigjeve të sakta për pyetjet e tjera por për hir të së vërtetës nuk kam siguruar informacion tjetër shtesë për të bërë një analizë më të thellë.

SKK 11 “Tatimi mbi fitimin”

I janë përgjigjur pyetësorit një numër shumë i vogël i profesionistëve, 33 nga 137 gjithsej, pra 24%. Nuk mund të jetë përcaktues në analizën e përgjithshme një vlerësim i bërë për këtë përgjigje. Më së shumti këtu mund të thuhet me bindje se ky

standard, me ligj jo i detyrueshëm për t'u zbatuar, njihet dhe përdoret shumë pak. Më saktë njihet pak dhe pothuaj nuk përdoret. Për të thelluar bindjen se ky standard njihet vetëm nga ata që kanë studiuar për arsye shkolle dhe jo pune, kam bërë një kryqëzim të numrave në këtë përgjigje me të dhënat personale të grupit që është përgjigjur. Më rezulton se në këtë grup 21 profesionistë kanë diplomën ACCA, 5 prej tyre CPA dhe 7 të tjerët kanë kualifikimin Master.

SKK 12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit”

SKK 12 është një nga standardet që ka marrë dhe numrin më të madh të përgjigjeve por në dy pyetjet që e mbulojnë këtë standard, tek njëra saktësia në përgjigje është 8.5% ndërsa tek pyetja tjetër 73%. Çfarë fshihet mbas numrave e zbulon analiza. Në pyetjen e parë 91.5% e përgjigjeve kanë shkuar drejt orientimit tatimor që nuk përputhet me atë të standardit. Pra një vlerësim me vlerën e drejtë është përjashtuar në 91.5% të rasteve dhe është pranuar në 11 nga 131 profesionistët e pyetur. Ndër ta vetëm 9 janë auditues dhe 2 të tjerët janë KM por të gjithë me nivel arsimor Master e më lart. Pyetjes së dytë i janë përgjigjur saktë 96 nga 134 por kjo për faktin se trajtimi sipas standardit është i njëjtë me trajtimin sipas fiskut.

SKK 13 – “Aktivet biologjike”

Pyetjeve që mbulojnë çështje të aktiveve biologjike iu përgjigjën nga 60-64% të të anketuarëve. Ky fakt është disi kontradiktor me peshën specifike që zënë në numrin e përgjithshëm të njësive ato në sektorin e bujqësisë. Në aneksin 1 ku janë paraqitur të dhëna të INSTAT për vitin 2013, vërehet se nga 111.083 njësi ekonomike aktive, vetëm 1.690 prej tyre operojnë në sektorin e bujqësisë, pra 1.5%. E vërtetë që nuk mund të pretendohet që dhe masa e kampionit që njeh SKK 13 të jetë po kaq e vogël pasi është vënë re se për pyetjet me karakter specifik e që nuk zbatohen shpesh në praktikë, ka patur përgjigje të sakta që mbështeten me edukimin që ka profesionisti i anketuar. Por në këtë rast kemi një hapsirë shumë të madhe, vëmdosin të përgjigjen 64% e kampionit dhe jep përgjigje të sakta 62% dhe 82% e atyre që janë përgjigjur. Kjo kontraditë justifikohet vetëm me faktin se përgjigjet e sakta janë në linjë me logjikën e fiskut, atë të vlerës kontabël dhe të kostos së amortizuar, prandaj dhe përgjigjet e sakta janë të shumta.

SKK 14 “Trajtimi kontabël i shoqërive të kontrolluara dhe pjesëmarrjeve”

Ashtu si SKK 9 edhe ky standard ka një nivel shumë të ulët reagimi. Numri i përgjigjeve vijon nga 33 në 39 pra nga 24 – 28% të të anketuarëve. Nuk janë përqindje domethënëse por tregojnë një të vërtetë të realitetit shqiptar, që praktika të tilla janë shumë të rralla sepse biznesi shqiptar është akoma në faza shumë genuine përsa i përket transaksioneve financiare mes njësive ekonomike. Gjithësesi, përgjigjet e sakta në këto pyetje janë më të shumta se ato të gabuara. Por ka një shpjegim, përgjigjet e sakta kanë brenda fjalën kosto që është një term i pranuar si absolut në praktikën e biznesit shqiptar kundrejt modeleve të tjera alternative të matjes dhe vlerësimit dhe së dyti nga analiza e përbërjes së këtij grupi sërish konfirmohet se

pyetjeve me karakter më shumë teorik se praktik u kanë dhënë përgjigje ajo pjesë e profesionistëve që për një arsye apo tjetër janë afër literaturës.

Në fund të analizës së seksionit të tretë të pyetjeve, për të forcuar bindjen time e për të kuptuar më mirë ku janë përgatitësit e pasqyrave financiare në raport me standardet e kontabilitetit, bëra një kryqëzim tjetër të rëndësishëm. I grupova pyetjet sipas orientimit të përgjigjes. Pra në njërin grup vura pyetjet me përgjigje në harmoni me trajtimin fiskal dhe në grupin tjetër ato me përgjigje të ndryshme nga trajtimi fiskal. Disa pyetje mbetën jashtë kësaj analize sepse nuk kishin të bënim me trajtime kontabël por më shumë me dije rreth kërkesave specifike apo dhe të të kuptuarit të terminologjisë.

Gjithashtu pyetjet lidhur me SKK 9, SKK 14 për sa i takon pasqyrave të konsoliduara dhe SKK 11 për sa i takon aktiveve / detyrimeve tatimore, ato janë përfshirë në grupin e pyetjeve asnjëse, pra që nuk kërkojnë një përgjigje nga praktika, qoftë në biznes qoftë ajo tatimore.

Nga kjo analizë dolën përfundimet si më poshtë:

- Grupi i parë – Pyetje që kanë përgjigje të njëjtë me trajtimin fiskal janë gjithsej 7 pyetje me një mesatare të saktësisë rreth 74.92%;
- Grupi i dytë - Pyetje që kanë përgjigje të ndryshme nga trajtimi fiskal janë gjithsej 12 pyetje me një mesatare të saktësisë 26.76%;
- Grupi i tretë – Pyetje, përgjigjet e të cilave nuk kanë të bëjnë me një trajtim kontabël apo fiskal janë 18 pyetje me një mesatare saktësie 56.48%.

Pas këtyre llogaritjeve përforcohet bindja se kërkesat, udhëzimet kontabël dhe raportimi financiar sipas standardeve janë të nënvlerësuara në raport me rregullimet fiskale.

Gjithashtu shihet qartë gjatë analizës se nëse pyetjet kanë të bëjnë me çështje të praktikës së përditshme të raportimit financiar, orientimi është tatimor ndërsa për çështje të tjera të standardeve, jo të aplikueshme në praktikën e biznesit shqiptar, orientimi është në një masë të konsiderueshme i saktë. Kjo tregon se pavarësisht sa njihen standardet kultura e raportimit është ajo tatimore.

Nisur nga këto përfundime të seksionit të tretë të pyetësorit është me vend të thuhet se seti i raportimit financiar nuk është fokusi i përgatitësve të pasqyrave financiare prandaj është irelevante çështja e adoptimit të një seti të ri financiar sepse dhe SNRF për NVM, ashtu si ka dalë nga matricat krahasuese është në linjë me SKK-të për sa i përket modeleve të njohjes, matjes dhe vlerësimit kontabël me disa përjashtime të parëndësishme për zhvillimet aktuale të biznesit shqiptar.

Një tjetër përfundim i rëndësishëm i analizës është dhe treguesi i përgjithshëm i saktësisë, rreth 50%. Ky tregues është mesatarja e thjeshtë e përqindjeve për të 37 pyetjet.

$$\frac{7 * 74.92\% + 12 * 26.76\% + 18 * 56.48\%}{\text{Gjithsej } 37} = 50.33\%$$

Numrat janë kokëfortë, sido që t'i rrotullosh, vetëm tek e vërteta të çojnë. Mesatarja e përgjithshme e saktësisë është 50.33% ndërsa shpërndarja probabilitare e saj është e madhe. Le t'i referohemi në analizë pyetjeve që kanë të bëjnë me çështje të

njohjes, matjes dhe rivlerësimit të mëpasshëm. Nga mesatarja e ponderuar e përgjigjeve të pyetjeve të ndara në dy grupet e para kemi këto llogaritje:

$$\frac{7 * 74.92\% + 12 * 26.76\%}{19} \approx 44.5\%$$

Pra përsëri gjejmë një shifër jo larg mesatares së përgjithshme 50.3%, megjithëse më të ulët, por janë larg nga njëra tjetra përqindjet sipas grupeve, njëra rreth 75% dhe tjetra rreth 27.%. Kjo forcon bindjen që shkalla e saktësisë 50.3% nuk vjen si pasojë e njohjes në nivel mesatar të të gjithë standardeve por për shkak se në një pjesë të tyre trajtimi është i njëjtë me atë fiskal.

Në fund desha të tërheq vëmendjen dhe për faktin e rëndësishëm se këta tregues pesimist janë marrë në një kampion elitar profesionistësh ku përveç të tjerash, në 94% të rasteve kanë mbi 5 vjet eksperiencë punë ose më ngushtë akoma 32% e tyre kanë mbi 15 vjet punë. Po t'i shkojmë logjikës së shkallëzimit të dijeve sipas edukimit dhe kualifikimit profesional, një tjetër kampion me një përzjerje tjetër, ku të bën pjesë profesionistë të praktikës me arsim dhe kualifikim më të ulët atëherë pritet që rezultatet të jenë më ulta akoma, gjë që tregon se seti aktual i raportimit financiar njihet në një shkallë akoma më modeste dhe se mundësia për një hap tjetër të madh, i konsideruar në teori si i dobishëm, atë të kalimit në SNRF për NVM, shkon drejt zeros referuar gjithë popullatës së hartuesve të pasqyrave financiare.

Megjithatë për të mos paragjykuar asnjë nën grup të kampionit thellova analizën duke bërë mesataren e përgjigjeve të dhëna vetëm nga EKR, vetëm nga KM dhe në fund përgjigjet vetëm të ekonomistëve të thjeshtë, ku gjithnjë përgjigjet janë të grupuara sipas të njëjtës logjike të ndjekur për gjithë kampionin.

Auditues

- Grupi i parë – Pyetjeve që kanë përgjigje të njëjtë me trajtimin fiskal, gjithsej 7, EKR i'u përgjigjën me një mesatare të saktësisë 78.05%;
- Grupi i dytë - Pyetjeve që kanë përgjigje të ndryshme nga trajtimi fiskal, gjithsej 12, EKR i'u përgjigjën me një mesatare të saktësisë 28.78%
- Grupi i tretë – Pyetjeve, përgjigjet e të cilave nuk kanë të bëjnë me një trajtim kontabël apo fiskal, gjithsej 18, EKR i'u përgjigjën me një mesatare saktësie 60.81%

$$\text{Mesatarja e përgjithshme} = \frac{7 * 78.05\% + 12 * 28.78\% + 18 * 60.81}{37 \text{ pyetje}} = 53.68\%$$

Mesatarja e dy grupeve të para është:

$$\frac{7 * 78.05\% + 12 * 28.78\%}{19} = 46.93\%$$

Kontabilistë të miratuar

- Grupi i parë – Pyetjeve që kanë përgjigje të njëjtë me trajtimin fiskal, gjithsej 7, KM i'u përgjigjën me një mesatare të saktësisë rreth 69.89%;

- Grupi i dytë - Pyetjeve që kanë përgjigje të ndryshme nga trajtimi fiskal, gjithsej 12, KM i'u përgjigjën me një mesatare të saktësisë 25.87%;
- Grupi i tretë – Pyetjeve, përgjigjet e të cilave nuk kanë të bëjnë me një trajtim kontabël apo fiskal, gjithsej 18, KM i'u përgjigjën me një mesatare saktësie 48.24%

$$\text{Mesatarja e përgjithshme} = \frac{7 * 69.89\% + 12 * 25.87\% + 18 * 48.24\%}{37 \text{ pyetje}} = 45.08\%$$

Mesatarja e dy grupeve të para është:

$$\frac{7 * 69.89\% + 12 * 25.87\%}{19} = 42.09\%$$

Ekonomistët e thjeshtë

- Grupi i parë – Pyetjeve që kanë përgjigje të njëjtë me trajtimin fiskal, gjithsej 7, Ekonomistët i'u përgjigjën me një mesatare të saktësisë rreth 66.4%;
- Grupi i dytë - Pyetjeve që kanë përgjigje të ndryshme nga trajtimi fiskal, gjithsej 12, Ekonomistët i'u përgjigjën me një mesatare të saktësisë 14.63%;
- Grupi i tretë – Pyetjeve, përgjigjet e të cilave nuk kanë të bëjnë me një trajtim kontabël apo fiskal, gjithsej 18, Ekonomistët i'u përgjigjën me një mesatare saktësie 19.84%

$$\text{Mesatarja e përgjithshme} = \frac{7 * 66.4\% + 12 * 14.63\% + 18 * 19.84\%}{37 \text{ pyetje}} = 26.96\%$$

Mesatarja e dy grupeve të para është:

$$\frac{7 * 66.4\% + 12 * 14.63\%}{19} = 33.7\%$$

Në mënyrë të përmbledhur rezultate paraqiten si më poshtë:

Tabelë 5.2 – Mesataret e përgjigjeve të sakta të ndara në tre nëngrupe

	Grupi i parë	Grupi i dytë	Grupi i tretë	Mesatarja
EKR	78.05	28.78	60.81	53.68
KM	69.89	25.87	48.24	45.08
Ekonomistë	66.4	14.63	19.84	26.96

Tabelë 5.3 – Mesataret e përgjigjeve të sakta të ndara në dy nëngrupe

	Grupi i parë	Grupi i dytë	Mesatarja
EKR	78.05	28.78	46.93
KM	69.89	25.87	42.09
Ekonomistë	66.4	14.63	33.7

Në të tre nënkampionët, mesatarja e pjesshme është afër mesatares së përgjithshme por amplituda e mesatareve të dy grupeve të para të pyetjeve është shumë e madhe. Pra llogaritjet konfirmojnë që njohuritë mbi standardet janë shumë nën nivelin mesatar dhe dominojnë njohuritë e mira për rregullimin fiskal.

Gjithashtu një tjetër përfundim del nga kjo analizë. Po të vërejmë mesataret e grupit të tretë të pyetjeve, tek nënkampioni i Ekonomistëve të thjeshtë në njësitë ekonomike, gjejmë mesataren më të ulët. Ky fakt tregon se në shkollimin e tyre Universitar ata nuk kanë marrë dije të mira rreth standardeve të kontabilitetit, pavarësisht se në kurikula kjo lëndë është më së miri e përshkruar. Ndërsa, ishte i pritshëm rezultati që nënkampioni i EKR dhe KM të kishte një mesatare të saktësisë më të lartë pasi këto dy nënkampione i nënshtrohen provimeve të licensimit profesional dhe patjetër që janë në kontakt me literaturën bazë të standardeve të kontabilitetit.

Madje është i justifikueshëm dhe fakti tjetër që EKR për grupin e dytë dhe të tretë të pyetjeve kanë një mesatare më të lartë se KM kjo për faktin se ky grup profesionistësh është gjithnjë në detyrimin profesional të kualifikimit të vazhdueshëm. Një deduksion logjik do të ishte që trajnimet që organizojnë shoqatat profesionale për KM nuk e mundësojnë realisht trajnimin për raportimin financiar dhe rezultati është një shkallë dije mesatare për standardet konsiderueshëm nën nivelin mesatar.

Një analizë e fundit lidhur me reagimet për pyetjet e pyetësorit, seksioni i tretë, tregon se grupi i tretë i pyetje të cilat nuk hasen shumë në praktikën e përditshme të bizneseve ka shkallën më të ulët të reagimit. Ndër 18 pyetjet e këtij seksioni, 10 prej tyre kanë një shkallë reagimi 30-50%, 2 pyetje kanë reagim më pak se 70% dhe 6 pyetjet e tjera kanë një reagim të kënaqshëm mbi 80%. Kjo tregon se 10/18 e pyetjeve pothuaj nuk njihen fare ekonomistët e thjeshtë dhe jo më shumë se 40% e dy nënkampionëve të tjerë u kanë dhënë përgjigje, të saktë apo të gabuar, kjo e fundit në përqindje më të lartë.

****Në fund të analizës së bërë për shkallën e përgatitjes profesionale të përgatitësve të pasqyrave financiare, kalimi në një set të ri raportimi kur përgatitësit akoma nuk kanë asimiluar setin ekzistues, do të ishte vetëm një hap fallco drejt cilësisë së pasqyrave. Profesionistët nuk mund të hartojnë pasqyra cilësore nëse nuk marrin trajnimet e duhura dhe kohën e nevojshme për t'u familiarizuar me një set të ri të raportimit financiar. Vlen të përsëritet fakti se u shtojmë përgatitësve barrën të njihen me një standard të ri 230 faqe, 35 seksione nga të cilat 6 janë të papërdorshme dhe për më tepër nuk u ofrohet aktualisht asnjë material udhëzues në zbatim të SNRF për NVM.*

Për më tepër nuk mund të pretendohet që SNRF për NVM do të rrisë transparencën e pasqyrave financiare, krahasuar me SKK-të, kur për hartimin e pasqyrave financiare, referuar kampionit në analizë, bëhet kontabilitet tatimor.

5.4 Analiza në aspektin ekonomik

5.4.1 Përdoruesit e pasqyrave financiare

Analiza do të bëhet mbi gjetjet nga pyetësi me përgatitësit e pasqyrave financiare dhe intervistat e zhvilluara me përdoruesit e pasqyrave financiare. Gjithashtu analiza do të bëhet në dritën e pyetjes së madhe të punimit, nëse adoptimi i SNRF për NVM ndikon që përdoruesit e pasqyrave financiare të marrin vendime ekonomikisht më të mira.

Në rrafshin teorik pranohet se përdoruesit e pasqyrave financiare të ndërtuara sipas SNRF-ve të plota janë një rreth më i gjerë se ai i përdoruesve të pasqyrave të NVM-ve. Të dytët, në teori limitohen në ofruesit e financimeve, pronarët jomenaxherë, investitorët potencialë, zyra e tatim taksave dhe më të rrallë klientët, furnitorët apo të punësuarit në njësinë ekonomike, këta të fundit për çështje të sigurisë së kontratave të punësimit. Të gjithë këta përdorues janë përdorues të jashtëm dhe mbështesin vendimet e tyre mbi pasqyrat financiare të njësisë ekonomike. Për të kuptuar nëse teoria gjen zbatimin në praktikën e bizneseve shqiptare:

- në pyetësin me përgatitësit, u vendos dhe një seksion për opinionet e tyre lidhur me çështjen se cilët janë përdoruesit e pasqyrave që ata hartojnë për njësinë ekonomike,
- u intervistuan 10 individë në cilësinë e pronarëve jomenaxherë të njësisë ekonomike të ndryshme, me aktivitet në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe të madhësive të ndryshme, por ku dominojnë ato të mesme, më pak të vogla dhe asnjë mikro;
- u intervistuan analistët e kredive pranë 16 institucioneve financiare;
- u intervistuan 4 përfaqësues të administratës tatimore.

5.4.1.1 Analiza e përdoruesve pronarë jomenaxherë të pasqyrave financiare

Për pyetjen e parë të seksionit të katërt të pyetësit, ku përgatitësisve i'u kërkua të listojnë përdoruesit e pasqyrave financiare në njësinë ekonomike ku ata gjenerojnë pasqyrat, të dhënat në përqindje paraqiten si më poshtë (klasifikimi është bërë sipas peshës specifike të numrit të reagimeve):

Rezulton se përdorues **të shpeshtë** të pasqyrave financiare janë inspektorët tatimorë (100%), shoqëritë e lizingut (100%), financuesit e fondeve (92%) dhe Këshillat mbikqyrës (84%).

Rezulton se përdorues **të rrallë** të pasqyrave financiare janë aksionerët (52%), investitorët privat (56%), agjencitë shtetërore rregullatore (54%), analistët financiarë (59%), konkurentët (62%), shoqëritë e sigurime (58%) dhe zyrat e avokatisë (52%).

Rezulton se **nuk janë** përdorues pasqyrave financiare agjencitë e akreditimit të biznesit, akademikët, furnitorët, gazetarët, klientët, sindikatat dhe të punësuarit.

Nëse shohim grupin e parë “përdorues të shpeshtë”, si grupi më kryesor që përbën interes në punim, përputhet në një pjesë të mirë rezultati i pyetësorit me teorinë, lidhur me faktin se përdorues kryesorë të pasqyrave financiare janë inspektorët tatimorë, bankat & shoqëritë e lizingut dhe të tretë janë këshillat drejtues por *nuk provohet teoria e pronarëve jomenaxherë* si përdorues të këtyre pasqyrave. Aksionerët dhe investitorët, i gjejmë tek opsioni “rrallë” respektivisht 52% dhe 56%, pasuar ky rezultat nga opsioni “ndonjëherë” 41% dhe 42%.

Përfundimet e dala nga pyetësi në fakt janë në linjë me gjetjet nga intervistat e zhvilluara me 10 pronarë jomenaxherë të njësive të ndryshme ekonomike. Po shkëpus një pjesë nga kapitulli i gjetjeve: *“...për pronarët/aksionerët në vendimmarrjen ekonomike rëndësi më të madhe kanë raportet narrative sesa pasqyrat financiare, qofshin dhe ato jo të përgatitura për zyrën e tatimeve”*.

Për të thelluar më tej analizën lidhur me këtë mospërputhje me teorinë dhe literaturën, përgjigjet e seksionit të katërt i kam kryqëzuar me të dhënat e seksionit të parë ku merret informacion për disa karakteristika të njësive ekonomike.

Nga informacioni i mbledhur në seksionin e parë, vërej se 52% e përgjigjeve që janë dhënë për opsionin “rrallë”, lidhur me aksionerët si përdorues të informacionit financiar, është dhënë nga 61 (gjithsej 118) të anketuar ku 44 janë profesionistë që hartojnë pasqyra për njësi ekonomike me shifër afarizmi 50 - 250 milionë lekë dhe 17 të tjerë hartojnë pasqyra për njësi me shifër afarizmi mbi 250 milionë lekë. Përsa i përket numrit të të punësuarve statistika tregon se 61 të anketuarit ishin të shpërndarë, 4 në njësi me mbi 50 të punësuar dhe 57 të tjerët në njësi me më pak se 50 të punësuar.

I njëjti trend vërehet dhe për treguesin që i përket investitorëve. Niveli 56% i përgjigjet numrit 66 të të anketuarëve ku 54 profesionistë hartojnë pasqyra me shifër afarizmi 51- 250 milionë dhe 12 të tjerë hartojnë pasqyra me shifër afarizmi mbi 250 milionë lekë. Referuar të punësuarve, të 66 përgjigjet “rrallë”, vijnë nga njësi ekonomike me më pak se 50 të punësuar .

Interesant në analizë është fakti që për aksionerët si përdorues “të shpeshtë” janë shprehur 4 profesionistë (nga 118) të cilët përgatisin pasqyra të njësive me xhiro afarizmi mbi 250 milion lekë por me të punësuar jo më shumë se 50. Ndërsa për investitorët nuk kemi asnjë reagim në opsionin “shpesh”. Këto statistika provojnë një tjetër detaj të teorisë ekzistuese, që sa më e vogël të jetë njësia ekonomike aq më e vogël është dhe varësia e vendimeve të pronarëve tek pasqyrat financiare dhe e kundërta.

Forcohet bindja se teoria gjen zbatim dhe në praktikën shqiptare për sa i përket mosvarësisë së vendimmarrjes në njësitë më të vogla, tek pasqyrat financiare sepse 4% e të anketuarëve që kanë dhënë përgjigjen “Asnjëherë” për aksionerët dhe 1.7 % të anketuarëve që kanë dhënë përgjigjen “Asnjëherë” për investitorët, janë të gjithë profesionistë në njësi ekonomike me një shifër afarizmi më të vogël se 10 milion lekë dhe më pak se 5 të punësuar.

Në dritën e gjetjeve nga intervistat dhe pyetësorët analiza shkon më tej. Në kapitullin e rishikimit të literaturës u vërejt se pranohet në teori që kultura e një kombi është një nga faktorët e rëndësishëm që përcakton kontabilitetin dhe raportimin financiar të atij vendi. Nga intervista me përdoruesit, konstatohet se kultura e raportimit në vendin tonë është ajo tatimore. Një gjë e tillë provohet edhe nga numrat e pyetësorit. Në 81 përgjigje (gjithsej 132) pra në 61% të përgjigjeve vërehet se përgatitësit janë më të informuar dhe të kujdesshëm ndaj legjislacionit dhe rregullimeve fiskale. Në këto kushte, të kulturës tatimore të raportimit, është i shpjgueshëm fakti përse aksionerët dhe investitorët nuk kualifikohen si përdorues të

informacionit financiar. Ata nuk mund të marrin vendime ekonomike, përveç se të firmosin vendimin e asamblesë çdo datë 30 qershor për ndarjen e fitimit, i cili në fakt është llogaritur mbi pasqyra që ndërtohen kryesisht për qëllime tatimore. Kjo e bën të parëndësishëm në aspektin ekonomik faktin e adoptimit të një seti tjetër të raportimit financiar. SNRF për NVM nuk do të çonte në vendime më të mira ekonomike sepse pasqyrat e ndërtuara me këtë standard nuk janë baza e vendimmarrjes.

Gjetjet tregojnë se pronarët jo menaxherë nuk i mbështesin vendimet e tyre tek pasqyrat financiare. Sidomos absolutizohet ky fakt në grupin e NVM-ve me më pak se 50 të punësuar dhe shifër afarizmi më pak se 250 milionë lek. Si përfundim, referuar gjetjeve por referuar edhe teorisë, NVM-të e vogla dhe të mesme e kanë të dobët lidhjen mes pasyrave dhe vendimeve ekonomike. Në kushtet kur në Shqipëri, njësitë ekonomike, person fizik¹⁶, janë 84.955 kundrejt 111.083 njësi gjithsej, pra në nivel 76%, atëherë, është i parëndësishëm fakti nëse zbatohen SKK-të apo SNRF për NVM. Pasqyrat në vetvete nuk janë baza e vendimmarrjes për këto NVM e për rrjedhojë nuk mundën ato të përmirësojnë vendimmarrjen ekonomike edhe nëse prezumohet se një set tjetër raportimi financiar është më cilësor se seti aktual, SKK-të (fakt i kundërshtuar në seksionin përkatës të analizës).

5.4.1.2 Analiza e institucioneve financiare si përdorues të pasqyrave financiare

Në analizën e përdoruesve është rasti të thuhet se gjithashtu provohet përfundimi teorik që bankat & shoqëritë e lizingut janë ndër përdoruesit kryesorë të informacionit financiar. Kjo vërtetohet nëpërmjet numrave që dalin nga përpunimi i pyetësorit por referuar intervistave me bankat dhe shoqëritë e lizingut evidentohen shmangje nga teoria, të lidhura këto gjithësesi me kulturën e raportimit dhe së dyti me nivelin profesional analistëve të pasqyrave financiare të punësuar nëpër banka.

Duket befasuese që vetëm rreth gjysma e institucioneve i përdorin në mënyrë të konsiderueshme pasqyrat financiare të hartuara në përputhje me SKK-të kur ka pak thellësi në të kuptuarit e kërkesave të standardeve. Kishte një ndryshim të rëndësishëm në profilet e të kuptuarit të bankave dhe shoqërive të lizingut siç tregohet në Tabelën 5.4 më poshtë.

Tabelë 5.4 – Niveli i të kuptuarit të SKK-ve nga institucionet financiare

Niveli i të kuptuarit	Bankat	Shoqëritë e lizingut	Totali
I mirë	14%	40%	21%
Mesatar	79%	20%	63%
I dobët	0%	0%	0%
Jo i sigurt	7%	40%	21%
TOTALI	100%	100%	100%

¹⁶ Shih Aneks 1 -

Vetëm 14% e bankave (2 institucione) e vlerësonin të kuptuarin e SKK-ve si të mirë, ndërkohë që pjesa më e madhe e tyre e vlerësonin të kuptuarin si mesatar. Nivelet relativisht të ulta të të kuptuarit të SKK-ve tregojnë se analistët e kredisë nuk do të jenë në gjendje të marrin potencialin maksimal të informacionit nga pasqyrat financiare të klientëve të tyre edhe për disa kohë mbas përfundimit të këtij punimi.

Për këtë arsye, nëse pasqyrat financiare duhet një ditë të jenë një bazë e rëndësishme e vendimmarrjes në sigurimin e financimit, është e qartë se njohuritë e përdoruesve të pasqyrave financiare duhet të përmirësohen.

Pothuajse gjysma e institucioneve raportuan se pasqyrat financiare të audituara të hartuara sipas SKK-ve nuk luanin një rol të rëndësishëm në vendimet e tyre të huadhënies. Arsyet e dhëna për këtë ishin se:

1. pasqyrat financiare nuk ishin në përputhje me SKK-të, duke përmenduar raste kur mungonte pasqyra e fluksit të parasë dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare; ose
2. pasqyrat financiare nuk përmbanin shifrat “e vërteta”, ku bankat shprehnin pikëpamjen se pasqyrat financiare të audituara nuk pasqyrojnë të gjithë fitimin, zmadhojnë vlerën e inventarit, pakësojnë aktivet dhe nuk pasqyrojnë në mënyrë të saktë koston e shitjeve.

Këto rezultate pasqyrojnë evidencën jo të besueshme të disponueshme nga bankat dhe shoqëritë e lizingut, por ndoshta më shqetësues është fakti që 95% e institucioneve financiare raportuan se ata asnjëherë ose rrallë herë kishin hasur raporte të kualifikuara të audituesve në pasqyrat financiare të klientëve të tyre. Rezultati përfundimtar i kësaj është se përdoruesit e pasqyrave financiare, rasti i bankave dhe shoqërive të lizingut nuk kanë besim në pasqyrat financiare të hartuara në përputhje me SKK-të.

Ka një konsensus në opinion midis institucioneve financiare dhe ai është se njësitë ekonomike kanë efektivisht tre grupe shifrash, nga të cilat asnjë nuk pasqyrohet në pasqyrat financiare të audituara. Ato janë:

1. **Pasqyrat për tatimet** – që priren të minimizojnë fitimin në mënyrë që të reduktohet barra tatimore mbi njësinë. Bankat u shprehën se këto pasqyra priren të zvogëlojnë fitimin dhe të zmadhojnë shpenzimet;
2. **Pasqyrat e përgatitura për bankën** – që priren të maksimizojnë fitimin e njësisë dhe perceptohen nga bankat sikur shfaqin një pamje shumë optimiste të performancës;
3. **Pasqyrat për drejtimin** – që japin një pasqyrim më të mirë të performancës së njësisë, por nuk janë në përputhje me SKK-të.

Si rezultat, bankat kanë zhvilluar procedurat e tyre për të vlerësuar përfitueshmërinë dhe aftësinë huamarrëse të klientëve pa u mbështetur në pasqyrat financiare të audituara. Një pasojë negative për raportimin financiar në Shqipëri e kësaj situatë do të jetë për një periudhë të gjatë kohe që nuk do të ketë kërkesë reale për pasqyra financiare të audituara të hartuara në përputhje me SKK-të nga furnizuesit e burimeve kryesore të financimit për bizneset shqiptare dhe si rezultat nuk do të ketë nxitje reale për njësitë për të zbatuar në mënyrë të vazhdueshme SKK-të në përgatitjen e pasqyrave financiare. Kjo duket sikur ka krijuar një rreth vicioz ku bankat nuk kërkojnë pasqyra financiare të audituara, duke çuar në një situatë në të cilën njësitë ekonomike e konsiderojnë përgatitjen dhe auditimin e pasqyrave financiare si të parëndësishëm për nevojat e tyre operative.

****Në përfundim të analizës për përdoruesit **banka dhe shoqëri lizingu** kemi një asimetri. Njësitë ekonomike i konsiderojnë bankat përdorues të pasqyrave financiare (por të pasqyrave të destinuara për bankën) ndërsa bankat dhe shoqëritë e lizingut nuk u besojnë këtyre informacioneve dhe ndërtojnë sistemet e tyre “mbrojtëse”. Një prej masave që merren nga bankat dhe shoqëritë e lizingut janë informacionet shitesë përveç pasqyrave financiare. Këtë fakt e mbështet nga ana tjetër edhe përgjigja e pyetjes përkatëse në pyetësor ku 98 nga 104 reagime thonë se institucionet e kreditimit kërkojnë **gjithmonë** informacione të tjera shitesë për të mbështetur vendimet e tyre të kredi dhënies. Pra adoptimi i SNRF për NVM nuk përmirëson vendimet ekonomike të institucioneve financiare.*

5.4.1.3 Analiza e intervistave me përfaqësuesit tatimorë

Grupi tjetër i rëndësishëm i përdoruesve sipas përgatitësve të pasqyrave financiare janë **tatimorët** (nëpunësit e administratës tatimore). Tek gjetjet e pyetësorit është vërejtur se të gjithë të anketuarit i kanë klasifikuar tatimorët tek përdoruesit e shpeshtë. Mbështetet kështu plotësisht përfundimi teorik që tatimorët janë përdorues të pasqyrave financiare. Gjithashtu, edhe referuar intervistave me tatimorët, evidentohet se pavarësisht faktit se sa të besueshme mund të jenë këto pasqyra financiare, gjithësesi mbeten i vetmi burim i të dhënave financiare për zyrën e tatimeve. Në vlerësimin e tyre, elementët më të manipuluar janë pa diskutim ato që gjenerojnë detyrime për tatime dhe taksa. Besimin e tatimorëve që pasqyrat tatimore janë të manipuluar e provon dhe një nga përgjigjet e pyetësorit. Pyetjes nëse janë të interesuar tatimorët të kontrollojnë zbatueshmërinë e SKK-ve, 82 nga 132 reagues i'u përgjigjën “aspak”. Kjo përgjigje përlligjet pjesërisht me faktin që ata nuk besojnë në këto pasqyra prandaj i qëndrojnë rigoroz vetëm rregullimeve fiskale por nga ana tjetër, ashtu si del nga intervistat me tatimorët, shkalla e njohjes së SKK-ve prej inspektorëve tatimorë është e ulët për arsyet që janë renditur tek kapitulli i gjetjeve. Inspektorët tatimorë nuk rekrutohen sipas aftësisë, inspektorët tatimorë nuk trajnohen për standardet dhe së fundi inspektorët tatimorë kanë në shumë raste probleme me etikën në sjelljen profesionale me bizneset (marrëdhënie korruptive).

****Duke marrë në konsideratë sa më sipër, është logjik përfundimi që seti i aplikueshëm i raportimit financiar kalon në dorë të dytë madje nuk shfaq interes pasi kontrolli i pasqyrave financiare apo përdorimi i pasqyrave financiare nga administrata tatimore bëhet krejtësisht e mbështetur në rregullimin fiskal duke nënvlerësuar atë sipas standardeve.*

Në analizën e bërë për secilin grup të përdoruesve të pasqyrave financiare del qartë që vendimet e tyre ekonomike merren mbi pasqyra financiare të ndryshme. Në asnjë nga intervistat e bëra me bankat, pronarët apo tatimorët nuk shihet problemi i cilësisë dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare i lidhur me setin e raportimit financiar por me manipulimin e shifrave të këtyre pasqyrave sipas interesave të biznesit. Pra seti i raportimit financiar nuk është përcaktues në cilësinë e vendimeve ekonomike të këtyre përdoruesve dhe nuk është vlerë e shtuar në aspektin ekonomik, që do të thotë se një set tjetër nuk do të mundësojë përfitime ekonomike nga vendime më të mira.

5.4.2 Analiza kosto përfitim

Sipas eksperiencës njerëzore asnjë sistem kontabël apo çfarëdo sistemi qoftë, nuk mund të vlerësohet nëse është më i mirë se një tjetër derisa të jetë provuar në praktikë. Por një gjë është e sigurtë që adoptimi i një regjimi të ri raportimi financiar do të shoqërohet me kosto. Nga intervistat me pronarët jomenaxherë të njësive ekonomike, bankat, tatimorët dhe akademikët evidentohet se kostot do të jenë në kohë, në energji dhe në para, në një mënyrë ose tjetër për të gjitha palët e përfshira në proces:

- do të kërkohej kosto në para për trajnime që të kuptohet dhe zbatohet seti i ri i standardeve në mënyrën e duhur nga përgatitësit në njërën anë dhe nga përdoruesit në anën tjetër;
- njësitë ekonomike do të kontraktojnë (kosto në para) një shoqëri kontabiliteti për të asistuar rideklarimin e pasqyrave financiare;
- në disa njësi ekonomike të mesme afër kufirit të sipërm do të lindë edhe nevoja (kosto në para, kohë dhe energji) e ndryshimeve të manualeve të drejtimit dhe kontrollit të brendshëm;
- bankat dhe shoqëritë e lizingut do të përballen me kosto të reja sepse do të përshtasin sistemet dhe metodologjinë e tyre të vlerësimit të dosjeve të kredive, përfshirë analizën e pasqyrave financiare;
- do të ketë kosto të përhershme në para për njësitë më të mëdha në grupin e NVM-ve sepse ato do të prirën të pajtojnë profesionistë me kopetencë më të mira lidhur me raportimin financiar ndërkombëtar;
- do të ketë kosto për njësitë ekonomike në kohë për përshtatjen e software-ve dhe formateve të raportimit financiar;
- do të ketë kosto në kohë dhe në energji për njësitë ekonomike sepse SNRF për NVM kërkon më shumë shënime shpjeguese;
- do të ketë kosto në administratën shtetërore sepse duhet investuar në kohë dhe energji për përshtatjen e legjislacionit fiskal, atij të raportimit financiar dhe legjislacioneve të tjera integrale që preken nga adoptimi i SNRF për NVM;
- do të jetë kosto në para, kohë dhe energji për shoqatat profesionale të cilat do të duhet të hartojnë materiale trajnime, ose të përkthejnë ato ekzistuese të SNRF për NVM;
- do të jetë kosto në kohë, energji dhe para përgatitja ose përshtatja e teksteve universitare të lidhura direkt ose indirekt me raportimin financiar.

Nga analiza e pyetësorëve me përgatitësit e pasqyrave financiare evidentohet se ata e vlerësojnë koston fillestare të adoptimit të SNRF për NVM në 72% të përgjigjeve në masën nga 200 deri në 400 mijë lekë. Duke marrë në konsideratë që përgatitësit kanë patur parasysh vetëm kostot në para që duhet të përballojë njësia, kuptohet që në nivel makro duke përfshirë edhe kostot e përmendura më lart të të gjithë palëve të interesuara në proces, atëherë mund të thuhet me bindje se është një proces i kushtueshëm.

Megjithatë kostot duhen vlerësuar kundrejt përfitimeve. Në intervistat me bankat nuk u paraqit ndonjë argument në lidhje me përfitimet që mund të kenë ata si përfitues nëse njësitë ekonomike do të raportojnë me SNRF për NVM kundrejt SKK-ve. Megjithatë akademikët vlerësuan se bankat janë ndër palët e interesuar të adoptimit të SNRF për NVM pasi personeli i huaj i tyre do të lehtësohej nëse do të zbatohet një standard ndërkombëtar për të cilin ata mund të kenë kopetencë të

mjaftueshme. Por në analizën e bërë të intervistave me bankat ky përfitim duket pothuaj i pamundur për sa kohë problemi i bankave është besueshmëria në nivel bazë, në atë nëse pasqyrat janë të vërteta. Në pyetësorin me tatimorët gjithashtu nuk u paraqit ndonjë argument në terma të përfitimit nëse kalohej në një regjim të ri të raportimit financiar.

Nga intervistat me akademikët evidentohet se përfitimet do të burojnë por në terma afatgjatë. Më së shumti përfitimet do të jenë të lidhura me perspektivën e bizneseve shqiptare për t'u rritur në 10 vitet e ardhshme dhe si të tilla do të kenë ambicien të hidhen në tregje të reja përtej kufijve ose të kërkojnë financime ndërkombëtare. Ky hap i zhvillimit cilësor të bizneseve duhet shoqëruar domosdoshmërisht edhe me standardizimin e raportimit financiar. Por kjo pritshmëri e akademikëve nuk provohet nga pyetësori dhe statistikatat e INSTAT të vitit 2013 për madhësinë e njësive ekonomike. Njësitë tona janë akoma larg mundësive për t'u bërë atraktive në tregje të huaja apo për të thithur investime dhe financime të huaja të niveleve që kërkojnë domosdoshmërisht globalizim të raportimit financiar. Sa më sipër mbështetet në analizën e të dhënave në paragrafin pasardhës.

Nga pyetësori evidentohet se 63% e njësive ekonomike të kontaktuara kanë një shifër afarizmi deri në 250 milion lekë, 97% e tyre kanë më pak se 50 të punësuar dhe 91% e tyre kanë një aktiv të bilancit jo më të madhe se 250 milionë lekë. Provohen rezultatet e pyetësorit lidhur me shpërndarjen e njësive sipas numrit të të punësuarve edhe po t'i referohemi statistika të INSTAT të paraqitura në Aneksin 1 të punimit. Nga 111.083 njësi ekonomike vetëm 1.406 kanë mbi 50 të punësuar, pjesa tjetër prej 98.7 % kanë më pak se 50 veta personel. Gjithashtu, prej 111.083 njësive ekonomike vetëm 4% e tyre (3.811 njësi ekonomike) janë me kapital të huaj ose të përbashkët¹⁷ gjë që tregon një trend të ulët të futjes së investimeve të huaja në Shqipëri.

Një tjetër përfitim i përmendur nga akademikët është fakti se studentët tanë ose profesionistët tanë të praktikës do të mund të lëvizin dhe transferojnë studimet apo shërbimet e tyre jashtë kufijve të vendit tonë. Ky është një përfitim por në nivel individual pasi në nivel kombëtar këtu flasim për eksport të trurit dhe jo import të trurit, teknologjisë dhe fondeve. Në terma afatshkurtër i vetmi përfitim është vetëm marrëdhënia mes tregjeve të dy territoreve shqiptare Shqipëri - Kosovë. Nëse të dy shtetet tona do të kishin një set të njëjtë raportimi, atëherë do të ishte më i lehtë transferimi i dijeve, kapitaleve dhe teknologjisë mes dy shteteve dhe në këtë rast nuk flasim për eksporte apo importe pasi gjithçka mbetet brenda territorit ku jetojnë dhe banojnë shqiptarë.

****Parë në këndvështrimin kosto përfitim, nuk justifikohet adoptimi i SNRF për NMV sepse janë të shumta dhe të konsiderueshme të gjitha kostot e listuara përkundrejt përfitimeve potenciale, që për më tepër pritet të jenë të zhvendosura gjatë në kohë.*

5.4.3 SKK-të vs. SNRF për NVM

Matricat krahasuese, intervistat dhe pyetësori, të gjithë këto instrumente kërkimi u shfrytëzuan për të kuptuar nëse ka realisht një vlerë të shtuar të raportimit financiar me SNRF për NVM krahasuar me SKK-të.

¹⁷ <http://www.instat.gov.al/al/themes/regjistri-statistikor-i-nd%C3%ABrmarrjeve.aspx>

Në të gjitha aspektet e analizuara vërehet se nuk ka një vlerë të shtuar praktike dhe të matshme për të paktën 10 vitet që vijnë. Megjithatë në analizën time jam fokusuar edhe në një dimension tjetër. Fakti që standardet kombëtare nuk njihen mjaftueshëm, fakti që asnjë palë e interesuar nuk pret që të përfitojë nga adoptimi i SNRF për NVM për argumente të dhënë dhe analizuar në kapituj përkatës si dhe fakti që kultura e raportimit financiar është e orientuar drejt rregullimeve fiskale, kam bërë dhe një tjetër kryqëzim të të dhënave të pyetësorit me ato të intervistave.

Sipas pyetësorit, pyetjes lidhur me qëndrimin ndaj filozofisë së standardeve të raportimit financiar, 66% e të anketuarëve ishin në favor të standardeve të mbështetura në rregulla. Mbështet ky përfundim numerik nga intervistat. Në pyetjet e fundit të intervistave me tatimorët, ata u shprehën se janë në favor të standardeve të mbështetura me rregulla sepse kështu do të ishte më e mirë përputhja me legjislacionin fiskal dhe kontrolli do të ishte më i saktë pasi nuk do të kishte vend për diskutime lidhur me gjykimin profesional.

Intervistat me pronarët gjithashtu rezultuan se ata janë të prirur drejt standardeve të mbështetura në rregulla sepse kështu ulet, sipas tyre, mundësia e gabimeve në gjykimin profesional dhe nga njëra anë evitohen gjambat për mos llogaritje të saktë të detyrimeve tatimore dhe nga ana tjetër nuk harxhohet kohë në korrigjimin e gabimeve të mundshme të bëra nga stafi i departamentit të kontabilitetit. Gjithashtu një standard i mbështetur në rregulla është guidë më e përshtatshme për kontrollin dhe më e kuptueshme nga pronarët, nëse kanë një arsim bazë në fushën e ekonomisë.

Intervistat me akademikët treguan të kundërtën. Jo vetëm si njohës të mirë të teorisë që qarkullon sot në nivel ndërkombëtar por dhe si pjesë e mentalitetit të tyre të hapur, akademikët ishin për standarde të mbështetura në parime pasi në këtë mënyrë njësitë ekonomike kanë mundësinë të gjejnë vijën e artë të gjyimit profesional.

Thënë sa më lart, në një mjedis ku dominon qëndrimi në favor të standardeve të mbështetura mbi rregulla, pakësohet mundësia që të jetë e pranueshme një qasje drejt një seti raportimi të mbështetur në parime, madje më i komplikuar në disa raste krahasuar me SKK-të lidhur me ushtrimin e gjyimit profesional.

Provohet kjo dhe nga një e dhënë tjetër e pyetësorit. Mes profesionistëve kanë dijeni për SNRF për NVM rreth 79% e tyre (92/116), ndër ta 84% (78/92) nuk janë të gatshëm të kalojnë në një regjim të ri raportimi financiar. Kjo përgjigje është e mbështetur nga seksioni i tretë i pyetësorit ku evidentohet qartë fakti se njohuritë mbi SKK-të janë larg të qenurit të kënaqshme, e në këto kushte përgatitësit nuk ndjehen të gatshëm të përballen me një tjetër rregullim të ri të raportimit financiar.

Adoptimi i SNRF për NVM, nga analizat përkatëse del jo i pranueshëm si opsion sepse praktikisht nuk sjell as përfitime ekonomike dhe as politike. Gjithashtu, edhe në terma teknik nuk është risi sepse ashtu si SNRF për NVM, edhe vetë SKK-të tona mbështeten në SNRF-të e plota. Mbështetur sa më lart dhe nga fakti që përgatitësit nuk janë profesionalisht gati sepse akoma nuk zotërojnë mirë setin aktual, atëherë e vetmja mundësi që raportimi financiar në vendin tonë të harmonizohet me atë ndërkombëtar, për të paktën 10 vitet që vijnë është përshtatja graduale e SKK-ve tona me SNRF për NVM. Qasja e përshtatshme është që të pranojmë gjithçka që nga njëra anë redukton barrën e raportimit pra thjeshton punën e kontabilistëve në njësitë ekonomike dhe nga ana tjetër sjell përfitime në aspektin ekonomik jo vetëm për njësitë ekonomike por për ekonominë kombëtare në përgjithësi.

Analiza e deritanishme u bë për t'i dhënë përgjigje disa nëpyetjeve të pyetjes së madhe të kërkimit. Këto nënpyetje të çojnë respektivisht në përfundimin "A duhet?" dhe "A mundemi?".

A duhet? - Gjetjet teorike dhe interpretimi i tyre tregon se në aspektin politik nuk duhet të bëjmë një përpjekje të tillë pasi nuk është një vlerë e shtuar as për çështjet e integritetit, as si stimul për nxitjen e investimeve të huaja dhe as kontributon në rritjen e të hyrave në buxhet. Përsëri, referuar aspektit teknik analiza e gjetjeve tregon se dallimet mes SKK-ve dhe SNRF-ve janë aq të pakta në numër dhe aq të vogla për nga rëndësia dhe ndikimi sa e bëjnë të pavlefshëm procesin e adoptimit të plotë të SNRF për NVM. *Me vlerë do të ishte integrimi i këtyre dallimeve tek SKK-të për aq sa shton vlerë së pari në thjeshtimin e SKK-ve dhe së dyti në përafrimin e kuadrit tonë të raportimit me atë ndërkombëtar.* Për t'u bindur plotësisht se realiteti shqiptar të biznesit nuk i shton vlerë një set i ri raportimi vlen gjetja tjetër e analizuar edhe në nivel sasior dhe në nivel cilësor, se përdoruesit e informacionit financiar nuk e shohin si një mundësi të përmirësimit të vendimeve të tyre ekonomike, qofshin ata pronarë, banka apo tatimorë por vetëm si një kosto shtesë për xhepat dhe arkat e tyre.

A mundemi? – Për të kuptuar a është e mundur, dy janë dimensionet që e përcaktojnë. Së pari a janë të gatshëm përgatitësit e pasqyrave financiare të bëjnë këtë kalim drejt SNRF për NVM dhe së dyti a është ekonomikisht e pranueshme, analiza kosto përfitim. Përgatitësit në një përqindje shumë zhgënjyese treguan se nuk njohin akoma mirë SKK-të që kanë 6 vite në treg prandaj nuk është e mundur të kalojnë këtë proces tranzicioni drejt SNRF për NVM pa kaluar më parë një periudhë 3-5 vjeçare trajnimesh dhe njohje me SNRF për NVM. Nga ana tjetër, këto trajnime apo tekste kërkojnë kosto. Biznesi sot në Shqipëri nuk është në ditët e veta më të mira dhe nuk është absolutisht i gatshëm të investojë në këtë proces që për më tepër e konsideron si një investim që frytet potenciale i jep në një periudhë shumë afatgjatë, NVM-të nuk besojnë se suksesi i biznesit, sidomos në madhësinë që kanë sot njësitë ekonomike në Shqipëri, të varet nga cilësia e pasqyrave financiare apo nga seti i raportimit financiar. Gjithashtu, kërkohet një reformë e mirëfilltë ndërgjegjësimi për bizneset që të ndryshojnë kulturën e tyre të raportimit dhe një reformë e tillë kërkon kohë si në hartimin e strategjisë ashtu dhe në implementim. Në një mjedis biznesi ku kultura e raportimit është ajo tatimore është e parakohshme të flitet për modele ndërkombëtare të raportimit financiar.

Në fund të punimit, mbështetet me evidencë cilësore dhe sasiore pohimi kryesor i këtij punimi, paraqitur në kapitullin 1 se ***“Adoptimi i plotë dhe i menjëhershëm i SNRF për NVM në Shqipëri nuk është një vlerë e shtuar e raportimit financiar”.***

Thënë sa më sipër se, disa dallime të SKK-ve me SNRF për NVM janë të dobishme për raportimin financiar në Shqipëri por nuk aspak është i nevojshëm adoptimi i plotë i këtij seti të ri, kombinuar kjo edhe me pamundësinë objektive për ta implementuar këtë standard qoftë sepse kërkon kosto qoftë edhe për faktin se përgatitësit nuk janë profesionalisht gati, atëherë alternativa optimale për t'u ndjekur në këtë rast do të ishte alternativa 3 që shtron si zgjidhje harmonizimin e SKK-ve me SNRF për NVM për aq sa ndryshimet mes tyre thjeshtojnë dhe përmirësojnë standardet kombëtare të kontabilitetit, SKK-të.

KAPITULLI 6 – KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Objektivi i këtij punimi ishte vlerësimi i mundësisë dhe dobishmërisë së adoptimit të SNRF për NVM në Shqipëri. Ky objektivi u realizua pas rishikimit të literaturës në lidhje me këtë çështje dhe më pas analizës së gjetjeve empirike kundrejt kuadrit teorik të ndërtuar pas rishikimit të literaturës. Instrumentet e kërkimit të zgjedhura në punim ishin matricat krahasuese, pyetësorët dhe intervistat. Për arritjen e objektivit u ndërtua qasja e arsyetimit logjik që mundësoi përcaktimin e faktorëve dhe aktorëve të cilët më pas u analizuan në dritën e gjetjeve empirike. Gjetjet empirike cilësore dhe sasore, të analizuar në mbështetje të njëra tjetrës dhe përkundrejt gjetjeve teorike, mundësuan konkluzionet dhe rekomandimet e punimit.

Në fillimet e punimit, pasi kisha parë literaturën ekzistuese mbi çështjen e SNRF për NVM, vura në diskutim pohimin kryesor të punimit pasi mendova se NVM-të dhe përdoruesit e pasqyrave financiare mund të ishin entuziastë dhe ta prisnin me interes adoptimin e SNRF për NVM. Por faktet e mbledhura nga intervistat dhe pyetësorët provuan të kundërtën.

6.1 Përmbledhje e përfundimeve

Përfundimet do të paraqiten të renditura sipas logjikës së ndjekur për arritjen e objektivit të punimit dhe në përgjigje të nënpyetjeve të paraqitura në kapitullin 1. Meqenëse qasja e arsyetimit logjik ndalet në tre aspekte, politik, teknik dhe ekonomik, edhe nënpyetjet e kërkimit u ndërtuan të tilla për të zbërthyer ndikimin e secilit aspekt në përgjigjen e pyetjes së madhe të kërkimit: “A është adoptimi i SNRF për NVM një vlerë e shtuar e raportimit financiar në Shqipëri?”. Thënë këtë, edhe përfundimet më poshtë janë të grupuara sipas secilit prej aspekteve të argumentuara në punim.

Për të vlerësuar vlerën e shtuar të adoptimit të SNRF për NVM, parë në *aspektin politik*, u shtruan tre nënpyetje për të cilat u arrit në përfundimet e përmbledhura si më poshtë:

- *Është adoptimi i SNRF për NVM një parakusht për integrimin e vendit tonë në Bashkimin Evropian?*

Adoptimi i SNRF për NVM nuk është pjesë e axhendës evropiane të integritit të Shqipërisë në BE. Ajo që kërkohet në këtë kontekst është përafrimi me Direktivat e BE dhe jo me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

- *Nxit adoptimi i SNRF për NVM investimet e huaja në Shqipëri dhe një akses më të mirë të njësive ekonomike vendase në financimet e huaja?*

Nuk konfirmohet gjetja teorike se cilësia e pasqyrave financiare nxit investimet e huaja dhe ul riskun e transferimit dhe sigurimit të kapitalit. Që prej vitit 2008, SKK-të që janë në treg u ofrojnë investitorëve të huaj mundësinë e krahasueshmërisë së pasqyrave financiare për faktin se janë ndërtuar në koherencë me standardet ndërkombëtare të plota. Megjithatë, në vendin tonë numri i njësive ekonomike me kapital të huaj ose të përbashkët është shumë i vogël, rreth 1.4% e njësive ekonomike aktive. Gjithashtu këto njësi ekonomike me kapital të huaj ose të përbashkët,

përfunduar ato në sektorët strategjikë si sektori bankar dhe i sigurimeve, telefonia, energjitika dhe ndonjë investim në industrinë e rëndë, janë investime të vogla dhe me një numër të vogël të punësuarish. Ndërsa, përsa i përket riskut më të ulët të sigurimit të financimeve të huaja, pyetësorët dhe intervistat zbuluan se njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme nuk kishin në planet e tyre afatshkurtër dhe afatmesëm ambicie për të kërkuar kreditime të huaja për rritje të bizneseve të tyre. Të dyja përfundimet e bëjnë të parëndësishëm adoptimin e SNRF për NVM.

- *Krijohen më shumë të ardhura në arkën e shtetit (tatime dhe taksa) nga raportimi me SNRF për NVM, krahasuar me kuadrin aktual të raportimit financiar?*

Adoptimi i SNRF për NVM nuk sjell asnjë ndryshim në arkëtimet në buxhetin e shtetit nga llogaritja e tatim fitimit të njërive ekonomike. Të gjitha dallimet mes SKK-ve dhe SNRF për NVM ose nuk kanë asnjë ndikim në llogaritjen e tatim fitimit ose ndikojnë në uljen e tatim fitimit të llogaritur. I vetmi rast përjashtimor është njohja e grave në të ardhura. Por ky dallim mes dy seteve të raportimit nuk justifikon adoptimin e plotë të SNRF për NVM.

Ndërsa në *aspektin teknik*, për të arritur në përfundimet përkatëse lidhur me vlerën e shtuar e adoptimit të SNRF për NVM, përmes matricave krahasuese, pyetësorit dhe intervistave, kërkimi u fokusua për t'i dhënë përgjigje nënpyetjeve si më poshtë:

- *A ka mes Direktivës së Kontabilitetit të BE dhe SNRF për NVM një dallim aq thelbësor sa pengon adoptimin e SNRF për NVM? (kjo pyetje bëhet për faktin se vendi ynë, si vend kandidat për hyrjen në BE ka prioritet Direktivën krahasuar me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit)*

Direktiva e BE për kontabilitetin është udhërrëfuesi i të gjitha vendeve anëtare dhe atyre që aspirojnë të anëtarësohen në BE. Por SKK-të dhe SNRF për NVM janë njësoj të barazlanguara nga kjo Direktivë e për më tepër asnjë dallim i tyre me Direktivën nuk përbën kontraditë me këtë të fundit. Në këtë kontekst adoptimi i SNRF për NVM nuk është një hap përpara drejt harmonizimit me Direktivën e BE për kontabilitetin.

- *A ka mes SKK-ve dhe SNRF për NVM dallime aq thelbësore sa që do të kërkonin ndryshime strukturore të thella në kuadrin e raportimit financiar në kuptim të përmirësimit të tij?*

Mes SKK-ve dhe SNRF për NVM dallimet janë të pakta në numër dhe jo të tilla që të ndryshojnë thelbin e regjimit financiar në vendin tonë. Për sa kohë këto dy sete raportimi burojnë nga SNRF –të e plota ato kanë të njëjtën filozofi pra mbështeten në parime dhe jo në rregulla. Dallimet që ekzistojnë mes tyre, në një numër të vogël, janë të dobishme për raportimin financiar në Shqipëri pasi thjeshtojnë barrën e raportimit për njësitë ekonomike dhe nga ana tjetër mbulojnë disa zhvillime të reja të tregut dhe biznesit që kanë lindur pas vitit 2008, vit kur janë shpallur të detyrueshme për herë të parë SKK-të. Fakti që këto dallime janë të dobishme nuk justifikon adoptimin e plotë të SNRF për NVM pasi bashkë me këto lehtësime do të vinin edhe shumë kërkesa dhe udhëzime të tjera që do të rëndonin pa arsye dhe pa vlerë të shtuar njësinë ekonomike. SNRF për NVM parashikon më shumë shënime shpjeguese, në disa raste të tjera ndryshe nga SKK-të parashikon përdorimin e vlerës së drejtë dhe për më tepër ka disa seksione që nuk gjejnë zbatim në praktikën e biznesit shqiptar.

- *A janë të gatshëm (përgatitja e tyre profesionale) përgatitësit e pasqyrave financiare të kalojnë, për një periudhë të shkurtër kohe, nga një kuadër raportimi tek një kuadër të ri ?*

Ajo çfarë i mungon NVM-ve në Shqipëri është njohja në nivel profesional e SNRF për NVM. Ka prej tyre që nuk dinë as për ekzistencën e saj megjithatë në përgjithësi ajo që mungon është kompetenca profesionale për ta zbatuar.

Përgatitësit e pasqyrave financiare nuk janë profesionalisht të gatshëm për kalimin drejt SNRF për NVM. Pyetësi tregoi një shkallë në nivelin mesatar të njohjes së SKK-ve ndërsa lidhur me SNRF për NVM, pyetësi tregoi se NVM-të në Shqipëri kanë dijeni për ekzistencën e SNRF për NVM por nuk janë të përgatitur për të kaluar drejt këtij standardi. Përgatitësit e pasqyrave financiare janë të prirur të shkojnë drejt një kontabiliteti me rregulla dhe jo parime madje kërkojnë një unifikim të rregullimit kontabël me atë fiskal. Përgatitësit e pasqyrave financiare kanë nevojë për trajnime lidhur me zbatimin e SNRF për NVM. Shoqatat profesionale nuk kanë filluar me përgatitjen e trajnimeve dhe literaturës së nevojshme si udhëzues për zbatim të SNRF për NVM. Kurikulat universitare gjithashtu, në nivel universitar nuk pajisin studentët me dije për SNRF për NVM.

- *A ka adoptimi i SNRF për NVM ndikim të drejtpërdrejtë dhe të matshëm në përmirësimin e cilësisë së vendimeve ekonomike të përdoruesve?*

Punimi nxori në dritë dhe një fakt që bie në kundërshtim me teorinë, atë se përdoruesit pronarë jomenaxherë në Shqipëri nuk janë përdoruesit më kryesorë të pasqyrave financiare. Në fakt gjetjet empirike treguan se pronarët jomenaxherë i marrin vendimet e tyre ekonomike mbi të tjera raporte që gjenerohen nga njësia ekonomike dhe jo mbi pasqyrat financiare vjetore. Pasqyrat, në këndvështrimin e tyre, janë një produkt i domosdoshëm për të plotësuar një kërkesë të ligjeve fiskale.

Një përfundim tjetër është në linjë me pohimin teorik që sa më të vogla njësitë ekonomike aq më pak varen vendimet e pronarëve tek pasqyrat pasi ata janë në lidhje të vazhdueshme me aktivitetin e përditshëm të njësisë ekonomike. Në fakt analiza e gjetjeve e provoi këtë përfundim teorik por gjithësesi nuk ishte shumë i lartë as interesi i pronarëve jomenaxherë të njësive të mesme (afër kufirit të sipërm). Në realitetin shqiptar ka një ndikim shumë të madh një fenomen i përhapur në masë. Biznesi shqiptar për pronarët përgatit një tjetër informacion (shifra të tjera) të ndryshëm nga ai që dorëzon në zyrën e tatim taksave.

Konfirmohet përfundimi teorik se bankat janë përdorues shumë të rëndësishëm të pasqyrave financiare por të befason fakti që nuk kanë interes të ndryshojë seti i raportimit financiar. Bankat e pranojnë teorikisht idenë se SNRF për NVM do të rrisë cilësinë dhe transparencën e pasqyrave financiare por nuk janë të mendimit se do të ketë efekte praktike. Në të kuptuarit e tyre NVM-të do të vazhdojnë të ndërtojnë pasqyra të trefishta, një për tatimet, një për bankat dhe një për pronarët. Kjo bën që ato të mos jenë të interesuara jo vetëm për të kaluar drejt SNRF për NVM por madje as për setin e raportimit të zbatueshëm në vetvete, pasi ato kanë ngritur sistemet e tyre mbrojtëse për të siguruar cilësinë e vlerësimit të riskut të kredidhënies.

Në aspektin ekonomik, synimi ishte që përmes një analize kosto përfitim, të mund arrihej në përfundime lidhur me interesin ekonomik që kanë njësitë ekonomike dhe përdoruesit e pasqyrave financiare për të investuar në kalimin drejt SNRF për NVM. Nënpyetjet e shtruara ishin:

- *Cilat mund të jenë kostot për t'u përballur nga njësia ekonomike në procesin e adoptimit për herë të parë të SNRF për NVM? Po kosto të vijueshme?*

NVM-të e konsiderojnë adoptimin e SNRF për NVM një proces që prodhon vetëm kosto. Kosto për njësitë ekonomike rezulton trajnimi i stafit, pajtimi i shërbimeve të kontabilitetit jashtë njësisë ekonomike për të përballuar fazën tranzitore të kalimit drejt SNRF për NVM përfshirë rideklarimin e pasqyrave financiare si dhe rekrutimi i një stafi më të kualifikuar në raportimin financiar ndërkombëtar.

- *Cilat mund të jenë kostot për t'u përballur nga përdoruesit e tjerë të pasqyrave financiare në procesin e adoptimit për herë të parë të SNRF për NVM? Po kosto të vijueshme?*

Nuk janë vetëm NVM-të që do të përballen me kosto por edhe përdoruesit e këtyre pasqyrave. Institucionet e financimeve do të duhet të përshtasin manualët e tyre të vlerësimit të riskut dhe analizave të kredidhënies, menaxhimi i lartë i njësive ekonomike duhet të përshtasë manualët e drejtimit dhe kontrollit, si dhe softëare-t për përgatitjen e raporteve për aksionerët e njësisë. Kosto do të jetë edhe për buxhetin e shtetit sepse adoptimi i SNRF për NVM do të kërkojë amendimin e pjesshëm apo të plotë të disa ligjeve që në mënyrë direkte apo indirekte preken nga ndryshimi i kuadrit të raportimit financiar. Shoqatat profesionale duhet të përgatiten për trajnimin e profesionistëve të praktikës mbi zbatimin e SNRF për NVM. Përgatitja e materialeve trajnuese dhe organizimi i trajnimeve është kosto për këto organizata dhe individët që anazhohen për të marrë këto trajnime. Edhe tekstet universitare në fushën e kontabilitetit dhe raportimit kanë nevojë për ndryshime dhe përditësime duke përfshirë në tekste seksione të caktuara të SNRF për NVM. Hartimi i teksteve të përmirësuara është një tjetër kosto në nivel makro.

- *Cila është pritshmëria e NVM-ve dhe përdoruesve të pasqyrave financiare për përfitimin e kalimit drejt SNRF për NVM?*

Përfitimet nga adoptimi i SNRF për NVM janë teorike dhe pritshmëria për to është në terma afatgjatë. NVM-të nuk janë të gatshme të investojnë në drejtim të adoptimit të këtij standardi pasi suksesi apo dështimi i biznesit të tyre nuk lidhet aspak me problematika të pasqyrave financiare por tërësisht probleme të natyrave të tjera. NVM-të janë të pritura të respektojnë rregullimet fiskale. Punimi tregoi përmes gjetjeve empirike se për aq kohë sa se kultura e raportimit financiar në vendin tonë është kulturë tatimore, dobishmëria e setit të raportimit financiar është e paëprfillshme.

Gjithashty, punimi tregoi se NVM-të shqiptare janë shumë të vogla që të aspirojnë hyrjen në tregje të huaja apo thithjen e financimeve ndërkombëtare. Ky përfundim është në linjë me kuadrin teorik i cili pranon gjithësesi se SNRF për NVM nuk është e përshtatshme për njësitë fare të vogla dhe të vogla. Konsideruar faktin që literatura i referohet shteteve të zhvilluara, është mëse bindës përfundimi që NVM-të tona nuk janë të gatshme për SNRF për NVM, pasi krahasuar me NVM-të evropiane, njësitë tona ekonomike në 99% të rasteve do të ishin mikro dhe më pak se mikro krahasuar me njësitë ekonomike të shteteve të mëdha të Evropës. Kështu që transparenca dhe krahasueshmëria e pasqyrave financiare të këtyre njësive ekonomike nuk është një nevojë e brendshme e NVM-ve në kushtet aktuale të zhvillimit ekonomik në vendin tonë.

6.2 Konkluzioni

Punimi arrin objektivin e vet të vlerësimit të mundësisë dhe dobishmërisë së adoptimit të SNRF për NVM duke konkluduar se ***“Adoptimi i plotë dhe i menjëhershëm i SNRF për NVM në Shqipëri nuk është një vlerë e shtuar e raportimit financiar”***. Ky konkluzion është plotësisht i mbështetur nga analiza e gjetjeve empirike.

6.3 Rekomandime

Konkluzioni i punimit është se sot adoptimi i plotë i SNRF për NVM nuk është vlerë e shtuar në aspektin politik, në aspektin teknik po ashtu dhe në aspektin ekonomik. Referuar këtij konkluzioni, por edhe me bindjen se në një të ardhme jo shumë të largët, Shqipëria si një vend kandidat për në BE do të duhet ta adoptojë këtë standard ndërkombëtar të raportimit financiar, paraqes rekomandimet e mia si më poshtë:

- Mundësia e adoptimit të SNRF për NVM duhet riparë sërish, të paktën pas 3 viteve, kohë që përkon me daljen e SNRF për NVM të përditësuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit;
- Shoqatat profesionale duhet të angazhohen në realizimin e materialeve dhe udhëzimeve në zbatim të standardeve të NVM-ve që do të ndihmonin anëtarët e tyre për t'u rritur profesionalisht. Trajnimet, seminarët, botimet profesionale si dhe fushatat sensibilizuese për njohjen e SNRF për NVM duhet të fillojnë që të jemi gati nëse një ditë Komisioni Evropian e shpall këtë standard të detyrueshëm dhe në të njëjtën kohë Shqipëria të jetë bërë anëtare me të drejta të plota në BE;
- Gjithnjë lidhur me edukimin profesional të përgatitësve të pasqyrave financiare rekomandoj futjen e moduleve të caktuara të SNRF për NVM në kurikulat universitare të degës së kontabilitetit. Në gjykimin tim ky hap është një kursim në kohë, para' dhe energji për njësitë ekonomike sepse nesër nuk do të duhet të trajnojnë stafet e tyre në momentin e adoptimit të SNRF për NVM. Profesionistët që do të dalin nga universitetet do të kenë bagazhin e mjaftueshëm teorik lidhur me këtë standard. E rekomandoj ndërhyrjen sot në kurikulat universitare në mënyrë që kur të shtrohet në një moment tjetër sërish çështja e adoptimit të SNRF për NVM, shkalla e njohjes dhe gadishmërisë për adoptimin e këtij standardi nga ana e përgatitësve të pasqyrave financiare të mos jetë në këto nivele si rezulton në pyetësorin e këtij punimi;
- Duhet shpjeguar përmes botimeve të ndryshme profesionale se SNRF për NVM-të nuk është një standard kompleks, madje në kushtet kur BSNK ka filluar një tjetër rishikim të këtij standardi me synimin për ta thjeshtuar akoma më shumë, kjo e bën më të lehtë procesin e kuptueshmërisë dhe zbatueshmërisë së tij në një moment të dytë kohe;
- Meqenëse kultura raportuese në Shqipëri është orientuar drejt rregullimeve fiskale, duhet punuar për të gjetur motivuesit e duhur nga njëra anë dhe mekanizmat rregullues nga ana tjetër për të nxitur bizneset që të hartojnë pasqyra të vërteta dhe të sinqerta. Ajo që përfitohet sot nga bizneset, duke manipuluar pasqyrat për të mos paguar taksa dhe tatime, kthehet në një bumerang për ekonominë në tërësi pasi vendimet e përdoruesve merren mbi pasqyra të shtrembëruara;
- Bankat si përdoruesi më i rëndësishëm i pasqyrave financiare duhet përmes rregullimeve ligjore ose marrëveshjeve institucionale të bëhen barriera kryesore për të mos lejuar raportimin e shumëfishtë financiar të njësive ekonomike. Nëse bankat do ta kryejnë këtë mision, kombinuar kjo edhe me nxitës fiskal apo ekonomikë të promovuar nga qeveria, atëherë do të mundësojmë që kultura e raportimit të ndryshojë e për rrjedhojë çështjet e kuadrit të raportimit financiar të jenë një nevojë e brendshme e njësive ekonomike dhe jo të detyrueshme nga ligjet në fuqi;
- Për njësitë ekonomike të mesme (përrjashtuar mikro dhe të vogla) të vendoset detyrimi ligjor i publikimit të pasqyrave financiare në websitet e tyre. Ky publikim do të parandalonte gjithashtu raportimin e shumëfishtë të njësive ekonomike të mesme;

6.4 Kontributi i punimit

Ky punim u konceptua sipas një qasje abduktive, ku nga njëra anë përfundimet teorike të gjetura gjatë rishikimit të literaturës u testuan kundrejt gjetjeve empirike (qasja deduktive) dhe nga ana tjetër gjetjet empirike çuan në përfundime të reja teorike (qasja induktive). Referuar qasjes induktive, punimi jep një *kontribut në teori*. Nga analiza e kombinuar e gjetjeve empirike nga pyetësi se SKK-të nuk njihen mjaftueshëm nga profesionistët e praktikës, e gjetjeve nga pyetësi dhe intervistat se NVM-të janë të prirur drejt kontabilitetit me rregulla dhe jo atij me parime si dhe një gjetje tjetër cilësore se kultura e raportimit financiar është e orientuar drejt rregullimeve fiskale, sa më sipër të çon në përfundimin teorik se standardet e mbështetura në parime, përfshirë SKK-të dhe SNRF për NVM, nuk janë vlerë e shtuar në vende të vogla, në faza genuine të zhvillimit të tregut dhe biznesit për sa kohë në to dominon kultura tatimore e raportimit financiar.

Për t'iu përgjigjur pyetjes së madhe të kërkimit dhe për të realizuar objektivin e këtij punimi kam ndërtuar qasjen e arsytimit logjik, i cili është një kontribut origjinal i këtij punim pasi në literaturën që kam konsultuar nuk kam hasur një model të tillë. Ndërtimi i këtij modeli është një *kontribut i punimit në metodologjinë e kërkimit*.

Sa më sipër, janë kontribute të punimit në fushën akademike. Por punimi sjell një kontribut praktik gjithashtu. Meqenëse rishikimi i kuadrit të raportimit financiar është një proces dinamik, ky punim mund të shërbejë si një guidë për vlerësimin e mëpasshëm të mundësisë dhe dobishmërisë së SNRF për NVM në një moment tjetër. Në mënyrë të veçantë ky punim i shërben Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit i cili është i vetmi organizëm publik, profesional, i pavarur që harton standardet e raportimit financiar në Shqipëri. Por ky punim mund t'u shërbejë dhe organizmave të tjerë standard hartues ndërkombëtarë për të kuptuar një realitet të një vendi tjetër si dhe kërkuesve apo studiuesve të fushës të cilët janë gjithnjë në kërkim të eksperiencave të vendeve të tjera për të ballafaquar përfundimet teorike dhe praktike të kërkimeve të tyre.

6.5 Kërkime të mëtejshme

Në kapitullin e parë janë dhënë kufizimet e këtij punimi. Këto kufizime janë një mundësi për kërkues të tjerë që ta shtrijnë këtë kërkim në të tjera përmasa, referuar shtrirjes gjeografike të NVM-ve, madhësisë së tyre dhe numrit të të punësuarve, masës së kampionit të përdoruesve apo të përgatitësve të pasqyrave financiare, sektorëve të veçantë të ekonomisë, etj.

Gjithashtu, kërkues të tjerë mund të thellohen në kërkimin e tyre për sa i përket modelit të arsytimit logjik. Të tjerë kërkues mund të shtojnë në këtë model faktorë ose aktorë të tjerë që mundësojnë arritjen e objektivit dhe përgjigjen e pyetjes së madhe të kërkimit.

ANEKS 1 – Të dhëna statistikore për njësitë ekonomike, INSTAT viti 2013¹⁸

Ndërmarrjet aktive sipas vitit të krijimit dhe madhësisë, 2013

Gjendje në fund të vitit

Viti krijimit	Gjithsej Total	Grupuar sipas numrit të të punësuarve			
		1-4	5-9	10-49	50+
Gjithsej	111,083	99,782	5,235	4,660	1,406
2013	12,131	11,358	539	196	38
2012	12,248	11,644	369	183	52
2011	11,033	10,458	349	190	36
2010	12,091	11,436	430	193	32
2009	8,685	8,032	365	225	63
2008	10,010	9,211	455	284	60
2007	6,499	5,657	345	439	58
2006	6,214	5,602	272	280	60
÷2005	32,172	26,384	2,111	2,670	1,007
%					
Gjithsej	100	100	100	100	100
2013	10.9	11.4	10.3	4.2	2.7
2012	11.0	11.7	7.0	3.9	3.7
2011	9.9	10.5	6.7	4.1	2.6
2010	10.9	11.5	8.2	4.1	2.3
2009	7.8	8.0	7.0	4.8	4.5
2008	9.0	9.2	8.7	6.1	4.3
2007	5.9	5.7	6.6	9.4	4.1
2006	5.6	5.6	5.2	6.0	4.3
÷2005	29.0	26.4	40.3	57.3	71.6

¹⁸ <http://www.instat.gov.al/al/themes/regjistri-statistikor-i-nd%C3%ABrmarrjeve.aspx>

Ndërmarrjet aktive të huaja e të përbashkëta (Shqiptarë + Të huaj) sipas shtetit dhe madhësisë, 2013

Gjendje në fund të vitit

Shtetet	Gjithsej	Grupuar sipas numrit të të punësuarve			
		1-4	5-9	10-49	50+
Gjithsej	4,654	3,307	561	518	268
Italia	1,903	1,329	216	227	131
Greqia	616	430	77	68	41
Turqia	336	242	40	35	19
Kosova	230	195	26	c	c
Maqedonia	152	104	22	14	12
Gjermania	148	112	22	c	c
Sh B A	142	101	15	22	4
Mbretëria e Bashkuar	106	77	20	c	c
Austria	92	58	9	15	10
Republika Popullore e Kinës	75	64	10	c	c
Të tjera	854	595	104	107	48

Njësitë ekonomike të klasifikuara sipas sektorit të aktivitetit ekonomik, 2013

Gjendje në fund të vitit

Aktivitetit ekonomik	2009	2010	2011	2012	2013
Gjithsej	94,953	103,038	109,039	106,837	111,083
Prodhuesit e të mirave	14,502	16,049	17,099	16,413	16,842
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	1,143	1,700	1,932	1,775	1,690
Industria nxjerrëse	514	594	636	624	684
Industria përpunuese	8,059	8,919	9,245	8,726	9,014
Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	154	185	228	249	279
Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	159	200	245	287	356
Ndërtimi	4,473	4,451	4,813	4,752	4,819
Prodhuesit e shërbimeve	80,451	86,989	91,940	90,424	94,241
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave	41,538	43,325	45,214	43,851	44,878
Transporti dhe magazinimi	8,073	8,307	8,505	7,961	8,024
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	13,426	15,674	17,113	16,888	17,825
Informacioni dhe komunikimi	1,233	2,009	2,270	2,330	2,495
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	562	651	662	701	765
Aktivitete të pasurive të paluajtëshme	280	356	395	415	453
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	3,824	4,309	4,647	4,893	5,590
Shërbime administrataive dhe mbështetëse	966	1,222	1,458	1,682	1,865
Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm	745	758	760	704	720
Arsimi	810	910	951	974	1,071
Shëndeti dhe aktivitete të punës sociale	1,988	2,133	2,220	2,233	2,342
Arte, argëtim dhe çlodhje	1,405	1,359	1,393	1,369	1,373
Aktivitete të tjera shërbimi	5,601	5,976	6,352	6,423	6,840

Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik dhe formës ligjore

Gjendje në fund të vitit

	Gjithsej	Person Fizik	Person Juridik
Gjithsej	111,083	84,955	26,128
Prodhuesit e të mirave	16,842	9,238	7,604
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	1,690	1,316	374
Industria	10,333	6,621	3,712
Ndërtimi	4,819	1,301	3,518
Prodhuesit e shërbimeve	94,241	75,717	18,524
Tregtia	44,878	36,824	8,054
Transporti dhe magazinimi	8,024	7,085	939
Akomodimi dhe shërbimi social	17,825	17,135	690
Informacioni dhe komunikacioni	2,495	1,767	728
Shërbime të tjera	21,019	12,906	8,113

ANEKS 2 - Matrica krahasuese mes SKK-ve dhe Direktivës së Kontabilitetit të BE 34/2013/EU

Neni	Pg	Teksti i Direktivës	Ref në SKK	Dallimet mes SKK-ve dhe Direktivës
	29	Many undertakings own other undertakings and the aim of coordinating the legislation governing consolidated financial statements is to protect the interests subsisting in companies with share capital. Consolidated financial statements should be drawn up so that financial information concerning such undertakings may be conveyed to members and third parties. National law.....	SKK 9 Pg 9 SKK 9 Pg 19 SKK 9 Pg 30-31	Direktiva kërkon që njësitë ekonomike të përgatisin paqyra të konsoliduara nëse plotësojnë kushtet për një gjë të tillë por transaksione të kontrolluara ose ndryshe transferimet e interesave pjesëmarrëse brenda grupit të kontabilizohen me metodën e bashkimit të interesave, ku vlera kontabël e aksioneve të një njësie të eliminohet kundrejt përqindjes korresponduese të kapitalit. SKK nuk lejon metodën e bashkimit të interesave por kërkon të përdoret metoda e blerjes SKK 9 nuk parashikon një rimatje të vlerës së emrit të mirë kur kjo e fundit transferohet tek një njësi tjetër e grupit.
	36	Associated undertakings should be included in consolidated financial statements by means of the equity method. The provisions on measurement of associated undertakings should in.....	SKK 14 Pg 9	Direktiva kërkon që pjesëmarrjet të përfshihen në konsolidim përmes metodës së kapitalit. SKK 9 lejon dy metoda: kapitali dhe kosto. Direktiva kërkon që aktivet ose aktivitetet e kontrolluara bashkërisht të konsolidohen proporcionalisht ndërsa SKK nuk e lejojnë metodën proporcionale.
	37	Consolidated financial statements should include all.....	SKK 9	Shënime shpjeguese shtesë lidhur me të dhëna (emri, adresa e zyrës, grupi) për filialet, pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta.
2	1	'public-interest entities' means undertakings within the scope of Article 1 which are:	Nuk ka përkufizim në SKK.	Në Direktivë është dhënë përkufizimi i njësive ekonomike me interes publik. Në ligjin tonë apo SKK- të përkufizimi mungon por SNRF-të u kërkohej atyre njësive që bien brenda këtij përkufizimi.
	2	'participating interest' means rights in the capital of other undertakings, whether or not represented by certificates, which, by creating a durable link with those undertakings, are intended to contribute to the activities of the undertaking	Nuk ka përkufizim në SKK	Ndërsa në SKK 9 jepet përkufizim për “kontrollin” si një interes pjesëmarrës që kalon kuotën 50% dhe SKK14 përkufizon “pjesëmarrjen” si një interes pjesëmarrës në kufijtë 20-50%. Pjesëmarrjet në 20% trajtohen si aktive financiare. Duhet bërë njëhësi i terminologjisë

Neni	Pg	Teksti i Direktivës	Ref në SKK	Dallimet mes SKK-ve dhe Direktivës
	3	'related party' has the same meaning as in the international accounting standards adopted in accordance with	SKK 1 Pg 93	Palët e lidhura në SKK jepen me shembuj por pa një përkufizim. Ndërsa Direktiva ka huazuar përkufizimin e SNRF të miratuara në BE.
	12	'affiliated undertakings' means any two or more undertakings within a group	SKK 1 Pg 93	SKK nuk kanë një përkufizim për filialet "affiliated undertakings". SKK 1 (93) shprehet pak gjatë duke dhënë një listë gjithëpërfshirëse të filialeve duke i përfshirë ato në palët e lidhura si më poshtë: Ndërsa Direktiva i përkufizon ato "si dy apo më shumë njësi ekonomike brenda të njëjtit grup"
	13	'associated undertaking' means an undertaking in which another undertaking has a participating interest, and over whose operating and financial policies that other undertaking exercises significant influence. An undertaking is presumed to exercise a significant influence over another undertaking where it has 20 % or more of the share-holders' or members' voting rights in that other undertaking;	SKK 14 Pg 5-7	"pjesëmarrje" "associated undertakings" nënkupton një njësi në të cilën një tjetër njësi ekonomike ka një interes pjesëmarrës, si dhe ushtron ndikim të rëndësishëm mbi politikën e shfrytëzimit dhe ato financiare të saj. Një njësi konsiderohet të ushtrojë një influencë të ndjeshme mbi një njësi tjetër kur ajo ka 20% ose më shumë të të drejtave të votës së aksionareve ose të Anëtarëve në atë njësinë tjetër; SKK kanë nevojë për një qartësim të termave mes këtyre emërtimeve të njësive ekonomike
4	1	The annual financial statements shall constitute a composite whole and shall for all undertakings comprise,.....	SKK 2 Pg 20	Lidhur me pasqyrat finciare, Direktiva u lejon vendeve anëtare që përjashtuar njësitë e vogla, mund t'u kërkojnë njësive të tjera edhe pasqyra shtesë
9	2	In the balance sheet and in the profit and loss account the items set out in.....	SKK 2 Shtojcë 1 Shtojcë 2 SKK 3 Shtojcë 3	Formatet janë shumë të harmonizuara por renditja e elementeve është bërë në të kundërt me Direktivën
	7.(c)	where the profit attributable to the participating interest and recognised in the profit and loss account exceeds the amount of dividends already.....	Nuk ka përkufizim në SKK	Rekomandim: Të përfshihet në SKK 14 një Pg – Kur e ardhura që njihet nga dividendët është më e madhe se dividendët e arkëtuar, diferenca të transferohet në rezerva të pashpërndashme në pasqyrën e lëvizjes së kapitalit
12	1	Where an asset or liability relates to more than one layout item, its relationship to other items shall	SKK 7–	Direktiva kërkon që aktivet dhe detyrimet që gjejnë vend më shumë se një herë në PF të paraqiten të

Neni	Pg	Teksti i Direktivës	Ref në SKK	Dallimet mes SKK-ve dhe Direktivës
		be disclosed either under the item where it appears or in the notes to the financial statements.		ndara ose të shpjegohen tek shënimet. SKK 7 në fakt nuk e kërkon një gjë të tillë për ndarjen e detyrimeve financiare në afatshkurtra apo afatgjata.
16	(b)i	movements in the revaluation reserve in the financial year, with an explanation of the tax treatment of items therein, and	SKK 11	Në SKK 11 duhet marrë parasysh kërkesa e Direktivës për të dhënë tek shënimet shpjegime lidhur me trajtimin e taksave të zërave që bëjnë pjesë tek lëvizjet në rezervat e rivlerësimit
	(b)ii	the carrying amount in the balance sheet that would have been recognised had the fixed assets not been revalued;	SKK 5	Direktiva kërkon që në shënimet shpjeguese të jepet informacion për vlerën e mbetur të aktiveve afatgjata, sa do të kish qenë kjo vlerë nëse këto aktive nuk do të kishin qenë rivlerësuar ndonjëherë
	(g)	amounts owed by the undertaking becoming due and payable after more than five years, as well as the undertaking's entire debts covered by valuable	Nuk parashiko het në SKK	Direktiva kërkon të jepen shpjegime për detyrime të pagueshme për më vonë se 5 vjet si dhe për të gjitha llojet e borxheve që mbulohen nga letra me vlerë të lëshuara nga njësia ekonomike të jepet natyra dhe forma e tyre
	(h)	the average number of employees during the financial year.	Nuk parashiko het në SKK	Në shënime të jepet numri mesatar i punonjësve. Rekomandim: Ky të jetë një detyrim që buron nga ligji jo nga standardi pasi SNRF për NVM apo SNRF e plotë nuk e kërkojnë një gjë të tillë
	3	Member States <u>shall not require</u> disclosure for small undertakings beyond what is required or permitted by this Article.		Direktiva u kërkon vendeve anëtare të limitojnë kërkesat për shënime shpjeguese të njësive të vogla deri në atë sa parashikon direktiva, jo më shumë.
17	(c)ii	for financial fixed assets carried at an amount in excess of their fair value: — the book	SKK 3-	Direktiva kërkon të jepen shpjegime për instrumentat financiare që mbahen me vlerë kontabël në rast se kjo vlerë tejkalon vlerën e drejtë të tyre.
	(c)ii	— the reasons for not reducing the book value, including the nature of the evidence underlying the assumption that the book value will be recovered;	SKK 3-	Direktiva kërkon të shpjegohen arsyet përse nuk zvogëlohet kjo vlerë kontabël përfshirë shpjegime mbi natyrën e evidencës që mbështet gjykimin se vlera kontabël do të rikuperohet
	(e)	the average number of employees during the financial year, broken down by categories and, if they are.....	N/A	Shpjegime mbi numrin mesatar të punonjësve të ndarë sipas kategorive, dhe nëse nuk janë bërë detajime në PASH, në shpjegime të jepen të ndara pagat, sigurimet dhe

Neni	Pg	Teksti i Direktivës	Ref në SKK	Dallimet mes SKK-ve dhe Direktivës
				pastaj pensionet.
	(h)	the number and the nominal value or, in the absence of a nominal value, the accounting par value of the shares subscribed.....	Nuk parashiko het në SKK 3	Numrin dhe vlerën nominale, ose në mungesë të vlerë nominale të jepet vlera kontabël për aksion të regjistruara gjatë periudhës ushtrimore brenda limitit të kapitalit të autorizuar
	(i)	where there is more than one class of shares, the number and the nominal value or, in the absence of a	Nuk parashiko het në SKK 3	Kur ka më shumë se një klasë aksionesh, numrin dhe vlerën nominale, ose në mungesë të vlerë nominale të jepet vlera kontabël për aksion për çdo klasë
	(j)	the existence of any participation certificates, convertible debentures, warrants, options or similar securities or rights, with an indication of their number and the rights they confer	Nuk parashiko het në SKK 3	Të jepen shpjegime për eksistencën e ndonjë certificate pjesëmarrëse, obligacioni të konvertueshëm, garanci, opsione ose të drejta apo letra të tjera me vlerë të ngjashme si dhe të jepn të dhëna për numrin e tyre dhe të drejtat që ato mbajnë;
22	6	Without prejudice to Article 23(9), a parent undertaking and all of its subsidiary undertakings shall be undertakings to be consolidated.....	Nuk parashiko het në SKK 9	Nuk thuhet në SKK 9, Direktiva e kërkon - Njësia ekonomike mëmë dhe të gjitha filialet e saj duhet të konsolidohen pavarësisht ku janë të regjistruara dhe operojnë filialet.
	7	Without prejudice to this Article and Articles 21 and 23, a Member State may require any undertaking governed by	Nuk parashiko het në SKK 9	Kërkohet konsolidim nëse.....
	(a)	that undertaking and one or more other undertakings to which it is not related as described in Paragraphs 1 or 2, are	Nuk parashiko het në SKK 9	Kërkohet konsolidim nëse.....
	(a)i	a contract concluded with that undertaking, or	Nuk parashiko het në SKK 9	Kërkohet konsolidim nëse.....
	(a)ii	the memorandum or articles of association of those other undertakings; or	Nuk parashiko het në SKK 9	Kërkohet konsolidim nëse.....
	(b)	the administrative, management or supervisory bodies of that undertaking and of one or more	Nuk parashiko het në SKK 9	Kërkohet konsolidim nëse.....
	8	Where the Member State option referred to in Pgraph 7 is exercised, the undertakings described in that	Nuk parashiko het në SKK 9	Kërkohet konsolidim nëse.....
	9	Pgraph 6 of this Article, Article 23(1), (2), (9) and (10) and Articles 24 to 29 shall apply to	Nuk parashiko het në	Kërkohet konsolidim nëse.....

Neni	Pg	Teksti i Direktivës	Ref në SKK	Dallimet mes SKK-ve dhe Direktivës
		the consolidated financial statements and the	SKK 9	
	(a)	references to parent undertakings shall be understood to refer to all of the undertakings specified in Ppgraph 7 of this Article; and	Nuk parashiko het në SKK 9	Kërkohet konsolidim nëse.....
	(b)	without prejudice to Article 24(3), the items 'capital', 'share premium account', 'revaluation reserve', 'reserves', 'profit or loss brought forward', and	Nuk parashiko het në SKK 9	Kërkohet konsolidim nëse.....
23	1	Small groups shall be exempted from the obligation to draw up consolidated financial statements and a	Nuk parashiko het në SKK	Grupet e vogla përjashtohen nga konsolidimi përjashtuar rastin kur një nga filialet është njësi me interes publik
	3	Notwithstanding Ppgraphs 1 and 2 of this Article, a Member State <u>shall</u> , in the following cases, exempt from the.....	Nuk parashiko het në SKK	Nuk kërkohet konsolidim nëse.....
	(a)	the parent undertaking of the exempted undertaking holds all of	Nuk parashiko het në SKK	Nuk kërkohet konsolidim nëse.....
	(b)	the parent undertaking of the exempted undertaking holds 90 % or more of the shares in the exempted	Nuk parashiko het në SKK	Nuk kërkohet konsolidim nëse.....
	(c)	severe long-term restrictions substantially hinder	SKK 9 Pg 41	Direktika nuk detyron të bëhet konsolidim nëse ka kufizime afatgjata të konsiderueshme ndërsa sipas SKK 9 nuk parashikohen përjashtime edhe kur aktivitetet e saj kryhen në vende ku juridiksioni nuk e lejon transferimin e mjeteve monetare
	(c)i	the parent undertaking in the exercise of its rights over the		Shih më lart
	(c)ii	the exercise of unified management of that undertaking where it is in one of the		Shih më lart
	10	Without prejudice to point (b) of Article 6(1), Article 21 and Ppgraphs 1 and 2 of this	Nuk parashiko het në SKK	Nuk kërkohet konsolidim nëse.....
	(a)	it only has subsidiary undertakings which are immaterial, both individually and	Nuk parashiko het në	Nuk kërkohet konsolidim nëse.....

Neni	Pg	Teksti i Direktivës	Ref në SKK	Dallimet mes SKK-ve dhe Direktivës
		collectively; or	SKK	
	(b)	all its subsidiary undertakings can be excluded from consolidation	Nuk parashiko het në SKK	Nuk kërkohet konsolidim nëse.....
27	4	The book value referred to in point (a) of Pgraph 2, or the amount corresponding to the proportion	SKK 14 Pg 9(c)	Metoda e kapitalit nuk ka kërkesa të ndryshme në Direktivë
28.1	(b)	in disclosing the average number of employees employed during the financial year, there shall be sePgte disclosure of the average number of employees	Nuk parashiko het në SKK	Direktiva kërkon të jepen në shënime të dhëna për numrin mesatar të të punësuarve gjatë vitit nga njësitë ekonomike që janë konsoliduar proporcionalisht;
		in disclosing the amounts of emoluments and advances and credits granted to members of the administrative, managerial and supervisory bodies, only amounts granted by the parent undertaking and its	Nuk parashiko het në SKK	Direktiva kërkon që të jepen shpjegime për Pgdhënie ose grante që u jepen stafëve drejtuese të njësisë mëmë nga vetë mëma ose filial të saj Rekomandim: Ky paragraf të shtohet në SKK 2, tek palët e lidhura
28.2	(a)iii	information as to which of the conditions referred to in Article 22(1), (2) and (7)	Nuk parashiko het në SKK	Infomacione shpjeguese shitesë për konsolidimin.....
	(d)	in relation to each of the undertakings, other than those referred to in points (a), (b) and.....	Nuk parashiko het në SKK	Infomacione shpjeguese shitesë për konsolidimin.....
	(d)i	the name and registered office of those undertakings	Nuk parashiko het në SKK	Infomacione shpjeguese shitesë për konsolidimin.....
	(d)ii	the proportion of the capital held,	Nuk parashiko het në SKK	Infomacione shpjeguese shitesë për konsolidimin.....
	(d)iii	the amount of the capital and reserves, and the profit or loss for the latest financial year of the undertaking.....	Nuk parashiko het në SKK	Infomacione shpjeguese shitesë për konsolidimin.....
	3	Member States may allow the information required by points (a) to (d) of Pgraph 2 to take.....	Nuk parashiko het në SKK	Infomacione shpjeguese shitesë për konsolidimin.....

ANEKS 3 – Përmbajtja e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Njësité e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NjVM)

SEKSIONET

- 1 *NJËSITË E VOGLA DHE TË MESME*
- 2 *KONCEPTE DHE PARIME TË PËRGJITHSHME*
- 3 *PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE*
- 4 *PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR*
- 5 *PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE DHE PASQYRA E TË ARDHURAVE*
- 6 *PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL DHE PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE FITIMIT TË PASHPËRNDARË*
- 7 *PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE*
- 8 *SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE*
- 9 *PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA DHE TË VEÇANTA*
- 10 *POLITIKAT KONTABËL, CMUARJET DHE GABIMET*
- 11 *INSTRUMENTAT FINANCIARË BAZË*
- 12 *CËSHTJE TË TJERA LIDHUR ME INSTRUMENTAT FINANCIARË*
- 13 *INVENTARËT*
- 14 *INVESTIMET NË PJESËMARRJE*
- 15 *INVESTIMET NË SIPËRMARRJE TË PËRBASHKËTA*
- 16 *AKTIV AFATGJATË MATERIAL I INVESTUAR*
- 17 *TOKA, NDËRTESA, MAKINERI E PAJISJE*
- 18 *AKTIVET JOMATERIALE ME PËRAJASHTIM TË EMRIT TË MIRË*
- 19 *KOMBINIMI I BIZNESEVE DHE EMRI I MIRË*
- 20 *QIRATË*
- 21 *PROVIZIONET DHE TË KUSHTËZUARAT*
- SHTOJCA—UDHËZIM MBI NJOHJEN DHE MATJEN E PROVIZIONEVE
- 22 *PASIVET DHE KAPITALI NETO*
- SHTOJCA—SHEMBULL I KONTABILITETIT TË EMETUESIT TË NJË BORXHI TË KONVERTUESHËM
- 23 *TË ARDHURAT*
- SHTOJCA—SHEMBUI TË NJOHJES SË TË ARDHURAVE SIPAS PARIMEVE TË PARAQITURA NË
- 24 *GRANTET QEVERITARE*
- 25 *KOSTOT E HUAMARRJES*
- 26 *PAGESAT E BAZUARA NË AKSIONE*
- 27 *ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE*
- 28 *PËRFITIMET E PUNONJËSVE*
- 29 *TATIMI MBI TË ARDHURAT*
- 30 *PËRKTHIMI NË MONEDHË TË HUAJ*
- 31 *HIPERINFLACIONI*
- 32 *NGJARJET PAS DATËS SË FUNDIT TË PERIUdhËS SË RAPORTIMIT*
- 33 *DHËNIE INFORMACIONESH SHPJEGUESE PËR PALË TË LIDHURA*
- 34 *AKTIVITETE TË VEÇANTA*
- 35 *KALIMI PËR NË SNRF PËR NJËSITË E VOGLA DHE TË MESME*

ANEKS 4 – Modeli i intervistës së zhvilluar me institucionet financiare

ANKETIMI I BANKAVE DHE SHOQËRIVE TË LEASING-UT NË SHQIPËRI	
Emri i Organizatës	
Emri i të intervistuarit	
Pozicioni i të intervistuarit	
Detaje Kontakti (e-mail)	
Datë	
A i përdorni pasqyrat financiare të audituara të përgatitura duke përdorur standardet kombëtare të kontabilitetit, kur merrni një <u>Vendim Huaje / Marrëveshje Qiraje</u> . Po ☐ Jo ☐	
Nëse jo – Pse jo?	
A i përdorni pasqyrat financiare të audituara të përgatitura duke përdorur standardet kombëtare të kontabilitetit, kur <u>Monitoroni Huatë/Qiratë ekzistuese</u> ? Po ☐ Jo ☐	
Nëse jo – Pse jo?	
Cilat Pjesë të Pasqyrave Financiare janë të dobishme? Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci) Pasqyra e të Ardhurave Pasqyra e Fluksit të Parasë Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital Shënime– Numrat shtesë Shënime– Shënimet Shpjeguese	E dobishme E pa dobishme ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐
Pse/Përse jo Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)?	
Pse/Përse jo Pasqyra e të Ardhurave	
Pse/Përse jo Pasqyra e Fluksit të Parasë?	

Pse/Përse jo Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital?	
Pse/Përse jo Shënimet?	
Çfarë informacioni shtesë duhet të përfshihet për të përmirësuar dobishmërinë e pasqyrave financiare?	
A mbështeteni në Raportin e Auditorit?	
Po ☐ Jo ☐	
Sa shpesh ndesheni me Raporte Auditori "Të Kualifikuar"	Shpesh ☐ Ndonjëherë ☐ Rrallë ☐ Asnjëherë ☐
Si ndikon në vendimin tuaj një Raport Auditimi i "Kualifikuar"?	
Si do ta vlerësonit të kuptuarit tuaj të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit?	Mirë ☐ Mesatar ☐ Pamjaftueshëm ☐ Nuk e di ☐
Çfarë hapash ka ndërmarrë organizata juaj për përmirësimin e të kuptuarit të Oficerëve të Kredisë / Oficerëve të Qirasë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit?	
Çfarë hapash mund të ndërmarrë KKK për t'ju ndihmuar të përmirësoni të kuptuarit tuaj të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit?	
Si do ta vlerësonit të kuptuarit e klientëve tuaj (NVM-të) të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit?	Mirë ☐ Mesatar ☐ Pamjaftueshëm ☐ Nuk e di ☐
Çfarë hapash mund të ndërmarrë KKK për t'ju ndihmuar të përmirësoni të kuptuarit e NVM-ve të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit?	
Sa të informuar jeni për ekzistencën e SNRF për NVM? Sa do të parapëlqenit dhe sa do të lehtësonin punën tuaj pasqyrat financiare të hartuara sipas SNRF për NVM?	

ANEKS 5 – Modeli i intervistës së zhvilluar me përfaqësuesit tatimore

ANKETIMI I PËRFAQËSUESVE TË ADMINISTRATËS TATIMORE	
Emri i të intervistuarit	
Pozicioni i të intervistuarit	
Detaje Kontakti (e-mail)	
Data	
SEKSIONI I – Përgatitja profesionale e administratës tatimore në drejtim të zbatimit të SKK-ve	
1. Si e vlerësoni përgatitjen profesionale të inspektorëve tatimore lidhur me SKK-të?	
2. A zhvillon institucioni juaj trajnime të rregullta për SKK—të?	
3. Ka raste kur subjektet refuzojnë aktet e kontrollit, madje çështjet përfundojnë në gjyq, për shkak të mosnjohjes apo keqinterpretimit të SKK-ve nga ana e inspektorëve tatimore?	
4. Sa mbahen parasysh parimet kontabël dhe të raportimit financiar kur hartohen ligjet dhe rregullimet e tjera fiskale? Sa profesionistë janë grupet e punës që ngrihen për këtë qëllim?	
SEKSIONI II – Rëndësia e pasqyrave financiare të hartuara sipas SKK-ve në llogaritjen e detyrimeve tatimore të bizneseve	
1. A shërbejnë PF sipas SKK-ve në llogaritjen e detyrimeve tatimore?	
2. Sa të besueshme dhe të dobishme janë ato?	
3. Sa i rëndësishëm është raporti i auditimit lidhur me besueshmërinë e pasqyrave financiare?	
SEKSIONI III – Qëndrimi i administratës tatimore ndaj kalimit drejt SNRF për NVM	
1. A i plotësojnë pasqyrat financiare sipas SKK-ve të gjitha kërkesat për informacion të administratës tatimore?	

2.	Në opinionin tuaj, është seti i raportimit financiar përcaktues i cilësisë së pasqyrave financiare, referuar praktikës aktuale të biznesit?
3.	A do të kishte kosto monetare monetare për buxhetin, si edhe kosto intelektuale, procesi i përshtatjes së legjislacionit aktual me regjimin e ri të raportimit financiar sipas SNRF për NVM?
4.	Si e shikoni raportin kosto / përfitim, në aspektin e buxhetit të shtetit, referuar ndryshimeve mes dy seteve të raportimit financiar, SKK vs. SNRF për NVM: a) Shpenzimet e zhvillimit të njihen si shpenzime periudhe b) Kostot e huamarrjes të njohen si shpenzime të periudhës c) Emri i mirë të amortizohet d) Të ndërtohet pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse e) Aktivitet biologjike të njihen me vlerën e drejtë f) Grantet të njihen në të ardhura sapo të plotësohet kushti i performancës
5.	A jeni në favor të adoptimit të SNRF për NVM apo përditësimit të SKK-ve me ndryshimet më të rëndësishme në fushën e raportimit financiar ndërkombëtar

ANEKS 6 – Modeli i intervistës së zhvilluar me pronarë të njësisë ekonomike

ANKETIMI I PRONARËVE TË NJËSIVE EKONOMIKE	
Emri i të intervistuarit	
Emri i njësisë ekonomike	
Pozicioni i të intervistuarit	
Detaje Kontakti (e-mail)	
Datë	
SEKSIONI I – SNRF PËR NVM vs. SKK	
5. Cilat standarde të raportimit financiar përdoren në njësinë tuaj ekonomike për hartimin e pasqyrave financiare?	
6. A keni dijeni për SNRF për NVM dhe cili është opinioni juaj lidhur me adoptimin e këtij standardi ndërkombëtar?	
7. Cili është qëndrimi juaj lidhur me zbatueshmërinë e SNRF për NVM, të jetë i detyrueshëm apo vullnetar?	
8. Cili prej dy seteve të raportimit mendoni se plotëson më së miri kërkesat tuaja për informacion? Për cilin set raportimi jeni në favor?	
SEKSIONI II – KARAKTERISTIKAT E SNRF PËR NVM	
4. A i vlerësoni cilësinë dhe krahasueshmërinë e shtuar të pasqyrave nga zbatimi i SNRF për NVM si të rëndësishme në ecurinë e biznesit tuaj? Sjellin ato përfitime në njësinë tuaj?	
5. A i përgjigjet realiteti shqiptar i biznesit përfundimeve teorike se standardet e harmonizuara ndërkombëtarisht rrisin eficientësinë e tregjeve dhe ulin koston e sigurimit të kapitalit?	
6. A i plotësojnë pasqyrat e hartuara sipas SKK-të karakteristikat e besueshmërisë, kuptueshmërisë, rëndësisë dhe krahasueshmërisë? Jeni ju të interesuar për këto karakteristika të pasqyrave financiare?	
7. E zgjidhin pasqyrat financiare sipas SKK-ve asimetrimin e informacionit mes njësisë dhe palëve të interesuara për informacionin financiar të pasqyrave të saj?	
SEKSIONI III – ANALIZA KOSTO / PËRFITIM NË PROCESIN E ADOPTIMIT TË SNRF PËR NVM	
6. A ka kosto në para, kohë dhe energji, në kontekstin e njësisë ekonomike, adoptimi i SNRF për NVM?	

7. Si e vlerësoni raportin kosto / përfitim të këtij procesi?
8. Si e shikoni zgjidhjen e ekspertizës për çështjen e implementimit të SNRF për NVM, zgjidhje me stafin brenda njësisë apo shërbime të jashtme të kontabilitetit?
SEKSIONI IV – PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E NJËSISË EKONOMIKE
1. Kanë pasqyrat financiare të përgatitura në njësinë tuaj, elementë të përgjegjësisë shoqërore të njësive ekonomike? Do të përmirësohej ajo nëse kalonit drejt SNRF për NVM?
SEKSIONI V – STANDARDE TË MBËSHTETURA MBI RREGULLA APO STANDARDE TË MBËSHTETURA NË PARIME
1. Si i vlerësoni SKK-të, të mbështetura më shumë në rregulla apo në parime? Si do të ishin më të dobishme standardet e raportimit financiar për ju dhe njësinë tuaj?
SEKSIONI VI – PËRDORUESIT E PASQYRAVE FINANCIARE
1. Cilët janë përdoruesit e tjerë të pasqyrave financiare që harton njësi juaj ekonomike?
2. A mbështeteni ju, në vendimarrjen ekonomike mbi njësinë ekonomike, tek pasqyrat financiare që ndërton stafi juaj?
3. Si e shikoni varësinë e vendimarrjes tek pasqyrat në raport me madhësinë e njësive ekonomike?
4. Në opinionin tuaj, e lehtëson punën e institucioneve kredishënëse, hartimi i pasqyrave financiare sipas një standardi ndërkombëtar, SNRF për NVM?
5. A mendoni se pasqyrat financiare që gjeneron njësi juaj janë baza e vlerësimit për kontrollin dhe vlerësimet tatimore që bën administrata tatimore?
SEKSIONI VII – STATUSI I ZBATUESHMËRISË SË STANDARDEVE
1. Standardet i zbatoni sepse përmirësojnë cilësinë e pasqyrave dhe të vendimarrjes apo të detyruar?
2. Si do ta prisnit një adoptim të menjëhershëm të SNRF për NVM?
3. Cila mund të ishte qasja më e mirë për t'iu përafëruar raportimit financiar ndërkombëtar të NVM-ve?

ANEKS 7 – Modeli i intervistës së zhvilluar me Akademikët

ANKETIMI I AKADEMIKËVE TË FUSHËS SË KONTABILITETIT	
Emri i të intervistuarit	
Universiteti / Fakulteti ku punon	
Pozicioni i të intervistuarit	
Detaje Kontakti (e-mail)	
Datë	
SEKSIONI I – AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E ADOPTIMIT TË SNRF PËR NVM NË VENDIN TONË	
9. Cilat janë avantazhet kryesore dhe përfitimet në përgjithësi nga adoptimi i SNRF për nvm në vendin tonë?	
10. Cilat janë disavantazhet kryesore nga adoptimi i SNRF për nvm në vendin tonë?	
SEKSIONI II – KURIKULAT UNIVERSITARE	
11. Si e vlerësoni cilësinë e kurikulave universitare? Janë ato bashkëkohore?	
12. Si i vlerësoni tekstet universitare? Sa mundësi I ofrojnë ato studentëve të asimilojnë kontabilitetin dhe raportin financiar, jo vetëm teorikisht? A përditësohen ato me të rejtat e raportimit financiar ndërkombëtar?	
13. Alektorët në nivelin e duhur profesional për të kombinuar teorinë me praktikën e kontabilitetit dhe raportimit financiar? Janë lektorët e kësaj fushe të interesuar të rrisin kreditet e tyre profesionale përveç karrierës akademike?	
14. Cila është në përgjithësi qasja e zhvillimit të orëve mësimore në universitete në lëndën e kontabilitetit? Bëjnë studentët tanë praktika të vërteta në njësitë ekonomike?	
SEKSIONI III – AFATET DHE KOSTOT QË SHOQËROJNË PROCESIN E ADOPTIMIT TË SNRF PËR NVM	
8. A janë të gatshëm përgatitësit e pasqyrave financiare për të asimiluar procesin e kalimit drejt SNRF për NVM pa qenë nevoja e trajnimeve fillestare?	
9. Nëse JO, cila është qasja më e mirë për lehtësimin e procesit të të kuptuarit të SNRF për NVM dhe implementimit korrekt të saj në praktikë?	
10. Si mund t'i paraprijnë Universitetet procesit të kalimit drejt SNRF për NVM?	
11. Sa e vlerësoni përafërsisht koston e trajnimit për individ në drejtim të SNRF për NVM?	
12. A ka kosto të tjera shtesë përveç trajnimit të stafit, që shoqërojnë procesin e adoptimit të SNRF për NVM?	
13. E vlerësoni të domosdoshëm kalimin drejt SNRF për NVM? Nëse Po cili do të ishte momenti i përshtatshëm	

ANEKS 8 – Rezultatet nga pyetësoret me përgatitësit e njësive ekonomike

Seksioni I

Të dhëna mbi njësinë ekonomike (5 pyetje)

1. Shifra e afarizmit (në milion lekë)

2 – 10	10 – 50	51 – 250	250 – 700	700 – 1.250	Mbi 1.250	Totali
4	28	54	51			137

2. Numri i të punësuarve

Deri në 5	5- 10	10 – 50	50 – 100	Mbi 100	Totali
6	66	61	4		137

3. Vlera e aktivitet (në milion lekë)

Deri në 10	10 – 100	100 – 250	Mbi 250	Totali
10	68	47	12	137

4. Sipërmarrje me kapital

Vendas	Të huaj	Të përbashkët	Totali
112	21	4	137

5. Standardet që aplikohen në njësinë tuaj ekonomike

SKK 15	SKK 1-14	SNRF	Të tjera	Totali
5	129	3		137

Seksioni II

Të dhëna mbi hartuesit e pasqyrave ekonomike (5 pyetje)

1. Grupmosha

Deri në 35 vjeç	35 – 45 vjeç	45 – 55 vjeç	Mbi 55 vjeç	Totali
26	64	42	5	137

2. Arsimi dhe kualifikimi (Plotëso kualifikimin më të lartë)

I mesëm	i lartë	Master	ACCA	CPA	Tjetër	Totali
2	71	36	22	6		137

3. Profesionin tuaj pranë njësisë ekonomike e ushtroni si

Ekonomist në njësi	Kontabilist i Miratuar	Auditues	Tjetër	Totali
17	29	83	8	137

4. Vite eksperience në profesion

Deri në 5	5-15	mbi 15	Totali
7	86	44	137

5. Qëndrimi ndaj filozofisë së standardeve (mbështetur mbi rregulla apo mbi parime)

Rregulla	Parime	Totali
91	46	137

Seksioni III (Shënim – me ngjyrë të zezë të theksuar janë paraqitur përgjigjet e sakta)

Të dhëna mbi kuptueshmërinë e SKK-ve (37 pyetje)

a) Njohuri mbi SKK 3

1. Si maten në njohje instrumentet financiare

Me vlerën e drejtë	Me kosto	Totali
21	75	96

2. Cilat janë metodat e lejuara për vlerësimin e mëpasshëm të instrumenteve financiarë

Kosto e amortizuar minus zhvlerësimin	Vlera e drejtë	Të dyja të lejuara	Totali
75	21		96

3. A trajtohen në SKK3 aktivet dhe pasivet financiare që rrjedhin nga marrëveshjet e qirave financiare

Po	Jo	Totali
24	48	72

4. Nëse "shitësi" mban detyrimin e riblerjes, transaksioni do të njihet

Si shitje	Si një transaksion financiar	Totali
38	83	121

b) Njohuri mbi SKK 4

5. Si maten në njohje inventarët

Kosto	Vlerë tregu	Shuma e paguar për blerjen e tyre	Totali
129	4	4	137

6. Cilat aktive afatgjata paraqiten si inventarë afatshkurtër

Aktivt afatgjata	Aktivt afatgjata të mbajtura për shitje	Aktivt afatgjata pa vlerë përdorimi	Totali
	116	16	132

7. Si vlerësohen inventarët në fund të periudhës raportuese

Me kosto	Kosto të amortizuar	Vlerë neto të realizueshme (VNR)	Më të voglën mes koston dhe VNR	Totali
79	2	26	28	135

8. Kur testohen inventarët për zhvlerësim

Sa herë ka një informacion të tillë	Në çdo fund viti	Një herë në tre vjet	Asnjëherë	Totali
4	41	11	73	129

c) Njohuri mbi SKK 5

9. Humbja nga zhvlerësimi është shuma me të cilën vlera kontabël e aktivit kalon

Vlerën e drejtë	Vlerën në përdorim	Shumën e rikuperueshme	Totali
65	22	44	131

10. Sa mënyra alternative njihen për njohjen e koston së huamarrjeve për blerjen e AAM

Një (kosto aktivi)	Dy (shp. periudhe / kosto aktivi)	Tre (shp. periudhe / kosto aktivi / shp. të shtyra)	Totali
86	34	13	133

11. Sa mënyra alternative njihen për vlerësimin e AAM në fund të periudhës raportuese

Një (kosto e amortizuar)	Dy (rivlerësim / kosto e amortizuar)	Totali
72	63	135

12. Si njihen shpenzimet e (1) kërkimit dhe (2) zhvillimit

Të dy si shpenzime periudhe	1-shpenzim periudhe 2-aktive jomateriale	1-aktive jomateriale 2-shpenzim periudhe	Të dy si aktive jomateriale	Totali
3	38	14	81	136

d) Njohuri mbi SKK 6

13. Provizionin është një detyrim _____ për të cilin nuk dihet koha ose shuma e shlyerjes

Aktual ligjor	Aktual i mundshëm	Aktual konstruktiv	Totali
72	19	53	134

14. Kur një provizion shlyhet 12 muaj pas datës së mbylljes së pasqyrave ai paraqitet me

Shumën që duhet për të paguar detyrimin	Vlerën aktuale të pagesës	Shumën e korigjuar me normën e inflacionit	Totali
81	44	6	131

e) Njohuri mbi SKK 7

15. Qiradhënësi njeh në pasqyrat e tij aktivin e dhënë me qira si një kërkesë të arkëtueshme në një shumë të barabartë me

Investimin bruto në qira	Investimin neto në qira	Vlerën e drejtë	Totali
21	43	32	96

16. Në fillim të afatit të qirasë, qiramarrësi do ta njohë qiranë financiare në bilancin e tij si zë aktiv dhe zë pasivi, në shuma që janë të barabarta me

Vlerën e drejtë të mjetit të marrë me qira	Me vlerën aktuale të pagesave minimale të qirasë	Me vlerën më të vogël mes të dyjave	Totali
37	11	48	96

17. Kostot fillestare direkte të qiramarrësit, për lidhjen e marrëveshjes së qirasë financiare, i shtohen

Kostos së mjetit të marrë me qira	Shpenzimeve të periudhës	Totali
56	45	91

f) Njohuri mbi SKK 8

18. Të ardhurat do të njihen me _____ të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme

Vlerën e drejtë	Vlerën aktuale	Vlerën e faturës	Totali
31	4	87	122

19. Të ardhurat nga kryerja e një shërbimi njihen

Pasi fatura përfundimtare është lëshuar	Menjëherë pas lidhjes së kontratës për kryerjen e shërbimit	Mbi bazën e metodës së fazës së përfunduar	Totali
75	2	42	119

20. Kur kostoja totale e kontratës së ndërtimit mendohet t'i tejkalojë të ardhurat prej saj, humbja e parashikuar nga kontrata

Shpërndahet në 3 vitet e ardhshme të aktivitetit	Njihet menjëherë brenda periudhës	I shtohet koston së aktivitetit	Totali
52	29	18	99

g) Njohuri mbi SKK 9

21. Kombinimet e bizneseve do të kontabilizohen duke zbatuar

Metodën e blerjes	Metodën e rregulluar të blerjes	Metodën e kapitalit neto	Totali
26	4	22	52

22. Vlera e drejtë e aktiveve neto të blera në një kombinim biznesi është vlera e drejtë e aktiveve, pasiveve ekzistuese dhe _____, minus vlerën e drejtë të aktiveve neto, që u përkasin aksionarëve të pakicës

Kapitalit aksionar	Pasiveve të kushtëzuara të njësisë së blerë	Aktiveve afatgjata të mbajtura për shitje	Totali
15	14	3	32

23. Emri i mirë është diferenca pozitive mes kostos së blerjes dhe vlerës së drejtë /vlerës kontabël para blerjes së

Aksioneve të zakonshme	Aktiveve neto të blera	Aktiveve të blera	Totali
8	41	16	65

24. Emri i mirë, që vjen nga një kombinim biznesesh

Testohet për zhvlerësim	Amortizohet	Totali
44	21	65

h) Njohuri mbi SKK 10

25. Grandet e marra në aktive jomonetare njihen me

Vlerën kontabël që kanë në librat e dhënësit të grantit	Vlerën e tregut	Vlerën në përdorim	Totali
47	31	7	85

26. Një grand që duhet kthyer duhet të kontabilizohet si një ndryshim i një _____

Politike kontabël	Vlerësimi kontabël	Gabimi material	Totali
18	13	10	41

27. Grandet e marra për aktivet e paamortizueshme duhet të njihen

Menjëherë në të ardhura	Si të ardhura gjatë atyre periudhave kontabël që do t'i duhet njësisë ekonomike të plotësojë detyrime të paracaktuara për grandin	Kur aktivi çregjistrohet	Totali
13	47	3	63

i) Njohuri mbi SKK 11

28. Diferencat e përkohshme janë diferencat mes vlerës _____ të një aktivi ose pasivi në bilanc dhe bazës së tij tatimore

Vlerës së drejtë	Vlerës kontabël	Vlerës së rikuperueshme	Totali
12	21		33

29. Pasivet (aktivet) tatimore afatshkurtra të periudhës kontabël aktuale dhe të atyre të mëparshme përlogariten mbi bazën e _____ që pritet t'u paguhet (ose rikuperohet nga) organeve tatimore

Shumës	Vlerës aktuale të shumës	Totali
24	9	33

j) Njohuri mbi SKK 12

30. Në çdo datë të bilancit zërat jomonetarë, që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën _____

E bilancit	Kur është përcaktuar vlera e drejtë	E transaksionit	Totali
82	11	38	131

31. Diferencat e këmbimit, që rrjedhin gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen fillestare gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen

Si rezerva në pjesën e kapitalit	Si diferenca konvertimi në aktivin/pasivin e bilancit	Si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin	Totali
7	31	96	134

k) Njohuri mbi SKK 13

32. Kostoja e prodhimit bujqësor të vjelë nga aktivet biologjike, me të cilën bëhet njohja në kontabilitet, është _____ në kohën e vjeljes

Vlera e tij kontabël	Vlera e drejtë	Çmimi i kontraktuar	Totali
51	12	19	82

33. Pas njohjes fillestare, njësia ekonomike duhet të mbajë aktivet biologjike afatgjata me _____

Kosto minus zhvlerësimin	Koston e amortizuar minus zhvlerësimin	Vlerën e drejtë	Totali
15	69		84

34. Prodhimi bujqësor kontabilizohet si _____

Aktiv biologjik afatshkurtër	Inventar	Totali
31	56	87

l) Njohuri mbi SKK 14

35. Në pasqyrat financiare të konsoliduara, njësitë e kontrolluara do të përfshihen me

Kosto minus zhvlerësimin në pasqyrat individuale	Vlerën e drejtë	Totali
21	15	36

36. Pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta do të përfshihen sipas _____ në pasqyrat financiare të konsoliduara të investitorit

Metodës së koston minus zhvlerësimin	Metodës së koston së amortizuar	Metodës së kapitalit	Totali
14	8	17	39

37. Sipas metodës së kapitalit, një investim njihet fillimisht me

Vlerën e drejtë	Kosto	Totali
4	29	33

Seksioni IV

Të dhëna mbi përdoruesit e pasqyrave financiare (8 pyetje)

- Në dijeninë tuaj, cilët nga të mëposhtmit janë përdorues të pasqyrave financiare të hartuara nga shoqëria juaj dhe si do t'i konsideronit ju këta përdorues të PF për nga frekuenca?

**Kësaj pyetje i janë përgjigjur 118 të anketuar.*

	Të shpeshtë	Ndonjëherë	Të rrallë	Asnjëherë
Agjencitë e akreditimit	0	0	0	118
Agjencitë e ndryshme rregullatore	0	19	64	35
Akademikët dhe kërkuesit shkencor	0	0	34	84
Aksionerët aktualë dhe potencialë	4	48	61	5
Analistët dhe konsulentët financiarë	0	31	70	18
Bankat dhe institucionet e tjera të kreditit	109	9	0	0
Furnitorët	0	0	8	110
Gazetarët	0	0	0	118
Inspektorët e tatim taksave	118	0	0	0
Investitorët privat	0	50	66	2
Klientët	0	0	0	118
Konkurentët	0	0	73	45
Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë	99	19	0	0
Shoqëritë e lisingut	118	0	0	0
Shoqëritë e sigurimeve	0	0	68	50
Sindikatat	0	0	0	118
Të punësuarit në shoqëri	0	0	0	118
Zyrat ligjore të avokatisë	0	0	61	57

- Cili është seti i parimeve dhe rregullave ndaj të cilit jeni më të kujdesshëm dhe të mirëinformuar pra cila është kultura e raportimit financiar brenda njësisë ekonomike

Legjislacioni fiskal	Standardet e kontabilitetit	Interesat ekonomike të pronarëve	Totali
81	41	10	132

- Si pjesë e drejtimit të shoqërisë, në dijeninë tuaj, sa mbështeten pronarët jo menaxherë në pasqyrat që ju përgatisni për të marrë vendimet në lidhje me biznesin e tyre? (Shkalla Likert)

Absolutisht po	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Absolutisht jo	Totali
4	11	23	56	35	129

- Në njësinë ku ju ndërtoni pasqyra financiare, a mbështetet kontrolli i brendshëm dhe kontabiliteti i kostos në raportet financiare që ju përgatisni

PO	JO	Totali
48	83	131

5. Sa të informuar janë pronarët jo menaxherë për setin e parimeve që ju zbatoni në hartimin e pasqyrave financiare

Shumë	Mjaftueshëm	Pak	Aspak	Totali
	12	24	80	116

6. Sa të mirëinformuar janë përfaqësuesit e administratës tatimore mbi kërkesat e standardeve të kontabilitetit?

Shumë të informuar	Kënaqshëm	Dobët	Totali
16	49	63	128

7. Sa të interesuar janë ata të kontrollojnë, krahas përlllogaritjes së detyrimeve tatimore, edhe zbatueshmërinë e SKK-ve?

Shumë	Mjaftueshëm	Pak	Aspak	Totali
3	9	38	82	132

8. Në rastin e institucioneve të kreditimit, a kërkojnë ata informacione të tjera shtesë përveç pasqyrave financiare?

Gjithmonë	Ndonjëherë	Asnjëherë	Totali
98	6		104

Seksioni V

Të dhëna mbi gadishmërinë e përgatitësve të pasqyrave financiare për të kaluar drejt SNRF për NVM (6 pyetje)

1. A keni dëgjuar për Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF për NVM)

PO	JO	Totali
92	24	116

2. Nëse PO a do të ishte i gatshëm, referuar përgatitjes profesionale, të ndryshonit regjimin e raportimit financiar që ju zbatoni në njësinë ekonomike

PO	JO	Totali
14	78	92

3. Nëse e njihni SNRF për NVM, përse mendoni se është një opsion më i mirë për njësinë ekonomike

Më i thjeshtë	Rrit cilësinë e PF	E kërkojnë pronarët	E kërkojnë investitorët	Synoni financime ndërkombëtare	Synoni të jeni njësi e madhe	Totali
13	5		7	1	4	29

4. Është i gatshëm pronari i njësisë ekonomike të investojë për kualifikimin tuaj në drejtim të SNRF për NVM dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e këtij standardi ndërkombëtar në njësinë ekonomike

PO	JO	Totali
5	49	54

5. Sa i vlerësoni investimet e nevojshme si kosto fillestare të njësisë për të adoptuar SNRF për NVM (në mijë lekë)

deri në 200	200 – 400	mbi 400	Totali
21	67	5	93

6. Sa i vlerësoni kostot vjetore të shtuara (në mijë lek)

deri në 50	50-200	mbi 200	Totali
37	52	4	93

**ANEKS 9 – Matrica Krahasese mes SKK 1 dhe SNRF për NVM
(seksioni 2, 10 dhe 32)**

SKK1 “Kuatridhëmb për përgatitjen e pasqyrave financiare”	SNRF PËR NVM (seksionet 2, 10 dhe 32)	KOMENTE
1. 1. Objektivi i Standardit Aktual Kombëtar të Kontabilitetit 1,	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
2. SKK 1 bazohet në kuadrin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.....	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
3. Pasqyrat financiare do të përgatiten	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
4. Kërkesat e SKK 1, “Parime të përgjithshme për përgatitjen	2.1 Ky seksion përshkruan objektivin e pasqyrave.....	Nuk ka ndryshim
5. Objektivi i pasqyrave financiare është	2.2 Objektivi i pasqyrave financiare të një njësie të vogël	Dallimi i rëndësishëm
S’ka	2.3 Pasqyrat financiare gjithashtu tregojnë rezultatet e.....	Kërkon ndryshim
6. Pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar,	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
7. Paraqitja e vërtetë dhe e besueshme nënkupton që.....	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
8. Zbatimi me korrektësi i të gjitha Standardeve	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
	2.15 Pozicioni financiar i një njësie ekonomike është marrëdhënia e aktiveve të saj, pasiveve	Ky është një paragraf i rëndësishëm për përcaktimin konceptit të “pozicionit financiar” të një njësie ekonomike por zgjidhet në SKK 2
	2.16 Disa zëra që plotësojnë përkufizimin e një aktivi	Zgjidhet në SKK 2
	2.23 Performanca është marrëdhënia e të ardhurave	Zgjidhet në SKK 2
	2.24 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve	Theksim i domosdoshëm
9. Aktivët, pasivët, kapitali, të ardhurat, shpenzimet dhe fitimi të paraqitura	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
10. Aktivi është një objekt ose e drejtë ekonomike e	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
11. Njësia ekonomike raportuese mund të marrë përfitime	2.17 Përfitimi i ardhshëm ekonomik i një aktivi është potenciali i tij për.....	Nuk ka ndryshim
12. Shumë aktive të tilla, si aktivët afatgjatë materiale, kanë përmbajtje fizike.	2.18 Shumë aktive, për shembull, aktivët afatgjatë materiale, kanë përmbajtje fizike.	Nuk ka ndryshim
13. Bazë për raportimin e aktiveve në bilanc është ekzistenca e	2.19 Në përcaktimin e ekzistencës së një aktivi, e drejta	Nuk ka ndryshim
14. Një aspekt me rëndësi të madhe në përcaktimin e	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
15. Mundësia për të gjeneruar përfitime ekonomike, zakonisht nënkupton	S’ka	Nuk kërkon ndryshim

SKK1 “Kuatridri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”	SNRF PËR NVM (seksionet 2, 10 dhe 32)	KOMENTE
16. Aktiv i regjistruhet në bilancin e njësisë ekonomike raportuese,	2.37 Një njësi ekonomike do të njohë një aktiv në pasqyrën e.....	Nuk ka ndryshim
17. Vetëm ato aktive, kostoja e të cilëve mund të përcaktohet me besueshmëri, njihen në bilanc.	2.38 Një njësi ekonomike nuk do të njohë një aktiv të kushtëzuar si një aktiv....	Nuk ka ndryshim
18. Pasivi është një detyrim aktual i njësisë ekonomike raportuese.....	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
19. Pasivi njihet në bilanc, nëse njësisë ekonomike raportuese,	2.21 Shlyerja e një detyrimi aktual zakonisht përfshin,	Nuk ka ndryshim
20. Shumë nga pasivet vijnë nga marrëveshjet ligjore (të ashtuquajtura “.....	2.20 Një karakteristikë thelbësore e një pasivi është që njësia	Nuk ka ndryshim
21. Në bilanc njihen vetëm pasivet, shlyerja e të cilave mund të	2.39 Një njësi ekonomike do të njohë një pasiv	Nuk ka ndryshim
	2.40 Një detyrim i kushtëzuar është ose një detyrim	Këto çështje mbulohen hollësisht në SKK 6.
22. Kapitali i vet (ose “aktivet neto”) është	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
23. Kapitali përfaqëson vlerën e aktiveve neto që u përkasin zotëruesve të	2.22 Kapitali është mbetja e aktiveve të njohura minus.....	Nuk ka ndryshim
24. Aktivet, pasivet dhe kapitali i njësisë ekonomike raportuese paraqiten në	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
25. Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
	2.25 Përkufizimi i të ardhurave përfshin si të ardhurat dhe fitimet. (a) Të ardhurat janë të ardhurat	Ndryshim i rëndësishëm por që nuk cënon llogaritjen e fitimit për investitorët e njësisë ekonomike
	2.41 Njohja e të ardhurave rezulton direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe pasiveve.	Ndryshim i rëndësishëm në kuadër të përafrimit të terminologjisë dhe paraqitjes
26. Shpenzimet janë flukse dalëse (pakësimet)	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
	2.26 Përkufizimi i shpenzimeve përfshin humbjet si	Ndryshim i rëndësishëm në kuadër të përafrimit të terminologjisë dhe paraqitjes
	2.42 Njohja e shpenzimeve rezulton direkt nga...	Është sqaruar në SKK 2
27. Karakteristikë kryesore e të ardhurave është fakti	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
28. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
29. Të ardhurat dhe shpenzimet përfshijnë si të ardhurat.....	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
30. Njësia ekonomike raportuese nuk duhet t’i	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
31. Transaksionet e njësisë	S’ka	Nuk kërkon ndryshim

SKK1 “Kuatridi i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”	SNRF PËR NVM (seksionet 2, 10 dhe 32)	KOMENTE
ekonomike		
	2.43 Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse është	Koncepti i të ardhurave gjithëpërfshirëse mungon në SKK
32. Fitimi (humbja) është diferenca midis të ardhurave	2.44 Fitimi ose humbja është dallimi aritmetik	Mungon në SKK
33. Për shembull, një fitim (humbje) nga.....	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
	2.45. Ky SNRF nuk lejon njohjen e zërave	Ky paragraf është i vlefshëm për të sqaruar se elementet e pasqyrave financiare nuk mund të njihen derisa ato të plotësojnë përkufizimet e përcaktuara në këtë standard.
34. Neni 10 i Ligjit të Kontabilitetit Nr. 9228 përcakton	2.35 Kërkesat për njohjen dhe matjen e aktiveve,	Nuk ka ndryshim
35. Me qëllim që të përmbushin objektivat	2.36 Një njësi ekonomike duhet	Nuk ka ndryshim
36. Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
37. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
38. Njësia ekonomike raportuese mban	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
39. Vetëm aktivet, pasivet, kapitali, të ardhurat,	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
40. Pasqyrat financiare përgatiten sipas	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
41. Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare,	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
	2.27 Njohja është procesi i përfshirjes në	Saktësim i rëndësishëm
	2.28 Pamundësia për të njohur një zë që	Saktësim i rëndësishëm
	2.29 Koncepti i probabilitetit përdoret ...	Jo dallim thelbësor, më shumë sqarues
	2.30 Kriteri i dytë për njohjen e një zëri ...	Jo dallim thelbësor, më shumë sqarues
	2.31 Një zë që nuk arrin të përmbushë kriteret	Jo dallim thelbësor, më shumë sqarues
	2.32 Një zë që nuk arrin të përmbushë kriteret	Trajtohet më hollësisht në SKK 13 kur konsiderohen aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara.
54. Karakteristika kryesore e të ardhurave është	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
55. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë si të	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
56. Transaksionet me aksionet e veta	S’ka	Nuk kërkon ndryshim

SKK1 “Kuatridi i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”	SNRF PËR NVM (seksionet 2, 10 dhe 32)	KOMENTE
57. Matja është procesi i përcaktimit të	2.33 Matja është procesi i përcaktimit të	Jo dallim thelbësor, më shumë sqarues
58. Dy bazat e zakonshme të matjes janë me kosto	2.34 Dy bazat e zakonshme të matjes janë me	Nuk ka ndryshim
59. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit mund	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
60. Në njohjen fillestare, një njësi ekonomike do	2.46 Në njohjen fillestare, një njësi ekonomike do të	Nuk ka ndryshim
61. Një njësi ekonomike mat aktivet financiare	2.47 Një njësi ekonomike mat aktivet financiare dhe	Në SKK 3 mungon koncepti i vlerësimit me vlerë të drejtë
	2.48 Në përgjithësi, një njësi ekonomike mat të	Nuk sjell ndryshim
62. Shumica e aktiveve jo-financiare të një njësie	2.49 Shumica e aktiveve jo-financiare të një njësie	Përcakton kuadrin për bazat e matjes të cilat detajohen gjatë SKK-ve të tjerë
	2.50 Për llojet e mëposhtme të aktiveve jo-financiare,	Krijon përplasje mes SKK-ve me njëra tjetrën
63. Shumica e detyrimeve përveç detyrimeve	2.51 Shumica e detyrimeve përveç detyrimeve	Nuk ka ndryshim
42. Aktivet e pasivët dhe të ardhurat e shpenzimet	2.52 Një njësi ekonomike nuk do të kompensojë aktivet	Nuk ka ndryshim
43. Është e rëndësishme që aktivet dhe pasivët,	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
44. Karakteristikat cilësore janë ato që e bëjnë	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
45. Informacioni në pasqyrat financiare duhet të	2. Informacioni në pasqyrat financiare duhet të	Ndryshime jothelbësore krahasuar me SKK 1
46. Pasqyrat financiare përgatiten për	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
47. Nëse një informacion i të njëjtit transaksion	S’ka	Ndryshime të vogla vetëm në terminologji
48. Pasqyrat financiare paraqesin të gjithë	2.5 Informacioni i dhënë në pasqyrat financiare	Ndryshime të vogla vetëm në terminologji
49. Në përgatitjen e pasqyrave financiare	S’ka	Ndryshime të vogla vetëm në terminologji
50. Në përcaktimin e materialitetit duhet	2.6 Informacioni është material dhe për këtë	Nuk ka ndryshim
51. Manipulimi i qëllimshëm i shumave jomateriale,	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
52. Për kontabilizimin dhe raportimin e	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
53. Informacioni, në lidhje me zërat dhe	S’ka	Ndryshim i vogël në terminologji
54. Në bazë të konceptit të materialitetit dhe	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
55. Për të qenë i dobishëm, informacioni duhet	2.7 Informacioni i dhënë në pasqyrat financiare	Ndryshim i vogël në formulim
56. Që të jetë i besueshëm informacioni,	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
57. Për regjistrimin e transaksioneve	2.8 Transaksionet dhe ngjarjet dhe kushtet e tjera	Nuk ka ndryshim
58. Për regjistrimin e	S’ka	Nuk kërkon ndryshim

SKK1 “Kuatridi i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”	SNRF PËR NVM (seksionet 2, 10 dhe 32)	KOMENTE
transaksioneve të		
59. Që të jetë i besueshëm informacioni i	S'ka	Nuk kërkon ndryshim
60. Pasqyrat financiare duhet të përgatiten me	2.9 Pasiguritë që në mënyrë të paevitueshme rrethojnë	Ndryshime të formës jo të përmbajtjes
61. Në vlerësimet kontabël, drejtuesit e njësisë	S'ka	Nuk kërkon ndryshim
62. Pasqyrat financiare duhet ta japin të gjithë	2.10 Të jetë i besueshëm, informacioni në	Nuk ka ndryshim
63. Në pasqyrat financiare paraqitet një vështrim i	S'ka	Nuk kërkon ndryshim
64. Për përgatitjen e pasqyrave financiare	2.11 Përdoruesit duhet të jenë në gjendje të	Nuk ka ndryshim
65. Qëndrueshmëria në politikat kontabël,	S'ka	Nuk kërkon ndryshim
66. Ndryshimet në politikat kontabël shpjegohen	S'ka	Nuk kërkon ndryshim
67. Paraqitja e informacionit (përfshirë këtu	S'ka	Formati i paraqitjes duhet ndryshuar për të reflektuar Direktivën e BE
68. Informacioni krahasues për periudhën	S'ka	Nuk kërkon ndryshim
69. Kur paraqitja e informacionit ndryshon, ...	S'ka	Nuk kërkon ndryshim
	2.12 Që të jenë të përshtatshme, informatat financiare duhet	Saktësim i nevojshëm
	2.13 Përfitimet që rrjedhin nga informacioni duhet të	Saktësim i nevojshëm
	2.14 Informacioni raportues financiar ndihmon	Saktësim i nevojshëm
	10.2 Politikat kontabël janë parimet specifike,	Përkufizim i rëndësishëm
70. Në përputhje me Standardet Kombëtare	S'ka	Nuk kërkon ndryshim
71. Përdorimi i politikave të papërshtatshme të	S'ka	Nuk kërkon ndryshim
	10.3 Nëse në mënyrë specifike ky SNRF adreson një	Saktësim i nevojshëm
72. Në rastet kur Standardet Kombëtare të	S'ka	Nuk kërkon ndryshim
73. Në rastet kur Standardet Kombëtare	S'ka	Nuk kërkon ndryshim
	10.4 Nëse në mënyrë specifike ky SNRF nuk adreson një transaksion,	Saktësim i nevojshëm
	10. 5 Në kryerjen e gjykimit të përshkruar në paragrafin 10.4, drejtimi do ti referohet,	Jo vlerë e shtuar
74. Nëse në disa fusha specifike mungojnë politikat kontabël, si në	10.6 Në kryerjen e gjykimit të përshkruar në paragrafin 10.4,	Nënkuptohet në paragrafë të tjerë
	10.7 Një njësi ekonomike do të zgjedhë dhe zbatojë	Jo dallim thelbësor
75. Pasi përzgjidhet një politikë kontabël,	10.8 / 10.9 Një njësi ekonomike do të ndryshojë	Nuk ka ndryshim

SKK1 “Kuatdri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”	SNRF PËR NVM (seksionet 2, 10 dhe 32)	KOMENTE
	10.10 Nëse ky SNRF lejon një zgjedhje të	Jo dallim thelbësor
76. Një ndryshim në politikat kontabël do të zbatohet	10.11 Një njësi ekonomike do të marrë në konsideratë	Nuk ka ndryshim
	10.12 Kur në politikën kontabël zbatohet	Jo dallim thelbësor
77. Ndryshimi në politikat kontabël zakonisht	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
78. SKK të caktuara mund të lejojnë zbatimin e një	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
79. Kur është praktikisht e pamundur të përcaktohen	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
80. Disa të dhëna financiare, të paraqitura në	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
81. Vlerësimet realiste luajnë një rol të rëndësishëm	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
82. Ndonëse pritët që disa vlerësime kontabël	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
	10.15 Një ndryshim në vlerësimin kontabël	Saktësim i nevojshëm
83. Ndryshimet në vlerësimet kontabël do të njihen	10.16 Një njësi ekonomike duhet të njohë efektin e	Nuk ka ndryshim
	10.17 Deri në masën që një ndryshim në një	Jo dallim thelbësor
84. Në rrethana të caktuara mund të jetë e vështirë	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
85. Gabimet janë mosraportime ose	10.19 Gabimet e periudhave të mëparshme janë	Nuk ka ndryshim
86. Për shembull, një gabim mund të shkatohet	10.20 Gabime të tilla përfshijnë efektet e	Ndryshime në formulim
87. Gabimet ndryshojnë nga ndryshimet në	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
88. Gabimet materiale të periudhave kontabël të	10.21 Për aq sa është e praktikueshme, njësia	Kërkesa e SKK më e detajuar se e SNRF për NVM
89. Gabimet jomateriale duhet të	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
90. Kur gabimet materiale të periudhave kontabël të	10.22 Në rastet kur është i pazbatueshëm	Nuk ka ndryshim
91. Nëse efekti i një gabimi material mbi	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
92. Kontabilizimi i ngjarjeve që ndodhin pas datës	32.2 Ngjarjet pas përfundimit të periudhës së raportimit	Nuk ka ndryshim
	32.3 Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese	Saktësim
93. Ngjarja pas datës së bilancit, për të cilën	32.4 Një njësi ekonomike duhet të rregullojë	Nuk ka ndryshim
94. Shembull i një ngjarjeje rregulluese është shitja	32.5 Në vijim janë shembuj të ngjarjeve rregulluese	Nuk ka ndryshim
95. Ngjarjet, për të cilat nuk bëhen rregullime, janë	32.6 Njësi ekonomike nuk do të korrigjojë shumat e	Ndryshime në formulim
96. Një ngjarje, për të cilën nuk bëhen rregullime,	32.7 Shembuj të ngjarjeve për të cilat nuk bëhen	Ndryshime në formulim
	Dividendët	Saktësim i nevojshëm
	32.8 Nëse një njësi ekonomike	

SKK1 “Kuatridi i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”	SNRF PËR NVM (seksionet 2, 10 dhe 32)	KOMENTE
	deklaron	
	32. Një njësi ekonomike duhet të njoftojë datën e	Saktësim
	32.10 Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet	Saktësim që komplikon së tepërmi zbatimin e standardit
97. Njësia ekonomike raportuese duhet të paraqesë	10.13 Në rastet kur një ndryshim i këtij SNRF-je	Ndryshim i rëndësishëm
	10.14 Në rastet kur një ndryshim i vullnetshëm	Lidhet me paragrafin më sipër
98. Nëse mënyra e paraqitjes së politikave kontabël	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
99. Në ato raste kur, për hir të një paraqitje sa më të	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
	10.18 Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese	Shpjegim i rëndësishëm
100. Në ato raste, kur zbulohen gabime materiale nga ushtrime	10.23 Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në lidhje.....	Dallimet të rëndësishme
101. Në shënimet shpjeguese duhet të përshkruhen	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
	32.10 Njësia ekonomike duhet të japë informacionet e	Mungon në SKK 1, dallim i rëndësishëm
102. Nëse ka pasiguri, në lidhje me vazhdimësinë	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
103. Ky Standard do të zbatohet në pasqyrat	S’ka	Nuk kërkon ndryshim
104. Tabela tregon se si korrespondojnë	S’ka	Nuk kërkon ndryshim

ANEKS 10 – Llogaritjet e pyetësorit për seksionin e III të pyetjeve

Nr	Pyetja	GJITHSEJ		Kontabilist i Miratuar		Auditus		Ekonomistë	
		Saktë	Reagime	%	Saktë	Reagime	%	Saktë	Reagime
1	1	75	96	78%	18	24	75%	3	4
2	5	129	137	94%	26	29	90%	22	25
3	17	56	91	62%	10	17	59%	1	3
4	27	47	63	75%	9	13	69%	1	1
5	31	96	134	72%	20	26	77%	14	25
6	32	51	82	62%	9	17	53%	3	6
7	33	69	84	82%	12	18	67%	5	8
				74.92%			69.89%		66.40%

Nr	Pyetja	GJITHSEJ		Kontabilist i Miratuar		Auditus		Ekonomistë	
		Saktë	Reagime	%	Saktë	Reagime	%	Saktë	Reagime
1	2	0	96	0%	0	23	0%	0	3
2	7	28	135	21%	6	29	21%	18	83
3	8	41	129	32%	6	27	22%	29	83
4	10	34	133	26%	9	28	32%	25	82
5	11	63	135	47%	11	28	39%	41	83
6	12	38	136	28%	9	29	31%	29	83
7	14	44	131	34%	9	27	33%	29	79
8	18	31	122	25%	4	22	18%	21	83
9	19	42	119	35%	8	22	36%	31	83
10	20	29	99	29%	4	16	25%	25	82
11	25	31	85	36%	9	20	45%	22	63
12	30	11	131	8%	2	28	7%	9	98
				26.76%			25.87%		28.78%
									14.63%

Nr	Pyetja	GJITHSEJ		Kontabilist i Miratuar		Auditus		Ekonomistë	
		Saktë	Reagime	%	Saktë	Reagime	%	Saktë	Reagime
1	3	48	72	67%	8	12	67%	40	57
2	4	83	121	69%	16	24	67%	60	83
3	6	116	132	88%	24	27	89%	76	82
4	9	44	131	34%	5	26	19%	39	83
5	13	72	134	54%	13	26	50%	59	83
6	15	43	96	45%	10	22	45%	32	66
7	16	48	96	50%	11	21	52%	36	72
8	21	26	52	50%	5	9	56%	21	43
9	22	14	32	44%	3	7	43%	10	22
10	23	41	65	63%	8	16	50%	33	48
11	24	21	65	32%	5	13	38%	15	49
12	26	13	41	32%	2	8	25%	10	31
13	28	21	33	64%	4	7	57%	17	26
14	29	24	33	73%	3	5	60%	20	26
15	34	56	87	64%	12	19	63%	43	64
16	35	21	36	58%	2	7	29%	19	29
17	36	17	39	44%	2	6	33%	15	33
18	37	29	33	88%	1	4	25%	28	29
				56.48%			48.24%		60.81%
									19.84%

BIBLIOGRAFIA

- Aras, G. and Crowther, D. (2008). Developing sustainable reporting standards. *Journal of Applied Accounting Research*. 9 (1). 4-16.
- Armstrong, C.S., Barth, M.E., Jagolinzer A.D. and Riedl E.J. (2008). Market Reaction to the Adoption of IFRS in Europe. Harvard Business School Working Papers. Accessed from: <<http://www.hbs.edu/research/pdf/09-032.pdf>>
- Bannock, G. (1981). *The Economics of Small Firms: Return from the Wilderness*. UK: WileyBlackwell.
- Bhimani, A. (2008). The role of a crisis in reshaping the role of accounting. *Journal of Accounting and Public Policy*. 27 (6). 444-454.
- BFN's reply to IASB's questionnaire. (2010, March). Available at <<http://archive.iasb.org.uk/docs/pv-NVM/NVMs-CL55.pdf>>
- Bryman, A. and Bell, E. (2007). "Business Research Methods." 2nd edition. New York, USA: Oxford University Press 2007.
- Carmona, S., and Trombetta, M. (2008). On the global acceptance of IAS/IFRS accounting standards: The logic and implications of the principles-based system. *Journal of Accounting & Public Policy*. 27 (6). 455-461.
- Chorafas, D. (2006). *International Financial Reporting Standards Fair Value and Corporate Governance*. First Edition. Burlington: Elsevier Ltd. 74
- Collis, J., Jarvis, R. and Skerratt, L. (2001). Size and the value of the audit. *Accounting & Business*. 4 (10). 41-42.
- Diener, E., and Grandall, R. (1978). *Ethics in social and behavioral research*. Chicago: University of Chicago Press.
- Elena, H., Catalina, M.C., Stefana, C.I. and Niculina, A.A. (2009). Some Issues About The Transition From U.S. Generally Accepted Accounting Principles (GAAP) To International Financial Reporting Standards (IFRS). *Annales Universitatis Apulensis Series Oeconomica*. 1 (11).
- Elliott, B. and Elliott, J. (2002). *Financial Accounting, Reporting and Analysis*. International Edition. England: Pearson Education.
- Epstein, B.J. and Jermakowicz, E.K. (2010). *Wiley IFRS 2010: Interpretation and Application of International Accounting and Financial Reporting Standards 2010*. New Jersey: John Wiley & Sons, Inc.

- Erixon, F. (2009). NVMs in Europe: taking stock and looking forward. Centre for European Studies. 8. 293-300. (DOI 10.1007/s12290-009-0093-7).
- European Commission. (2009). Commission Staff working document on the implementation of Commission Recommendation of 6 May 2003 concerning the definition of micro, small and medium-sized enterprises. Brussels: European Commission.
- European Commission. (2008). Putting small businesses first: Europe is good for NVMs, NVMs are good for Europe. [Booklet]. European Commission.
- European Commission. (2005). New NVM definition user guide and model declaration. EC Enterprise and Industry Publications.
- Fitzpatrick, M. and Frank, F. (2009). IFRS for NVMs: The Next Standard for U.S. Private Companies? *Journal of Accountancy*. 208 (6). 50-54.
- Gray, I. and Manson, S. (2008). *The Audit Process: Principles, Practices and Cases*. 4th Edition. London: Thomson Learning.
- Ghuri P. and Gronhaug K (2005). *Research methods in business studies: a practical guide*. 3rd Edition. New Jersey: Prentice Hall.
- Guba E.G. & Lincoln Y.S. (1994). Competing paradigms in qualitative research. In N. K. Denzin & Y. S. Lincoln (Eds.), *Handbook of qualitative research* (pp. 105-117). London: Sage. 75
- Harvey, D. and Walton, P. (1996). *Differential Reporting - An Analysis* (NVM Foundation). London: The Foundation for Manufacturing and Industry.
- Hillary, R. (2000). *Small and Medium-Sized Enterprises and the Environment*. UK: Greenleaf Publishing Limited.
- Holmes, S., Kent, P. and Downey G. (1991). The Australian differential debate: A survey of practitioners. *Accounting and Business Research*. 21(82). 125-132.
- IASB. (2010). Who we are and what we do. International Accounting Standards Board (IASB) and IASC Foundation (January 2010).
- IASC Foundation Education. (2009). *Training Material for the IFRS for NVMs*. London: IASC Foundation Publications Department.
- International Accounting Standards Board. (2009). *International Financial Reporting Standards (IFRS) for Small and Medium-sized Entities (NVMs) by International Accounting Standards Board (IASB)*. London: IASB.
- International Accounting Standards Board. (2009). *Basis for Conclusions: IFRS for NVMs*. (2009). [Booklet]. London: IASB.

International Accounting Standards Board. (2009). International Financial Reporting Standards (IFRS) for Small and Medium-sized Entities (NVMs) by International Accounting Standards Board (IASB). London: IASB.

International Accounting Standards Board (IASB). (2010, March). Available from:

<<http://www.iasb.org/Current+Projects/IASB+Projects/Small+and+Medium-sized+Entities/Small+and+Medium-sized+Entities.htm>>

Jaruga, A. and Fijatowska, J. (2004). Small and medium-sized enterprises in Poland - the case of accounting regulations. Unpublished research paper.

Jarvis, R. (2003). Financial Reporting: IFRS and NVMs – A question of definition. *Accountancy*. 132 (1323). 80.

Jarvis, R. and Collis, J. (2003). IFRSs and Differential Reporting. British Accounting Association Annual Conference of the South Eastern Accounting Group. 1-15.

John, B. and S. Heales. (2000). Financial reporting Standard for small entities: a fundamental or coNVMtic change? ACCA Occasional Research Paper No. 30. Available via: 76

http://www.accaglobal.com/general/activities/research/reports/smallbusiness_research/op-030 [Retrieved March 29th, 2010]

Kekäle, T., De Weerd-Nederhof, P., and Cervai, S., Borelli, M. (2009). "The "dos and don'ts" of writing a journal article". *Journal of workplace learning*, 21 (1), 71-80.

Kent R.A. (2007). *Marketing research: approaches, methods and applications in Europe*. USA: Thomson Learning.

Kotler P. and Lee N. (2005). *Corporate Social Responsibility Doing The Most Good For Your Company And Your Cause*. New Jersey: John Wiley & Sons, Inc.

Lincoln, Y., and Guba, E. (1985). *Naturalistic inquiry*. New York: Sage.

Lippitt, J. & Oliver, B. (1983). Big GAAP, Little GAAP: Financial Reporting in the small business environment. *Journal of Small Business Management*.

Lungu, C. Caraiani, C. & Dascalu, C. (2007). *New Directions of Financial Reporting within Global Accounting Standards for Small and Medium-Sized Entities*.

Media Center: International Federation of Accountants (IFAC). (2010, March). Available from

<<http://www.ifac.org/MediaCenter/?q=node/view/658>>

Mirza, A. Holt, G. and Orrell M. (2008). *IFRS Practical Implementation Guide and Workbook*. 2nd Edition. New Jersey: John Wiley & Sons, Inc.

- Munter, P.H., Anderson, S.R. and Mellentine, J. (2009). Issues In-Depth: A Closer Look at IFRS for NVMs. KPMG Department of Professional Practice. 09 (2). 1-17.
- Neag, R., Masca, E., & Pascan, I. (2009). Actual Aspects Regarding The IFRS For NVM – Opinions, Debates and Future Developments. *Annales Universitatis Apulensis Series Oeconomica*, Faculty of Sciences. 1(11).
- Nelson, M.W. (2003). Behavioral evidence on the effects of principles- and rules-based standards (commentary). *Accounting Horizons*. 17. 91–104.
- Nicoleta, P.D., Victoria, B., Mariana, F. (2009). Standards, Rules or Principles based accounting regulation. *Journal of Faculty of Economics*, III, 1125-1131.
- Organization for Economic Co-operation and Development (OECD). (2006). *The NVM Financing Gap (Vol. 1): Theory and Evidence*. France: OECD Publishing.
- Pacter, P. Standards and NVMs: who, what, when and why? *Accounting & business WCOA special edition*. 31-33.
- Pacter, P. 2004. Will the GAAP widen for NVMs? *Institute of Chartered Accountants in England & Wales, Accountancy*. 133(1325). 118-122. 77
- Paoloni, M., Demartini, P., Moneva, J.M. and Cuellar, B. (1999). Financial reporting by NVMs in Italy and Spain. Paper presented at the annual congress of the European Accounting Association, Bordeaux, France.
- Riistama V. and Vehmmanen P. (2004). Globally applicable conceptual framework for small and medium-sized entities, in Evans L. and di Pietra R. (2005). Comment on the IASB discussion paper: preliminary views on accounting standards for small and medium-sized entities.
- Rundfelt, R. 2007. Accounting Standards for unlisted entities: Do we need special accounting standards for unlisted entities and, if so, what should they look like?
- Scott, M. and Bruce, R. (1987). Five stages of growth in small business. *Long Range Planning*. 20 (3). 45-52
- Shortridge, R.T. and Myring, M. (2004). Defining Principles-Based Accounting Standards. *The CPA Journal Online*.
<<http://www.nysscpa.org/cpajournal/2004/804/essentials/p34.htm>>
- Sleigh-Johnson, N., & Shearer, B. (2009). Shortened IFRS, Intended for Smaller Companies, Could Work As Well for Larger Entities. *Journal of Aountancy*. 144 (1395), p 64-65.
- Street, D. and Jr. Needles, B. (2009). IFRS: Don't Get Caught Short. *Journal of Accountancy*. 207 (5). 56-57.

- Taylor, D.W. (2009). Costs-benefits of adoption of IFRSs in countries with different harmonization histories. *Asian Review of Accounting*. 17 (1). 40-58
- Tudor, A.T. and Mutiu, A. (2008). Pro And Contra Opinions Regarding A NVM Accounting Standard. *Annales Universitatis Apulensis Series Oeconomica*, Faculty of Sciences. 1(10). 1-4.
- Tyrrall, D., Woodward, D. and Rakhimbekova, A. (2007). The relevance of International Financial Reporting Standards to a developing country: Evidence from Kazakhstan. *The International Journal of Accounting*. 42 (1). 82-110.
- Wittsiepe, R. (2008). *IFRS for Small and Medium-sized Enterprises: Structuring the Transition Process*. 1st Edition. Wiesbaden: Betriebswirtschaftlicher Verlag.